

REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Fuqia e Besnikërisë

GARY KEESEE

REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Fuqia e Besnikërisë

GARY KEESEE

Your Financial Revolution
The Power of Allegiance. Albanian. By Gary Keesee
Copyright © 2023 by Gary Keesee

Originally printed In English
ISBN: 978-0-9729035-9-2
Faith Life Now
P.O. Box 779
New Albany, OH 43054, USA

This book is a free gift from the author and is NOT FOR SALE

You can reach Faith Life Now Ministries on the Internet at
FaithLifeNow.com

More resources by the same author are available for free download at
FLNFree.com

Revolucioni Yt Financiar
Fuqia e Besnikërisë. Shqip. Nga Gary Keesee
E drejta e autorit © 2023 nga Gary Keesee

Botuar nga origjinali në Anglisht
ISBN: 978-0-9729035-9-2
Faith Life Now
P.O. Box 779
New Albany, OH 43054, USA

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta e autorit

© 2009 Shoqëria Biblike Shqiptare. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje. Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

Ky libër është një dhuratë nga autori dhe NUK ËSHTË PËR SHITJE

Mund të gesh shërbesat e Faith Life Now në internet në
FaithLifeNow.com

Më shumë burime nga i njëjti autor gjenden falas për shkarkim në
FLNFree.com

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
HYRJE.....	7
KAPITULLI 1: Mbretëria.....	19
KAPITULLI 2: Mjegullim i Kaltër.....	57
KAPITULLI 3: Të lutem Perëndi, Ki Mëshirë!.....	65
KAPITULLI 4: Peshku Gjigant.....	93
KAPITULLI 5: Zgjedhja e Kujt Ishte?.....	103
KAPITULLI 6: Bekimi i Zotit.....	137
KAPITULLI 7: Dera.....	155
KAPITULLI 8: Fuqia e Besnikërisë.....	165
KAPITULLI 9: Ushqejini Ju!.....	175
KAPITULLI 10: Grumbulloni pa u shqetësuar!.....	189
KAPITULLI 11: Fluturimi Është Më i Lehtë Se Ecja!.....	195

PARATHËNIE

Kam dashur të hedh në letër udhëtimin në të cilin prej vitesh Perëndia na udhëhoqi mua dhe Drendën. Jetët tona kanë ndryshuar kaq shumë! Ne kemi parë të gjitha mrekullitë që Jezusi bëri në Bibël të ndodhnin para syve tanë përgjatë viteve: të vdekurit të ringjallen; të paralizuarit të ngrihen, të ecin dhe të kthehen në punë të nesërmen; njerëz të panumërt të shëruar; dhe financa të restauruara për qindra mijëra njerëz. Por mrekullia më e madhe që kemi parë ndodhi në familjen tonë dhe në jetën tonë personale.

Qëllimi im është t'ju marr në një udhëtim, një udhëtim zbulimi që shpresoj se do të ndryshojë jetën tuaj ashtu siç ndodhi me jetën time. Historia nuk mund të tregohet në një libër. Ky është libri i parë i një serie librash që do t'ju çojë drejt revolucionit tuaj financiar dhe do të fillojë të zbulojë misteret e Mbretërisë së Perëndisë që ndryshuan jetën time. Për mua, ky është një udhëtim emocionues, që nuk do të përfundojë kurrë. Ne do të vazhdojmë të mësojmë! Njohja e Mbretërisë është e pashtershme.

I jam shumë mirënjohës Perëndisë. Mëshirat e tij janë të reja çdo ditë, dhe Ai është i duruar dhe falës, ndërsa na drejton neve në rrugën e shpëtimit. Unë nuk mund t'ju marr në këtë udhëtim pa përmendur së pari gruan time të mrekullueshme, Drenda. Ishte zemra e saj për Perëndinë, dashuria dhe durimi i saj, që më dhanë kurajo për t'u përballur me dobësitë e mia dhe t'i kërkoja Perëndisë përgjigjet për të cilat kisha dëshpërimisht shumë nevojë. Me gëzim të jashtëzakonshëm po ndaj me ju:

Revolucioni Yt Financiar
Fuqia e Besnikërisë



HYRJE

Ke larguar shpirtin tim nga paqja; kam harruar mirëqenien.

– Vajtimet 3:17

U zgjova duke e ditur se diçka ishte e gabuar, shumë e gabuar! Një frikë e madhe më kaploi mendjen ndërsa u zgjova. Nuk mund ta ndjeja gjuhën time. Duart e mia, këmbët dhe njëra anë e fytyrës ishin të mpira. E zgjova Drendën dhe u mundova shumë t'i tregoja se çfarë po ndodhte, ndërsa e gjithë fytyra dhe gjuha ime refuzonin të bashkëpunonin. Atëherë vura re se zemra ime po rrihte fort dhe mezi merrja frymë ndërsa i transmetoja asaj situatën time. Ajo u zgjua dhe menjëherë filloi të lutej për mua. Ngadalë, habia dhe ndjenjat e frikës u qetësuan disi. U shtriva sërish në shtrat ndërsa Drenda u ofrua të më sillte diçka për të ngrënë. Unë isha konfuz dhe i frikësuar për atë që po i ndodhte trupit tim, ndërsa qëndroja shtrirë dhe lutesha. Më mbulonin valë paniku; një frikë që nuk e kam ndjerë kurrë më parë në jetë sulmoi mendjen time. Borxhi nën të cilin kam jetuar dhe nevoja e vazhdueshme për para e bëri frikën pjesë normale të jetës sime të përditshme. Unë kam qenë nën një stres të jashtëzakonshëm gjatë viteve të fundit në lidhje me përkeqësimin e situatës sime financiare. Unë isha agent shitjesh dhe nuk po ia dilja dot financiarisht. Kishim marrë me qira një shtëpi të vogël në një fermë të viteve 1800, e cila dukej se nuk ishte restauruar kurrë që kur ishte ndërtuar. Ndoshta po e zmadhoj pak, por shtëpia nuk ishte në gjendje të mirë. Kornizat

e dritareve kishin boshllëqe në të cilat kishin mbirë bimë dhe ishin zgjatur deri në dhomën e ndenjjes. Shumë prej xhamave ishin thyer dhe ne i kishim mbyllur me shirita kartoni dhe ngjitës. Megjithëse në vështirësi, Drenda kishte mundur ta bënte atë shtëpinë tonë. Por as me aftësitë e saj mahnitëse, nuk mund ta mbulonim faktin se shtëpia kishte probleme serioze.

Gjithçka kishim ishin në të njëjtën gjendje — të prishura! Të dyja makinat tona ishin të vjetra, kishin kilometrazh mbi 330,000 km dhe mezi ndizeshin. Të dy djemtë tanë flinin mbi dyshekë që po ishin nxjerrë nga një azil, tapeti në dyshe-menë e dhomës së tyre të gjumit ishte gjetur në rrugë te mbeturinat. Dyqanet e pengjeve ishin një mënyrë jetese dhe ne huazonim nga kushdo që mendonim se mund të na ndihmonte. Jetonim duke mbijetuar çdo ditë, duke gjetur diçka për të shitur, duke kërkuar një mënyrë për të mbijetuar dhe duke shpresuar se e nesërmja do të ishte më mirë.

Të dhjetë kartat e mia të kreditit ishin anuluar muaj më parë, dhe tre kreditë e mia të institucioneve financiare, të cilat ishin me 28 përqind interes, nuk ishin shlyer. Pagesave të makinës sime (po, unë ende paguaja për makinat e mia shumë të vjetra) u kishte kaluar afati me 120 ditë dhe ishte në prag sekuestrimi. Çdo fature i kishte kaluar afati. Vendimet e gjykatave dhe bllokimi i garancive ishin ngritur kundër meje, e përmbaruesit më telefonin çdo mëngjes. Isha debitor te tatimet dhe gjithashtu më kërkonin një garanci hipotekore për taksat e prapambetura. Drenda dhe unë i detyroheshim prindërve tanë 26 000 dollarë, dhe ata ishin lodhur duke na ndihmuar. Frigoriferi ynë rrallë herë ishte plot me ushqime. Shumë herë kërcënoheshim me ndërprerjen e energjisë elektrike, madje çdo muaj. Dhe kështu kisha arritur në fund të litarit tim emocional. Tani stresi po i shkaktonte diçka që nuk e kuptoja trupit tim. Pasi takova disa mjekë, ata më thanë se kisha përjetuar një atak paniku dhe më dhanë antidepresantë.

Fatkeqësisht këto atake paniku vazhduan të shtoheshin aq sa fillova të kisha frikë edhe të dilja nga shtëpia. Gjatë këtyre ditëve të zymta frike, ndërsa kërkoja përgjigje, fillova të vija re se disa ushqime si ato me sheqer, niseshteja apo kafeina, më shkaktonin sulme paniku. Kështu që kisha frikë të haja ushqim dhe tregoja kujdes me çdo gjë

që konsumoja. Jeta ime u kthye në skllavëri, deri në atë gradë sa nuk mund të punoja, gjë që sigurisht e përkeqësoi akoma më shumë situatën financiare. Gruaja ime mendonte se po e humbiste burrin dhe pasi u shërova, më tregoi që kishte qënë duke planifikuar se çfarë do t'i duhej të bënte për t'u kujdesur për fëmijët. Unë i klitha Zotit për përgjigje pasi nuk kisha përvojë ose njohuri mbi atë me të cilën po luftoja. Mjekët kishin emra të mëdhenj për atë që nuk shkonte me mua dhe thoshin se ishte e pashërueshme e se do të merrja gjithmonë ilaçe. Mjekë të tjerë më thanë se rrezikojta të bëhesha diabetik, duke deklaruar se do të isha një rast i mirë studimi për t'u ndjekur teksa sëmundja përparonte dhe mosha avanconte. Megjithëse isha i krishter, nuk kisha asnjë eksperiencë në luftën frymërore apo se si të qëndroja kundër armikut. Në fakt, deri në këtë pikë nuk e kisha dalluar që po luftoja me një frymë demonike. Unë mendoja se kisha thjesht probleme me trupin tim dhe po i kërkoja Perëndisë të më shëronte. Si i krishterë, e dija që Perëndia ishte përgjigjja ime, por në atë kohë ndjeja sikur Perëndia ishte shumë larg meje. Doktorët më dhanë një diagnozë me emra të ndryshëm për gjendjen ku isha, gjithçka lidhej me problemet mendore dhe trajtohej vetëm duke marrë mjekime të ndryshme. Ashtu siç e thashë më sipër, nuk kishte një kurë të caktuar, thjesht ishin ilaçe që më ndihmonin të përballoja gjendjen time mendore. Kisha efekte anësore nga mjekimet e megjithatë nuk më ndihmuan fare. Në fakt, unë besoj se më shtuan simptomat të tjera. Më bënë të ndiheshja sikur po jetoja në mjegull, i torturuar vazhdimisht nga mendime plot frikë që nuk mund t'i kontrolloja. Unë nuk kisha asnjë përgjigje dhe asgjë nuk po më ndihmonte. Kjo situatë vazhdoi për disa javë dhe depresioni mu shtua ndërsa simptomat dhe frikërat kishin pushtuar jetën time.

Por një natë, pata një zbulim të madh ndërsa i kërkoja Perëndisë përgjigje. Zbulova një çelës kryesor të lirisë sime. Isha në kishën time, në shërbesën e së mërkurës në mbremje. Gjatë lavdërimit dhe adhurimit, pata një atak paniku të fortë. Nuk dija se çfarë të bëja. Ndihesha i dëshpëruar dhe e kuptova që kisha nevojë për lutje, ndaj dola përpara kishës. Edhe pse do ta ndërprisja plotësisht shërbesën, nuk e pata fare problem. Isha në një kishë të madhe dhe pastori nuk më njihte personalisht, por dikush prej anëtarëve të skuadrës së adhurimit më

njihte. Ndërsa u zvarrita deri te platforma i dëshpëruar, gjithçka ndaloi dhe të gjithë sytë u kthyen nga unë. Anëtarë i grupit të adhurimit, i cili më njëjti reagoi menjëherë kur pa oficerët e sigurisë që po ecnin drejt meje për të më ndaluar.

Ndërsa ia shpjegonte situatën time pastorit, shikoja që reagimi i pastorit po zbutej. Ai erdhi drejt meje dhe u lut për mua. Miku im i tregoi pastorit që kisha qenë i sëmurë. Pastori më vështroi dhe tha, “Ai ka një frymë dobësie.” Ndërsa tha këtë, ai shtriu duart e tij në kokën time dhe e urdhëroi atë frymë të largohej. Në atë moment, diçka e jashtëzakonshme ndodhi — u çlirova. Për herë të parë pas shumë muajsh u ndjeva normal, pa mendime torturuese, pa frikë, kisha vetëm një paqe të thellë. Të thuash se isha mirënjohës do të ishte një nënvlerësim. Të them se isha i ngazëllyer nuk do ta shpjegojë se si ndihesha. Ndihesha i trullësuar, i lehtë si pendë dhe plot gëzim.

Pas kishës, unë dhe Drenda shkuam të festonim me disa miq në një restorant picash. Ndërsa isha ulur aty duke ngrënë pica, më kujtohet që u dëgjua një këngë në radio dhe papritmas, ndjeva se e njëjta ndjenjë e neveritshme frike më mbuloi si batanije — ndodhi sërisht. Përsëri, në atë kohë e kuptova se ishte një frymë. Pastori kishte thënë se ishte një frymë dobësie, por unë nuk e dija se çfarë do të thoshte kjo në të vërtetë dhe isha pak i hutuar. Mendova se isha shëruar në shërbesë, por mesa duket jo. Ditën tjetër po luftoja me ataket e panikut sërisht, por nuk ndaloja dot së menduari për atë që ndodhi një natë më parë në kishë. Kur pastori u lut për mua, ai nuk u lut që unë të shërohesha. Ai ushtroi autoritet mbi një frymë. Fakti që gjendja ime reagoi kështu ndaj pastorit, dukej se tregonte që ndoshta ishte një frymë në vend të një sëmundjeje. (Sërisht, ju mund ta shihni se sa i papjekur isha në Krishtin ndaj nuk e kuptoja këtë.) Në atë kohë, dija shumë pak për luftën frymërore, por e dija që demonët ishin realë. E kisha parë një.

Në vitet e adoleshencës, menaxhoja njërin prej dy dyqaneve të picave që zotëronin prindërit e mi. Një natë, hyri një burrë që më tha se po mbante një takim rilindjeje në atë rrugë, në një kishë lokale metodiste. Më ftoi të shkoja dhe të merrja pjesë. Ai e përfundoi ftesën e tij me frazën: «Jezusi ende po bën të njëjtat gjëra që bëri në Bibël». Kjo ma tërhoqi vëmendjen. Unë isha rritur në kishë. Unë ia dhashë zemrën

Zotit gjatë shkollës verore biblike kur isha në klasën e pestë. Por gjatë gjithë këtyre viteve, kurrë nuk kisha parë që fuqia e Zotit të shëronte dikë, asgjë që të më tërhiqte vërtet vëmendjen dhe që të kuptoja se ishte prej Zotit. Kështu që jeta ime u largua nga Zoti gjatë viteve të shkollës. Herë pas here gjatë atyre viteve, zotohesha se do të shkoja në kishë, por interesi im atje nuk zgjati ndonjëherë. Por ky burrë dukej ndryshe. Jezusi ende po bënte të njëjtat gjëra që kishte bërë në Bibël? Isha i interesuar të shihja se për çfarë e kishte fjalën. Disa nga punonjësit e mi shkonin në atë kishë dhe më inkurajuan të shkoja, prandaj vendosa të shkoja.

Natën e parë që isha atje, ndjeva praninë e Zotit në një mënyrë që nuk e kisha provuar kurrë më parë. Më dukej sikur me të vërtetë mund ta ndieja praninë e Zotit; ishte e prekshme. Mesazhi që ai burrë dha ishte i fuqishëm dhe kur pyeti nëse dikush donte t'ia dedikonte apo ridedikonte jetën Jezusit, unë ngrita dorën. Uau! Çfarë nate. Isha aq i ngazëllyer. Doja t'u tregoja të gjithëve se sa i madh ishte Zoti.

Në ato ditë, nuk kishte internet, nuk kishte CD apo kaseta dhe ne kishim tre kanale në televizorin tonë. Qyteti ynë ishte shumë i vogël dhe nuk kishte se çfarë të bëje orëve të vona. Kështu që adoleshentët zakonisht qëndronin te dyqani i picave për t'u argëtuar deri natën vonë. Ne zakonisht e mbyllnim dyqanin në orën 01:00 pas mesnate të premteve e të shtunave dhe parkingu ynë mbushej plot me adoleshentë. Shumë herë më duhej t'i largoja, pasi ata ua vështirësonin punën për të gjetur një parkim klientëve të mi. Disa herë zënkat e tyre duhej të qetësoheshin nga policia dhe fëmijët të dërgoheshin në shtëpi. Por tani unë kisha një ide. Ata adoleshentë kishin nevojë të dëgjonin për Jezusin. Kështu që dola dhe u thashë se nëse dikush prej tyre dëshironte të qëndronte, unë do të organizoja një studim Biblik te dyqani i picave pas mbylljes së tij. Kini parasysh që kjo do të ndodhte në orën 01:30 pas mesnate, pasi ne ta kishim mbyllur dhe pastruar dyqanin, nga ora 01:00 deri në orën 1:30. Nuk e kisha aspak idenë nëse ndonjëri prej tyre do të vinte, por e dini se çfarë, disa prej tyre erdhën dhe disa prej punonjësve të mi qëndruan po ashtu. Natën e parë që mbajta takimin, një prej adoleshentëve atje tha se dëshironte t'i shërbente Krishtit dhe më pyeti se çfarë duhej të bënte. Kjo përbënte një problem unik për

mua pasi nuk e kisha menduar ende atë pjesë. Mos harroni, unë nuk dija asgjë për Biblën, por kisha lexuar një varg që dukej se i përgjigjej shqetësimeve të mia.

Dhe do të ndodhë që kushdo që të thërrasë emrin e Zotit, do të shpëtohet.

– Veprat 2:21

Dukej mjaft e thjeshtë, kështu që vendosa ta bëja. Grupi ishte larguar kur ky adoleshent më bëri këtë pyetje, kështu që i thashë të ulë në një karrige dhe të thoshte emrin e Jezusit. Mendova se ishte një gjë e thjeshtë për t'u bërë, por unë u ula atje për rreth dy minuta, dhe ai nuk tha asgjë. Kështu që përsërita udhëzimet e mia, duke menduar se ai nuk më kishte dëgjuar. Akoma asgjë. Më pas vura re se ai po dridhej. Unë gjithashtu mund të them nga shprehja e tij se ai dukej se kishte probleme për ta nxjerrë atë emër nga goja e tij. Papritmas, si një shpërthim dige, ai tha emrin e Jezusit dhe paqja u shfaq mbi fytyrën e tij. Mirë, funksionoi! Pra ky ishte plani im sa herë që dikush dëshironte t'i jepte zemrën Zotit. Unë i ulja ata në një karrige dhe ata thoshin emrin e Jezusit. Pothuajse pa përjashtim, ata nuk mund ta thoshin lehtësisht atë emër. Ata fillonin të dridheshin, dhe dukej se kishin vështirësi, më pas, e shpallnin dhe paqja vinte mbi ta.

Një ditë ndërsa isha në dhomën e pasme duke përzier brumin, dëgjova një të trokitur në derën e pasme. Kur hapa derën, njoha dy prej adoleshentëve të cilëve u kisha folur më parë për Krishtin. I ftova të hynin brenda dhe njëri prej tyre dëshironte t'i jepte zemrën Perëndisë. Kështu që e ula në karrige dhe, si zakonisht, filloi të dridhej dhe më në fund e shpalli emrin e Jezusit. Kur ngrita sytë, pashë që adoleshenti tjetër më kishte kthyer shpinën dhe ishte strukur në një cep të dhomës si një kafshë në kafaz. Po përpiquej të gërmonte në mur sikur të donte të arratisë larg meje. Kjo që shumë e çuditshme dhe nuk kisha asnjë shpjegim për këtë. Ndërsa qëndroja duke e vështruar,

papritur mendova, “ Po sikur ky të jetë një demon.” Nuk kisha asnjë eksperiencë me demonët, por kisha lexuar për ta në Bibël. Unë me të vërtetë nuk mund të mendoja ndonjë shpjegim tjetër për veprimet e tij të çuditshme. Ndaj thashë, “Jezus, a është ky një demon?” Në çast, si një vello që tërhiqet mbrapa, pash një demon të kapur pas këtij djaloshi. Demoni ishte i gjatë rreth tre metra dhe i ishte ngjitur këtij djaloshi me këmbët të mbledhura kruspull. Njerëzit gjithmonë më pyesin, “Çfarë pamje kishte?”. Dukej si një lloj majmuni, por ndryshe. Ishte leshtor si majmun, kishte krahë të gjatë si majmun, por kishte sy të shndritshëm e të kuq dhe ishte i shpërfytyruar. Në momentin që pashë ata sy, unë në të vërtetë bërtita me të madhe. Urrejtja që pashë në ata sy ishte shumë më tepër nga sa mund ta përballoja. Mënyra më e mirë për ta përshkruar atë që pashë në ata sy do të ishte “një urrejtje e lëngshme¹, një urrejtje depërtuese që pothuajse mund ta prekje”. Unë e kuptova menjëherë që kjo gjë jo vetëm më urrente, por gjithashtu ishte shumë e inatosur me mua. Po tani? Unë nuk dija se çfarë të bëja kur e pashë atë gjë. Por mendova, nëse emri i Jezusit na futi në Mbretëri, atëherë duhet të ketë autoritet mbi këtë demon, prandaj thashë me zë të lartë: «Në emër të Jezusit». Në çast, veli u mbyll. Nëse ju kujtohen televizorët e vjetër bardhë e zi, kur i fikje, shfaqej një hije e zbehtë e asaj që ishe duke parë dhe shuhej ngadalë në ekran. Pikërisht kështu u duk edhe kjo gjë. Nuk mund ta shihja qartë, por mund të shihja një hije të zbehtë të tij që shuhej. Kur veli u mbyll, djaloshi u largua me vrap nga ndërtesa.

Pra, unë e dija që demonët ekzistonin. Do të doja ta thoja këtë që në momentin kur kuptova se problemi im ishte një frymë, unë luftova me të dhe eca i lirë që prej atij momenti. Por kjo nuk ndodhi menjëherë. Është e trishtë që, në gjithë ato vite që shkoja në kishë, nuk kisha marrë kurrë kohë për të mësuar se kush isha në Krishtin dhe se si të ushtroja të drejtat e mia ligjore kundër armikut. Por tani që e kisha kuptuar, ose të paktën dyshoja se po përballesha me një frymë, isha i inkurajuar që mund të mësoja se si ta mundja atë. Unë e dija se

¹ Shënim i përkthyesit: Termi ‘i lëngshëm’ i referohet teorisë së Zygmunt Bauman mbi dashurinë, urrejtjen dhe imoralitetin.

demoni supozohej t'i nënshtrohej autoritetit tim, por isha konfuz sepse kjo nuk po ndodhte. Disa ditë më vonë, pata një përvojë tjetër pozitive që vërtetoi se problemi im ishte vërtetë një lloj fryme.

Isha në shtratin tim duke u lutur në Frymë dhe kisha vendosur të kaloja kohë në lutje që të mund të kuptoja se çfarë po ndodhte. Gjatë atij sesiioni lutjesh, papritur, ndjeva një çlirim dhe isha sërish i lirë, njësoj si në momentin kur pastori u lut për mua. Unë qëndrova i lirë për rreth dy orë atë natë, derisa u rikthye sërish, por pas kësaj isha absolutisht i sigurt që ishte frymë përderisa reagoi ndaj lutjes.

U përpoqa të lutesha sërish por asgjë. Kështu që fillova të lexoja në lidhje me luftën shpirtërore dhe të kaloja kohë duke kuptuar se kush isha në Krishtin. Por ende ajo gjë nuk po lëkundej. Vetëm se një herë, kur isha duke u lutur, pashë frymën t'i nënshtrohej autoritetit tim. Isha konfuz dhe fillova t'i kërkoja me zjarr Zotit se çfarë të bëja. Edhe pse nuk mundja të çlirohesha plotësisht, nuk kisha më sulme paniku dhe të gjitha paralizat ishin larguar. Pra kishte goxha fitore deri në atë çast. Unë ende po luftoja me mendimet torturuese dhe depresionin, por isha i sigurt që po forcohesha. Kaloja kohë çdo ditë duke rishikuar se çfarë thotë Bibla për autoritetin tonë në Krishtin.

Një pasdite isha duke luftar këtë ndjesi të njohur tmerri dhe frike ndërsa po punoja në zyrën time. Isha përpjekur të lutesha dhe të urdhëroja që shpirti i frikës të largohej, por nuk pati asnjë efekt, si zakonisht. Papritur, dëgjova zërin e Zotit. Ai më tha ta urdhëroja atë frymë të largohej, ta bëjë këtë gjë me zë të lartë, dhe me autoritet. Ai pastaj më tha gjithashtu diçka që ndryshoi mënyrën se si unë e shikoja autoritetin shpirtëror. Ai më tha të mos i kushtoja vëmendje ndjenjave të mia kur urdhëroja frymën të largohej, por të qëndroja në Fjalën e Tij, jo në atë që shihja apo ndjeja. Unë po punoja në zyrën time, ndaj nuk ishte e thjeshtë të ngrihesha menjëherë dhe të filloja t'i bërtisja djallit ndërsa të gjithë punonjësit e mi ishin aty. Kështu që u ngrita dhe shkova në tualet dhe thashë me zë të lartë, "Në emrin e Jezusit, unë të lidh ty, frymë frike. Ajo që ti po bën është e padrejtë,

dhe unë të urdhëroj të largohesh prej meje tani, në emrin e Jezusit.” Asgjë, nuk ndjeva asnjë ndryshim. Por më kujtohej se çfarë Zoti më kishte thënë, “Mos i kushto vëmendje ndjenjave të tua.” Kështu që falënderova Zotin për autoritetin që më kishte dhënë mbi këtë frymë dhe fillova ta lavdëroja Perëndinë që isha i lirë. Shkova sërisht në zyrë për të punuar. Ndërsa u ula në tryezën time, edhe pse nuk ndjeva asnjë ndryshim, vetëm falënderoja Zotin që isha i lirë sa herë që frika sulmonte mendjen time. Unë po punoja me dosjen e një klienti, kur papritur ndjeva praninë e Perëndisë të vinte mbi mua dhe pashë një re të zezë të imët të largohej nga unë dhe menjëherë u zhduk në tavanin e zyrës time.

Unë isha i lirë!

Ajo frymë demonike frike ishte larguar dhe nëse kthehej, unë e dija se si të merresha me të. Isha shumë i lumtur! I telefonova Drendës dhe i tregova për ato që sapo kishin ndodhur. Ajo tha se do të vinte menjëherë dhe ne festuam duke drekuar atë ditë në një restorant kinez (i preferuari im). Mu desh ta përsërisja qëndrimin tim kundër asaj fryme frike shumë herë pas asaj dite, pasi demonët nuk dorëzohen shpejt. Dhe megjithëse demoni ishte larguar, kaosi financiar në jetën time nuk ishte larguar. Kështu që frika në lidhje me financat u përpoq vazhdimisht të më rikthehej në mendje dhe unë duhej të mësoja se si të merresha me mendjen time dhe se si të ruaja paqen.

Ka pasur beteja të tjera gjatë jetës sime që më është dashur t'i luftoj dhe nga të cilat të nxjerr mësim, madje shumë mësim shpirtërorë rreth Mbretërisë që akoma kam nevojë t'i mësoj, por arsyeja se përse doja t'jua tregoja këtë histori është për t'ju bërë të ditur se unë e kuptoj se si ndikon stresi financiar te njerëzit dhe jeta e tyre dhe se si i ekspozon ata ndaj frikës së mundimshme. Dua të sigurohem që ta dini se e kam provuar. Pra, pa marrë parasysh se me çfarë lloj telashi po përballesh sot, ka shpresë. Do të doja ta kisha njohur Mbretërinë e Perëndisë në fillim të jetës sime. Është e trishtueshme të mendosh se Drenda dhe unë jetuam në kaos financiar për ato nëntë vjet kur nuk

duhej të ishte ashtu!

Fatkeqësisht, problemet tona financiare nuk qenë të përkohshme; por qëndruan gjatë. U bënë mënyrë jetese për ne. Nëntë vjet lutje për jetën tonë, kujtime rrethanash dhe ngjarjesh poshtëruese. Ngjarje që thjesht doja t'i harroja. Bekuar qoftë gruaja ime! Ajo duroi aq shumë ato vite. Prandaj sot mundohem ta bekoj gjithmonë.

Zoti, ashtu si më mësoi se si të luftoja me atë frymë demonike frike, filloi të më mësonte edhe se si të përballesha me financat e mia nga një këndvështrim frymëror. Ajo që Perëndia na mësoi mua e Drendës dhe ajo që Ai na ka treguar lidhur me financat tona, ka qenë kaq jetëndryshuese dhe kaq dramatike sa që u përkushtuam të kalonim të gjithë jetën tonë duke ndihmuar njerëzit të zbulojnë të njëjtat parime.

Drenda dhe unë kaluam nga të qënir jashtëzakonisht të varfër në fazën ku paguanim me para në dorë për makinat tona, ndërtuam shtëpinë tonë të ëndrrave pa borxhe, hapëm disa kompani dhe transmetuam programit tonë ditor televiziv *Fixing the Money Thing (Të Zgjidhësh Problemet me Paranë)*, në çdo zonë kohore në botë. Drenda gjithashtu filloi transmetimet e programit *Drenda* në rrjetin Familja ABC që të ndihmonte familjet të mësonin se si të jetonin dhe që të inkurajonte gratë. Ne ndjemë se Perëndia na drejtoi të nisnim kishën *Faith Life* (Jeta e Besimit), ku ende mësojmë me mijëra njerëz për Mbretërinë e Perëndisë në baza javore. Nevojiten miliona në vit për të bërë atë që bëjmë, mbi 200,000 dollarë në muaj vetëm për të realizuar programin televiziv. Sigurisht, asnjë nga këto nuk do ndodhte nëse Perëndia nuk do të na mësonte atë që dëshirojmë t'ju mësojmë juve në këtë seri librash. Do të dëshiroja të mos e shihnit këtë libër si thjesht një tjetër libër mbi financat. Nuk është thjesht një libër tjetër se si të organizoni buxhetin, megjithëse kjo është shumë e nevojshme dhe sugjerohet. Nuk është një ripunim i librit “të ardhura të pamjaftueshme”. Jo, ky është një libër mbi revolucionin, një revoltë kundër mbretërisë së errësirës dhe varfërisë së saj mbytëse. Ky është një libër që tregon se si të hedhësh tutje shtrëngimet e një qeverisje

të korruptuar dhe se si të fillosh të jetosh ndryshe. Përgjigjja ime nuk ishte thjesht një këshillë financiare. Zbulova se kisha nevojë për një rindërtim të plotë financiar:

NJË REVOLUCION FINANCIAR!

KAPITULLI 1

MBRETËRIA

Unë ju prezantova në hyrje se si u konsumua jeta ime nga frika torturuese. Ndaj besoj se është e rëndësishme që ta filloj udhëtimin tonë së bashku me këtë deklaratë që ju keni vërtetë nevojë ta kuptoni: **MOS U MËSONI TË JETONI ME FRIKË!** Frika hap dyert për të gjitha llojet e ndikimeve demonike, konfuzionin dhe depresionin, ashtu siç e pamë që ndodhi në jetën time dhe siç ndodh në jetët e miliona njerëzve. Unë besoj që trauma financiare është një derë e madhe e hapur ndaj frikës në jetët e njerëzve. Unë personalisht kam ndihmuar njerëz me financat e tyre për 34 vjet nëpërmjet shoqatës sime të planifikimit financiar dhe kuptova që nuk isha personi i vetëm që kisha patur apo kisha luftuar me çështje financiare në jetë. Në fakt, duke u bazuar në hulumtimin tim, zbulova që 23 përqind e popullsisë Amerikane nuk kryejnë as pagesën minimale të detyrimeve të borxhit të tyre financiar dhe ngadalë po rrëshqasin drejt harresës financiare.

¹Pra një e katërta e vendit! Dyzetë e shtatë milionë, një e gjashta e popullsisë, janë me kupona ushqimorë dhe tetë nga dhjetë familje mezi ia dalin deri në fund të muajit. ²Dhe nuk do të flas për 18 trilionë dollarë detyrime që ka kombi ynë dhe që kurrë nuk mund t'i shlyejë. Unë gjithashtu nuk do të përmend detyrimet financiare

¹Tracy Turner, "Debt Is People's Biggest Worry... Finance Problems Rank Higher Than Terrorism and Disasters." *The Columbus Dispatch*, 2006.

²Brad Plumer, "Why are 47 million Americans on food stamps? It's the recession—mostly." *The Washington Post*, 2013.

me vlerë prej 120 trilionë dollarësh që vendi ynë i detyrohet vetes pa asnjë mekanizëm financimi për të mbuluar koston.³Ne jetojmë në një komb me probleme serioze financiare! Ajo që kam kuptuar në jetën time është që problemet financiare të pazgjidhura dhe stresi financiar e kthen të jetuarit në frikë një stil jetese. Por ka zgjidhje! Ti mund të jesh i lirë! Bibla është e qartë në këtë subjekt: Jezusi erdhi për t'i predikuar lajmin e mirë të varfërve!!

Fryma e Zotit, Zoti, është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t'u dhënë një lajm të mirë të varfërve;

— Isaia 61:1

Çfarë është lajmi i mirë për një të varfër? Që ai mund të jetë i lirë! Sot, ti mund të mos e kesh idenë se si mund të ndodhë kjo. Një herë në jetën time, jam ndjerë plotësisht i pafuqishëm. Mendimi i të pasurit

thjesht 100 dollarë pa iu detyruar askujt ishte një mendim aq i huaj për mua sa do të qeshja me këtë mendim nëse nuk do të ishte kaq tmerrues dhe i trishtë. Ato nëntë vite mbijetesë më dëmtuan emocionalisht. Stresi financiar na privon nga gjithçka e mirë. Kur shikoj videot tona në shtëpi

në ato vite, më vjen turp.

Duhet të më shihni në një video

ku dal nga makina dhe fëmijët e mi të çmuar vrapojnë për të më takuar pas një dite të gjatë në zyrë. Ata vrapojnë, më kapin prej këmbësh dhe thërrasin “Erdhi babi!”. Në video, unë as i përgjigjem dhe as nuk i shoh.

**“FRYMA E ZOTIT, ZOTI,
ËSHTË MBI MUA, SEPSE ZOTI
MË KA VAJOSUR PËR T’U
DHËNË NJË LAJM TË MIRË TË
PËRULURVE.”**

—ISAIA 61:1

³Glenn Kessler, “Does the Nation have 128 Trillion in Unfunded Liabilities.” Washington Post, 2013.

Kam qenë kaq i stresuar dhe i dekurajuar saqë nuk isha i vetëdijshëm se çfarë kishte rëndësi. Korniza e mendjes sime më kujton diçka që e kam mësuar në klasën e notit. Nëse dikush po mbytet dhe po kërkon ndihmë, ki kujdes kur të shkosh ta ndihmosh. Pse?

Sepse është lodhur duke u përpjekur të mbijetojë saqë mund të të tërheqë edhe ty pa e kuptuar. I tillë isha unë, si një zombi i pavetëdijshëm për jetën, duke lëvizur pa ndjenja. Si një bashkëshort po dështoja. Si një baba po dështoja. Si një sigurues po dështoja. Jeta ime ishte një rutinë pa emocione, pa vizion dhe me një pamje të dëshpëruar.

Columbus, Ohio, po mbushej me shtëpi ato ditë. Po ndërtoheshin kudo shtëpi dhe për shkak të kësaj, qyteti ynë qe një Paradë Shtëpish për shumë vite me radhë. Nëse nuk e dini se çfarë është kjo, më lejoni t'ua shpjegoj. Një Paradë Shtëpish është një grup shtëpish të cilat ndërtues të ndryshëm i ndërtojnë për të treguar stilin e tyre unik, aftësitë, si dhe të gjitha pajisjet e reja dhe finiturat. Për të gjithë në atë zonë, kjo ishte një çështje e rëndësishme dhe shijohej nga mijëra njerëz. Por unë i druhesha Paradës së Shtëpive. Duke jetuar në varfërinë në të cilën ndodheshim, unë nuk dëshiroja që Drenda të shkonte dhe t'i shihte ato shtëpi. Unë tashmë ndihesha mjaftueshëm keq që kisha dështuar financiarisht; sigurisht, nuk dëshiroja që gruaja ime ta dinte sa të keqe e kishte shtëpinë. E di se ky mendim ishte marrëzi, por në atë kohë, kjo ishte pikëpamja ime. Unë e dija që nëse ajo do të gjendej atje, do të dëshironte njërën prej tyre. Kështu që vit pas viti, unë thoja, "Jo!" Por më në fund, një herë u dorëzova dhe vendosa që të shkonim atje. Shtëpitë, siç mund ta imagjinoni, ishin thjesht të shkëlqyera. Ato e bënë shtëpinë tonë të 1800-tës të dukej si një shtëpi e destinuar për t'u shembur. Pasi kishim ecur përmes shtëpive të para dhe ndërsa po ecnim nëpër trotuar, papritur kuptova që Drenda nuk po ecte përkrah meje. U ktheva pas për të parë se ku ishte dhe u trishtova kur e pashë të qëndronte jashtë shtëpisë, prej të cilës sapo ishim larguar. Lotët përshkonin faqet e saj. Unë eca drejt saj dhe i bëra pyetjen e marrë, "Çfarë nuk shkon?". A thua se nuk e dija përgjigjen. Ajo thjesht më pa

dhe më pyeti, “Kur mund të kem një shtëpi?

Mendja më vërtitej: “Një shtëpi? Si këto? Këto janë të gjitha shtëpi nga 500,000 dollarë deri në 700,000 dollarë.” Unë ende po përpiqesha të gjeja një mënyrë për të paguar këstin e prapambetur të qerasë prej 300 dollarësh në muaj të shtëpisë së vjetër në fermë. Unë e di që është e trishtë, por thjesht nuk shihja asnjë rrugëzgjidhje dhe nuk i ofroja dot asnjë lloj shprese gruas sime të bukur dhe të çmuar. Frika dhe dështimi kishin mbështjellë mendjen dhe pamjen time të jashtme. Ky nuk isha unë; çfarë i ndodhi gëzimit tim, lumturisë sime? Thjesht dukej se nuk do t’i shpëtoja dot këtij stresi financiar. Ishte ora 02:00 apo 03:00 e mëngjesit dhe nuk mund të flija. Dhimbja e përshkonte nofullën e fytyrën time si një gjilpërë dhe kisha nevojë të çlirohesha. Tridhjetë e gjashtë orë më parë kisha mjekuar kanalin e një dhëmbi për të ndaluar një infeksion që e kishte fryrë fytyrën time si tullumbace. Dhimbja dhe paretat ishin të pabesueshme. Kam marrë Tylenol çdo katër orë për dhimbjen, por nuk po më ndihmonte. Ndërsa isha ulur në dhomën time të ndenjes, në pamundësi për të fjetur dhe duke marrë edhe një dozë tjetër, thjesht po shikoja kutinë e Tylenol-it dhe lexova udhëzimet. Jo sepse nuk e dija si ta përdorja por nga mërzia e madhe, ashtu si të gjithë ne kemi lexuar kutinë e drithërave duke ngrënë mëngjesin. Jo sepse jemi vërtetë të interesuar por thjesht e kemi para syve. Po, 2 tableta çdo katër orë, por çfarë thoshte? Jo më shumë se 10 tableta në një periudhë 24 orëshe? Mendja ime shpejt shtoi numrin e tabletave që një person do të konsumonte nëse i merrte çdo 4 orë, siç e kisha bërë gjatë 2 ditëve të fundit - 12 tableta në ditë, 2 tableta mbi dozën maksimale. Papritmas, m’u mblodh stomaku dhe më kapi frika.

Nëntë vjet që jetoja në ngushticë financiare, duke dështuar si baba, si bashkëshort, si siguries, gjë që më kishte shkatërruar emocionalisht. Doktorët më dhanë antidepresantë për të më ndihmuar. Por asgjë nuk ndodhi. Atë natë, ndërsa qëndroja ulur me infeksionin në dhëmb, pa gjumë prej dy ditësh rrjesht dhe me dhimbjen e thellë, ishte e pamundur të flija. Tani, ndërsa lexoja kutinë e ilaçit, kuptova që kisha edhe një gjë

tjetër për t'u shqetësuar, një mbidozë e mundshme e Tylenol-it. Nuk e kisha idenë se çfarë mund të më bënte një mbidozë e Tylenol-it, por isha i sigurt se ishin gjëra mjaft vogla, pasi çdokush mund t'i blinte ato. Kuptova që ata thjesht duhet të vendosnin paralajmërime në kuti që të qëndronin brenda kërkesave të tyre ligjore. Unë thjesht nuk mund ta imagjinoja që marrja e 2 tabletave më shumë, mund të më shkaktonte dëme madhore. Por fryma e frikës kaploi mendjen time duke u bazuar te ky fakt dhe filloi të më mbushte me mendimet të tilla si “po sikur”. Kështu që për të qetësuar mendjen time, vendosa të telefonoj Qendrën e Kontrollit të Helmimit për të kuptuar më shumë. Unë isha i sigurt që ata do të thonin se nuk kishte asnjë problem.

Zonja në anën tjetër të linjës tingëllonte profesionale kur u përgjigj. Ajo më pyeti se si mund të më ndihmonte dhe unë i shpjegova që kam marrë Tylenol çdo 4 orë për 36 orët e fundit, duke marrë kështu 12 tableta në ditë dhe jo 10 tableta në ditë sipas udhëzimit. I tregova që thjesht po telefonoja për të verifikuar nëse marrja e atyre 2 tabletave më shumë mund të më shkaktonte dëme serioze. Pati një pauzë dhe unë dëgjova tastet e kompjuterit që shtypeshin. Më pas dëgjova këto fjalë dhe po citoj saktësisht se çfarë më tha ajo, “Zotëri, askush që ka marrë atë dozë nuk ka mbetur gjallë.” A e dëgjova mirë? Me siguri jo! Kështu që i shpjegova edhe një herë që kisha marrë 2 tableta më shumë në 24 orë dhe këtë e kisha bërë 2 ditë rresht. Këtë herë ajo u përgjigj me një zë më të ashpër, “Zotëri, unë thashë, askush që ka marrë atë dozë nuk ka mbetur gjallë. Dua të vish në urgjencë, TANI!” Kur u përpoqa t'i shpjegoja përsëri se çfarë kishte ndodhur, pasi isha i sigurt se nuk po më dëgjonte mirë, ajo më ndaloi dhe tha, “Ose eja vetë në spital ose unë do të dërgoj ambulancën.” Mbeta i shokuar! “Do vij vetë.” belbëzoja. “Në cilin spital do të shkosh?”, më pyeti. Ia tregova dhe ajo e mbylli telefonin. Unë qëndrova i habitur. Kisha një takim shumë të rëndësishëm në orën 09:00 paradite dhe tani ishte ora 03:30 e mëngjesit.

Ngjita shkallët drejt dhomës së gjumit, zgjova Drendën dhe i

tregova se çfarë ndodhi. Ajo më pa me një vështrim patetik tronditjeje. Burri i saj ishte duke vepruar dhe kishte qenë duke vepruar paksa çuditshëm prej disa muajsh dhe ajo ishte lodhur duke u kujdesur për gjithçka dhe tani ndodhi kjo? “Geri, ishin vetëm dy tableta më shumë. Me siguri, ti e di që nuk ke pse të besosh se do të të vrasin. Telefonoji sërish.”, tha ajo. Por frika është irracionale dhe munduese. “Zonja më tha që mund të vdes; Duhet të shkoj në spital.” Kur i ktheva shpinën që të dilja nga dhoma e gjumit mund ta dalloja atë shikim në sytë e gruas sime, që thoshte, “Po tallesh tani”. Kur shkova në spital, dy djem me bluza të bardha po prisnin te hyrja e urgjencës. Kur ndalova, mu afruan dhe më thanë, “A jeni Geri Kisi?” Nxituan të më dërgonin te dhoma e trajtimit. Kur kalova dhomën e urgjencës, pashë emrin tim të shkruar në tabelë. Aty shkruhej, “Geri Kisi—mbidozë.” Nuk mund ta besoja. Për ta përmbledhur shkurt, kur doktori më mori një kampion gjaku, tha, “Pse ke ardhur këtu? Niveli i Tylenolit në gjakun tënd nuk është i lartë as për të kuruar një dhimbje koke.” Kur i tregova historinë me Qendrën e Kontrollit të Helmimit, filloi të qeshte. Mua nuk më dukej për të qeshur dhe nuk ishte për të qeshur kur më erdhi në email fatura 2 000 dollarëshe. Djalli më mashtroi dhe më vodhi sërish. Ua tregova këto histori, së bashku me hyrjen për t’ju ndihmuar të shihni se ku ishte jeta ime para se të zbuloja Mbretërinë e Perëndisë. Po, isha i krishterë. Po, e jepja të dhjetën. Po, kam drejtuar adhurimin në kishën time. Po, e doja Perëndinë. Por diçka ishte e gabuar, tmerrësisht e gabuar! Ju tregova se si Perëndia më mësoi të luftoja frymën e frikës dhe se si u çlirova nga antidepresantët dhe sulmet e panikut. Por ende nuk isha i lirë nga rrethanat që sollën betejën time me frikën, situatën time të pashpresë financiare. Unë ende kisha të njëjtin presion të tmerrshëm për të gjetur para dhe për të paguar faturat, plus kisha dhjetë karta prej të cilave kisha tërhequr shumën maksimale të lejuar dhe më ishin anuluar, tre kredi të kompanive financiare, pagesa të pakryera te Shërbimi i të Ardhurave të Brendshme, para që u detyroheshim të afërmve dhe shumë gjykime dhe barra financiare. Ashtu siç e kam

thënë, jetët tona ishin në një kaos financiar. Unë veproja i stresuar dhe i trazuar emocionalisht. Edhe pse të krishterë, po vdisnim financiarisht dhe një nga një kartat e mia të kreditit u anuluan. Barrat financiare ishin depozituar, krediti ishte revokuar dhe kreditorët telefononin. Në kulmin e gjendjes sonë të keqe financiare dhe me biznesin që nuk po prodhonte shumë të ardhura, nuk po përballonim dot as ushiqmin. Familja ime mblidhej rreth sobës me dru në dhomën tonë të ndenjes për të qëndruar ngrohtë, sepse nuk kishim mundësi të paguanim naftën.

Ne kërkonim nëpër karrige dhe divanë për monedha të humbura që mund të kishin rënë nga xhaketat, duke shpresuar të gjenim para për një vakt te Mc Donald, për t'ua ndarë fëmijëve.

Dija shumë mirë ta shtyja afatin kur më telefononin kreditorët, por një ditë një prej kreditorëve punësoi një avokat për të mbledhur detyrimet e mia. Ky djalë më telefonoi dhe s'kishte aspak personalitet. Ai thjesht tha, "I dua paratë për tre ditë ose do të ngre padi kundër jush në emër të klientit tim." Isha i mbaruar. Nuk kisha asnjë lloj mundësie, nuk kisha para, kisha trokitur te të gjithë miqtë e mi dhe isha në atë pikë ku e dija që isha i mbaruar. U ngjita zvarrë-zvarrë te dhoma e gjumit, rashë mbi krevat dhe i thirra Perëndisë. Shumë shpejt dëgjova zërin e Zotit. Një varg që e kisha dëgjuar shumë herë më lundroi në mendje.

**“DHE PERËNDIA DO TË
PLOTËSOJË TË GJITHA
NEVOJAT TUAJA SIPAS
PASURISË SË TIJ NË LAVDI,
NË KRISHTIN JEZUS.”**

—FILIPIANËVE 4:19

– Filipianëve 4:19

Iu thash Zotit se e dija atë varg por nevojat e mia nuk ishin plotësuar! Ai iu përgjigj menjëherë pyetjes sime, “Po, por ky nuk është

faji im. Ti kurrë nuk ke gjetur kohë të mësosh se si operon Mbretëria ime. Në fakt, shumica e kishës sime jetojnë siç jetoi Izraeli në Dhjatën e Vjetër, si skllëvër. Stili i tyre i jetesës përfshin borxhet dhe skllavërinë financiare. Unë dua që populli im të jetë i lirë.” Zbrita shkallët menjëherë, kapa Drendën dhe i tregova se çfarë më kishte thënë Zoti. I kërkova falje që nuk e kisha kërkuar Perëndinë dhe nuk kisha mësuar se si funksionon Mbretëria e Tij. Në fakt, në atë kohë, vërtet që nuk e dinim se çfarë donte të thoshte Perëndia kur tha se nuk e dinim se si operon Mbretëria e Tij. Në fund të fundit, shkonim në kishë, jepnim të dhjetën e të ardhurave tona shumicën e kohës dhe e donim Perëndinë. Ne mendonim se tashmë e kishim mendësinë e Mbretërisë. Sidoqoftë, çështja, ashtu siç e zbulova, ishte se, po, unë isha rrugës për në qiell, por nuk e kisha idenë se si ta sillja fuqinë dhe autoritetin e qiellit në jetën time që të ndikonte te rrethanat e mia. Kështu që filluam të studionim Biblën dhe Perëndia filloi të na fliste dhe na ndihmoi të mësonim se për çfarë e kishte fjalën kur tha Mbretëria. Ajo që mësuam ishte shokuese! Ishte si të ndizje dritën në një dhomë të errët. Për herë të parë në jetën tonë, gjetëm përgjigjet lidhur me jetën tonë financiare!

Perëndi, Çfarë Do Të Thuash Me Mbretëri?

Kur Perëndia më tha që kurrë nuk kisha mësuar se si funksiononte Mbretëria e Tij, u konfuzova, për të mos thënë gjë tjetër. Mbretëria? Drenda dhe unë as që e kishim idenë fare. Ne u lutëm dhe pyetëm Perëndinë se çfarë donte të thoshte me këtë: “Zot, na mëso se çfarë kupton Ti me Mbretëri!” Kështu që gjëja e parë që duhej të mësoja ishte domethënia e Mbretërisë.

Unë mendoj se ky koncept është i vështirë për t’u rrokur nga mendjet tona perëndimore, që kanë një mendësi Amerikane të demokracisë dhe fjalës së lirë. Mbretëria e Perëndisë nuk është demokraci; është një Mbretëri me një Mbret.

Autoriteti i Mbretit rrjedh nëpër Mbretëri përmes autoritetit që u është deleguar pozicioneve të ndryshme qeverisëse dhe njerëzve

që operojnë nën atë autoritet. Një turmë njerëzish nuk përbëjnë një mbretëri. Mund të gjenden një milionë njerëz në një turmë dhe ajo nuk përbën një mbretëri. Mbretëria është një grup njerëzish të cilët qëndrojnë bashkë me anë të ligjit ose qeverisë. Përkufizimi i mbretërisë në fjalor është: “mbretëria: një shtet ose qeveri që ka një mbret ose mbretëreshë në krye”.

Megjithëse e festojmë ardhjen e Jezusit në tokë në Krishtlindje, zakonisht nuk arrijmë ta kuptojmë se Ai solli një qeveri me Vete. Bibla flet për këtë qeveri të Isaia 9:5-6:

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes. Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive.

Jezusi është kreu i kësaj qeverisje dhe kur pranojmë Jezusin si Shpëtimtarin tonë personal bëhemi pjesë të kësaj qeverisje; ne bëhemi qytetarë të saj. Jo vetëm bëhemi qytetarë por bëhemi gjithashtu pjesë e shtëpisë së Perëndisë si bij dhe bija të Tij..

por të gjithëve atyre që e pranuan, ai u dha pushtet të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e tij, të cilët nuk lindën as prej gjakut, as prej vullnetit të mishit, as prej vullnetit të burrit, por prej Perëndisë.

– Gjoni 1:12-13

Kështu, pra, nuk jeni më të huaj e bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtorëve dhe pjesëtarë të shtëpisë së Perëndisë,

– Efesianëve 2:19

Si pjesëtarë të shtëpisë së Perëndisë bëhemi pjesë e familjes së tij dhe kështu zotërojmë dhe jemi pjesë e gjithçkaje që Perëndia zotëron. Por ne gjithashtu bëhemi qytetarë të qeverisë së Tij të mahnitshme. Kjo nënkupton që kemi të drejta ligjore dhe përfitime brënda kësaj qeverie. Për ta kuptuar më mirë atë që po them, më lejoni të flas rreth të qenit qytetar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Si një qytetar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ti ke të drejta ligjore. Të drejtat e tua ligjore janë shkruar në kushtetutën tonë dhe në ligjet e qeverisë sonë. Këto ligje dhe përfitime arrijnë te çdo qytetar, pavarësisht se kush është ai. Këto të drejta nuk bazohen te ndjenjat tona apo te fakti se sa të zgjuar jemi. Jo, janë vendosur me ligj, janë ligjërish të disponueshme për çdo qytetar që e quan Amerikën shtëpinë e tij. Ka mundësi që një qytetar të mos i dijë të drejtat e tij ligjore, por gjithsesi, i gëzon thjesht sepse është qytetar i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Tani këtu ka diçka për të cilën duhet të mendojmë dhe shpresoj që kjo do ta ndryshojë gjithë këndvështrimin tënd mbi Perëndinë. Këtu në Shtetet e Bashkuara, nëse gjejmë diçka apo dikë që po përpiket të na shkel të drejtat tona ligjore ose nëse trajtohem në mënyrë të padrejtë, kemi akses te drejtësia (drejtësi do të thotë zbatimi apo administrimi i ligjit), një proces që zbaton të drejtat tona ligjore. Ne shkojmë në gjykatë dhe gjyqtari nuk i kushton vëmendje pamjes së jashtme apo pasurisë sonë. Ai shikon ligjin. Çdo herë ai duhet të drejtojë në favor të ligjit. Kjo është siguria jonë: që kemi të drejta ligjore dhe qeveria jonë i respekton të drejtat tona ligjore përmes një procesi drejtësie brenda Shteteve të Bashkuara. Me këtë në mendje, t'i hedhim një vështrim Isaia 9 ndërsa flet për këtë qeverisje të re që Jezusi ka sjellë në tokë.

Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mençurisë dhe të drejtësisë....

– Isaia 9:6

Ky varg thotë që Mbretëria e Perëndisë është vendosur pa u tundur përmes drejtësisë, administrimit të ligjit të Perëndisë. Administrimi do të thotë procesi i implementimit ose zbatimit të të drejtave të tua ligjore. Të drejtat e tua ligjore janë ato që Perëndia i quan drejtësi apo ajo që Ai thotë se është e drejtë, ligji i Tij. Për t'u siguruar që keni atë që Perëndia thotë se është e drejtë brenda Mbretërisë së Tij, atë që është ligjërisht e juaja si qytetar i Mbretërisë, Perëndia ju ka dhënë akses në drejtësi, procesin ose garancinë se do të keni atë që Ai ju ka premtuar. Perëndia na e ka treguar vullnetin e Tij me anë të Fjalës së Tij, Biblës, që njohim të drejtat tona në Mbretërinë e Tij. Ky është lajm i mirë! Çdo gjë që lexoni në Bibël e që ka të bëjë me atë që Perëndia ju ka premtuar është tashmë ligjërisht e juaja si qytetar i Mbretërisë së Tij!

2 Korintasve 2:20 qartësisht thotë që çdo premtim – ÇDO PREMTIM – është “Po” dhe “Amen”. Tashmë është vendosur; është ligjërisht yti.

Sepse të gjitha premtimet e Perëndisë janë në të “po” dhe në të “amen”, për lavdi të Perëndisë nëpërmjet nesh.

– 2 Korintasve 1:20

Themeli i Mbretërisë së Perëndisë është drejtësia – ai nuk mund të lëkundet. Prandaj mendojeni kështu: “Nëse e njoh ligjin e Mbretërisë së Zotit (vullnetin e Tij) dhe e di që kam qasje në drejtësi, në procesin e zbatimit që më garanton atë që thotë ligji, atëherë jam i sigurt dhe nuk kam frikë.

Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, na dëgjon. Dhe nëse dimë se na dëgjon për atë që i kërkojmë, ne dimë se marrim kërkesat që i kemi kërkuar.

– 1 Gjonit 5:14-15

Kur ky varg thotë se Ai na dëgjon, nuk po flet për të dëgjuarit e fjalëve tona përmes valëve zanore; por thotë se do të kujdeset. Mendoni për një gjykatës që e dëgjon çështjen për t’u siguruar se do të vendoset drejtësia në vend. Salla e gjyqit dhe gjyqtari janë atje për t’u siguruar që drejtësia të jetë në dispozicion të çdo qytetari. Vendimi i gjyqtarit nuk bazohet te ndjenjat e tij por te ligji që kryeson për t’u zbatuar te çdo qytetar. Gjykatësi ndodhet aty për t’u siguruar që drejtësia (zbatimi i ligjit) të vihet në vend sipas ligjit të shkruar.

MBRETËRITË OPEROJNË ME ANË TË LIGJEVE DHE LIGJET NUK NDRYSHOJNË.

Në rastin e Perëndisë, froni (vendi i autoritetit) dhe fuqia e Tij janë aty për të siguruar drejtësi (zbatimin e vullnetit të Tij) te të gjithë njerëzit që shkojnë te Jezusi dhe te Mbretëria e Tij.

Ju lutemi lexojeni atë thënie përsëri shumë ngadalë dhe lëreni të kthehet në vizionin tuaj aktual për Zotin. Shumë njerëz ndjejnë që Perëndia i merr vendimet sipas rastit, por kjo nuk është e vërtetë. Ai është Mbreti i një Mbretërie me ligje që nuk ndryshojnë. Ai nuk vendos dhe nuk merr vendime jashtë ligjit të Tij. Kështu që ne mund ta dimë se cila është përgjigja e tij përpara se ta pyesim dhe mund të jemi të sigurt që e kemi atë që ligji i Tij thotë përpara se ta shohim sepse Ai ka fuqinë të zbatojë ligjin e Tij.

Teksa Drenda dhe unë filluam të mësonim mbi të drejtat tona ligjore në Mbretëri, kjo ndryshoi në mënyrë dramatike mënyrën se si mendonim për Perëndinë dhe Biblën. Rezultati i botëkuptimit tonë të ri ishte një jetë e ndryshuar.

Nuk kishte më lypje. Nuk kishte më përgjërime. Ne mësuam se ajo që Perëndia tha, tashmë na ishte dhënë ligjërisht si qytetarë të Mbretërisë së Tij. Ne vetëm duhej të vazhdonim të mësonim se si ligjërisht të kërkonim atë që ishte e jona ligjërisht dhe ta sillnim në sferën tokësore. Mendoni për arkëtimin e një çeku. Edhe pse mund të keni shumë para në llogarinë tuaj, ka një proces ligjor me anë të të cilit kërkonit paratë dhe arkëtoni çekun. Ka një proces në çdo sistem ligjor ku ne bëjmë një kërkesë ligjore për diçka, edhe nëse ne e zotërojmë tashmë.

Duke qenë se fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë, me anë të njohjes së atij që na thirri përmes lavdisë dhe virtytit..

– 2 Pjetrit 1:3

Është një mbretëri! Ata që janë qytetarë të Mbretërisë kanë të njëjtat të drejta si kushdo tjetër që është qytetar i Mbretërisë. Është e rëndësishme që ta kuptojmë këtë pikë: Mbretëritë funksionojnë sipas ligjeve dhe ligjet nuk ndryshojnë. Pse është e rëndësishme kjo? Është e rëndësishme sepse do të thotë që nëse Mbretëria punon ose vepron bazuar në ligje të ndryshueshme, atëherë nuk ka respekt për personat në Mbretëri. Përkundrazi, gjithsecili në Mbretëri ka të njëjtën të drejtë të gëzojë operimin e ligjit të Mbretërisë njësoj si çdo person tjetër në Mbretëri.

Këtu gjërat ngatërrohen disi në botën e kishës. Shumica e të krishterëve mendojnë se Perëndia, në mënyrë arbitrare, vendos se çfarë dëshiron të bëjë në jetën e dikujt. Me fjalë të tjera, ata mendojnë se Zoti zgjedh të bekojë dikë dhe dikë tjetër jo. Ata mendojnë se Perëndia lejon që t'u ndodhin gjëra njerezve mbi të cilat ata nuk kanë kontroll. Ata mendojnë se Ai do të shërojë një person dhe jo një tjetër. Shumica e të krishterëve lypin Perëndinë që t'i ndihmojë kur Ai tashmë ka bërë

gjithçka që mundet për t'i ndihmuar. Ai u ka dhënë atyre Mbretërinë, të gjithë Mbretërinë. Kur Perëndia filloi të më fliste mua për financat e mia dhe që unë duhej të mësoja më shumë për Mbretërinë e Tij, Ai më dha këtë varg.

Lum ju, të varfër, sepse juaja është mbretëria e Perëndisë.

– Luka 6:20b

Perëndia po më thoshte që përgjigjja ime për financat e mia ishte Mbretëria e Tij dhe ti mund t'i shtosh kësaj, duke ditur se si t'i përdorësh ligjet e Mbretërisë këtu në sferën tokësore, ashtu siç Jezusi bëri. Unë e pranoj që në fillim nuk e kisha aspak idenë se çfarë do të thoshte kjo. Por ndërsa mendoja për atë që Perëndia më kishte thënë, kuptova që mbretëritë, në fakt, operojnë me anë të ligjit. Funksioni dhe efekti i një ligji të caktuar mund të njihet dhe mund të jesh i sigurt se do të funksionojë në të njëjtën mënyrë çdo herë, sepse ligjet nuk ndryshojnë. Kurrë më parë nuk kisha menduar për këtë nga një këndvështrim frymëror. Sidoqoftë, nëse kjo ishte çështja dhe Mbretëria e Perëndisë operonte në atë formë, atëherë unë e dija se mund t'i mësoja ato ligje, t'i aplikoj dhe të përfitoja nga ato ligje. Unë e kuptova që ligjet që qeverisin këtë tokë nuk ndryshojnë. Në fakt, mund të mbështetesh te funksioni i tyre i vazhdueshëm dhe i pandryshueshëm aq sa të dërgosh dikë në Hënë apo të bësh një aeroplan të fluturojë. Por shumë të krishterë nuk i afrohen Perëndisë me këtë botëkuptim. Përkundrazi, ata lypin dhe qajnë kur iu nevojitet diçka, duke u përpjekur ta bindin Perëndinë për atë që kanë nevojë, sikur Perëndia të zgjedhte nëse do të kujdesej për ta apo jo.

Për shembull, nëse unë do të shkoja të predikoja në një konferencë të caktuar të kishës, a do të luteshin njerëzit e asaj konference që të kishte energji elektrike gjatë të gjithë eventit? A do të agjëronin dhe të luteshin, duke lypur Perëndinë, “Perëndi, ti e di se sa e rëndësishme

është ky takim dhe se sa nevojë kemi që të kemi energji elektrike gjatë gjithë kohës,” duke kërkuar me ngashërime dhe vajtime në lutje? Unë nuk mendoj kështu. Në fakt dyshoj nëse ndokush do të shqetësohej për elektricitetin gjatë organizimit të atij takimi.

Nëse për ndonjë arsye ata vijnë në konferencë atë mbrëmje dhe dritat nuk janë të ndezura, a mendoni se ata do të telefonin kompaninë e furnizimit me energji elektrike dhe t’i përgjëroheshin atyre të rikthenin rrymën? Jo. Nëse do ta bënin, jam i sigurt se përfaqësuesi i kompanisë do dëgjonte për një sekondë dhe do t’i thoshte bashkëpuntorit të tij, “Kam një kokëkrisur në linjë”. Ai do të thoshte, “Zonjë, keni energji elektrike; problemi qëndron te ju.” Kur ia them këtë njerëze në konferencat e mia të gjithë qeshin.

A e dini pse? Sepse ata e dinë që është budallallëk të telefonosh kompaninë përkatëse e t’i thuash të risjellë energjinë elektrike; shumica e njerëzve e dinë saktësisht se ç’duhet të bëjnë. Ata thjesht ndezin çelësin. Është kaq e thjeshtë! Nuk është ndonjë punë e madhe, nuk ka stres; thjesht duhet ndezur çelësi. A e dini përse ata nuk shqetësohen nëse do jenë të ndezura dritat? Sepse PRESIN që dritat të jenë të ndezura. Ata supozojnë që dritat janë të ndezura sepse e dinë se si funksionon elektriciteti. Ata i kuptojnë LIGJET që qeverisin elektricitetin dhe e dinë që ato ligje nuk ndryshojnë kurrë.

Por nëse kthehesh pas në kohë, 1 000 vjet, dhe i thua dikujt se do të ndriçosh të gjithë qytetin me llamba qelqi, ai do të mendojë që je i krisur. Dhe nëse do të shikonin një llambë të ndezur diku do ta quanin një mrekull. Çdo gjë që njerëzit nuk mund ta shpjegojnë, e quajnë mrekulli. Por nuk është një mrekulli; është thjesht ligji i funksionimit të elektricitetit, njësoj si për këdo që merr kohë dhe mëson se si funksionon elektriciteti.

Ne e kemi mësuar tashmë se si funksionon elektriciteti ose mund të themi që i kemi përtërirë mendjet tona ndaj ligjeve që rregullojnë elektricitetin. Kështu që presim që ai të funksionojë dhe nuk habitemi kur e shohim duke funksionuar. Në fakt, ne habitemi më shumë

kur shohim që nuk funksionon. Duke kuptuar ligjet që rregullojnë elektricitetin dhe duke i shkruar ato, mund të publikojmë drita në të gjithë botën.

Si? Duke i mësuar të tjerët se si funksionojnë këto ligje dhe duke i lejuar ata të shijojnë përfitimet e elektricitetit. Kjo bëhet e mundur kur kupton ligjet që qeverisin elektricitetin. E njëjta gjë është e vërtetë për ligjet frymërore. Nëse nuk i kuptojmë, nuk do të jemi në gjendje t'i shijojmë përfitimet e tyre apo t'i publikojmë kur të na duhen.

Kur shohim një avion duke fluturuar, nuk themi, “Uau kjo është një mrekulli.” Jo, ne presim që avioni të fluturojë sepse, sërisht, e kuptojmë si fluturon avioni dhe pse fluturon. Dhe sërisht, nëse do të ktheheshim pas në kohë, 1 000 vjet më parë, dhe nëse një avion *Airbus 380* fluturon mbi lartësinë e një peme, çfarë do të thonin njerëzit? Ata do të thonin që është një mrekulli! Unë jam dakord që *Airbus 380* është mbresëlënëse, peshon rreth 1,2 milionë paund, mban rreth 800 persona në bord, fluturon me 570 milje në orë deri në 9 000 milje. Është kaq magjepsës sa mund të tundohesh të mendosh se është një mrekulli. Por nuk është. Ne mund të pyesim inxhinierët që e ndërtuan *380*-ën se si fluturon dhe ata do të na tregojnë çdo ligj të fizikës që kanë përdorur për fluturimin e atij aeroplani dhe mund të na thonë çdo vidë dhe pjesë të përdorur. Inxhinierët nuk qëndrojnë në pistë gjatë fluturimit të tij duke thënë, “Uau, shikojeni atë; nuk mund ta besoj që ajo gjëja fluturon.” Sërisht, ne ndihemi të sigurt kur hipim në avion sepse e dimë që aftësia e tij flutuese bazohet te ligjet e fizikës që nuk ndryshon. Për sa kohë qëndrojmë brenda parametrave të atyre ligjeve, ai avion do të fluturojë. Mbajeni mend këtë: Ligjet nuk ndryshojnë!

Ne nuk do të hipnim kurrë në atë avion nëse ligji nuk do të ishte i qëndrueshëm. Nëse blejmë një biletë avioni dhe aty thuhet midis rreshtave të parë që, “Udhëtimi në këtë aeroplan është në riskun tuaj pasi ligji i ngritjes funksionon në mënyrë sporadike. Një ditë punon, një ditë nuk punon. Askush nuk e di me siguri—paçi fat!

Fluturim të këndshëm.” Kur ishte hera e fundit që kishit frikë se

mos shkëputeshit nga karrigia? Asnjëherë? Pse jo? Sepse e dini që ligji i gravitetit nuk ndryshon kurrë. Këto gjëra që kam përmendur janë ligje të fizikës në sferën tokësore që Perëndia ka krijuar. Por e dini se çfarë? Ligjet frymërore të Mbretërisë së Tij funksionojnë në të njëjtën mënyrë – nuk ndryshojnë! Përpara se Perëndia të më fliste mua për Mbretërinë e Tij, isha shumë i përgatitur se si funksionin ligjet në tokë, por mendoja që Mbretëria e Perëndisë ishte ndryshe. Mendoja që Perëndia thjesht bëri gjithçka deshi dhe kurdo deshi. Por kuptova që kjo nuk ishte e vërtetë. Kur kuptova që ligjet e Mbretërisë frymërore të Perëndisë nuk ndryshojnë dhe mund të mësohen, të kuptohen dhe të zbatohen, kuptova se përse Jezusi thoshte vazhdimisht “Kjo është Mbretëria e Perëndisë.” Ai e lidhte Mbretërinë me diçka në fushën natyrore në mënyrë që njerëzit të mund ta kuptonin se si funksiononte ajo. Papritmas, u duk sikur një llambë m’u ndez në mendje. Pata këtë mendim, “Nëse Perëndia na ka dhënë Mbretërinë dhe po, na e ka dhënë, dhe Mbretëria operon me anë të ligjeve që nuk mund të ndryshojnë, atëherë unë mund t’i mësoj ato ligje dhe t’i zbatoj në jetën time.”

Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t’ju japë mbretërinë.

– Luka 12:32

Kjo ishte dita kur u bëra shkëncëtar frymëror! Unë e pashë Biblën në një këndvështrim plotësisht ndryshe. Fillova të bëja pyetje kur lexoja Biblën: “Pse u shumëfishuan peshqit? Pse u shërua ai person? Pse u shumëfishua buka?” dhe kështu me radhë. Kur i përqasesha Biblës në këtë formë, duke i kërkuar Perëndisë të më tregonte ligjet që ishin atje – mahnitesha! Kur Zoti më foli ditën që më telefonoi avokati dhe më tha që telashi im ishte për shkak se kurrë nuk kisha marrë kohë të mësoja se si funksiononte Mbretëria e Perëndisë, zbrita shkallët menjëherë dhe

i shpreha gruas sime pendesën që nuk e kisha kërkuar Zotin dhe që kisha lejuar të mbërrinin në këto telashe, ashtu siç tregova më parë.

Por ne nuk e dinim se çfarë do të thoshte në të vërtetë t'i besonim Mbretërisë për përgjigjet tona. Sërisht, ne ishim tashmë pjesë e një kishe, ishim në rrugën tonë për në qiell dhe e donim Perëndinë. Ne nuk e konceptonim se çfarë donte të thoshte Perëndia kur përmendi “Mbretërinë” në atë kohë. Kishim një problem të vërtetë në duart tona dhe nuk e dinim se si të gjenim paratë që avokati na kërkoj t'i paguanim për tre ditë apo se si të trajtonim padinë që do të ngrihej kundër nesh nëse nuk paraqiteshim me ato para për tre ditë.

Pra, ky ishte një test i mirë. Ishte përvoja ime e parë me një problem parash dhe doja që Zoti të më tregonte se çfarë donte të thoshte me «Mbretërinë». Ndaj, më lejoni t'ju tregoj se çfarë ndodhi. Mos harroni që avokati na kishte thënë se kishim tri ditë kohë për t'i dërguar paratë, të cilat nuk i kisha fare! Ky dëshpërim më bëri të shkoj në dhomën time të gjumit dhe t'i thërras Zotit; isha në telashe! Sigurisht, në këtë moment Ai më tha se Mbretëria ishte zgjidhja ime; dhe përsëri, nuk e kisha idenë se çfarë donte të thoshte Ai me këtë, por sigurisht që isha i gatshëm të mësoja.

Dy ditë më vonë, në mbrëmje, po shkoja të takoja një klient në lidhje me sigurimin e jetës. Zakonisht, në ato ditë, unë gjithmonë e parkoja automjetin tim në qoshe të shtëpisë së klientit tim, kurrë para shtëpisë. Minifurgoni që ngisja kishte një problem të vockël. Kur ndizej, e mbushte rrugën me tym të bardhë dhe unë nuk e kuptoja aspak. Thjesht mendoja që nuk ishte ndihmë për biznesin tim nëse parkoja përpara shtëpisë së klientit dhe kur të largohesha ta mbushja rrugën plot me tym të bardhë. Supozoja se besueshmëria ime në fushën e financave mund të ndikohej pak nëse kjo ndodhte pasi u kërkoja atyre të investojnin qindra mijëra dollarë me mua. Mbi të gjitha, nëse do të isha një menaxher kaq i shkëlqyer financiar, pse drejtoja një automjet që mezi lëvizte? Kjo natë nuk ishte ndryshe.

Teksa po dilja nga shtëpia e klientit tim, u tmerrova kur pashë që

ai në të vërtetë po më shoqëronte për te makina ime. Ai nuk donte të thoshte asgjë me këtë; thjesht po flisnim. Por isha pak i shqetësuar se do të ishte aty kur të ndizja makinën. Ne vazhduam të flisnim ndërsa po afroheshim te makina ime. Duke ulur xhamin e dritares, vazhdova të flisja, duke shpresuar që do të thoshte natën e mirë dhe unë do të veproja sikur po merresha me diçka derisa ai të largohej, por ai nuk lëvizi fare. Më në fund, ai më tha natën e mirë, por thjesht u zbraps nga furgoni dhe qëndroi aty. E dija që do të ndodhte kjo një ditë. Unë e nderova furgonin, duke shpresuar që këtë herë nuk do ta lëshonte shtëngullën e bardhë të tymit, por kjo ishte një dëshirë që nuk u realizua. Menjëherë, ajri u mbush me tymin që na dogji sytë. Ai burrë më bëri shenjë të fikja menjëherë furgonin. U afrua te dritarja dhe më pyeti nëse mund të ngrija kofanon dhe pastaj vazhdoi të më shpjegonte që punonte me kohë të pjesshme si mekanik makinash, dhe dëshironte të kontrollonte problemin e furgonit tim. Pas një minute, ai erdhi dhe më tha, “Ashtu siç dyshoja; të është prishur guarnicioni i testatos. Shko në shtëpi dhe rregulloje menjëherë.” Unë e falenderova ndërsa po largohesha, por diagnoza e tij nuk kishte kuptim për mua. Unë nuk kisha fare para për të riparuar makinën.

Zyra ime gjendej rreth gjashtë milje nga shtëpia e klientit tim dhe ndërsa u ktheva drejt zyrës sime, ajo batanije e njohur depresioni më pushtoi. Por ndërsa po ngisja makinën, kujtova atë që Zoti më kishte thënë dhe fillova të flas me të për furgonin tim. Unë thashë, “Zot, nuk kam para për ta rregulluar këtë furgon. Unë ende kam borxhe edhe për furgonin dhe nuk mund ta shes të prishur. Nuk e di se çfarë të bëj. Ndoshta do të ishte më mirë nëse furgoni digjej. Në atë mënyrë kompania e sigurimit do të paguante dhe unë do të çlirohesha.” Rreth tre milje larg zyrës sime, vura re një flluskë që nuk e kisha vërejtur më parë në kofano. Ndërsa po e shihja, flluska u bë gjithnjë e më e madhe dhe kur po hyja në parkingun e zyrës time, flluska shpërtheu në flakë.

Isha i shokuar; e gjithë pjesa ballore e furgonit u përfshi nga flakët që shpërthyen jashtë kofanos. Menjëherë vrapova te ndërtesa e zyrës dhe

i telefonova departamentit të rasteve të zjarrit. Të nesërmen, furgoni u shlye në total nga kompania e sigurimeve, dhe ata më dhanë një çek për

**NË ATË PIKË, NE I KISHIM
PROVUAR VETES SE SISTEMI
I PERËNDISË FUNKSIONON
DHE U PËRKUSHTUAM TË
VAZHDONIM TË MËSONIM
DHE TË PËRDORNIM
SISTEMIN E MBRETËRISË SË
PERËNDISË, QË PREJ
ATIJ MOMENTI**

këtë madje mbeti mjaftueshëm për të bërë pagesën te avokati i cili më kishte telefonuar tre ditë më parë. Drenda dhe unë ishim të mahnitur.

Nuk dinim se çfarë të mendonim. E dimin se Perëndia po punonte për ne dhe që diçka po ndryshonte.

Por përkushtimi ynë në Mbretëri do të testojë në një mënyrë të re përcaktoi hapat tanë në vitet e ardhshme. Pasi furgoni u dogj, sigurisht që ishim të gëzuar, por papritur kuptuam

që kishim mbetur pa mjet. Megjithëse furgoni ishte tashmë i shlyer nga detyrimet dhe karta e kreditit e paguar, ne nuk kishim para që të blinim një makinë të re. Me të dëgjuar për humbjen e makinës, babai im më telefonoi dhe më tha që dëshironte të na ndihmonte të blenim një furgon të ri. U gëzuam pa masë kur dëgjuam këtë lajm. Kështu që babai im dhe unë shkuam te një shitës vendas dhe gjetëm një furgon që unë dhe Drenda e pëlqyem. Babai tha që do të na jepte 5 000 dollarë për ta blerë por furgoni kushtonte 17 000 dollarë. Pra, duhet të siguronim 12 000 dollarë vetë. Pa dëshirë plotësova një kërkesë për kredi dhe babai bashkë-nënshkroi për të. Ata do të më njoftonin në mëngjes. Atë natë nuk mundëm të flinim. E dinim që nuk mund ta merrnim kredinë. Zoti sapo më kishte folur për një veprim të tillë.

Por të mbetur pa makinë, isha që të përkulesha dhe të dorëzohesha. Pas një nate me gjumë të tmershëm, Drenda dhe unë ramë dakord që nuk mund ta firmosnim kredinë. Unë i telefonova babait tim dhe e

falenderova për ofertën e tij bujare por i thashë që do ta refuzonim. Më pas, i telefonova shitësit dhe i thashë të njëjtën gjë. Ata gjithashtu ishin të zhgënjyer pasi kredia ishte aprovuar atë mëngjes dhe furgoni ishte gati për t'u marrë. Megjithëse nuk e kishim aspak idenë se si do të na ndihmonte Perëndia në lidhje me furgonin, ndjemë paqe për këtë çështje.

Gjatë asaj periudhe kohore, Drenda kishte shitur disa gjëra antike që i kishte gjetur te panairot e sendeve të përdorura. Ajo i kishte lënë një mesazh një burri se do të blinte disa dhoma mobiljesh, të cilat ai i kishte në shitje, një muaj para se furgoni të digjej, por nuk kishte mundur të kontaktonte me të. Disa ditë, pasi u dogj furgoni ynë, ai telefonoi dhe ra darkod që t'ia shiste Drendës këto tri dhoma plot me mobije për më pak se 1 000 dollarë. Drenda bëri një marrëveshje me një kompani ankand që t'i shisnin mobiljet për të dhe që në gjendje të negocionte komisionin e saj në ankand me një makinë të mirë të përdorur që e zotëronte kompania e ankandit, në vend të parave në dorë. Kështu që tani kishim një kamionçinë të mirë të paguar, kartë krediti të paguar dhe kredinë e furgonit të paguar.

Uau! Pra kështu operon Mbretëria. Në këtë pikë, ia vërtetuam vetes që sistemi i Perëndisë funksionon dhe u përkushtuam të vazhdonim të mësonim dhe të përdornim sistemin e Mbretërisë së Perëndisë që prej atij momenti. Ti mund të pyesësh, "Cilin parim përdorëm?" Më i madhi ishte të mos i besonim borxhit, por t'ia kërkonim Zotit atë që na duhej dhe ta linim të na tregonte se si ta korrnim atë.

Incidenti i furgonit më intrigoi dhe përforcoi një incident tjetër që ndodhi disa muaj më parë, por në atë kohë, nuk e kuptoja atë që po më tregonte Zoti. Ndodhitë nuk ishin lidhur ende në mendjen time që të formonin parimin e Mbretërisë.

Mua më pëlqen gjuetia e drerit, por kam dalë duarbosh për vite me rradhë. Dilja, ulesha në të ftohtë dhe largohesha ditë pas dite pa fat. Nuk ishte se thjesht më pëlqente gjuetia; kisha fëmijë për të ushqyer dhe sigurisht që mund të përdorja mish dreri. Kam pasur disa herë sukses në të kaluarën, por kishin kaluar vite që nga sezoni i fundit i

suksesshëm i gjuetisë së drerit kur çova mish në shtëpi. Një ditë, ndërsa isha duke menduar për sezonin tjetër të drerit, dëgjova zërin e Zotit. Ai tha, “Pse nuk më lejon të të tregoj se si ta marrësh drerin tënd këtë vit?” Kjo më trembi. “Të më tregosh se si të marr drerin tim këtë vit?” Çfarë do të thotë kjo? Duke u lutur për këto fjalë, u ndjeva i detyruar të mbjell një farë financiare ose dhuratë me qëllimin e përpiktë të korrjes së atij dreri. Ndjeva se Zoti po më thoshte që kur të mbillja farën për të marrë drerin tim, duhej të besoja që e kisha marrë përpara se ta merrja realisht, sipas Markut 11:24:

Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkon duke u lutur, besoni se do t'i merrni dhe ju do t'i merrni.

Edhe pse si i krishterë gjithmonë kam dhënë dhe e kam mbështetur kishën time, të mbillja në këtë mënyrë me qëllim të caktuar dhe të besoja se e kisha marrë ndërsa lutesha, ishte diçka e re për mua. Mora një çek dhe shkruajta te seksioni i përshkrimit, “Për drerin e vitit 1987”. Vura duart mbi të dhe ia dërgova me postë një shërbese në të cilën kisha besim dhe shpalla që e kisha marrë drerin ndërsa e postova. Duke jetuar në Tulsa, Oklahoma, me gjithë kufizimet e qytetit, unë me të vërtetë nuk kisha një vend ku të gjuaja, por një mik i imi nga kisha më ftoi të shkoja në shtëpinë e gjyshes së tij për festën e Falenderimeve. Ai tha që kishte disa drerë rrotull fermës. Kështu që familja ime në mëngjesin e Falenderimeve u nis të shijonte një ditë të shkëlqyer me ushqim dhe miqësi dhe për të marrë drerin. Miku im, në të vërtetë, nuk dinte të më thoshte se ku të shkoja, por aty ishte një kullotë e rrethuar nga pemë, dhe ai më sugjeroi të shkoja atje dhe të ulesha pranë një peme të madhe që ishte atje. Dëshiroj që ta kuptoni këtë pamje. Isha ulur në një kullotë me bar që kishte një pemë të madhe në mes. Kështu që u mbështeta te pema dhe vështroja drurët e tjerë që ishin rreth 120 metra larg meje. Tani që e mendoj përsëri, isha vetëm, i ulur atje në fushë të hapur pranë një peme; në të vërtetë ju nuk do ta quanit

situatë ideale.

Rreth 30 ose 40 minuta në mëngjes, pa e vërejtur, një dre po vraponte nëpër fushë pas meje drejt asaj peme. Pema ishte midis meje dhe drerit, kështu që dreri nuk më pa dhe as unë nuk e pashë. Dreri vrapoi drejt pemës që të hynte në pyll pa më parë që isha ulur atje. Ndërsa u afrua te pema, nuhati aromën time dhe ndaloi të kërkonte se ku ndodhesha. Dreri vështroi rrotull pemës dhe sytë tanë u ndeshën në të njëjtën kohë, në vetëm 5 metra distancë. Nuk jam i sigurt se kush ishte më shumë i habitur, por ai dre nuk humbi kohë aspak. Me një zhurmë të fortë, u kthye me shpejtësi drejt pyjeve. Unë isha ende i ulur atje, teksa dreri po largohej me shpejtësi prej meje, duke u përpjekur të ngrija pushkën dhe të gjeja shënjestrën.

Të përpiqeshe të kapje atë dre që vraponte me gjithë forcën dhe ta qëllonte nuk ishte e lehtë. Të them të vërtetën, nuk kisha qëlluar kurrë më parë një dre që vraponte. Më kujtohet që mezi e mbaja atë dre në shënjestër sepse ai vraponte dhe kërcente në ajër, siç bëjnë drerët kur vrapojnë. Por kur tërhoqa këmbëzën, dreri ra dhe nuk lëvizi. Isha i shokuar! Gjithçka ndodhi në një sekondë. Ajo goditje ishte në 100 metra largësi.

Me të dëgjuar të shtënë e pushkës, miku im erdhi dhe më uroi për drerin ndërsa e pa të shtrirë përtokë. Nuk i kisha treguar mikut tim se çfarë Zoti më kishte thënë lidhur me marrjen e drerit, por i thashë, “Nuk mendoj që kjo ishte për shkak të aftësive të mia.” Më pas nxorra nga xhaketa e gjuetisë një copë letër në të cilën kisha shkruar ditën kur postova çekun.

Aty thuhej thjesht, “Unë besoj që e kam marrë drerin e 1987-ës, në emrin e Jezusit.” Kisha shkruar aty ditën dhe orën kur isha lutur. Ia drejtova letrën mikut tim që ta shihte dhe i tregova se çfarë Zoti më kishte thënë të bëja.

Kjo gjë tërhoqi vëmendjen time. Unë isha i sigurt që kishte vepruar Perëndia. Por, për disa arsye, nuk e kuptoja që po trokisja në ligjin e Mbretërisë. Në fakt, termi “Mbretëri” nuk ishte diçka për të

cilën kisha menduar ndonjëherë. Kapja e atij dreri ishte mahnitëse, por a do të ndodhte sërisht? Pa konceptin e ligjit të Mbretërisë, nuk do ta dija si dhe çfarë ligjesh bënë që të shfaqej ai dre. Kështu që e regjistrova si një gjë prej Perëndisë dhe mezi prisja ta testoja sërisht sezonin e ardhshëm. Por para se të hynte sezoni, furgoni u dogj. Sapo furgoni u dogj dhe kamionçina u shfaq e paguar, Zoti pati vëmendjen time të plotë. Unë isha shumë i emocionuar teksa prisja gjuetinë e drerit sezonin tjetër. Dëshiroja të testoja teorinë time dhe të mësoja më shumë për Mbretërinë e Perëndisë. Sezoni i drerit nuk ishte dhe aq larg!

E qëllova atë dre të parë në Oklahoma në vjeshtën e vitit 1987. Por në Korrik të vitit 1988, u shpërngulëm në Ohajo ku isha rritur. Megjithëse isha rritur atje, kishin kaluar 12 vjet nga momenti kur isha larguar. Teksa rritesha nuk pata kurrë sukses në gjuetinë e drerit në Ohajo. Edhe pse isha përpjekur disa herë, kurrë nuk kisha qëlluar në shenjë. Sapo u vendosëm në shtëpinë që kishim marrë me qira në Ohajo, kuptova se nuk dija ku të gjuaja. Si djalë, kisha gjuajtur lepuj nga ana tjetër e rrugës së shtëpisë së babait, përgjatë një përroi që ishte atje. Unë kisha ngritur kurthe për vite me radhë ndërsa rritesha, por nuk kisha parë asnjë dre apo shenjë dreri në atë zonë. Një ditë, kur isha në kolegji, vëllai im thirri gjithë ngazëllim. Ai tha se kishte parë një dre përgjatë përroit pranë shtëpisë. Të dy u shokuam.

Duke kujtuar atë bisedë, vendosa që të shkoja te përroi në ditën e hapjes së sezonit të drerit.

I telefonova tim vëllai dhe i kërkova këshillë se ku të shkoja saktësisht te përroi. Megjithëse kishin kaluar disa vite që kur ai ishte kthyer aty, iu kujtua një pemë e madhe panje në kufi me përroin përgjatë pyjeve dhe mendoi ajo mund të ishte një vend i mirë. Meqenëse e kisha përshkuar lart e poshtë atë përrua gjatë gjithë viteve të adoleshencës, dija çdo kthesë të atij përroi dhe e kuptova saktësisht se për ku po më drejtonte im vëlla.

Drenda dhe unë kopjuam atë që Zoti na kishte treguar një vit

më parë në Oklahoma — mbollëm një farë, e mbajtëm shënim dhe besuam që marim kur lutemi, sipas Markut 11:24. Në atë kohë, Ohajo kishte një kufi gjuetie, dy drerë të cilësdo gjini, por ne me të vërtetë menduam se do të mbillnim për një dre dhe më vonë do të dilnim dhe do të merrnim një të dytë. Drenda dhe unë mbollëm një farë për drerin dhe besuam që e morëm kur u lutëm. Mrekullisht, për 40 minuta në mëngjesin e hapjes së sezonit të drerëve, unë zura jo një por dy drerë. Uau, me siguri e kishim kuptuar saktë se çfarë po ndodhte!

Një muaj më vonë, pashë një ëndërr për një ide biznesi. Biznesi përfshinte të gjitha njohuritë financiare që kisha marrë nga biznesi i sigurimeve, por kishte një qëllim tjetër në ëndërr. Nuk e kuptova plotësisht, por isha i sigurt që Zoti po më drejtonte të filloja biznesin tim dhe të largohesha nga firma me të cilën kisha punuar për tetë vjet. Në kohën e kësaj ëndrre, unë ende po punoja në shitjen e siguracioneve të jetës dhe letrave me vlerë.

Javën që pashë ëndrrën, kisha planifikuar një vizitë te një familje për të biseduar në lidhje me sigurimin dhe megjithëse biseduam për sigurimin e jetës, e dija që sigurimi i jetës nuk ishte nevoja apo problemi i tyre i vërtetë. Ata duhej të paguanin çdo muaj interesat e blerjeve që kishin bërë dhe kishin borxhe. Pjesë e planifikimit tim të zakonshëm për klientët ishte që të plotësonin një fletë me të gjitha të dhënat e tyre financiare. Kjo më lejonte të kuptoja se sa siguracion iu duhej.

Atë natë, ndihesha i mërzitur për këtë familje. Doja t'i ndihmoja, por nuk dija se si. U ula me fletën e tyre të të dhënave dhe fillova të punoja me disa mundësi. Ndërsa punoja me kalkulatorin tim financiar, u shmanga nga këndvështrimi i sigurimit të jetës dhe fillova të shoh se si mund të hiqja mënjane para nga buxheti i tyre mujor.

Duke riorganizuar disa gjëra dhe duke luajtur me kalkulatorin, u trondita nga fakti që kjo familje, pa ndryshuar të ardhurat e tyre, mund të ishte pa borxhe në më pak se 7 vjet, përfshirë hipotekën e tyre.

Në atë moment, kisha qenë në fushën financiare për 8 vite dhe nuk

kisha dëgjuar kurrë dikë të thoshte që kjo ishte e mundur. E ripunova çështjen pa pushim dhe mora të njëjtën përgjigje: 6,2 vite dhe ata nuk do të kishin më borxhe. Pastaj shkova te sirtari im i dosjeve dhe

**U TRONDITA QË KJO FAMILJE
MUND TË ISHTE PA BORXHE
NË MË PAK SE 7 VJET,
PËRFSHIRË HIPOTEKËN E
TYRE, PA NDRYSHUAR TË
ARDHURAT E TYRE.**

fillova të tërheq fletat e të dhënave të klientëve të tjerë. Bëra të njëjtat llogaritje dhe mora të njëjtën përgjigje: nën 7 vite pa borxhe. Sinqerisht, u trondita nga këto të dhëna.

Mendova se klienti im do të inkurajohej kur ta shihte këtë, kështu që vendosa të shkruaja një prezantim të këndshëm dhe ta paraqisja atë që kisha gjetur kur t'i

takojta për të folur në lidhje me nevojat e tyre të sigurimit të jetës. Ndihesha me të vërtetë keq për këtë familje. E dija se si stresi financiar ndikonte në çdo fushë të jetës dhe doja që ata të dinin se nuk ishin të pashpresë.

Kështu që i paraqita klientëve prezantimin tim të shkurtër dhe ndërsa kaloja nëpër shifra ata u shtangën. Pasi u tregova se sa shpejt mund t'i shlyenin borxhet, burri shpërtheu në lot dhe filloi të më falënderonte. Në të vërtetë, ndodhi si në televizion kur një familje fiton llotarinë ose çmimin e madh në një lojë. Ata vështirë se mund t'i besonin ato që po u thosha. Ishte vërtet një përvojë prekëse për ta, por edhe për mua.

Ndërsa mendoja rreth asaj mbrëmjeje, nuk mund ta rrokja faktin se thjesht duke riorganizuar asetet dhe shifrat e atij klienti qesh në gjendje t'u tregojta se si të shlyenin borxhet në më pak se 7 vite. Unë pashë ndikimin dhe shpresën që kjo gjë u dha atyre. Iu ktheva edhe njëherë dosjeve të klientëve të mëparshëm për të parë se sa prej klientëve të mi do të “çliroheshin prej detyrimeve të tyre në më pak se shtatë vite” dhe ishte surprizuese të shihje që 85% e tyre mund ta arrinin. Por kush do

t'ua thoshte njerëzve këtë? Pas asaj nate me atë familje dhe pasi punova me dosjet e klientëve të vjetër, kuptova që mund të filloja një biznes ku t'u tregoja njerëzve se si të shlynin detyrimet e tyre me planin tim.

Në atë kohë nuk isha çliruar ende nga borxhet dhe detyrimet e mia, por sigurisht që kisha empati për njerëzit që ishin financiarisht të stresuar dhe ky mision më thërriste shumë më tepër sesa thjesht shitja e sigurimeve të jetës. Fillova t'u tregoja të gjithë klientëve të mi të sigurimeve të njëjtin lloj prezantimi dhe të gjithë pa përjashtim u tronditën. Si një model biznesi, kisha disa probleme për të zgjidhur. Së pari merrte shumë kohë kryerja e llogarive me dorë dhe pastaj shkrimi i tyre po me dorë në një format prezantimi. Së dyti, si do të fitoja para duke bërë këtë gjë? Në fund, bëra një marrëveshje me një dizajner softuerësh kompjuterikë dhe mora një program që mund ta përdorja për ta prodhuar më shpejt planin. Sa i përket problemit tim të dytë, e dija që nuk mund t'u kërkoja njerëzve të paguanin për të dalë nga borxhet kur në të vërtetë nuk kishin para.

Fillova të lutesha për këtë. Një ditë pata këtë ide. Ndjeva vërtet se Perëndia më dha një ide se si të drejtoja kompaninë time, duke i ndihmuar njerëzit pa i detyruar të paguanin menjëherë dhe në të njëjtën kohë të fitoja para për vete. Sipas planit tim, do të kërkoja ato që i quaj para të humbura, para që klienti i kishte tashmë por nuk i shihte. Për shembull, do të bëja një krahasim të makinës, shtëpisë, jetës dhe siguracionit të shëndetit, duke kërkuar për mundësi kursimi. Do të krahasoja normat e hipotekës për të parë nëse ia vlente rifinancimi. Kontrollloja shumë gjëra të këtij lloji edhe pse nuk merresha personalisht me çdo fushë të biznesit që hulumtoja. Kur të shkoja në shtëpinë e klientit, do t'i tregoja mënyrat e kursimit dhe pastaj do t'i thoja të gjente vetë një kompani që mund të zbatonte idetë e mia ose të gjente një përfaqësues të kompanisë që kisha gjetur unë, e cila ishte më pak e kushtueshme për ta. Papritur, kuptova që mund t'u vendosja një tarifë referimi kompanisë ku dërgoja klientin. Në thelb, kisha bërë të gjithë punën duke i dhënë klientin tim kompanisë. Gjithçka që

ata duhet të bënin ishte të firmosnin. Kështu që fillova të kontaktoj shitësit, përfaqësuesit dhe profesionistët që u sugjerova klientëve të mi, u tregova se çfarë po bëja dhe i pyeta nëse mendonin se ia vlente një tarifë referimi. Të gjithë thanë «Po». Kështu që ja se çfarë bëra. Lashë kompaninë time të vjetër dhe hapa kompaninë time për të ndihmuar njerëzit të shlyenin borxhet. Biznesi mori hov dhe, në vazhdim, prodhoi para të mjaftueshme që unë dhe Drenda të shlyenim borxhet për dy vite e gjysmë! U ngazëllyem shumë! (Nëse jeni të interesuar të krijoni një plan falas, telefononi 1-800-815-0818. Ne vazhdojmë ta bëjmë këtë prej 28 vitesh!) Çdo ditë ishte një ditë e re ku Perëndia na tregonte gjithnjë e më shumë se si funksiononte Mbretëria e Tij. Kur po vizitoja një klient, Zoti më foli për punësimin e njerëzve dhe kthimin e biznesit tim të vogël në një biznes të vërtetë.

Ndërsa punësoja njerëz për të punuar me ne, biznesi ynë filloi të përparonte në nivele gjithnjë e më të mëdha. Unë ju tregova në hyrje se si filluam të paguanim me para në dorë për makinat tona dhe se si ndërtuam shtëpinë tonë të ëndrrave. Gjatë takimeve të mia mujore të biznesit me të punësuarit e rinj u tregoja për Mbretërinë e Zotit dhe njerëzit vinin te kompania ime për të dëgjuar më shumë për Mbretërinë dhe si ta zbatonin në jetën e tyre, po aq sa vinin edhe për vetë mundësinë e biznesit.

Mësimet që Zoti po më tregonte ishin të mahnitshme dhe, natyrisht, shumë nga ato mësimet i more ndërsa shkoja për gjueti çdo vit. Historitë që pashë duke gjuajtur ishin të mahnitshme, në mos më shumë se kaq. Unë nuk do t'i kisha besuar ato histori nëse nuk do t'i shihja të shpalosura para syve të mi. Çdo histori më mësoi diçka të re për Mbretërinë që unë nuk e kisha parë kurrë më parë. Mendova të përfshij disa prej tyre në këtë libër, por nëse vërtet dëshironi të lexoni historitë e mia të gjuetisë, mund të merrni një kopje të librit, *Faith Hunt* (Gjueti me besim) nga faqja ime e internetit.

Kjo histori ndodhi dy vite pas zbulimit tim të gjuetisë së drerit duke përdorur njohuritë e mia të sapo gjetura mbi Mbretërinë. Siç e

kam ndarë tashmë me ju, Perëndia më mësoi se si të mbillja për drerin tim dhe ta merrja atë si të kryer kur lutesha – dhe pa përjashtim, unë e korrrja drerin tim brenda 30 deri 45 minuta çdo vit. Kjo ka ndodhur për 28 vite tashmë. Gjithsesi, këtë vit të veçantë dola si zakonisht, plotësisht i sigurt se dreri do të shfaqej. Sigurisht, brenda pak minutave pash një dre që po largohej prej meje dhe gati po hynte në pronën e fqinjit tim 180 m larg. E dija që sapo ai dre të shkonte në ato pyje do të zhdukej, megjithatë e dija që ishte dreri im. Kjo ndodhi para se të mësoja ndonjë gjë në lidhje me gjuetinë me hark ose ndjelljen e drerëve. Unë e dija që dreri ishte e korra ime, por vështroja i pashpresë teksa dreri gati po hynte te pemët e fqinjit tim. Por krejt papritur ndjeva në frymën time, “Thuaji drerit të vijë te ti.” “Çfarë?

T’i them drerit të vijë tek unë; çfarë do të thotë kjo?” Nuk isha i sigurt, kështu që i fola me zë të lartë, por jo aq lartë mjaftueshëm sa dreri të më dëgjonte, “Dre, të urdhëroj të ndalosh, kthehu pas, dhe eja të qëndrosh nën pemë.” Gjuetinë po e bëja me hark dhe pjesën e fundit që të qëndronte nën pemën time shtova sepse doja që dreri të ishte vërtet afër. Kuptova që nëse besimi do të ma sillte përballë, atëherë po ashtu mund ta vendoste nën pemën time, ku mund ta godisja në shenjë.

Çuditërisht, kur i thashë ato fjalë, dreri u ndal menjëherë, u kthye dhe filloi të drejtohej për nga pema ime. U trondita kur ai dre përshkoi ato 180 m, erdhi direkt nën pemën time dhe qëndroi pa lëvizur pikërisht nën karrigen e gjuetisë, e cila gjendej vetëm 4 metra mbi të. Nuk kisha kamuflazh, as aroma, as nuk e kisha ndjellë, vetëm unë dhe Zoti, megjithatë ai dre po qëndronte tamam poshtë meje. Nuk mendoj se ndokush mund ta humbiste atë goditje. E mora atë dre në shtëpi me gëzim të madh, por nuk më largohej nga mendja ajo që kisha parë. A erdhi ai dre tek unë sepse i fola dhe e urdhërova? Sigurisht, ashtu dukej.

Ferma që kishim marrë me qera në Ohajo ishte rreth 360 metra katrorë dhe përbëhej nga një pjesë pylli, përrenj dhe fusha. Gjatë muajve të dimrit dhe veçanërisht nëse kishte dëborë, neve na pëlqente

shumë të dilnim për të gjuajtur lepuj. Në Ohajo sezoni i fazanëve me qafë unazore ishte paralelisht me sezonin e lepujve, por rrallë shihje ndonjë fazan në fermën tonë.

Një ditë të veçantë, dolëm për gjueti lepurit dhe po gjuanim nëpër pjesën e poshtme të përroit, veç kur u duk një fazan. E qëllova menjëherë. E dija që në momentin që tërhoqa këmbëzën që i kisha prerë vetëm krahun zogut. Fazani ra përtokë. Megjithatë, në momentin që goditi tokën, u ngrit dhe vrapoi aq shpejt sa i mbanin këmbët. Një fazan mund të vrapojë deri në 15 metra në sekondë, dhe ai zog po bënte gjithçka për ta vërtetuar këtë.

Toka ishte e mbuluar me një shtresë të re dëbore dhe zogu po vraponte përpjetë në kullota, kështu që mund të shikoja lehtësisht çdo hap që zogu merrte në arratinë e tij.

Qëndrova i pafuqishëm për një moment duke menduar se zogu do të largohej, por në frymën time pata një nxitje të papritur. Unë e dija se çfarë ndodhi kur e urdhërova drerin të ndalonte dhe të vinte drejt meje. E ndjeva që duhej ta provoja sërish, kështu që thirra me zë të lartë, “Fazan, në emrin e Jezusit, NDALO!” Në çast, nuk e pashë më zogun të vraponte. Mund ta shihja qartë të gjithë fushën dhe fazani ndaloi pikërisht në momentin që i foli. Djali im Timi ishte me mua dhe tha, “Babi, fazani ndaloi në momentin që i thirre.” Po ku gjendej tani fazani? Timi dhe unë ndoqëm gjurmët e tij në fushë dhe fazani gjendej në dëborë. Gjysma e kokës së tij ishte nën dëborë, ndërsa i gjithë trupi ishte jashtë mbi dëborë. Në anë të tij kishte pak bar, prandaj e kishim të vështirë ta dallonim nga larg. A kishte ngordhur? E mora zogun, i cili menjëherë përplasi fort krahët dhe klithi. Zogu ishte plotësisht i gjallë! Duke e vështruar zogun se ku mund të ishte plagosur, pashë që kisha goditur krahun e tij të djathtë. Timi dhe unë vështruam njëri-tjetrin të mahnitur. Askush nuk mund ta besonte atë që sapo kishim parë, askush.

Siç e kam përmendur më parë, Ohajo kishte një limit gjuetie prej dy drerësh të cilësdo gjini, por vetëm një dre në vit mund të merrje.

Ohajo po përpiqej të ulte numrin e drerëve duke synuar të kishte më shumë drenusha. Kështu që unë mund ta mbillja farën time për një dre dhe një drenushë dhe si me sahat, dreri do të vinte në 30 apo 40 minutat e para; dhe më pas, herën tjetër do të vinte drenusha. Një ditë mendova, “Prit një minutë; dreri erdhi tek unë ashtu siç shkrova kur mbolla farën time.” A mund të ishte e vërtetë? Çfarë do të ndodhte nëse e ndryshoja renditjen? Zakonisht unë mbillja për një dre dhe një drenushë dhe ata shfaqeshin sipas kësaj renditjeje. Kësaj here, unë mbolla për një drenushë dhe një dre në vend të një dreri dhe një drenushe; dhe sërish erdhën, por kësaj here drenusha erdhi e para dhe pastaj erdhi dreri. E ndryshova këtë për disa vite, duke e testuar teorinë time dhe funksiononte çdo herë. Teksa shikoja të ndodhnin këto gjëra, u mahnita plotësisht me Mbretërinë e Perëndisë dhe sa pak dija për të. Një gjë ishte e sigurt, Zoti po më tregonte që kisha shumë më tepër autoritet në lidhje me atë që ndodhte me jetën time nga sa kisha menduar ndonjëherë.

Ja një rast: ishte sezoni i drerit i vitit 2015. Unë mbolla për një dre katër-pikësh ose më të madh, një drenushë një-vjeçare dhe një kaproll një-vjeçar, për ushqim. Si me sahat, një dre gjashtë pikësh erdhi drejt pemës time; më pas, mora një drenushë njëvjeçare, e vetmja që erdhi te pema ime. E dija se herën tjetër do të shfaqej një kaproll. E di që tingëllon si çmenduri; unë vetëm po ju tregoj atë që pashë të ndodhte.

Por një gjueti dreri i bëri të gjitha kaq të qarta sa më trembi. Unë kisha mbjellë farën time për një dre katër-pikësh ose më të madh dhe pastaj për një kaproll (kaprolli llogaritet si drenushë sepse brirët e tij gjenden ende nën push dhe janë shumë të vogla). Unë dola si zakonisht dhe mora një dre tetë pikësh për 15 minuta. Kur dola herën tjetër isha i sigurt që kaprolli do të ishte atje.

Dy javë më vonë dola sërish dhe ndërsa po ulesha në karrigen time, pashë një dre tetë pikësh që vinte përmes kullotës rreth 270 m larg meje. Ai po vinte drejt pemës sime. Nuk u shman nga rruga që po ndiqte dhe erdhi direkt nga fusha për te pema ime dhe thjesht qëndroi

aty përreth 20 sekonda. Pastaj u rrotullua dhe u kthye nëpër atë kullotë përmes të njëjtin shteg që kishte ndjekur për të shkuar aty. Mos harroni, vetëm një dre ishte e ligjshme të merrje në Ohajo dhe unë e kisha marrë tashmë një dre tetë pikësh, kështu që duhej të qëndroja ulur dhe vetëm ta shikoja atë dre pa e qëlluar. Isha plotësisht konfuz. Kjo ishte hera e parë që dilja për gjueti dhe kisha një dre aq pranë meje, i cili nuk ishte saktësisht ai për të cilin kisha mbjellë farën. Mënyra se si veptoi ai dre, duke ardhur drejt meje nën pemën time dhe duke u kthyer sërisht tek i njëjti vend ishte shumë e çuditshme. Dukej sikur dreri kishte një detyrë. Unë prita gjithë mëngjesin, por kaprolli nuk u shfaq.

Atë natë në zyrën time isha i trazuar nga e gjithë kjo. Diçka nuk shkonte; kaprolli nuk u shfaq. Dhe pse u shfaq në atë mënyrë dreri tetë pikësh? Ndërsa qëndroja ulur, fillova të lutesha në frymë, duke i kërkuar Perëndisë të më tregonte se çfarë kishte ndodhur. Unë dëgjova zërin e Tij që më thoshte, “Shiko farën tënde.” Të shihja farën time? Unë e dija se për çfarë kisha mbjellë. Banka ime u bën kopje çeqeve të mia dhe pashë çekun që kisha shkruar kur mbolla për drerin tim. Mendoja se e kisha mbjellë farën time për dy drerë, një dre katër-pikësh ose më të madh dhe një kaproll që llogaritet si një drenushë, ashtu siç thashë më parë. Por ja se çfarë shkruhej te çeku im, “dy drerë katër-pikësh ose më shumë, një kaproll.” Megjithatë kisha dashur të shkruaja dy drerë, një katër pikësh ose më të madh dhe një kaproll, nuk kisha shkruar ashtu. Aty thuhej, “dy drerë katër pikësh ose më shumë dhe një kaproll.” Sa drerë janë? Tre, dhe i dyti ishte katër pikësh ose më i madh, njësoj si i pari. Kur e pashë këtë, u shtanga. Ai dre tetë pikësh kishte ardhur me një detyrë. Ai u gjend atje për shkak të ligjit të Mbretërisë. Fillova të hidhesha e të thërrisja nëpër shtëpi. Uau!!!!

Në të njëjtën kohë, ajo që pashë me trembi. Nëse ajo që pashë tregonte se sa saktë dhe specifikisht funksionon Mbretëria, atëherë duhej të tregohesha më i kujdesshëm. Padashur kisha bërë të ndodhnin ngjarje që në të vërtetë nuk doja të ndodhnin, megjithatë ato ndodhën sepse i kisha çliruar sipas ligjit shpirtëror. Atëherë kuptova që shumë

njerëz, përfshirë edhe mua, po përjetonin gjëra të cilat nuk dëshironin vërtetë t'i shihnin të ndodhnin,

por megjithatë, ata vetë kishin bërë të ndodhnin ato që po përjetonin. Mos harroni, me fjalët e Tij, Jezusi thau një pemë fiku dhe një herë tjetër thirri Llazarin të dilte nga varri. Në të dyja rastet përdori të njëjtin ligj për qëllime të ndryshme. Herën tjetër që dola për gjueti, ai kaproll u shfaq, pikërisht ashtu siç e kisha mbjellë.

E gjithë kjo seri ngjarjesh më zunë në befasi dhe patën një ndikim të jashtëzakonshëm në botëkuptimin tim mbi Mbretërinë. Në atë moment e kuptova, pa asnjë konfuzion, që Mbretëria është vërtet shumë specifike. A duhet të habitemi me këtë? Çdo ligj fizik në realitetin tokësor është po aq specifik. Unë mendoj se nuk e kuptoja fare që ligjet shpirtërore funksiononin ashtu si ligjet fizike, që në ekzistencë i sollën ligjet shpirtërore. Unë duhej ta kisha kuptuar por nuk e kisha kuptuar. Por tani e di që Mbretëria është specifike, shumë specifike.

Epo, meqë e kërkuat, do ju tregoj edhe një histori tjetër gjuetie. (I dua shumë këto mësimë që i mora gjatë kohës së gjuetisë, kështu që duhet të më duroni.) Kur kuptova se sa specifike ishte Mbretëria, vendosa të bëja një eksperiment akoma më specifik. Këtë vit, vendosa të mbjell për një dre shtatë-pikësh. Zakonisht, një dre ka të njëjtin numër pikësh në çdo anë. Dreri katër pikësh ka dy pikë në secilën anë; tetë-pikëshi ka katër pikë në secilën anë, etj. Por shumë herë, brirët e drerit nuk janë njësoj për arsye të ndryshme, kështu që kanë një numër të ndryshëm pikësh në secilën anë. Siç e thashë, zakonisht, ata kanë një numër të njëjtë pikësh në secilën anë.

Unë dëshiroja të çliroja besimin tim për diçka shumë specifike dhe që nuk ishte normë, sepse po eksperimentoja. Tashmë e kisha mësuar se sa më specifik të jesh, aq më gjatë do të të duhet të presësh dhe aq më të sakta do të jenë udhëzimet nga Fryma e Shenjtë për ta realizuar qëllimin. Kështu që ditën e hapjes së sezonit të drerëve, unë e dija se kur nuk duhej të dilja; e dija kur nuk ishte atje. Në fakt, prita gjatë gjithë tetorit dhe e dija në frymën time, “Jo, nuk ka ardhur ende.” Ishte

frustruese; ngjyrat e vjeshtës, drurët e pemëve, dëshiroja vërtet të dilja. Por prita. Më pas ndodhi kjo gjë. Një natë, kur isha i ulur në dhomën e ndenjes duke biseduar me prindërit e bashkëshortes sime, të cilët kishin ardhur për vizitë nga Xhorxhia, e dëgjova. Të nesërmen në mëngjes ishte dita e shumëpritur. Dreri shtatë-pikësh ishte atje! I tregova të gjithë familjes që do të shkoja të merrja drerin tim të nesërmen. U zgjova kaq i emocionuar dhe ia arrita qëllimit përpara se të errej.

Isha duke gjuajtur me hark nga një karrige në pemë prej së cilës vështroja kënetën prej katër hektarësh që kufizonte pyjet e mia. Është një vend i bukur. Rosat fluturojnë ndërsa ti qëndron ulur; kastorë, madje edhe nuselala mund të shihen aty rrotull.

Shkurret kufizojnë kënetën dhe është një nga vendet më të mira për drerët në pronën time. Ndërsa prisja në karrigen time, asgjë nuk ndodhi. Prita për 45 minuta, pastaj një orë, por asgjë.

Dëgjova të hapeshin dhe të mbylleshin dyer makinash rrotull shtëpisë sime dhe e dija se po largoheshin për në Xhorxhia prindërit e Drendës. U kisha premtuar atyre se do ta hanim mëngjesin bashkë përpara se ata të largoheshin, madje do të gatujmë unë. Plani im origjinal ishte ta merrja drerin tim shumë më herët dhe do të kthehesha në kohën e duhur për të përgatitur mëngjesin në shtëpi. Por dreri nuk kishte ardhur ende dhe unë me gjysmë zemre zbrita nga karrigia në pemë dhe u drejtova për në shtëpi. E dija nga përvoja me pronën që dreri vinte në zonën e kënetës më vonë në mëngjes, pasi ajo ishte një nga zonat kryesore ku pushonin, ashtu siç e përmenda. Oh mirë, e dija që dreri do të vinte nga minuti në minutë aty, por nuk mund të qëndroja më gjatë. Thjesht duhej të kthehesha sërish mëngjesin tjetër.

I përshëndeta të gjithë në shtëpi dhe fillova të gatuj mëngjesin. Unë jam ai që gatuj gjithmonë mëngjesin në shtëpi dhe e kam bërë këtë që nga fillimi. Kam recetën time të veçantë për waffles me grurë të plotë që janë absolutisht të mahnitshëm. Po lavdëroj veten në këtë rast. Vezët, suxhuku dhe grimcat e djathit kryesojnë në menu, por artikulli kryesor që e bën mëngjesin tim kaq të mrekullueshëm është shurupi

i panjës. Ohajo është vendi i shurupit të panjës dhe të gjithë njerëzit në zonën time bëjnë dhe shesin shurup panje. Unë nuk lejoj shurup fallco në shtëpinë time, vetëm atë të vërtetë. Kështu që ja ku jam duke gatuar mëngjesin dhe dritarja e kuzhinës tonë është përballë pemëve dhe kënetës. Krejt papritur, shoh një dre që kalon fushën dhe drejtohet për nga kënetë. Thirra me zë të lartë, “Ja ku është dreri im!” I thashë grupit që të merrte përsipër gatimin sepse do të shkoja pas tij!

Duke qenë se i kisha parë drerët e tjerë të kalonin fushën sipas të njëjtit drejtim si ky dre, e dija që edhe ky do të shkonte poshtë karrigës sime. Kuptova që nëse mund të shkoja për te karrigia nga ana e pasme dhe të ngjitesha aty përpara se dreri të mbërrinte, mund ta godisja. Të shkoja atje dhe të ngjitesha te karrigia në pemë përpara se dreri të arrinte do të ishte e vështirë, ndaj duhej të nisesha MENJËHERË! Vrapova drejt derës duke rrëmbyer harkun tim. Vrapova nëpër fushë dhe pastaj, me qetësi u ngjita ngadalë te karrigia. Deri më tani mirë, por nuk pashë asnjë shenjë të drerit.

Kur u ula pashë drerin teksa vinte përmes kënetës për nga karrigia ime. Dreri nuk po i kushtonte vëmendje asgjëje përveç drenushës që po ndiqte, ndaj as më pa dhe as më nuhati. Drenusha shkoi nga karrigia ime drejt kënetës dhe dreri po ecte në të njëjtin shteg. Nuk mund të kërkoja një organizim më të përsosur se kaq. Me drerin 23 m larg, mora shenjë me kujdes me hark dhe e lëshova shigjetën. E kuptova që në momentin kur u lëshua shigjeta që ia kisha dalë mbanë. Le ta pranojmë; isha pothuajse pa frymë nga vrapimi në anën e pasme të fushës përreth kënetës duke u përpjekur ta godisja drerin aty.

U zhgënjeva kur pash që shigjeta e goditi shumë poshtë dhe e kuptova që nuk kisha goditur në zonë jetike. Kur e godita, dreri kërceu në shkurret e dendura që rrethonin kënetën dhe ngadalë eci nëpër

**TANI UNË E DI, PA
ASNJË KONFUZION,
QË MBRETËRIA ËSHTË
VËRTET SHUMË
SPECIFIKE.**

fushë. Në gjuetitë e mëparshme kisha vënë re që kur gjuan me hark, ndonjëherë dreri nuk e kupton se çfarë ka ndodhur. Shumë herë ata thjesht largohen, për sa kohë nuk të kanë parë apo nuhatur. Gjithashtu dija që zakonisht një dre i plagosur shtrihet në shkurre dhe nuk shkon shumë larg. Duke qenë se dreri nuk më kishte parë, kjo ishte saktësisht ajo që po bënte. Me shumë qetësi zbrita nga pema dhe u drejtova për nga shtëpia nëpër shtegun që kisha ndjekur për të ardhur, duke u kujdesur që të mos trembja drerin.

Kur mbërrita në shtëpi të gjithë më pyetën se çfarë kishte ndodhur dhe nëse e kisha kapur drerin. I tregova të gjithëve atë që kishte ndodhur dhe i kërkova djemve të mi të vinin dhe të më ndihmonin të nxirrja drerin nga shkurrja, duke shpresuar se do të mund ta godisja sërish. Ne e rrethuam zonën e shkurreve dhe ngadalë u drejtuam drejt tij. Papritur, pashë që njëri nga djemtë e mi kishte hipur mbi dre dhe ai po kërcente në shkurren e gjatë. Ai ishte 65 m larg meje, duke kaluar nga e djatha në të majtë.

Papritur, dreri pa djalin tjetër në cep të fushës. Duke e kuptuar që nuk ishte i njëjti person që kishte hipur mbi të dhe duke mos ditur se cila ishte rruga më e sigurtë për të vrapuar, ndaloj që të vlerësonte mundësitë e tij. Unë e dija që ky ishte shansi im i vetëm nëse doja ta merrja. Ai nuk më kishte parë ende. Qëndronte 65 metra larg meje duke shikuar drejt djalit tim. Një hark ka mjaft energji që ta vrasë një dre në atë distancë, por shigjeta do të binte shumë metra më këtej në një distancë prej 65 m. Unë kurrë më parë nuk kisha qëlluar me harkun tim në atë distancë dhe ky nuk ishte një nga harqet më të reja me tërheqje 185 kile që mund t'i japë një shigjete shpejtësinë mbi 120 metra në sekondë. Saktësia e tij ishte e kufizuar në rreth 30 ose 35 metra.

Meqenëse dreri ishte afër dhe qëndronte i qetë, vendosa të gjuaj. Ngrita harkun, e drejtova sipër drerit me hamendësim dhe e lëshova shigjetën. Pashë shigjetën të fluturonte drejt drerit dhe, për habinë time, shigjeta e goditi drerin në qafë. Duke kaluar në gjysmën e qafës së

drerit (më falni për të gjitha detajet), shigjeta doli nga të dy anët e drerit dhe e mbyti. Ndërsa dreri u fut në shkurre, nuk pashë se ku kishte shkuar. Ngadalë fillova të ecja drejt shkurrese ku dreri ishte zhdukur. Aty ishte! Shigjeta e kishte bërë punën, dhe unë e kisha drerin tim.

Ndërsa djali im Timi u bashkua me mua, unë isha më i interesuar për brirët e drerit në këtë pikë sesa gjithçka tjetër. Në të vërtetë nuk kisha pasur një shans për t'ë numëruar, por ndërsa i numëruam, kishte shtatë pikë. Duke e parë nga më afër drerin, vumë re se ishte në të vërtetë një tetë-pikësh, por një nga cepat ishte thyer, duke e bërë dre shtatë-pikësh. Unë dhe Timi thjesht qëndruam aty me nderim ndaj Zotit dhe e lavdëruam Atë. Mbretëria ishte absolutisht e mahnitshme! Ndërsa Timi dhe unë qëndronim atje, gjithashtu kuptuam se “Kush do të na besonte? A e di ndokush se Mbretëria funksionon edhe në këtë mënyrë?”

Unë mendoj se ju e kuptuat thelbin. Mbretëria operon sipas ligjeve shumë specifike që janë vendosur dhe janë llogaritur të funksionojnë në të njëjtën mënyrë gjithmonë. Ishte shumë emocionuese në fillim kur kuptova që këto ligje funksiononin për çdo gjë, përfshirë edhe paratë. Unë mund t'ë mësoja këto ligje. Do mund të bëhesha shkencëtar frymëror dhe do të kuptoja më shumë se si operon Mbretëria. Perëndia do të më ndihmonte.

KAPITULLI 2

MJEGULLIM I KALTËR

Kur Drenda dhe unë filluam të shihnim Mbretërinë të vepronte dhe funksiononte në jetën tonë, shlyem çdo borxh dhe donim t'u tregonim të gjithëve që takonim atë që kishim mësuar. Ne u treguam të gjithëve që dëshironin të dëgjonin ndërsa filluam kishën tonë dhe unë drejtoja bizneset e mia. Por ndjeva në frymën time se kishte edhe diçka tjetër; nuk e dija se çfarë, por e dija që Perëndia po më drejtonte të bëja më shumë për t'u treguar të tjerëve për Mbretërinë.

Gjatë të gjithë vitit 2005 kisha një nxitje në frymën time, një dëshirë për të drejtuar atë që do ta quaja konferencë e revolucionit financiar, një seri prej pesë takimesh ku ndjeva se do të kisha kohë të parashtroja disa nga parimet financiare të Mbretërisë që kishin ndryshuar jetën time. Të rritur në një kishë metodiste, ndonjëherë mbanim takime javore rizgjimi. Ishte ky lloj modeli që unë pashë në frymën time, pesë sesione ku unë do të kisha kohë t'u tregoja njerëzve konceptet dhe principet që Perëndia më kishte mësuar në fushën financiare. Deri në atë kohë, unë kurrë nuk i kisha bashkuar këto parime në një format sistematik. Por në frymën time vazhdoja ta shihja veten duke zhvilluar një takim pesë seancash mbi financat.

Ndërsa po lutesha për këtë, u hasa me Lerin, një mikun tim që nuk e kisha parë për ca kohë. Ai më tregoi për një konferencë që do të ndodhte në Shqipëri, të cilën po e organizonte ai, dhe më ftoi të flisja atje.

Leri ka qënë në fushën e misionit në Shqipëri për pothuajse 12 vjet dhe ka patur një ndikim të madh në atë vend. Mendimi për të udhëtuar deri atje ishte pak i ri për mua. Unë nuk kam udhëtuar shumë dhe kurrë nuk kisha qënë në Shqipëri dhe nuk isha i sigurt nëse e dija se ku ishte Shqipëria. Leri më inkurajoi, duke thënë se ai po organizonte një takim mbarëkombëtar ku do të vinin shumë nga pastorët e atij kombi dhe ai mendoi se njohuritë e mia mbi financat e Mbretërisë do të ishin të dobishme për njerëzit. Leri tha se do të kisha dy ose tre sesione për të folur në atë konferencë. Megjithëse nuk ishin pesë sesione, unë sërish mezi prisja të jepja mësim mbi atë temë. Kështu që pranova me shumë dëshirë.

Kur zbrita nga avioni në Shqipëri, Leri më përshëndeti me një deklaratë të mahnitshme. “Geri,” tha ai, “një nga folësit e mi e anulloi ardhjen në minutën e fundit dhe ti do të kesh pesë sesione të plota.” Zemra ime kërceu nga gëzimi. Po, kështu duhet të jetë! Unë e dija që gjithçka ishte caktuar nga Perëndia dhe tashmë do të shikoja si do të zhvillohej ajo që pashë në frymën time. I kisha me vete shënimet e mia por nuk i kisha vendsour bashkë në një format prej pesë sesionesh. Kështu që çdo ditë unë do të jepja mësim, pastaj do të kthehesha dhe do të lutesha në frymë dhe do të shkruaja shënimet e mia për sesionin tjetër. Në çdo sesion, vajosja ishte e jashtëzakonshme.

Përpara se të vazhdoj më tej, duhet t’ju tregoj që Shqipëria ishte një vend jashtëzakonisht i varfër në kohën kur unë shkova. Paga mesatare ishte 500\$ në muaj dhe ryshfeti ishte një mënyrë jetese për njerëzit. Ndërsa mendoja të mësoja njerëzit mbi fushën e financave, nuk isha i sigurt se si do ta prisnin këtë. E dija që Fjala funksiononte për këdo, por kjo ishte një përvojë e re për mua. Ndërsa jepja mësim në sesionin e parë, në fillim ndieja një mur. Në sesionin e dytë, mund të ndieja urinë frymërore të njerëzve që më tërhiqte dhe mund të shihja besimin që rritej në fytyrat e tyre ndërsa dëgjonin lajmin e mirë të Mbretërisë.

Çdo ditë ndërsa jepja mësim, njerëzit bëheshin gjithmonë e më të lumtur, dhe mund të them që ishin të ngazëllyer për Mbretërinë.

Mbrëmjen para seancës së fundit që do të jepja mësim, Zoti më foli se do të mblidhja një ofertë për kishat lokale. Unë isha i pasigurt për këtë sepse, para së gjithash, nuk ishte takimi im; dhe së dyti, nuk isha i sigurt se si njerëzit do të reagonin. Leri dhe unë duhej të paguanim shumë për transportin dhe strehimin e pastorëve lokalë vetëm që ata të mund të vinin në takim. Unë fola me Lerin për këtë dhe ai më tha që ta mblidhja ofertën.

Kështu që gjatë sesionit të fundit mblodha ofertën për konferencën dhe vajosja ishte kaq e fortë sa që mezi qëndroja. Të gjithë në atë dhomë kërcenin dhe brohorisnin ndërsa sillnin paratë e tyre si ofertë. Bashkëpunëtorët mbanin koshat e ofertës ndërsa njerëzit që ofronin paratë e tyre po qanin dhe mezi qëndronin në këmbë. Kurrë nuk kisha parë diçka të tillë më parë, të paktën jo gjatë mbledhjes së një oferte. Ndërsa vështroja njerëzit që kërcenin dhe thërrisnin me gëzim kur jepnin, isha i tejmbushur nga vajosja dhe gjithashtu nga besimi i sigurt që i atyre që po jepnin një farë kaq të çmuar. Pas shërbesës, Leri sigurisht që u prek nga gjithçka kishte parë. Ai gjithashtu u befasua nga dy koshat e mbushur të ofertës që po merrnim në banesën e tij nga shërbesa e mbrëmjes. Leri më tregoi që zakonisht vetëm një kosh oferte ishte mbushur pjesërisht pas një takimi kur ai kishte mbledhur ofertë në të shkuarën. Lëvizëm shpejt dhe fshehëm koshat e parave ndërsa ecnim për në apartamentin e vogël të Lerit përmes rrugës së mbushur me njerëz.

Kur shkuam tek apartamenti i Lerit, u ulëm në dhomën e ndenjes dhe hapëm koshat e ofertës për të numëruar paratë. Ndërsa Leri i vendosi të gjitha në tryezë, ndodhi diçka që është shumë e vështirë për ta përshkruar me fjalë. Krejt papritur, një mjegull e lehtë kaltëroshë, mbushi dhomën dhe prania e Perëndisë na pushtoi.

Ne u ulëm përsëri nën vajosjen që mbushi vendin. Nuk i ngjante asnjë vajosjeje që kisha ndjerë më parë kur kam predikuar apo jam lutur për njerëzit. Përkundrazi, kjo vajosje kishte një prezencë në vetvete. Ishte e shenjtë dhe më bëri të ndihesha vërtetë në prezencën e vetë

Perëndisë. Ndërsa u ulëm atje, bëhej gjithmonë e më e fortë në dhomë. E vetmja gjë që mund të bënim ishte të uleshim dhe qanim. Më pas pashë, në mes të grumbullit me para që tani ishte mbi tryezë, unazën e martësës të një burri. Më preku shumë fakti se dikush atje atë natë, që nuk kishte para, dha të vetmen gjë që ishte e çmuar për të. Zoti më foli në atë moment dhe më tha:

“Unë po të therras ty për te kombet për t’i mësuar atyre këto parime që Unë të kam mësuar ty për Mbretërinë dhe financat. Kjo unazë u vendos sot në ofertë me besim të madh. Por unë dëshiroj që ti ta marrësh dhe ta ruash në përkujtim të kësaj nate. Dije që ashtu si një lidhje martese flet për një besëlidhje, ti po shpall besëlidhjen time të sigurimit për njerëzit e mi. Dhe dije që kudo që do të të dërgoj, Unë do të siguroj paratë që duhet të paguash”

Nuk munda të fle gjithë natën. Po qëndroja tek apartamenti i Lerit atë natë dhe vajosja mbeti aty. Përgjatë të gjithë Atlantikut, rrugës për në shtëpi, nuk munda të vë gjumë në sy. E vetmja gjë që mund të bëja ishte të vështroja jashtë dritares dhe kam lotuar për 8 orë fluturim. Nuk munda të fle për 46 orë pasi Zoti më foli atë natë. Për muaj me radhë, pas asaj nate, sa herë që mendoja për të, ndjeja të njëjtën prezencë dhe filloja të lotoja.

Unë nuk i tregova Lerit se çfarë Zoti më kishte thënë për atë unazë. Paratë e ofertës i përkisnin kishave në Shqipëri dhe e dija që ajo unazë mund të shitej gjithashtu për t’iu shtuar parave. Por e dija se çfarë Zoti më kishte thënë për të.

Prandaj u lumturova shumë kur Leri më telefonoi dhe më tha që Zoti i kishte folur atij që të ma jepte mua atë unazë. E montova në një bazament unazën dhe tani ndodhet në zyrën time. Ka patur shumë raste që e kam vështruar atë unazë dhe kam kujtuar fjalët që Zoti më

tha atë natë, teksa jam përballur me sfida të mëdha financiare përgjatë viteve që rrodhën. Padyshim, Perëndia ka qenë besnik duke siguruar gjithçka që kam patur nevojë për të ecur në drejtimin që më tregoi atë natë. Ajo natë në Shqipëri ndryshoi jetën time, por Perëndia kishte akoma më shumë për të më treguar në ditët që do të pasonin.

Kur u ktheva në shtëpi nga Shqipëria, ndjeva një nxitje të fortë për ta çuar këtë mesazh të Mbretërisë kudo që të mundja. Unë kisha një pasion kaq të fortë për ta ndarë këtë informacion dhe isha i etur të jepja përsëri mësim me pesë sesione dhe të shikoja nëse do të ndodhte e njëjta gjë. Nuk mu desh të prisja shumë gjatë. U ftova nga një pastor në Utah që të mund të shkoja për të dhënë mësim ato pesë sesione. Ai kishte dëgjuar nga Leri që mësimi kishte qenë jetë-ndryshues dhe dëshironte që unë të shkoja. Ai ishte pastor i një kisha të vogël dhe shumë të varfër indiane. Ata kishin nevoja financiare dhe nëse ajo që Leri më tha ishte e vëretë, ai mendonte se unë mund t'i ndihmoja.

Kështu që shkova atje dhe drejtova takimet të dielën në mëngjes, të dielën në darkë deri të mërkurën në darkë. Ishin po ato pesë sesione si në Shqipëri dhe mora të njëjtin reagim. Njerëzit brohorisnin dhe kërcenin natën e fundit të konferencës nën një vajosje shumë të fortë teksa jepnin ofertën e tyre. Nuk e pashë mjegullën e kaltër kësaj here, por ndjeva një vajosje të fortë përgjatë të gjithë pesë sesioneve. Pas sesionit të fundit, u shokova ashtu si Leri në Shqipëri, në ofertën e madhe vetëm 17 çifte kishin dhënë. E futa ofertën në një çantë oferte që mbyllej dhe e çova në zyrën time që të vazhdoja me të nesërmen. Në mëngjes vonë atë ditë më telefonuan nga zyra ime. Sekretarja ishte në telefon dhe unë e kuptova se diçka kishte ndodhur.

Zëri i saj dridhej dhe dukej sikur kishte qarë. Fjalët e saj ishin, "Pastor, ka ndodhur diçka me paratë që solle me vete." "Çfarë do të thuash, Treisi?" e pyeta. Ajo vazhdoi duke më treguar që kishte hapur çantën e parave për t'i numëruar dhe depozituar, por në momentin që e kishte bërë këtë, një vajosje e fortë kishte ardhur mbi të, në atë zyrë, sa që ajo kishte rënë në dysHEME. Sekretarja tjetër, kishte dëgjuar

zhurmën, ndaj kishte ardhur te qoshja dhe edhe ajo kishte filluar të dridhej nën atë vajosje. Treisi tha, “Çfarë ndodhi me ato para atje në Utah?” I thashë asaj që nuk e dija.

Disa javë më vonë, po jepja mësim mbi të njëjtat parime në një kishë të vogël në pjesën jugore të Ohajos. Në këtë kishë, ne kishim dërguar katër sesionet e para me DVD dhe ata i kishin parë katër javët e mëparshme. Unë shkova një të diel në mbrëmje për të përfunduar të pesë sesionet. Vajosja po trokiste sërish mbi ne. Kur mblodha ofertën atë natë, mora të njëjtin reagim që kisha parë në takimet e tjera. Njerëzit ishin kaq të lumtur ndërsa jepnin. Gjatë kohës së ofertës, kisha, vendosi një shportë përpara njerëzve, ku ata mund të hidhnin dhuratat e tyre. Këtë herë mjegulla e kaltër ishte

**POR JEZUSI JO VETËM QË
PAGOI PËR TË DREJTËN TONË
PËR TË SHKUAR NË QIELL, AI
GJITHASHTU NA MUNDËSOI
TË JETOJMË SI BIJ OSE
BIJA TË PERËNDISË DHE
TË SHIJOJMË BENEFITET E
MBRETËRISË SË PERËNDISË
KËTU NË TOKË.**

atje sërish. Ishte si një sferë me diametër rreth pesë metra rrotull shportës së ofertës ndërsa njerëzit jepnin. Vajosja ishte kaq e fortë saqë mu desh ndihmë për të shkuar te makina sepse nuk mund të ecja vetë.

Kur ndodhën këto gjëra, unë nuk e kuptoja vërtet se çfarë po ndodhte dhe nuk kam dëgjuar për këtë askund tjetër.

Unë vazhdova të zhvilloja konferenca dhe vajosja vazhdonte të ishte shumë e fortë. Dhe po,

mjegulla kaltëroshe u shfaq sërish në disa konferenca. Por pjesa që më çuditi më tepër ishte fakti që vajosja ishte te vetë paratë. Pas një konference, stafi im e kishte të vështirë të numëronte ofertën. E mbani mend që vajosja erdhi në apartamentin në Shqipëri kur Leri vendosi të gjithë ofertën mbi tryezë? Nëse merrje një nga paratë e dhëna në këto oferta, ndjeje menjëherë vajosjen dhe dridheshe. E di që kjo tingëllon

si çmenduri, por kjo është ajo që unë vëzhgova.

Si një shkencëtar frymëror, u habita nga të gjitha këto dhe e pyeta Zotin. Ai më foli dhe më tregoi se përse kjo vajosje kaq e fortë shfaqej tek oferta. Ai më tha se shumica e njerëzve japin nga detyrimi ose nga legalizmi. Disa japin si një formulë, por nuk besojnë me të vërtet kur japin. Shumica japin sepse mendojnë që Perëndia do të zemërohet me ta nëse nuk e bëjnë këtë. Disa japin njësoj sikur paguajnë një faturë. Ai më tha që ndërsa u mësioja rreth Mbretërisë së Tij dhe u zbuloja parimet e fshehura financiare të Mbretërisë, besimi lindte në zemrat e njerëzve. Më pas kur japin, ata besojnë vërtet dhe prania e Mbretërisë është aty dhe kështu rrjedh vajosja.

Që prej atij udhëtimi në Shqipëri në vitin 2005, jeta ime ka ndryshuar kaq shumë. Dëshira ime për të arritur njerëzit me lajmin e mirë të Mbretërisë, bëri që Drenda dhe unë të përdornim TV për të arritur kombet me këtë lajm të mirë. Fjalë për fjalë, tani po shpenzojmë miliona në vit për t'u treguar njerëzve për këtë Mbretëri që kemi zbuluar vite më parë. Por mbase ende nuk e keni dëgjuar lajmin e mirë të Mbretërisë. Ne ishim të tillë - besimtarë që do të shkonim në qiell, por nuk dinin si ta çlironin qiellin në tokë. Por Jezusi pagoi jo vetëm për të drejtën tonë për të shkuar në qiell, Ai gjithashtu bëri të mundur që të jetojmë si bij dhe bija të Perëndisë dhe të shijojmë përfitimet e Mbretërisë së Perëndisë këtu në mbretërinë e tokës.

Por më e rëndësishmja, janë me miliona njerëzit që duhet të arrijmë me lajmin e mirë të ungjillit dhe duhen para për ta bërë këtë. Njerëzit po shohin. Jetët tona duhet të duken ndryshe!

Çfarë ishte ajo që unë mësiova në Shqipëri që nisi atë vajosje? Çfarë ishte ajo që Zoti më tha t'u predikoj kombeve? Epo, ky është qëllimi i këtij libri dhe unë besoj se do të ndryshojë jetën tuaj ashtu si ndodhi edhe me mua.

KAPITULLI 3

TË LUTEM PERËNDI, KI MËSHIRË!

Xherri telefonoi në zyrën time dhe më pyeti nëse mund të vinte që të hanim drekën bashkë meqenëse ndodhesha në zonën e tij. Unë po bëja një intervistë në një stacion televiziv në një qytet afër tij dhe ai donte të më tregonte se si u ndryshua jeta e tij nga materialet e mia dhe transmetimi televiziv. Unë nuk e kisha takuar kurrë më parë Xherrin, por kam folur në telefon me të një apo dy herë. I thashë, “Sigurisht”. Sidoqoftë duhej të hanim drekë dhe mendova, teksa ndodhesha atje se do të më pëlqente ta takoja dhe të dëgjoja historinë e tij.

Në drekë takova Xherrin me të birin dhe Xherri filloi të më tregonte historinë e vet. Xherri ishte një pastor i cili kishte pastoruar për 30 vjet, por i ishte dashur të largohej nga shërbimi për shkak të një goditje në tru që e kishte lënë me aftësi të kufizuara. Gjatë kohës pasi kishte ndodhur goditja në tru, jeta e tij kishte ndryshuar tërësisht. Duke qenë se nuk mund të punonte, financiarisht, ferma e familjes pati rënie dhe doli në shitje. Pagesa e faturave dhe blerja e ushqimit u bë një sfidë po ashtu. Në fakt, Xherri tha që gjërat shkuan kaq keq sa që ai ishte ulur një ditë me armën e mbushur në një dorë dhe një Bibël në dorën tjetër, duke menduar t’i jepte fund jetës së tij.

Pikërisht në këtë gjëndje, plotësisht i pa shpresë, Xherri pa programin tonë në TV dhe porosi një kopje të materialeve të mia. Ai vazhdoi të më shpjegonte që kur i mori materialet në fillim, kishte një nevojë të ngutshme për rreth 2,000 dollarë për të mbuluar faturat

kryesore dhe ushqimin. Ai i kishte dëgjuar disa herë materialet derisa besimi kishte filluar të rritej në zemrën e tij. Ai vendosi t'i besonte Perëndisë për shifrën prej 2 000 dollarësh që kishte nevojë. Kështu që bëri atë që unë dhe Drenda bëmë me drerin tonë të parë. Ai mbollti një farë për ato 2 000 \$. Ai shkroi në një copëz letre datën, kohën dhe faktin që ai besonte se i kishte marrë ato para, sipas Markut 11:24 dhe ia dërgoi çekun shërbesës sonë.

Unë nuk isha në dijeni që kjo gjë po ndodhte sepse nuk kisha folur me Xherri. Ai tha se për rreth një javë e gjysmë një burrë erdhi te dera e përparme dhe kërkoi të fliste me të. Xherri e njihte burrin nga e kaluara e tij, por gjithashtu tha se nuk kishin folur prej kohësh. Ata kishin vazhduar një bisedë të shkurtër për pak, më pas burri i kishte thënë se kishte ardhur vërtet për t'i dhënë Xherrit një çek prej 2 000 dollarësh. Ai vazhdoi të shpjegonte se një javë e gjysmë më parë në filan ditë dhe në filan kohë, ai ishte ndjerë i shtyrë nga Fryma e Shenjtë për t'i sjellë Xherrit 2 000 dollarë.

Xherri ishte habitur. Me nxitim kishte hapur portofolin e tij ku kishte vendosur copëzën e letrës me shënimin e ditës dhe orës kur besoi se i kishte marrë ato 2 000 dollarë që kishte nevojë. Dita dhe ora e shënuar në letren e Xherrit përkohte saktësisht me kohën që ai burrë po i referohej se kishte ndjerë shtytjen nga Fryma për t'i dhënë Xherrit 2 000 dollarë. Xherri e dinte që kjo nuk ishte një rastësi; ai e dinte që kjo ishte një përgjigje direkte e Mbretërisë së Perëndisë, veçanërisht e ligjeve të Mbretërisë.

Ai e vazhdoi historinë e tij dhe më tregoi se kishte shtatë fëmijë, të gjithë të martuar, përveç një djali 16-vjeçar (ai që ishte me të në drekë), i cili ishte larguar nga Zoti kur pa të gjitha ato që babai i tij po kalonte. Djali ishte i zemëruar me Zotin sepse babai i tij kishte qenë besnik për 30 vjet dhe djali mendonte që Zoti e kishte braktisur.

Xherri donte të gjente një mënyrë për të arritur djalin e tij dhe ai kishte një ide. Unë flas shumë rreth gjuetisë së drerit në materialet e mia dhe tregoj se si Zoti më mësoi të gjuaj me besim. Gjuetia e drerit

ishte pasioni i djalit të tij, ndaj Xherri i shpjegoi djalit të tij se si të arrinte të merrte drerin e vet, sipas mënyrës së Mbretërisë.

Djali mendoi për këtë dhe më në fund ra dakord, atëherë ai dhe Xherri çliruan besimin e tyre, ashtu si Xherri kishte bërë për 2 000 dollarët e tij. Djali mori një dre të këndshëm në tetë minuta. Ndërsa Xherri dhe djali i tij e çuan drerin në dyqan te kasapi, Xherri kishte vendosur CD-në time në CD player. Ndërsa Xherri po çonte drerin në dyqan, djali tha se donte të qëndronte në makinë dhe të dëgjonte edhe për ca kohë. Kur Xherri doli, djali i tij tha: “Babi, mendoj se na ka humbur diçka gjatë gjithë këtyre viteve. Unë e di që dreri ishte rezultat i Mbretërisë së Perëndisë ”.

Djali i tij më pas ia kushtoi jetën Perëndisë dhe i tha babait se nëse Perëndia solli 2 000 dollarë dhe drerin, atëherë Ai mund të sillte edhe 17 000 dollarë që iu duheshin për të nxjerrë shtëpinë nga bllokimi.

Në këtë pikë u prezantova për herë të parë me Xherrin. Më kujtohet se letra e Xherrit erdhi me farën e Xherrit dhe të djalit të tij për të nxjerrë shtëpinë nga bllokimi. Mbaj mend që letra ishte e shkurtër, por thjesht shtronte ato që duheshin. Nuk ishte përmendur asgjë tjetër, thjesht çlirimi i shtëpisë nga bllokimi. Më kujtohet gjithashtu që vura dorën mbi atë letër dhe rashë dakort me ta. Mund ta kujtoj momentin dhe kohën e saktë që e bëra këtë .

Në këtë pikë, Xherri më tregoi se brenda dy javësh, një burrë tjetër kishte ardhur te dera e shtëpisë. Sërisht, ky ishte dikush që Xherri e kishte njohur në të shkuarën. Ky burrë i kishte thënë se e kishte parë shtëpinë në listën e ankandeve për shitje dhe kishte pyetur Xherrin se sa ishte shuma që duhej për ta nxjerrë shtëpinë nga bllokimi. Xherri i kishte thënë atij shumën prej 17 000 dollarësh. Ai burrë kishte shkruar një çek për të gjithë atë shumë menjëherë dhe ishte larguar. Xherri kishte shtangur te porta. Në këtë pikë, i ulur në tryezë përballë meje, ai po qante aty në restorant, duke më falenderuar për mësimet mbi Mbretërinë e Perëndisë. Xherri tha se ishte i gëzuar që të gjithë fëmijët e tij kishin parë dorën e Perëndisë dhe kjo i kishte dhënë atij

mundësinë që të ndante më shumë me ta mbi Mbretërinë e Perëndisë. E dua shumë këtë!

Ky është realiteti i Mbretërisë së Perëndisë dhe unë jam i lumtur për

**“SEPSE NË TË VËRTETË,
PO JU THEM, SE PO TË KENI
BESIM SA NJË KOKËRR SINAPI,
DO T’I THONI KËTIJ MALI:
“ZHVENDOSU NGA KËTU ATJE”,
DHE DO TË ZHVENDOSET;
DHE ASGJË NUK DO TË JETË E
PAMUNDSHME PËR JU.”**

— MATEU 17:20B

mundësinë që kam për ta ndarë atë me njerëzit dhe më pas të dëgjoj historitë e tyre. E shihni, Xheri nuk kishte nevojë për keqardhje. Ai kishte nevojë për përgjigje dhe i gjeti në Mbretëri.

Tashmë ndiej se duhet të shtoj diçka në lidhje me historinë e Xherrit. Edhe pse mund të duket sikur njerëzit thjesht erdhën në derën e Xherrit dhe i dhanë atij para, unë nuk dua që ju të kuptoni idenë e gabuar se përgjigjja juaj financiare thjesht do të shfaqet teksa jeni ulur

duke pirë një kola. Jo, ju duhet të luani pjesën tuaj në korrjen e asaj që ju nevojitet. Në rastin e Xherrit, ai kishte pastoruar për 30 vjet. Ai kishte mbjellë te këta njerëz për një kohë shumë të gjatë.

Dhe së dyti, Xherri nuk ishte në gjendje të largohej nga shtëpia e tij për shkak të goditjes në tru. Xherri korri nga ku kishte mbjellë, nga njerëzit në kishën e tij, te të cilët kishte mbjellë për të gjitha ato vite. Duhet t’ju them se Xherri ishte shëruar plotësisht nga goditja në tru dhe kishte humbur mbi 70 paund kur e takova për drekë atë ditë. Lavdi Perëndisë, ai mori Mbretërinë. Ju mund të thoni: “Epo, Xherri ishte një pastor; sigurisht, ai ka ditur gjithçka për Mbretërinë. Me sa duket jo dhe jam i sigurt që nuk është i vetmi nga ata që kam parë. Fatkeqësisht, shumë njerëz të kishës nuk dinë si të përdorin Mbretërinë e Perëndisë dhe të marrin përgjigjet e tyre. Një histori te Mateu ilustron se si mendojnë shumica.

Dhe kur erdhën afër turmës, një burrë iu afrua dhe, duke u gjunjëzuar para tij, tha: «Zot, ki mëshirë për birin tim, sepse është epileptik dhe vuan shumë; shpesh ai bie në zjarr dhe shpesh në ujë. Dhe e solla te dishepujt e tu, por nuk mundën ta shërojnë».

Dhe Jezusi duke u përgjigjur tha: «O brez mosbesues dhe i çoroditur! Deri kur do të qëndrojnë midis jush? Deri kur do t'ju duroj? E sillni këtu tek unë». Dhe Jezusi e qortoi demonin dhe ky doli nga djali; dhe që nga ai çast djali u shërua.

Atëherë dishepujt iu afruan Jezusit mënjanë dhe i thanë: «Përse ne nuk ishim në gjendje ta dëbonim?». Dhe Jezusi u tha atyre: «Prej mosbesimit tuaj; sepse në të vërtetë, po ju them, se po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t'i thoni këtij mali: “Zhvendosuni nga këtu atje”, dhe do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju.”

– Mateu 17:14-20

Në këtë histori, ne shohim një njeri që është i dëshpëruar; djali i tij po torturohej nga shpirtrat e këqij, pothuajse deri në vdekje. Duke dëgjuar shërbesën e Jezusit dhe që Jezusi kishte fuqinë për të dëbuar demonët, ai bëri plane për ta çuar djalin e tij te Jezusi në mënyrë që Ai ta shëronte. Sidoqoftë, kur arriti atje, ai zbuloi se Jezusi nuk ishte atje, por kishte marrë tre nga dishepujt e Tij në mal për t'u lutur. Dishepujt e tjerë që ishin atje thanë se nuk ishte problem; ata kishin dëbuar demonë që kur Jezusi u dha autoritetin për ta bërë këtë në emrin e Tij dhe mund ta bënin këtë gjë për djalin e tij. Por ndërsa ata u lutën për këtë të djalosh, demoni nuk u largua. Edhe pse u përpoqën, demoni nuk largohej. Babai ishte i mërzhitur dhe turma që ndiqte Jezusin ishte turbulluar.

Por pikërisht në atë moment, Jezusi dhe tre dishepujt arritën në

skenë duke zbritur nga mali. Jezusi, duke parë rrëmujën, pyet se çfarë po ndodhte. Babai i djalit shpjegoi se si e kishte sjellë djalin te dishepujt, por ata nuk kishin mundur ta dëbonin demonin. Atëherë babai bëri atë që bëjnë shumica e njerëzve kur përballen me një krizë dhe duket se nuk ka zgjidhje. Ai i thërret Jezusit për mëshirë. Edhe pse lutja për mëshirë tingëllon si një gjë e mirë për t'u bërë kur je i dëshpëruar, nuk ishte reagimi i këtij burri dhe nuk është as yti. Babai, duke dashur të ndjellë dhembshurinë e Jezusit për situatën e tij, vazhdon t'i tregojë Jezusit se si demoni e ka torturuar djalin e tij, duke e hedhur në zjarr dhe duke u përpjekur ta vrasë. Jezusi e ndalon atë burrë. Ai nuk kishte nevojë të dëgjonte më shumë nga mundimet që po kalonte djali i tij. Nga zhgënjimi, Jezusi bërtet, «*O brez mosbesues dhe i çoroditur! Deri kur do të qëndrosh midis jush? Deri kur do t'ju duroj? E sillni këtu tek unë*». Me një fjali të Tij, Jezusi shpjegon plotësisht se përse demoni nuk kishte dalë.

Por, para se të gërmojmë implikimet e asaj që tha Jezusi, duhet të riafirmojmë themelin mbi të cilin mbështetemi, që është se Perëndia nuk gënjen dhe nuk mund të gënjejë. Ajo që Ai thotë është e vërtetë. Duke zgjidhur këtë pjesë, mund ta vlerësojmë situatën me këtë thënie, «Demonët DUHET të dalin!» Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë ka diçka që nuk shkon dhe nuk është në dorën e Perëndisë por në tonën. Mos e harroni këtë, nëse nuk marrim dot nga Perëndia, problemi qëndron te ne. Jezusi na e tregon qartë arsyen se përse demoni nuk u largua - mendimi i çoroditur dhe mosbesimi. Ne do t'i trajtojmë këto dy arsye në rreshtat e mëposhtëm. Por në këtë pikë të diskutimit tonë, dua të përqendrohem te babai dhe djali i historisë.

Babai padyshim që ishte i dëshpëruar për djalin e tij. Kur dukej se nuk po ndodhte gjë teksa dishepujt u lutën për të, nuk mund të bëhej asgjë më shumë. Nuk kishte asnjë përgjigje të sigurt. E vetmja gjë që ai mendonte se mund ta ndihmonte nuk bëri ndonjë të mirë. Kishte mbetur vetëm diçka për të bërë dhe ishte të lypte mëshirë. Faza «të kërkosh mëshirë» do të thotë se dikush e ka fuqinë ose autoritetin për

të ndihmuar, por ka zgjedhur të mos ndihmojë.

Kështu, e vetmja gjë që mbetej për t'u bërë ishte të jepej një shpjegim i gjatë i torturës së tmerrshme që djali po duronte, duke u përpjekur që Jezusit t'i ngjallej dhembshuri për situatën.

Singerisht, kështu luten shumica e njerëzve, e dinë që Perëndia ka fuqi për të ndihmuar, por janë të pasigurt për përgjigjen e Tij, ata kërkojnë mëshirë. Pra, me lutje të gjata dhe shumë fjalë, ata paraqesin detajet e dhimbjes dhe rrethanave. “O At, ti e di që unë kam nevojë për ato para të premten; të lutem, Perëndi më ndihmo.” Ose “Perëndi, të lutem, nëse e shëron fëmijën tim, unë do të të shërbej gjithë ditët e jetës sime. Të lutem, Perëndi.” Unë nuk po hedh dritë mbi situatat me të cilat përballen njerëzit, por ju lutem vini re se sa shpejt Jezusi solli fuqinë e Perëndisë në mes të asaj situatë dhe e çliroi djalin. Këtë do Perëndia, kjo është dëshira e Tij. Nuk i mungon dhembshuria, fuqia apo autoriteti. Nuk ishte ky problemi në këtë histori. Jezusi shtron si problem mosbesimin dhe mendjen e çoroditur. Me fjalë të tjera, në këtë rast, mendimi i gabuar dhe mungesa e besimit të tyre penguan juridiksionin e Mbretërisë.

Mirë, këtu ka shumë për të folur, shumë çelësa të Mbretërisë dhe mënyra se si funksionon. Unë nuk dua të hyj plotësisht në disa nga gjërat që duhet të dini rreth kësaj, por të paktën do t'i përmend dhe do të studiojmë ligjet dhe funksionin e tyre më vonë.

Për të fituar një kuptim themelor të ligjit të Mbretërisë, duhet ta kuptojmë këtë pikë kryesore dhe themelore: Zoti i dha Adamit juridiksion të plotë mbi tokën. Ai duhej të sundonte mbi të.

Pastaj Perëndia tha: «Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne dhe të ushtrojë sundimin e tij mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit, mbi kafshët e mbi gjithë tokën, mbi gjithë rrëshqanorët që zvarriten mbi dhe» ”

– Zanafilla 1:26

Unë mendoj që Hebrenjve 2:7-9 e thotë shumë qartë:

Ti e bërë për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe e vure përmbi veprat e duarve të tua; Ti e nënshtrove gjithçka nën këmbët e tij”. Sepse, mbasi ia nënshtroi atij gjithçka, nuk la asgjë pa ia nënshtruar. Por tani nuk e shohim ende gjithçka të nënshtruar, por atë që u bë për pak kohë më i vogël se engjëjt, Jezusin e shikojmë të kurorëzuar me lavdi dhe nder, për shkak të vuajtjes së vdekjes, që me anë të hriti të Perëndisë për të gjithë njerëzit, të shijojnë vdekjen.

Të paktën për momentin, kuptoni që Perëndia nuk mund të ushtrojë autoritetin e Tij në realitetin tokësor (në mbretërinë e njeriut) derisa një burrë ose grua që ka juridiksion ligjor, të çlirojë këtu realitetin e qiellit.

Ja pse Jezusi i tha dishepujve të Tij tek Mateu 18:18:

**POR TI NUK JE I TILLË
MIKU IM; TI KE HYRJE TEK
DREJTËSIA E MBRETËRISË.
KA PËRGJIGJE PËR
PROBLEMET E TUA.**

*“Në të vërtetë ju them se
ç’të keni lidhur mbi tokë do të
jetë lidhur edhe në qiell; dhe ç’të
keni zgjidhur mbi tokë do të jenë
zgjidhur edhe në qiell.”*

Sërisht pra, qielli nuk ka juridiksion këtu në tokë derisa të jetë një burrë apo grua që e çliron atë autoritet këtu. Ja pse Jezusi po thotë këtu që nëse një burrë apo grua do të çlirojë autoritetin e qiellit në tokë, qielli do ta mbështesë atë. Nëse nuk e bëjmë, as qielli nuk mundet. Nëse ky mendim ju duket i çuditshëm, ju lutem mos ndaloni

këtu. Unë do ta trajtoj këtë temë me më shumë detaje, më vonë. Por për momentin, ta pranojmë këtë të vërtetë si arsyen se përse demoni nuk e la djalin - **nuk kishte pse ta bënte!** Demoni po vepronte sipas të drejtës së tij ligjore për të qëndruar aty, Të Lutem Perëndi, Ki Mëshirë! që kur Adami u largua nga Perëndia përmes rebelimit. Në atë moment Satani fitoi juridiksionin e tij mbi të gjithë njerëzimin.

Pastaj djalli e çoi (Jezusin) në një mal të lartë dhe, për një çast, i tregoi të gjitha mbretëritë e botës. Dhe djalli i tha: “Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse mua më është dhënë dhe unë ja jap kujt të dua. Në qoftë se ti, pra, duke rënë pëmbys, më adhuron, do të jetë krejt jotja”

– Luka 4:5-7

Si pasojë, Perëndia e humbi juridiksionin e Tij në realitetin tokësor ndërsa humbi njeriun që mbante atë — Adamin. Sërisht, unë do ta trajtoj këtë temë me më shumë detaje pak më vonë, ashtu siç thashë, por arsyeja kryesore se përse e nxorra në pah këtë histori ishte për të theksuar qëndrimin dhe dëshpërimin e babait dhe se si ai kërkon të lypë mëshirë. Ju lutem lexoni me shumë kujdes fjalitë pasardhëse.

Nëse nuk ka aspak autoritet apo ligj dhe një sistem për të administruar drejtësinë që të sjellë zgjidhje për një person në nevojë, atëherë lypja e mëshirës është gjithçka mbetet. Më lini ta them në një mënyrë tjetër. Nëse një person nuk ka zgjidhje ligjore ndaj një problemi dhe nuk ka asnjë qasje në një proces ku ofrohet drejtësi, atëherë nuk ka asnjë siguri se do të marrë përgjigje. Lypja është gjithçka ka mbetur për t'u bërë.

Por ti nuk je i tillë miku im; ti ke qasje te drejtësia e Mbretërisë. Ka zgjidhje për problemet e tua. Mbaj mend, një mbretëri është një formë qeverisjeje dhe funksionon me ligje që janë të paanshme dhe të disponueshme për çdo qytetar që jeton nën juridiksionin e asaj

mbretërie. Siç e kam përmendur më parë në këtë libër, Mbretëria e Perëndisë është ndërtuar mbi drejtësinë (procesi ligjor që ka qasje te autoriteti i Perëndisë për të zbatuar të drejtën që ligji i Tij thotë) dhe të vërtetën. Kishte një arsye se përse demoni nuk dilte dhe nuk ishte dobësia e Perëndisë apo një ndryshim i vullnetit të Tij.

Jezusi na e tregon këtë me anë të reagimit të shpejtë ndaj dishepujve të Tij dhe më pas shporr demonin jashtë.

**QË KUR NJERIU KA
LIGJSHMËRINË NË SFERËN
TOKËSORE, QEVERISJA E
PERËNDISË DHE AUTORITETI
I TIJ NUK MUND TË VEPROJNË
DERISA NJË BURRË OSE GRUA,
QË KA JURIDIKSION NË TOKË,
T'I BINDET PLOTËSISHT ASAJ
QË QIELLI THOTË, ATËHERË
ÇLIROHET AI AUTORITET KËTU.**

Shumica e të krishterëve, kur nuk shohim një demonstrim të Mbretërisë, e ndryshojnë doktrinën e tyre, duke thënë, “Jo të gjithë demonët mund të shporren.”

Ata e dinë që Perëndia e ka të gjithë pushtetin, ndaj supozojnë se Perëndia mund të bëjë gjithçka në realitetin tokësor. Pra nëse demoni nuk doli jashtë, atëherë Perëndia ka vendosur ashtu. Miku im, kjo është plotësisht e gabuar.

Jezusi tha se ishin mendimet E

TYRE të çoroditura dhe mosbesimi i tyre që e pengonin juridiksionin e qiellit në këtë rast. Me lejoni ta them në një tjetër mënyrë. Arsyeja që demoni nuk doli ishte një çështje ligjore – pikë! Ai nuk dilte sepse askush atje nuk e solli autoritetin e qiellit dhe juridiksionin ligjor. “Por, Geri, ata po përpiqeshin ta nxirrnin demonin jashtë.” Po, por, ashtu siç thashë, ligjërisht nuk kishte pse dilte.

Përse? Qielli nuk kishte aty juridiksion që ta nxirrte jashtë. Më lejoni ta perifrazoj atë që sapo thashë. Ata kishin një mendje të çoroditur, quanin të mirë dhe të pranueshme diçka që ishte e gabuar, duke patur

mendime të ndryshme nga ato të Perëndisë për një çështje të caktuar. Mosbesimi ishte gjithashtu një çështje madhore ndërkohë që kërkohej besim që juridiksioni i qiellit të vihej në veprim. Dishepujt nuk ishin të bindur dhe absolutisht të çoroditur. Ata kishin frikë.

Duke qenë se njeriu ka ligjshmëri në sferën tokësore, qeverisja e Perëndisë dhe autoriteti i Tij nuk mund të veprojnë derisa një burrë apo një grua, që ka juridiksion në tokë, t'i bindet plotësisht asaj që qielli thotë dhe ta çlirojë atë autoritet këtu. Të kesh një zemër që bindet ndaj asaj që qielli thotë quhet besim dhe askush nuk pati besim atë ditë. Ata ishin me dy mendje dhe plot mosbesim, duke e penguar kështu veprimin e autoritetit qiellor në atë shtatë. Por Jezusi kishte besim dhe e dinte që demoni do të dilte! Jezusi e mori situatën në dorë dhe demoni u largua. “Por, Geri, arsyja që demoni doli jashtë kur Jezusi e qortoi ishte vet Jezusi.” Vërtet? Le të shohim te Marku 6:5 kur Jezusi po shërbente në qytetin e tij.

Dhe nuk mundi të kryejë aty asnjë vepër të pushtetshme, veçse shëroi disa të sëmurë, duke vënë duart mbi ta.

Jeni dakord që Jezusi kishte të gjithë fuqinë për të shëruar? Atëherë duhet të jeni në gjendje të përgjigjeni se përse nuk mundi të bënte gjithçka dëshironte në këtë histori. Nevoja ekzistonte, por diçka e pengoi Atë. Ai përgjigjet në vargun 6, “*Dhe çuditej për mosbesimin e tyre.*” Besimi (marrëveshja me qiellin) i jep qiellit ligjshmëri në sferën tokësore. Për shembull, ju mund ta shihni lehtësisht këtë parim po të mendoni si u shpëtuan dhe i besuat Krishtit.

Sepse me zemër, njeriu beson në drejtësi dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.

— Romakëve 10:10

Ju besoni në zemrën tuaj (atë që qielli thotë) dhe drejtësoheni. Ky është një term ligjor, që nënkupton administrimin e ligjit dhe implikimin që qielli ka në sferën tokësore. Në një pamje të thjeshtë të këtij parimi, le të kujtojmë që Adamit iu dha dominim ligjor këtu në tokë dhe njeriu e ka ende këtë pozitë. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me paaftësinë e njeriut për të sunduar frymërisht, gjë që e humbi te Satani në Kopësht. Perëndia nuk mund të dhunojë pozitën ligjore që njeriu mban tani në sferën tokësore.

Kështu që, Perëndia duhet të gjejë një burrë ose grua, që do të jetë dakord me qiellin për të fituar ligjërisht qasje në qiell dhe ta shprehë në sferën tokësore.

Të Romakëve 10:10, do të vini re që janë dy gjëra që duhet të ndodhin përpara se autoriteti dhe fuqia e qiellit të çlirohen këtu në tokë. Të parën sapo e përmenda: duhet të jemi plotësisht të bindur dhe të jemi dakord në zemrat tona me atë që qielli thotë; ky quhet besim. Së dyti, duhet të kuptojmë që të qenit thjesht në besim nuk do ta çlirojë qiellin këtu. U habite? Më lini ta shpjegoj. Mendoni për një çelës drite. Ka elektricitet por duhet të shtypësh çelësin që të ndizen dritat. Kur ne besojmë në zemrat tona atë që qielli thotë, kjo e bën lidhjen me drejtësinë e qiellit. Por ne duhet ta çlirojmë atë autoritet këtu. Si në çdo shembull, duhet ta shtypim çelësin. Ne e bëjmë këtë kur shpallim dhe veprojmë sipas autoritetit të Mbretërisë.

E di që po përsëris veten, por të kuptosh këtë ligj të Mbretërisë është JETIKE në mënyrë që të kesh aftësinë për të marrë atë që ka qielli për ty. Ju do të merrni çdo gjë që duhet të merrni nga qielli në të njëjtën mënyrë si u shpëtuat – duke besuar në zemrën tuaj atë që qielli thotë dhe duke folur ose vepruar siç thotë qielli.

Mbretëria, siç e mësoi dhe e demonstroi Jezusi, ishte plotësisht diçka e huaj për dishepujt. Shumë herë, ne i shohim dishepujt të konfuzuar nga ajo që shihnin. Në Shkrimet që lexuam më sipër, unë besoj se dishepujt u trembën nga shfaqja e demonit dhe u bënë me dy mendje, duke e anuluar kështu besimin e tyre.

Unë po supozoj se ndërsa ata shkuan ta dëbonin këtë demon, ai u manifestua, ndoshta duke hedhur djalin poshtë dhe duke bërë një demonstrim të madh. Kjo mund të ketë nxitur frikë. Unë thjesht po spekulloj këtu, por për një gjë jam i sigurt. Diçka ndodhi që i bëri zemrat e tyre të mos ishin më dakord me qiellin dhe të përfundonin në mosbesim.

Nga ana tjetër, Jezusi ishte plotësisht i bindur për atë që tha qielli për një situatë të tillë dhe e urdhëroi demonin të largohej. Kështu siç mund ta shohim, problemi me demonin që nuk doli kishte të bënte me sferën tokësore, jo me atë të qiellit.

Nëse do të më duhej të zgjidhja vetëm një shkrim të shenjtë që do të ilustronte funksionin e Mbretërisë së Perëndisë në mbretërinë e tokës më mirë se çdo tjetër, do më duhej të thosha se është Marku 11:22–24.

Për të krijuar një pamje më të qartë, duhet të përsërisim disa vargje dhe do të shohim që Jezusi i foli një peme fiku dhe ajo u tha. Pasi nuk gjeti fruta në pemë, Jezusi e mallkoi.

Të nesërmen, ndërsa dishepujt kalojnë përsëri tek e njëjta pemë, zbulojnë se ajo është tharë. Pjetri habitet nga ajo që sheh dhe i thërret Jezusit i tronditur.

**“PRANDAJ PO JU THEM: TË
GJITHA ATO QË JU KËRKONI
DUKE U LUTUR, BESONI SE
DO T’I MERRNI DHE JU DO T’I
MERRNI.”**

— MARKU 11:24

“Dhe Pjetri, duke u kujtuar, i tha: «Mjeshtër, ja, fiku që ti mallkove qenka tharë». Atëherë Jezusi, duke u përgjigjur, u tha atyre: «Kini besim në Perëndinë! Sepse ju them në të vërtetë se, nëse dikush do t’i thotë këtij mali: “Luaj vendit e hidhu në det” dhe nuk do të ketë dyshime në zemër të vet, por do të besojë se ajo që po thotë do të ndodhë, çdo gjë që të thotë do t’i bëhet. Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkoni duke u lutur, besoni se do t’i merrni dhe ju do t’i merrni”

— Marku 11:22-24

Vini re se Pjetri u habit nga ajo që ndodhi. Si ndodhi kjo? Jezusi thjesht i kishte folur pemës. Dhe pa asnjë dyshim pema reagoi ndaj fjalëve të Jezusit dhe u tha. REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Jezusi më pas i tha Pjetrit një “të vërtetë”, një ligj të Mbretërisë së Perëndisë. Shpjegimi i Jezusit na e sqaron më mirë se si Mbretëria e Perëndisë ndërvepron në tokë. Në këtë shembull ne shohim përsëri të njëjtin ligj veprues për të cilin kemi folur; një burrë apo grua në tokë, i bindur plotësisht për ato që thotë qielli, (tashmë i/e drejtësuar) flet ose çliron autoritetin e qiellit. Sigurisht, njeriu në këtë histori, ishte Jezusi vetë, por Jezusi e bën shumë të qartë për dishepujt e Tij se «çdokush» mund të bëjë atë që sapo kishte bërë Ai.

Jam i sigurt që do të pranoni se nëse njerëzit do ta dinin me të vërtetë këtë dhe do ta kuptonin ligjin që Jezusi po u mësonte, ai do të kishte një ndikim dramatik në jetën e tyre. Unë e pashë ndikimin e Mbretërisë në jetën e familjes sime, por ishte gjithashtu e jashtëzakonshme të shihje Mbretërinë në familjet e tjera teksa u mësonim ato që kishim mësuar vet. Më lejoni të tregoj një histori në kishën time ku u demonstrua ky ligj. Shumë herë, të kesh njohuri mbi Mbretërinë dhe funksionin e saj bën dallimin midis jetës dhe vdekjes. Kjo ndodhi në këtë histori.

Xheniferi filloi të marrë pjesë në kishën time dhe të dëgjojë për besimin dhe Mbretërinë. Ajo u entuziazhua kur mësoi rreth autoritetit dhe të drejtave të saj në Mbretëri ndërsa ishte shtatzënë me fëmijën e saj të dytë dhe dëshironte të lindte në shtëpi. Kështu që filloi të studionte atë që Fjala e Zotit thotë për lindjen e fëmijës dhe premtimet e Mbretërisë, që do të zbatoheshin për fëmijën e saj. Ajo ishte e bindur se mund të lindte shëndoshë e mirë në shtëpi. Ajo u lidh me një mami dhe pyeti një nga gratë e kishës sonë, e cila kishte kryer vetë disa lindje në shtëpi, nëse mund ta trajnonte gjatë lindjes. Gjatë kohës që i paraprinte lindjes, ajo vinte në çdo shërbesë dhe përpinte parimet e Mbretërisë. Këto koncepte ishin të reja për Xheniferin dhe i pëlqeu shumë kur mësoi se në Mbretërinë e Perëndisë merrje përgjigje.

Fatkeqësisht, gjatë kësaj kohe, bashkëshorti i saj duhej të punonte

të dielave dhe ishte e pamundur që të vinte shpesh në kishë bashkë me të. Më në fund erdhi dita që bebi të lindte. Mamia dhe trajnuesja u telefonuan.

Ishte ora 2:00 apo 3:00 e mëngjesit kur ra telefoni që është pranë shtratis tim. Në anën tjetër, dëgjova trajneren e Xheniferit të bërtiste në telefon: «Pastor, të lutem lutu; foshnja ka lindur e vdekur!» Lajmi më zgjoi plotësisht. Trajnerja e lindjes më sqaroi që bebi ishte dërguar me ambulancë në spital. Ajo më bëri të ditur se në fakt, ekipi mjekësor e kishte shpallur foshnjën të vdekur pas mbërritjes.

Drenda dhe unë u ngritëm dhe u veshëm. Unë fillova të lutesha në Frymë, duke dëgjuar se çfarë duhej të bëja. E dija që djalli do të donte të shpifte për kishën tonë me këtë ngjarje.

Unë mund t'i imagjinoja titujt kryesorë të gazetave, “Vdes Foshnja Sepse Kisha Kult Inkurajon Lindjet në Shtëpi.” Ne me të vërtetë nuk mbajtëm një qëndrim të caktuar mbi çështjen se si duhet të lindë një fëmijë, qoftë në shtëpi apo jo, por shumë nga gratë zgjedhin të lindin në shtëpi; kjo ishte e vertetë. Drenda dhe unë vazhduam të luteshin në Frymë ndërsa ngisnim makinën për në spital, rreth 20 minuta rrugë. Në gjysëm të rrugës, papritur ndjeva Frymën e Perëndisë të vinte mbi mua dhe e kuptova që bebi do të bëhej mirë. Saktësisht në atë sekondë gruaja ime u kthye nga unë dhe më tha që Zoti i kishte thënë se bebi do të bëhej mirë.

Unë e dija atë që Zoti i kishte thënë gruas sime dhe mua, ndaj hyra në urgjencë, duke qenë kurioz për atë që do të gjeja. Në urgjencë pashë një grup prej shtatë apo tetë infermieresh që qëndronin rrotull një bebi normal që po qante. Vështrova me kujdes fytyrat e tyre. Në shumicën e rasteve kur një grup grash mbajnë një foshnje, sheh buzëqeshjet e tyre. Por kësaj here, nuk kishte asnjë të tillë. Përkundrazi, ato ishin të shokuara.

Takuam gruan që na telefonoi. Ajo sërish na infomoi se foshnja ishte deklaruar e vdekur në shtëpi dhe shtëpia ishte 20 minuta larg. Foshnja ishte deklaruar e vdekur edhe në spital kur kishte mbërritur,

por papritur, ashtu siç ishte, ishte zgjuar. Lavdi Perëndisë! Drenda dhe unë u mahnitëm kur e pamë foshnjen gjallë, pikërisht ashtu siç Fryma e Shenjtë na kishte thënë.

Ndërkohë, një ambulancë tjetër kishte transportuar mamanë e foshnjes, Xheniferin, për në maternitet. Si rrjedhojë, ajo nuk e dinte gjendjen e vajzës së saj. Gruaja ime, Drenda, u ngjit lart në repartin e maternitetit për ta kontrolluar. Kur shkoi drejt dhomës ku Xheniferi po pushonte, Drenda i tha, “Xhenifer, foshnja jote është shumë mirë dhe është një vajzë shumë e bukur.” Infermierja që po qëndronte te dera ndërhyri dhe në mënyrë të prerë tha, “Jo, ajo foshnje është në morg!” Gruaja ime me shumë empati e korrigjoi infermieren. Sot, për lavdi të Perëndisë, ajo foshnje, që quhet Heili, është një zonjushë e bukur, pa asnjë dëmtim të trurit apo çështje shëndetësore, të asnjë lloji. Duke ditur që Mbretëria e Perëndisë vepron bazuar në ligjet frymërore, unë e dija që ky rezultat nuk ishte rastesi. Pra, duke qenë shkencëtar frymëror (jo Shkenca e Krishterë, por dikush që studion se si Mbretëria e Perëndisë funksionon), dëshiroja të kuptoja saktësisht se çfarë kishte ndodhur.

Unë e dija që bebi Heili ishte shpallur zyrtarisht “mbërriti e vdekur” nga ambulanca që ishte në shtëpinë e saj. Unë gjithashtu e dija që foshnja ishte deklaruar e vdekur kur mbërriti në spital. Pra çfarë ndodhi? Bisedova me trajneren e lindjes, e cila ishte atje dhe i kërkoja të më tregonte me detaje gjithçka kishte ndodhur. Unë po kërkoja për të dhëna. Ajo tha se me lindjen kishte shkuar gjithçka mirë deri në momentin që kishte ardhur bebi. Ajo nuk kishte shenja jete dhe ishte e gjitha ngjyrë blu. Mamija ishte përpjekur ta risillte bebin në jetë por nuk kishte mundur. Trajnerja vazhdoi të më tregonte se Xheniferi kishte shumë pjesëtarë të famijes së saj atje, të cilët i kishte kapluar paniku.

Por Xheniferi me qetësi u kishte kërkuar të qëndronin të qetë dhe pastaj kishte vendosur gishtin në fytyrën e bashkëshortit të saj duke i thënë, “Mos thuaj asnjë fjalë – kjo bebe do të jetë mirë!”

E ndalova historinë e trajneres pikërisht aty dhe e pyeta nëse mund ta përsëriste atë që Xhenifer i kishte thënë bashkëshortit të saj. Ajo tha

të njëjtën gjë që kishte deklaruar më parë, që Xhenifer vendosi gishtin në fytyrën e bashkëshortit të saj dhe i tha, “Mos thuaj asnjë fjalë – kjo bebe do të jetë mirë!” Uau! Kaq ishte! Ky ishte momenti, deklarata që shpëtoi jetën e bebushes Heili. U ndjeva si një detektiv i cili sapo kishte zgjidhur një çështje madhore! Isha i gëzuar. Kjo gjë ishte kaq e thjeshtë, por shumë e thellë. Xheniferi thjesht kishte aplikuar ligjin frymëror në mes të asaj situate dhe kjo i kishte shpëtuar jetën bebes së saj! Duke medituat mbi këtë që sapo kisha mësuar, gjithçka mori kuptim.

Xheniferi e dinte që, për shkak të orarit të punës së tij, bashkëshorti i saj nuk ishte rritur në besim si ajo gjatë muajve të fundit. Ajo e dinte që, si kreu i shtëpisë së tyre, nëse ai do të binte dakord me skenën e tmerrshme të lindjes do të vuloste fatin e bebes. Ja pse reagimi i saj i parë ishte t’i fliste bashkëshortit dhe të mos e lejonte të binte në dakordësi me vdekjen e fëmijës së tyre. Përkundrazi, Xhenifer ishte e bindur që fëmija do të jetonte dhe do të ishte mirë, dhe ajo e deklaroi këtë me guxim e besim.

Sapo Xheniferi doli nga spitali, ajo takoi ekipin e ambulancës dhe i pyeti se çfarë kishin bërë për beben ndërsa po shkonin drejt spitalit atë natë. Ata e panë të turpëruar.

“Asgjë,” u përgjigj dikush.

“Çfarë do të thotë, asgjë?” pyeti Xheniferi, “A kryet CPR?”

“Jo,” thanë ata.

“A bëtë ndonjë gjë për beben?”

“Jo,” thanë ata sërish.

Ata i treguan asaj se bebja ishte thjesht e vdekur dhe nuk kishin asnjë shpresë për rikuperimin e saj. Sidoqoftë, bebja thjesht “u zgjua” kur mbërriti në spital! Ky ekuipazh i ambulancës u vlerësuan si reagimi i vitit nga spitali dhe zjarrfiksjë, një çmim vjetor bazuar në rezultatin e një situate të vështirë. Por ata pranuan se nuk kishin bërë asgjë.

Kohët e fundit kemi pasur Heilin me nënën e saj, Xheniferin, në transmetimin tonë televiziv; dhe të gjithë ne, me lot në sy, festuam përsëri Mbretërinë e Zotit. Ne festuam faktin se dikush që dinte të

vepronte brenda ligjit dhe autoritetit shpirtëror të Mbretërisë u gjend në skenë.

Në këtë histori shohim Xheniferin plotësisht të bindur për ato që thotë qielli, duke lëshuar atë autoritet në atë situatë me fjalët e saj. Ligji funksionon!

Një familje tjetër në kishën time pati përvojën e mëposhtme me të njëjtin ligj të Mbretërisë së Zotit. Dy motra kishin vendosur të hanin drekë së bashku, gjë që nuk ishte një detyrë e lehtë, pasi ato kishin 12 ose 13 fëmijë të dyja bashkë. Ndërsa po hanin drekë, vunë re se Joeli, djali katër vjeçar, mungonte. Ato kërkuan në të gjithë shtëpinë dhe nuk mundën ta gjenin. Kështu që menduan se ai ndoshta po fshihej, por prapë se prapë, pasi kërkuan në të gjithë shtëpinë, nuk e gjetën dot. Papritur Tinës, mamasë, i kaloi në mendje një mendim i tmerrshëm. Po te pishina në oborrin e shtëpisë? Ajo vrapoi për te dera e pasme me mbesën e saj, 13-vjeçaren Kortnei. Tina u tmerrua nga frika kur e gjeti Joelin në fund të pishinës, pa lëvizur. Askush nuk e dinte se prej sa kohësh gjendej aty. Tina urdhëroi me zë të lartë që të telefonohej 911-a dhe u zhyt në pishinë dhe e nxorri Joelin jashtë. Ai nuk po merrte frymë, ishte bërë gri dhe nuk lëvizte.

Vajza 13-vjeçare, e cila ishte rritur në departamentin e shërbesës së fëmijëve, i tha tezes së saj, “Jo, teze Tina, nuk kemi nevojë të telefonojmë 911-ën; ne kemi autoritet këtu. Ne duhet të lutemi.”

Kështu që ato të dyja filluan të luten, por asgjë nuk ndodhi. Tina thirri sërish, “Telefononi 911!”

Kortnei atëherë i tha tezes së saj, “Teze Tina, ne duhet të flasim jetë mbi të.” Kështu që Kortnei tha, “Joel, në emrin e Jezusit, zgjohu!” Papritmas Joeli u kollit, pështyu ujin dhe erdhi në vete, krejt normal.

Sa herë e mendoj këtë histori, mrekullohem gjithmonë, jo për shkak se djali u bë mirë, por mahnitem me 13-vjeçaren dhe gjendjen e saj mendore në atë moment. Në një situatë shumë stresuese mes jetës dhe vdekjes, ajo ishte në gjendje të vlerësonte se çfarë duhej bërë pa iu dorëzuar frikës. Kortnei riafirmoi se të dish se si funksionon Mbretëria

do të thotë më shumë se një predikim i këndshëm; do të thotë jetë a vdekje!

Sërish, vini re se si funksionoi ligji i Mbretërisë. Në fillim, Kortnei tha se ata kishin nevojë të luteshin, gjë që e bënë, por asgjë nuk ndodhi. Kjo sepse kur lutemi nuk çlirojmë autoritetin dhe fuqinë e Perëndisë. Por lutemi për drejtim. Kjo është pikërisht ajo që duhej në atë moment. Më pas do të vini re në histori që Kortnei thotë se ata kishin nevojë të flisnin jetë mbi të. Kur bënë këtë, ai u zgjua totalisht mirë dhe kështu është edhe sot e kësaj dite. Sërish, shohim zemrën që është plotësisht e bindur për ato që thotë qielli, por gjithsesi asgjë nuk ndodh derisa ai autoritet të çlirohet në mbretërinë e tokës nga një burrë apo grua që është në besim.

Më lejoni t'ju tregoj edhe një histori, që ndodhi shumë afër shtëpisë. Vëllai i Drendës e kishte çuar Kendin, gruan e tij, në spital për të sjellë në jetë fëmijën e tyre të pestë. Drenda dhe unë u ndalëm pranë spitalit atë mëngjes kur Kendi po lindte për të parë anëtarin më të ri të familjes. Ne menduam se lindja kishte ndodhur shumë më përpara se të arrinin ne atje. Por siç e zbuluam, për shkak të disa vonesave, lindja sapo kishte ndodhur. Ndërsa ecnim në repartin bebeve të martenitetit, bebushi Holland sapo po sillej në infermieri. Ashtu siç disa mund ta kenë parë, ai vend është një dhomë e rrethuar nga xhama që të lejojnë të shohësh të sapolindurin kur sillet aty.

Sapo e sollën Hollandën e vogël, menjëherë vura re që ishte pothuajse e bardhë. Të gjithë fëmijët e Xhonit ishin pothuaj të bardhë, me flokë bjond; dhe në fillim mendova se mungesa e ngjyrës ishte normale për fëmijët e tij kur lindnin. Por gjithsesi, ajo nuk dukej mirë. Papritur, doktorët filluan të vraponin.

Infermieret menjëherë mbyllën perdet që të mos shikoja asgjë dhe e dija që kjo nuk ishte shenjë e mirë. Edhe pse e mbuluan vendin me perde, kishte një çarje përmes së cilës pashë gjithçka po ndodhte.

Infermierët filluan të tërhiqnin pajisjet dhe një mjek filloi të bënte CPR mbi Hollandën e vogël.

U drejtova për te dera tjetër e infermierisë ku mund të dëgjoja qartë se çfarë flisnin mjekët. Ndërsa dëgjoja, u trondita kur i dëgjova të thoshin se foshnja nuk kishte rrahje zemre dhe ata nuk mund ta bënë zemrën të reagoje. Ndërsa vazhdoja të dëgjoja, mund të dëgjoja monitorin e zemrës që rrihte aq shpesh. Dëgjoja një rrahje, pastaj

kalonin 15 ose 20 sekonda dhe dëgjoja një rrahje tjetër. Hollanda nuk kishte rrahje zemre!

MOS HARRONI QË LIGJET E MBRETËRISË FUNKSIONOJNË PËR KËDO NË ÇDO KOHË!

Doktori doli nga dhoma dhe shkoi për te Xhoni duke i thënë, “Nuk duket mirë, Xhon; më vjen keq, ne po përpiqemi shumë.” Nuk na lejuan brenda, kështu që

Drenda dhe Xhoni vunë duart te dera në njërin skaj dhomës dhe unë vura duart te dera në skajin tjetër. Filluam të luteshim dhe të shpallnim që Hollanda e vogël do të jetonte dhe nuk do të vdiste dhe se do të bëhej mirë. E urdhëruam atë zemër të rrihte në emër të Jezusit.

Papritmas, mjeku i cili kishte qenë duke biseduar me Xhonin doli nga infermiera me një nxitim të madh. Ai u turr nga ne pa thënë asnjë fjalë.

Pas pak minutash, u kthye me nxitim me një infermiere që e ndiqte, duke folur me zë të lartë: “Doktor, ne nuk mund ta bëjmë atë. Ne nuk jemi të autorizuar në këtë spital për të kryer atë procedurë. Nuk mund të të lejoj ta marrësh atë gjak”. Ai nuk i kushtoi vëmendje asaj kur u kthye përsëri në sallë. Kapi një manual dhe mund të them se po studionte me kujdes se si të kryente një procedurë. Unë e pash përmes një të çare mes perdes kur u çua dhe filloi të fuste një tub të gjatë te foshnja. Tani e kuptova se ai po i jepte foshnjës gjak.

Papritmas, dëgjova rrahjet e zemrës që filluan. Ishin të shpejta dhe u barazuan me rrahjet normale të zemrës së një të porsalinduri. Brenda një minute mjeku doli dhe tha: “Kishte engjëj atje; më ndihmoi Zoti me këtë fëmijë!” Mund të themi se ai ishte tronditur. Atëherë zbuluam se nuk ishte në detyrë dhe nuk ishte përfshirë në lindjen e Kendit. Ai

sapo kishte ardhur nga spitali për të kontrolluar një pacient tjetër në momentin kur ndodhi e gjithë kjo. Mund të them se mjeku ishte ende i mahnitur nga ajo që kishte ndodhur teksa na thoshte që Hollanda nuk kishte pasur rrahje zemre për 36 minuta!

Sot Hollanda është një katër vjeçare normale. Besoj se fakti që ne e kuptonin se si funksiononte ligji në Mbretërisë solli zgjidhje për atë situatë. Më kujtohet edhe tani kur vura duart te dera e sallës së bebeve, duke menduar me vete: “Nuk do të ketë një funeral për mbesën e vogël të Drendës! Jo para syve tanë!”

Ndërsa ndalemi për të menduar sesi Mbretëria ndikoi në secilën nga historitë që kam ndarë deri tani, do të doja që të mbani mend se ligjet e Mbretërisë funksionojnë çdo herë, për këdo! Siç thashë në fillim të këtij libri, ligjet natyrore të mbretërisë së tokës sjellin të njëjtat rezultate çdo herë. Ato janë të paanshme dhe funksionojnë për këdo që do të gjejë kohë t'i mësojë dhe t'i zbatojë ato. Energjia elektrike funksionon njësoj si në SHBA dhe në Afrikë; nuk ka asnjë ndryshim.

Kur fillova të kuptoj se Mbretëria e Perëndisë ishte një Mbretëri me ligje të mirëpërcaktuara edhe pse të fshehura, e dija se kisha gjetur përgjigjen e problemeve të mia. Kuptova që kurrë nuk kishte qenë Perëndia Ai që po më mbante sekrete, duke zgjedhur të mos më bekonte ose të mos më ndihmonte në kohën time të nevojës. Jo, kuptova që Perëndia më kishte dhënë gjithçka që do të më duhej në jetë, përmes Jezus Krishtit, i cili përmes sakrificës së Tij më lejoi qasjen te gjithçka që ka qielli. Atëherë e kuptova që Mbretëria vepronte me ligje të përcaktuara që unë mund t'i mësoja dhe t'i zbatoja në jetën time.

Fillova të lexoja çdo histori në Bibël me një mendje të ndryshuar, duke kërkuar të dhëna që zbulonin ndonjë ligj tjetër të Mbretërisë. Unë u angazhova të isha një shkencëtar frymëror në mënyrë që të mund të mësoja pse ndodhën ato që ndodhën në historitë biblike që kisha lexuar atëherë. Ky varg tek 1 Gjonit tingëllon qesharak dhe i çuditshëm për shumë njerëz. E di që e kemi lexuar më herët, por le ta lexojmë përsëri, sepse ai kumbon të vërtetën që është edhe përgjigja juaj.

Kjo është siguria që kemi përpara tij: nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të tij, na dëgjon. Dhe nëse dimë se na dëgjon për atë që i kërkojmë, ne dimë se marrim kërkesat që i kemi kërkuar

– 1 Gjonit 5:14-15

Unë e pëlqej shumë këtë varg sepse flet për ligjin dhe ligji na jep siguri se do të marrim drejtësi. Kjo është siguria jonë - nëse kërkojmë diçka sipas vullnetit të Perëndisë (ligjit, atë që Perëndia e quan të drejtë), Ai na dëgjon. Pra, ky term “na dëgjon” nuk po thotë që Perëndia dëgjon fjalët tona të dëgjueshme, megjithëse Ai e bën këtë. Por përkundrazi, thotë që Perëndia merr situatën nën kontroll. Nëse mendoni për një gjykatës, i cili merr përsipër një çështje dhe sundon sipas rregullave të ligjit, jo sipas ndjenjave të tij (të paktën kështu duhet të funksionojë), atëherë do ta kuptoni këtë varg.

Ai na dëgjon—Ai e merr çështjen apo e dëgjon çështjen dhe ne mund të jemi të sigurt që do të marrim drejtësi, atë që na përket ligjërisht.

Miku im, me të vërtetë mendoj se duhet të ndalesh dhe ta lexosh përsëri, ngadalë. Nëse ajo që sapo keni lexuar është e vërtetë dhe në fakt është, atëherë jeta juaj do të jetë përplotë me gëzim! Njerëzit që luten pa këtë njohuri nuk kanë besim; ata thjesht pëshpërisin kur luten. Jezusi e tha këtë te Mateu 6:7–13.

“Por kur luteni, mos përdorni përsëritje të kota si paganët, sepse ata mendojnë se do të dëgjohen ngaqë kanë përdorur shumë fjalë..

– Mateu 6:7

Fjala «përsëritje të kota» do të thotë të nxjerrësh një ngatërrim të pakuptimtë fjalësh ose tingujsh. Kështu luten shumica e njerëzve. Ata nuk e njohin aspak të drejtën e tyre për të pasur drejtësi, madje as për atë që Perëndia u ka dhënë tashmë ligjërisht në Mbretëri. Ju nuk keni pse të lypni ose të qani për diçka që tashmë e keni!

Le të supozojmë se një oficer policie po qëndron në rrugë dhe po i thotë një shoferi kamion të ndalojë dhe fillon të qajë e të lutet që kamioni të ndalojë. “Të lutem, kamion, ndalo. Ki mëshirë për mua. Të lutem shumë, të lutem, ndalo.” Kjo do të ishte fyerja më e madhe dhe më e turpshme për kombin e Shteteve të Bashkuara dhe sistemin e tij ligjor. Jo, ai oficer policie qëndron drejt dhe i thotë qartë kamionit që të ndalet, ai e ndal bazuar në ligjin e vendit dhe pozicionin e tij si oficer policie që përfaqëson qeverinë e kombit.

Njerëzit që i lypin Perëndisë nuk kanë asnjë ide rreth ligjit të vendit ose pozicionit të tyre. Arsyeja përse një oficer policie lyp që një kamion të ndalojë është fyerje e madhe për kombin sepse ai po portretizon një komb pa ligj dhe autoritet. Gjithçka që do të ketë në atë lloj kombi është anarkia. Kur të krishterët lypin dhe vazhdojnë, portretizojnë Mbretërinë e Perëndisë si të dobët, duke mos ofruar asnjë përgjigje.

Kjo i bën njerëzit të dyshojnë në gatishmërinë e Perëndisë ose aftësinë e Tij për t’i ndihmuar, kur gjatë gjithë kohës, ata kanë të drejtë në atë që po kërkojnë. Jezusi na jep një përgjigje të qartë në lidhje me këtë lloj lutjeje të uritur - «NDALO!”

“Por kur luteni, mos përdorni përsëritje të kota si paganët, sepse ata mendojnë se do të dëgjohen ngaqë kanë përdorur shumë fjalë. Mos u bëni, pra, si ata, sepse Ati juaj e di ç’nevoja keni, para se ju t’i kërkon. Ju, pra, lutuni kështu:

“Ati ynë që je në qiej, u shenjtëroftë emri yt. Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt në tokë si në qiell. Bukën tonë të përditshme na e jep sot. Dhe na i fal fajet tona, siç ua falim edhe ne fajtorëve tanë. Dhe mos lejo të biem në tundim, por na shpëto nga i ligu, sepse jotja është mbretëria dhe fuqia, dhe lavdia, përjetë. Amen”.

– Mateu 6:7-13

Mbani mend, Jezusi në këtë varg po na mëson se si të lutemi. Fatkeqësisht, shumë njerëz i mbajnë këto vargje nëpër pllaka të bukura në shtëpitë e tyre por nuk i kuptojnë. Pasazhi quhet Lutja e Zotit, por Ai po mëson dishepujt e Tij se si të luten me anë të këtyre fjalëve. Ai nuk po lutej siç bëjmë ne në shërbesat tona të kishës. Ato fjalë janë një manual udhëzimi, ku të tregohet se si të lutesh dhe të marrësh rezultate, nuk janë fjalë për t'u mësuar përmendësh.

“Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt në tokë si në qiell” është një udhëzues se si të lutemi. Ne duhet të lutemi, duke sjellë vullnetin e Perëndisë që është në qiell në realitetin tokësor dhe në situatat tona. Pra, cila është përgjigja juaj? Besoni atë që Perëndia thotë se është juaja dhe përdoreni autoritetin në Mbretërinë e qiellit për të sjellë qiellin në sferën tokësore dhe për të plotësuar nevojat tuaja dhe të atyre rreth jush.

Pra, ndaloni për një moment dhe mendoni. Nëse do ta dinit pa asnjë hije dyshimi se lutja juaj është e efektshme dhe i gjithë qielli e mbështet atë, a do t'ju bënte kjo të sigurt kur luteni? PO!!! Duke e ditur saktësisht se cilat janë të drejtat tuaja ligjore si një qytetar i qiellit, duke ditur atë që tashmë ju është dhënë lirisht dhe duke kuptuar procesin e marrjes dhe duke shijuar përfitimet e këtyre ligjeve, ju mund të jetoni krejt ndryshe – sipas mënyrës së Mbretërisë. Çfarë do t'i ndodhte frikës? Çfarë do t'i ndodhte pasigurisë? Si do ta nxiste kjo njohuri sigurinë në mes të një stuhije? Ky ishte ndikimi që Mbretëria pati te Drenda dhe unë kur filluam ta zbulonim. Shpesh mahniteshim me atë që shikonim. Jo, më lejoni ta them sërish. Vazhdimisht mahniteshim dhe surprizoheshim! Akoma më shumë, mahniteshim me autoritetin që Perëndia i ka dhënë kishës për të vepruar në emër dhe përmes asaj qeverie këtu në mbretërinë e tokës.

sepse LIGJI i Frymës së jetës në Krishtin Jezus më çliroi nga LIGJI i mëkatit dhe i vdekjes.

– Romakëve 8:2

Të kuptonim që ishim të lirë nga “ligji i mëkatit dhe vdekjes” dhe që na ishte dhënë Mbretëria dhe qasja të “ligji i Frymës së jetës” ishte mahnitëse. Sërish, akoma më mahnitëse për ne ishte të shihnim që ligji prodhonte drejtësinë e Mbretërisë në jetën tonë.

Mbretëria më lejoi të shërohesha fizikisht dhe emocionalisht dhe të kisha një shpresë të re, duke qenë i lirë nga antidepressantët. Më lejoi të kaloja nga varfëria, apo nga beteja për të paguar çdo muaj qeranë prej 300 dollarësh për një shtëpi të rrënuar 1 800 vjeçare, drejt mundësisë për ta ndërtuar dhe për ta paguar plotësisht një shtëpi 7 700 metër katror në 59 hektarë të bukur.

Edhe gruas sime i pëlqejë më shumë! Të përdorje makina të mira që nuk prisheshin çdo ditë ishte e paçmueshme. Të ishe në gjendje të jepje qindra mijëra dollarë për Ungjillin ishte një mendim i pamundur vetëm disa vite më parë. Jeta, drita e Mbretërisë, po e mbyste errësirën; dhe ashtu siç Perëndia tha te libri i Zanafillës ndërsa vështroi krijimin e Tij të përfunduar, “Është mirë!”, edhe unë qëndrova dhe vështrova i mahnitur e thashë, “Kjo është e mirë, shumë e mirë.”

Drenda dhe unë ishim shumë të kënaqur që mund t’i tregonim për Mbretërinë kujt do që do të na dëgjonte dhe kishim mundësinë t’i tregonim historinë tonë. Njerëzit në kishën tonë filluan të kishin po të njëjtat rezultate si ne dhe një prej tyre ishte vajza jonë 12 vjeçare. Ajo e kishte parë Perëndinë të bënte aq shumë dhe kishte dëshmuar herë pas here atë që ligjet e padështueshme të Mbretërisë prodhojnë në jetën tonë. E dija që ajo po shikonte dhe po mësonte rreth këtyre ligjeve, por një histori më tregoi se vërtet po mësonte.

Një ditë u ngjita në dhomën e saj për t’i thënë natën e mirë dhe diçka ishte ndryshe. Atje në murin e saj ndodhej fotoja e një qeni pomerian. Për çdo prind, kjo është një shenjë që shumë shpejt do t’u kërkohet një qen. Motra e Kirsten, Polli, e kishte tashmë një qen të sajën dhe ato të dyja e ndanin dhomën bashkë, kështu që qeni i Pollit ishte aty bashkë me Pollin dhe Kirstenin.

Me butësi i thashë Kirstenit se po më pëlqente ajo foto, por nuk

dëshiroja një qen tjetër brenda në shtëpi. Nëse ajo dëshironte një qen shtëpie, duhej të kalonte më shumë kohë me qenin e motrës së saj. Kirsten nuk tha asnjë fjalë atë natë, thjesht miratoi atë që thashë. Mendova se çështja kishte mbaruar, por pomerani u përmend disa herë pas kësaj, me komente si: «A nuk do të ishte mirë të kishim një pomerian?» ose «Ata janë kaq leshatorë dhe me push të butë». Dhe sigurisht që Kirsten më tregonte foto të ndonjërit prej tyre, që i gjente në internet.

Sërish, unë thoja thjesht, “Jo.” Unë isha autoriteti në shtëpi dhe nuk do të merrnim një qen tjetër brenda në shtëpi.

Vazhdoja të mendoja se çështja ishte e mbyllur dersia, një ditë, rreth një muaj më pas, kur erdha në shtëpi nga kisha, Kirsten më doli përballë me shumë siguri dhe me një buzëqeshje në fytyrën e saj, më tha “Babi, sot unë e mora me anë të besimit qenin tim Pomerian, pikërisht ashtu siç ti na mëson.” Unë ia kujtova asaj sërish deklaratat e mia të mëparshme rreth çështjes së qenit. Pa e shuar buzëqeshjen, ajo tha, “Por babi, mami thotë që Perëndia mund ta ndryshojë zemrën e një mbreti.” Komenti i saj ndaj meje nuk ishte rebelim. Ajo thjesht ishte dakord me mamane e saj dhe ishte lutur që Perëndia të ndryshonte zemrën time. M’u bë fakt. E kuptova që ajo dhe e ëma kishin biseduar dhe mamaja e kishte inkurajuar që Perëndia mund të ndryshonte mendjen time.

Bazuar në atë inkurajim, ajo kishte çliruar besimin e saj atë mëngjes në kishë, duke mbjellë dhe rrëfyer që ajo e kishte marrë atë qen me besim. Unë mbajta të njëjtin qëndrim dhe e risigurova për dashurinë time dhe deklarova sërish që “Ne nuk do të merrnim asnjë qen tjetër në shtëpi.” I thashë që më vinte keq, por kjo gjë nuk do të ndodhte. Ajo dukej që nuk i interesonte se çfarë thojta unë; ajo u largua duke buzëqeshur. Dhe sërish unë mendova se çështja u mbyll.

Por një muaj më vonë, isha i ftuar për të dhënë mësim në një kishë të vogël në Misisipi. Ishte një kishë shumë e vogël e rrethuar nga milje tokë e hapur. Në fund të natës së parë, pastori eci drejt meje dhe më

tha që Zoti i kishte folur gjatë shërbesës. Ai tha, “Nuk e di nëse e dini këtë apo jo, por unë rris pomeranianë dhe Zoti më tha që t’ju jap një nga këlyshët që janë tashmë gjashtë javësh dhe të gatshëm të shkojnë në një shtëpi tjetër.”

Mbeta me gojë hapur. I qëndrova mendimit që nuk do ta merrja qenin, kështu që i thashë, “Do të të njoftoj”. Unë nuk e kisha idenë që ai rriste qen të atij lloji dhe sigurisht nuk i thashë asgjë për time bijë që mezi po e priste këlyshin për të cilin ai foli.

Përfundimisht u dorëzoval dhe i tregova Drendës se çfarë kishte ndodhur dhe që nuk dëshiroja ta merrja qenin në shtëpi. Ajo më tha, “A dëshiron të mohosh besimin e vajzës tënde?” Drenda në të vërtetë nuk dëshironte një qen të dytë në shtëpi, por ajo e donte Kirstenin më shumë se sa paretat që do të na shkaktonte qeni. Dhe tani që Perëndia e solli qenin si rezultat i besimit të Kirstenit, si mund ta mohojm atë? Ndaj i thashë pastorit që do ta merrja qenin.

Nuk i treguam Kirstenit por i treguam motrës së saj që të sigurohej të sillte Kirstenin në aeroport kur të vinte për të na marrë. Kirsten erdhi në aeroport dhe ne i dorëzuam asaj një valixhe të vogël udhëtimi që e kishim blerë për qenin. Kur Kirsteni pa pomerianin e vogël, filloi të qante. Gjithçka ndaloi. Çdo person rreth nesh ndaloi dhe po shikonte skenën. Në pak çaste një turmë e madhe ishte mbledhur rreth nesh dhe shihnin Kirstenin që qante, duke mbajtur në krahë këlyshin e vogël. Drenda filloi t’i tregonte të gjithëve se si ai qenush na ishte dhënë dhe se si Kirsteni i kishte besuar Perëndisë për ta pasur atë.

Këtu kuptova se një rizgjim mund të ndodhë edhe në një aeroport, thjesht duke mbajtur një qenush në duar. Të gjithë dëshironin të shikonin këlyshin, e gjithë turma në aeroport po qante me Kirstenin, madje dhe oficerët e policisë. Gjatë kësaj kohe, u ndjeva si një baba i tmerrshëm. Kur pashë gëzimin që ai këlysh kishte sjellë te vajza ime dhe se si Perëndia e solli atë qen si rezultat i besimit të saj, habitesha se si kisha qenë kundër diçkaje që ishte e çmuar për të. Shekspir, kështu ia vuri emrin, ishte shumë tërheqës.

Ai u bë një pjesë e vërtetë e familjes sonë. Edhe pse ishte qenush i pavarur, e ndiqte Kirstenin kudo që shkonte, ditë e natë.

Edhe pse kjo është një histori prekëse, duhet të bëj një pyetje që duhet të marrë përgjigje dhe që është me të vërtetë qëllimi i këtij libri. **Si u shfaq ky qen?** Kurrë më parë nuk më ishte ofruar një qen. Dhe si ka mundësi që ishte qeni specifik për të cilin vajza ime kishte çliruar besimin e saj? A ishte rastësi? Jo, padyshim që jo. Ishte rezultati i drejtpërdrejtë i Mbretërisë dhe ligjeve që e qeverisin atë, që u prodhuan në familjen time. U prodhuan njësoj siç ndodh çdo herë për këdo që ka besim dhe çliron autoritetin e Mbretërisë këtu në sferën tokësore. Mund ta pranojmë që ishte Mbretëria e Perëndisë që e solli atë qen. Po si e bëri këtë? Cilat ishin ligjet që u vunë në veprim dhe e sollën?

Shpresoj që ndërsa vazhdojmë më tej në këtë libër, të kemi përgjigje të qarta, që do të të ndihmojnë të dish saktësisht se si të gëzosh Mbretërinë e Perëndisë. Mbi të gjitha, ti je një qytetar i asaj Mbretërie me të drejta dhe përfitime ligjore! Por së pari më lejo të të jap një shembull të Mbretërisë nga jeta e familjes sonë.

KAPITULLI 4

PESHKU GJIGANT

Ndërsa Drenda dhe unë mësonim rreth Mbretërisë së Perëndisë dhe për autoritetin që kishim në sferën tokësore, u bëmë gjithmonë e më shumë të vetëdijshëm për faktin që ishim ata që përcaktonim në të vërtetë mënyrën se si jetonim. Mbretëria e Perëndisë ndikoi në çdo fushë të jetës sonë, por ne ishim ata që kishim çliruar sigurimin për të cilin kishim nevojë apo që dëshironim në jetët tona. Kjo gjë nuk ndodhi vetë. Njësoj si qeni i vajzës tonë, asgjë nuk ishte shumë e vogël apo e parëndësishme për ta sjellë nën sundimin e Mbretërisë. Kur e kuptuam këtë, nuk kishte asgjë të pamundur apo jashtë mundësive për ne. Në pjesën më të madhe të jetës sime, kurrë nuk e kisha kuptuar në të vërtetë që Perëndia na e ka dhënë Mbretërinë TË PLOTË për ta gëzuar. Ndaj ishte bukur të shihnim ndikimin e Mbretërisë në çdo fushë të jetës sonë, madje edhe në gjëra të vogla jo thelbësore. Një shembull për këtë ilustrohet me historinë e mëposhtme. Unë e quaj historia e peshkut të madh.

Kjo histori ndodhi kur familja jonë ishte në Alaska me pushime. Fakti që gjendeshim atje ishte një ëndërr për mua. Fluturam për në kryeqytetin Anchorage dhe morëm me qera një rulot për 3 javë dhe udhëtuam më së shumti në bregun perëndimor. Ishte shumë bukur! Një ditë, ndërsa po udhëtonim nëpër gadishullin Kenai, vumë re një peshk shumë të madh të varur anash një peshkarexhe. Shumica e peshkarexhave sapo kishin mbërritur në port dhe i njëjti peshk i madh

varej në to.

Mua më dukeshin si gjuhëza (lloj peshku) të mëdha. Kurrë më parë në jetën time nuk kisha parë shojza dhe as që e dija se çfarë ishin, por ishin shumë të mëdhenj. Ishim të mahnitur ndërsa po kalonim peshkarexhat me rradhë, të gjitha njoftonin ditën e peshkimit për shojzë. Papritur, gruaja ime, u kthye nga unë dhe më tha, “Do të më pëlqente të kapja një shojzë dhe do të doja ta kapja me atë kapitenin atje.” Ajo tregoi me gisht një reklamë peshkimi që kishte në të shenja e krishterë të peshkut.

Para së gjithash, u shokova! “Ti dëshiron të kapësh një shojzë?” Ajo kurrë më parë nuk ka dashur të peshkojë. Por nguli këmbë, ndaj shkuam te zyra përkatëse. Personeli i zyrës ishte i zënë me një klient tjetër, kështu që thjesht vështruam rrotull për pak kohë, duke lexuar artikujt që njerëzit kishin vendosur. Pamë një njoftim që fliste për një garë shojze që po zhvillohej, por së shpejti do të përfundonte. Meqenëse as ne nuk e dinim se çfarë ishte kjo, ka mundësi që edhe ju të mos e dini, kështu që më lejoni ta shpjegoj. Gara e shojzës ishte një garë për këdo që kapte shojzën më të madhe të muajit, ndërmjet të gjithë kapitenëve të peshkarexhave. Fituesi do të merrte fotografinë e tij në letër dhe një çek. Drenda dhe unë biseduam që të futeshim në garë duke qenë se ishim aty. Hyrja kushtonte vetëm pak dollarë.

Drenda, gruaja ime e ëmbël, shumë femërore u kthye nga unë dhe tha që kishe vendosur ta fitonte garën që biznesi i këtij kapiteni të njihej midis të gjitha bizneseve të tjera të peshkimit sepse ai ishte i krishterë dhe Perëndia do të merrte lavdi. Kështu që kur erdhi radha jonë për t’u regjistruar, Drenda tha me guxim se do ta fitonte garën e shojzës që Perëndia të merrte lavdi dhe që biznesi i tyre të njihej më shumë sepse ishte një biznesi i krishterë. Sigurisht, mund ta imagjinoni se çfarë mendonte kapiteni i peshkarexhës.

Të gjithë duan ta fitojnë garën e shojzës; dhe jam i sigurt që e kishte dëgjuar këtë nga shumë persona, në mos nga të gjithë turistët që shkonin aty. Megjithatë, nuk jam i sigurt nëse kishte dëgjuar shumë

njerëz që deklarorin se do ta fitonin garën për lavdinë e Perëndisë.

Mirë, ai nuk tha shumë mbi komentet e Drendës për garën. Kur dolëm jashtë dhe filluam të peshkonim, filluam të kapnim shojzë, dhe Drenda vazhonte të pyeste kapitenin i cili ishte dhe pronari se sa i madh duhej të ishte peshku shojzë që të fitonin garën. Ai thoshte që duhej të ishte më i madh se ai që Drenda kishte kapur, gjë që e nxiste të përsëriste pyetjen sa herë kapte peshk. Kur kapi një peshk 18 kg, ai i tha që nuk ishte mjaftueshëm i madh. Edhe kur kapi një peshk 30 kg, nuk ishte mjaftueshëm i madh. Sigurisht, të gjithë e dinë se sa i mirë për t'u ngrënë është peshku shojzë, kështu që ne po planifikonim t'i merrnim në shtëpi ato që kapëm. Limiti ishte dy për person, kështu që ne mbajtëm atë që ishte 30 kg.

Dita kaloi dhe ia la vendin mbrëmjes dhe po afrohej muzgu. Djali im Tom, vajza Poli, plus unë, secili e kishim limitin tonë prej dy peshqish. Dy fëmijët e tjerë, Ami dhe Timi, u kthyen në shtëpi sepse duhej të merrnin pjesë në një konferencë ndaj nuk ishin me ne. Drenda, sigurisht, kishte peshkun e saj 30 kg, por asnjë nga peshqit që kishim nuk mund ta fitonte garën. Por Drenda ishte ende e sigurt që do ta kapte peshkun e madh. Ndërsa muzgu po afrohej me shpejtësi, kapiteni na tha të gjithëve që të mblidhnim kallamat tanë të peshkimit, pasi ishte koha të shkonim në stacion. Drenda e shpërfilli urdhrin ndërsa kapiteni na ndihmoi të gjithëve të mblidhnim kallamat dhe të sistemonim pajisjet. Ajo iu lut për disa minuta më tepër dhe sërisht deklaroi se do ta fitonte garën e peshkut shojzë. Kapiteni priti edhe disa minuta dhe më pas eci drejt saj duke thënë, "Më vjen keq, por vërtet duhet të kthehem."

Pak para se ai të merrte kallamin e saj, kallami u përkul shumë. Me siguri ishte një peshk i madh sepse kallami u përkul shumë dhe rezistenca ishte shumë e fortë. Kapiteni e tërhoqi lart me forcë që të kuptonte se sa i madh ishte peshku dhe mendoi se mund të ishte një peshkaqen. Ai e tha këtë duke parë se sa fort e tërhoqte poshtë peshku. Në fakt, u desh pak kohë që Drenda ta kapte peshkun. U desh gjithë

forca e saj për ta ngritur peshkun lart nga thellësia, që ishte 90 metra. Kur peshku doli në sipërfaqe, të gjithë mund ta shihnin që ai ishte vërtet një peshk shojzë shumë i madh, madje më i madh se Drenda vetë.

Ndërsa peshkun e tërhoqën në varkë, kapiteni tha se peshku ishte jashtëzakonshti i madh dhe kur ta hidhnin në varkë do të përpëlitej fort, aq sa mund të lëndonte ndokënd ose të dëmtonte varkën. Ai kishte një produkt të veçantë që ishte krijuar për peshq aq të mëdhenj. Produkti kishte pak eksploziv, dhe kur peshku goditej me të në kokë, eksplozivi e vriste. Kur kapiteni e hodhi në kokën e peshkut, peshku u hodh, duke bërë që rezistenca të shtoej.

Menjëherë, peshku u zhyt përsëri me të gjitha forcat drejt në fund. Ai shkoi sërish 90 metra poshtë. Ne kishim frikë se fildispanja do të këputej dhe nuk do mund ta mbante peshkun ose grepi mund të dilte nga peshku për shkak të peshës së madhe. Sërish, Drendës iu desh ta tërhiqte lart atë peshk të madh. Ajo po luftonte që ta nxirrte sërish lart, duke qënë se e kishte bërë një herë; kështu që i vendosa krahët e mi rreth saj dhe të dy, ngadalë, e nxorrëm sërish në sipërfaqe. Këtë herë kapiteni që në gjendje ta fuste në barkë, ku të gjithë u mrekulluam me madhësinë e tij. Ne e morëm peshkun e madh shojzë në sheshin e qytetit ku kishin një peshore të madhe ku mund ta peshonin. Peshku peshonte 55 kg dhe ishte më i gjatë se Drenda. Burri që e peshoi tha se ai ishte peshku më i madh që kishte hyrë ndonjëherë në garë; por konkursi ishte pas dy javësh,

Ndaj ende nuk e dinim me siguri nëse peshku ynë do ta fitonte apo jo konkursin. Por, një ditë mbërriti një çek me emrin e Drendës dhe një kopje e artikullit të një gazete me foton e saj. Ne u ngazëllyem.

Mbretëria funksionoi përsëri! Dhe përsëri më duhet të bëj pyetjen: «Si e kapi atë peshk?» Unë e kam parë të peshkojë vetëm dy herë të tjera në jetën tonë martesore dhe peshkimi nuk ishte pasioni i saj. Unë ende habitesha që ajo dëshironte të kapte peshkun shojzë më të madh që ishte kapur ndonjëherë. Por kishte arsytet e saj; ajo do ta fitonte

atë derbi! Dhe e arriti këtë. Kur po ndaheshim me kapitenin atje në Alaskë, i treguam për Mbretërinë e Perëndisë dhe mënyrën se si e kapëm peshkun. Megjithëse nuk ishte ende fituesi zyrtar, pasi atë ditë u larguam nga kapiteni, peshku ishte aq i madh sa ia tërhoqi vëmendjen. Dhe sigurisht, në fund fitoi.

Ju mund të mendoni se historia e peshkut tonë, ose më saktë e peshkut të madh të Drendas përfundon këtu. Unë e di që njerëzit do të mendojnë se ishte thjesht me fat, por po nëse them se ndodhi dy herë? Mirë, rreth pesë vite më pas, Drenda dhe unë ishim ftuar nga një miku ynë pastor që të shkonim të peshkonim në Alaskë për salmon. Nuk ishim kthyer atje që nga udhëtimi familjar dhe që nga ajo kohë ishim përpjekur të gjenim një justifikim për t'u kthyer. Përsëri morëm me qira një rulot dhe planifikuam të peshkonim salmon. Ndërsa po kapnim salmon, ra fjala te peshkimi i shojzës dhe peshku i Drendës. Shoku ynë kurrë më parë nuk kishte peshkuar shojzë, kështu që thamë: «Epo, le të shkojmë atëherë.» Vendosëm që të ktheheshim në të njëjtin vend dhe tek i njëjti kapiten anijeje nëse do të ishte ende aty.

Ndërsa udhëtonim për atje ku ishte pozicionuar ai, vumë re se nuk ishte më aty dhe menduam se mund të na duhej të përdorim një kapiten tjetër. Përpara se ta bënim këtë, menduam se ndoshta duhej të kërkonim në internet për të parë nëse mund t'ia gjenim emrin, sepse nuk na kujtohej emri i biznesit të tij. Pas disa kërkimesh, gjetëm një kopje të gazetës ku ishte artikulli që fliste për peshkun e madh të Drendës, tashmë pesë vite më parë. Aty përmendej emri i anijes dhe i biznesit, kështu që arritëm të bënim një telefonatë të shpejtë. Biznesi vazhdonte të funksiononte por kishte lëvizur 5 milje më tej në atë rrugë.

Kur hymë atje, gruaja te recepsioni, që ishte bashkëshortja e kapitenit dhe pronarit, na pa dhe tha, "Fituesit e Garës së Shojzës!" Ne u kënaqëm duke biseduar me të për pak minuta rreth asaj ngjarje dhe se çfarë kishte ndodhur në ato pesë vite që kishin kaluar. Kishin patur recesion ekonomik dhe biznesi nuk kishte qenë aq mirë. Ajo tha se

njerëzit thjesht nuk po udhëtonin dhe nuk po i shpenzonin më paratë e tyre për peshkim ndaj burri i saj dekurajuar. Ia kujtuam Mbretërinë por ajo tha se burri i saj nuk ishte i interesuar t'i shërbente Perëndisë.

Kur po hipnim në anije, edhe ai e mbante mend Drendën dhe peshkun e madh. Drenda eci drej tij dhe e pyeti se si kishte qenë peshkimi dhe ai tha se kishin kapur peshq të vegjël në krahasim me peshkun e saj. Por tha që të mëdhenjtë nuk jetonin në atë zonë pasi ishte shumë cekët. Ai vazhdoi të shpjegonte se arsyeja përse e kishte lëvizur biznesin e tij ishte sepse atje ku kishte qenë duke peshkuar dhe ku Drenda kishte kapur fituesin e garës, ishte shumë më thellë, por ishte plot me peshkaqenë. Peshkaqenët grabisnin karremin dhe kjo i kushtoi atij shumë karrema dhe shumë kohë.

Kështu që e pyetëm se çfarë madhësie po zinin në këtë zonë të re, dhe ai tha se nuk kishte parë një peshk më të madh se 10 - 13 kg brenda një muaji. Kështu që Drenda e vështroi dhe i tha: «Epo, unë do të kap një të madh sot, më të madhin që ke parë këto kohë, kështu do të kuptosh se Zoti është besnik». Por ai thjesht qeshi me të. Gjatë gjithë ditës po kapnim peshq 10 kg, ashtu siç tha kapiteni, dhe gjatë gjithë ditës kapiteni ironizonte Drendën vazhdimisht për «peshqit e mëdhenj» që do të kapte.

Ishte një përsëritje e udhëtimit të mëparshëm. Në fund të ditës, kapiteni na tha që të mblidhnim të gjithë kallamat dhe Drenda nuk i kushtoi vëmendje, duke thënë se i duheshin vetëm një ose dy minuta për të kapur peshkun e madh. Përsëri, kapiteni priti një minutë, por më pas i tha asaj se duhej të largoheshin. Pikërisht atëherë, kallami i saj u zhyt dhe për t'i rënë shkurt historisë, ajo kapi një peshk 30 kg. Kapiteni u befasua përsëri.

Kur shkuam në një restorant pas peshkimit, folëm me një kapiten tjetër, i cili gjithashtu po hante darkë aty. Kur dëgjoi se Drenda kishte kapur një 30 kilogramësh, nuk mundi ta besojë. Ku po peshkonit; sa larg? Ai donte të dinte se ku e kishim kapur atë peshk të madh. Pasi u larguam nga restoranti, duhej të shkonim tek anija edhe një herë dhe të

nënshkruanim që peshqit të dërgoheshin në shtëpinë tonë.

Para se të largoheshim nga kapiteni i anijes, përsëri kishim një shans tjetër për t'i treguar për Mbretërinë e Perëndisë. Vështrova kapitenin dhe thashë: “Ju me të vërtetë duhet të zbuloni se si i kapi ajo ato dy peshq. Ligjet e Mbretërisë funksionojnë edhe për paranë.» Këtë herë patëm vëmendjen e tij dhe së paku ishte i interesuar. I lamë atij librin tim, *Fixing the Money Thing* (Të zgjidhën çështjen e parave) dhe u larguam.

A ishin këta dy peshq rezultat i rastësisë apo i ligjit të Mbretërisë? Ju vendosni, por unë dhe Drenda tashmë e kemi vendosur shumë kohë më parë. Nga udhëtimet e peshkimit, të qenit pa borxhe apo të shëruar, përvoja jonë me Mbretërinë e Perëndisë ishte emocionuese dhe jetë ndryshuese. Edhe të tjerët po e përjetojnë Mbretërinë. Këtu është një letër nga një zonjë që dëgjoji historinë e Drendës.

Përshëndetje Geri dhe Drenda,

Pasi lexova librin tuaj ku Drenda kapi çmimin për peshkun, mendova që edhe unë duhej të ndaja me ju historinë time të peshkut.

Kohët e fundit shkuam me pushime në Cocoa Beach/Cape Canaveral, Florida. Bashkëshorti im, Roberti, donte të shkonte me një anije peshkimi në det në thellësi dhe shpresonim të sillte disa peshq në shtëpi, në Kolorado. Kishim disa muaj që po e planifikonim udhëtimin, kështu që kur ai më tha se donte të shkonte për peshkim, u ngazëllava dhe thashë: “Le ta bëjmë! Dhe le t'i besojmë Zotit për një peshkim të shkëlqyer!» E pyeta Bob-in se çfarë lloj peshku kishte në Florida, ku po peshkonim. Nga të gjithë peshqit që ai më përmendi, unë zgjodha të lutem dhe të besoja për korbin e kuq gjigant.

Erdhi dita dhe po prisnim të merrnim udhëzimet nga kapiteni i anijes dhe ekuipazhi. Unë kisha shpallur se do të kapja një peshk të kuq gjigant, kështu që emocioni im

shtohet ndërsa kapiteni fliste. U zhgënjeva kur dëgjova kapitenin të thoshte se aktualisht të vetmit lloje peshku që nuk do të ishim në gjendje të kapnim ishin levreku, gjuca dhe korbi kuq! Uf, mendova; për çfarë tjetër duhet të besojmë?

Epo, nuk do ta humbisja këtë mundësi për të vepruar me besim. Thashë, “Zot, kam qenë duke besuar për një peshk të kuq gjigant dhe ashtu qoftë, unë do të kap një të tillë dhe do të çoj disa lloje peshqish në shtëpi!

Kështu që, ndërsa isha në anije, u ktheva te vajza ime 8-vjeçare, Rakela dhe i thashë: “Mos harro që mund të lutesh dhe t’i besosh Zotit që sot të kapësh një peshk. A beson?” Ajo buzëqeshi dhe tundi kokën duke rënë dakort. I thashë të njëjtat fjalë inkurajuese vajzës time 21-vjeçare, Jordanës. Ajo më pa me një vështrim të habitur, por më pas ra dakord. Pash Bobin dhe i thashë: “Le të besojmë që do të kapim shumë sot.”

Kaluan disa orë dhe nuk ndodhi asgjë. Pastaj papritmas, fija e Raketës lëvizi dhe ajo u ngazëllye shumë. Ajo i thirri babait për ta ndihmuar. Pak minuta më vonë, kapën një peshkaqen atlantiku!

Uau, Rakela e mori atë që besoi! Ndaj e përgëzuam. Çfarë eksperteje!

Mbaj mend që fillova të mendoja se mund të mos merrja asgjë, por e ndalova këtë mendim dhe rrëfeva se tashmë e kisha peshkun tim. Unë u ula, u qetësova dhe dëgjova Perëndinë të thoshte, “Nëse thjesht relaksohesh dhe më lejon ta sjell peshkun te ty, do ta marrësh.” Epo, e dija që nuk isha ndonjë peshkatare e zonja, kështu që gjithsesi nuk mund të mbështetesh te aftësitë e mia. U ula dhe mora frymë thellë me besim në Zotin dhe prita. Rreth 20-30 minuta më vonë, fija ime u tërhoq; të paktën

kështu mendova unë, por doli që përfundimisht ishte peshk.

Burri im filloi të më trajnonte dhe më pas kapiteni erdhi të bënte të njëjtën gjë. Ndërsa po tërhiqja peshkun lart ai më tha që ndoshta kisha kapur një peshk të kuq gjigant. U befasova aq shumë që ai e dinte se çfarë ishte para se peshku të dukej! Sigurisht, ndërsa unë vazhdoja ta mbështillja dhe ta tërhiqja fijen, peshku im i kuq dhe gjigant prej 10 kilesh doli në sipërfaqe! Unë po falënderoja Zotin me kaq shumë gëzim dhe ngazëllim. E dija që kisha përparuar në sistemin tim të besimit. Thjesht kujtoja sigurinë e Drendës dhe mendoja se isha e aftë të kisha të njëjtin besim dhe siguri. Ngulmova dhe më dha rezultat.

Faleminderit për shërbesën tuaj dhe për shkrimin e librave, përfshirë The Faith Hunt (Gjuetia e Besimit) I jam mirënjohëse dhe falënderuese Zotit dhe shërbesës suaj që më ka ndihmuar të marr bekime më të mëdha. E pres të ardhmen me më shumë besim dhe emocion. E di se sa shumë i shërbeu kjo përvojë edhe familjes sime!

Sinqerisht,
S.T.

KAPITULLI 5

E KUJT ISHTE ZGJEDHJA?

Në historitë e mëparshme, pamë që Mbretëria e Perëndisë prodhoi këtu në mbretërinë e tokës, një qen, një peshk, para për të marrë pronën e mbetur peng, para për të paguar makinat dhe shtëpitë që na duheshin në jetë, përkujdesje për jetën e tre fëmijëve dhe akoma më shumë. Të gjitha këto histori janë prodhuar nga Mbretëria e Zotit, ose më lejoni ta bëj më personale, Mbretëria e Zotit TONË! Nuk duhet të habitemi sepse Mbretëria e Tij nuk ka fund.

2 Pjetrit 1:3a thotë:

Duke qenë se fuqia e tij hyjnore na dhuroi të gjitha gjërat që i takojnë jetës dhe perëndishmërisë....

Në të gjitha historitë që kemi parë, unë dua të bëj një pyetje shumë të rëndësishme, “E kujt ishte zgjedhja?” Ajo që dua të them është kjo: A vendosi Zoti papritmas ta sillte atë qen për Kirsten, apo atë peshk për gruan time, Drendën? A ishin këto thjesht ngjarje që Zoti në vullnetin e Tij sovran vendosi t’i bënte për ne? Apo kishte ndonjë arsye tjetër përse ndodhën këto gjëra? Mendoj se përgjigjja do të trondisë shumicën e njerëzve. E di, ndodhi edhe me mua.

Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje, le të shohim një histori në Bibël nga Luka 8.

Dhe ndodhi që, kur Jezusi u kthye, turma e mirëpriti sepse të gjithë ishin duke e pritur. Dhe, ja, erdhi një njeri me emër Jair, që ishte kryetari i sinagogës; dhe ai i ra ndër këmbë Jezusit dhe iu lut të shkonte në shtëpinë e tij, sepse ai kishte një vajzë të vetme rreth dymbëdhjetë vjeçe dhe ajo po vdiste. Ndërsa ai po shkonte atje, turma po shtyhej rreth tij. Dhe një grua që kishte një rrjedhje gjaku prej dymbëdhjetë vjetësh dhe kishte shpenzuar ndër mjekë gjithçka ajo kishte, pa mundur që të shërohej nga asnjëri, iu afrua nga pas dhe i preku cepin e rrobës së tij dhe në atë çast iu pre rrjedhja e gjakut.

Dhe Jezusi tha: «Kush më preku?». Pasi të gjithë e mohuan, Pjetri dhe ata që ishin me të, thanë: «Mjeshtër, turmat po të shtyhen dhe po të ngjeshin dhe ti thua: “Kush më preku?”». Por Jezusi tha: «Dikush më preku, sepse e kuptova që një fuqi doli prej meje».

Atëherë gruaja, duke parë se nuk u fsheh dot, erdhi duke u dridhur, dhe i ra ndër këmbë dhe i tregoi në prani të gjithë popullit, përse e kishte prekur dhe si ishte shëruar në çast. Dhe ai i tha: «Merr zemër, bijë; besimi yt të shpëtoi; shko në paqe!». ”

– Luka 8:40-48

Bibla tregon shumë qartë se Jezusi po shtypej nga të gjitha anët, madje Pjetri u befasua me pyetjen e Jezusit, “Kush më preku?” Si një shkencëtar frymëror, dua të di, duhet të di, pse kjo grua u shërua dhe askush tjetër nuk u shërua. Pse vajosja shkoi tek ajo dhe jo te të gjithë të tjerët që e prekën Atë në atë moment? Përgjigja është këtu, por para

se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje, më lejoni të shtroj tjetër pyetje.

A po i shërbente Jezusi me qëllim asaj? A i kishte vënë duart mbi të? Përgjigja është jo; në fakt, Jezusi as nuk e dinte që ajo ishte atje. Ai duhej të pyeste se kush e kishte tërhequr vajosjen sepse Ai nuk e kishte parë. Pra, zgjedhja e kujt ishte që ajo u shërua atë ditë?

Më lejoni ta shtroj ndryshe pyetjen. A zgjodhi Zoti ta shëronte në atë moment apo ishte vendimi i saj që të shërohej prej Zotit? Kjo është një pyetje e rëndësishme pasi kaq shumë njerëz po «presin» që Zoti të bëjë diçka në jetën e tyre. Unë besoj se fakti që Jezusi as nuk e dinte që ajo ishte atje, dëshmon se ishte vendimi i saj për t'u shëruar dhe jo i Jezusit.

Kjo ofron një zbulësë jashtëzakonisht të rëndësishme që është kjo - Zoti nuk zgjedh të shërojë rastësisht një person të caktuar dhe dikë tjetër jo. Ai tashmë na e ka dhënë të gjithëve mundësinë e shërimit përmes qëndrimit tonë ligjor në Mbretërinë e Tij. Pra, në realitet, ne zgjedhim. Por unë dua të di, si e shfrytëzoi ajo atë fuqi? Si “vendosi” ta merrte? Jezusi na tregon saktësisht se si ajo hyri në autoritetin dhe fuqinë e Mbretërisë. Ai tha: “Bijë, besimi yt të shpëtoi. Shko në paqe.” Kjo fjali na tregon gjithçka që duhet të dimë dhe i përgjigjet pyetjes sonë se përse ajo mori dhe pse askush tjetër nuk po merrte atë ditë. Si shkencëtarë shpirtërorë, le të fillojmë t'i hedhim një vështrim më të afërt kësaj historie dhe të shohim nëse mund të marrim ndonjë të dhënë se përse ajo u shërua.

Para së gjithash, Jezusi e quan “bijë” që do të thotë se ishte pjesë e popullit të Izraelit. Kjo do të thotë se kishte një besëlidhje me Perëndinë. Ose ju mund të thoni, ajo mund të merrte me ligj nga Perëndia përpara qiellit, si një qytetare e kombit të Izraelit. Ky fakt nuk mund të jetë arsyeja e vetme që ajo mori pasi të gjithë atje atë ditë që po shtynin drejt Jezusit ishin pjesë e ligjit. Duhet të jetë diçka tjetër që ka shkaktuar rrjedhjen e fuqisë. Pastaj Jezusi na tregon edhe një arsye më shumë se përse ajo u shërua. Në fakt, Jezusi tha se kjo ishte arsyeja e saktë që ajo u shërua personalisht. Ai tha se besimi i saj e kishte shëruar.

Deri tani e dimë arsyen përse ajo që në gjendje të shërohej. Së pari, ishte ligjërisht e drejta e saj që ta merrte duke qenë se ishte bijë e Abrahamit; dhe së dyti, besimi i saj ishte kanali që lejoi fuqinë të derdhej personalisht në trupin e saj, pikërisht në atë moment. Fakti që ajo ishte bijë e Abrahamit, që do të thotë se qëndronte para qiellit nën besëlidhjen që Zoti kishte vendosur me Abrahamin, mund të krahasohet me kompaninë e energjisë elektrike që ka hapur energjinë elektrike dhe telat e sjellin në shtëpinë tuaj. Por kjo nuk do të thotë që dritat tuaja do të jenë të ndezura. Ju gjithashtu duhet të shtypni çelësin që dritat të ndizen. Deri tani gjithçka që duhet të zbulojmë është se ku është ndërprerësi ose çfarë është ndërprerësi. Jezusi e quajti atë besimin e saj, por çfarë është besimi dhe si mund ta ndezim atë? Kjo është një pyetje jetike që duhet të marrë përgjigje.

Çfarë është besimi?

Besimi është një term që të krishterët e përdorin lirshëm. Dhe jam i bindur që shumica, ose pjesa më e madhe, nuk e dinë çfarë është besimi, pse është i nevojshëm, si ta dinë nëse po besojnë dhe si ta gjejnë besimin. Nëse besimi është çelësi që e shëroi këtë grua, atëherë duhet ta shohim më nga afër besimin! Përkufizimin tonë të besimit e gjejmë te Romakëve 4:18–21. Oh, unë e di se çfarë po mendon, “Jo, Geri. Hebrenjve 11:1 përcakton besimin tonë.”

Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen;

– Hebrenjve 11:1

Po, kjo është përgjigjja tradicionale, por nëse shikoni Shkrimin, Hebrenjve 11: 1 po na tregon përfitimet e besimit, jo atë që është në

të vërtetë besimi. Unë besoj se vargjet te Romakët do të na japin një pamje shumë të qartë të asaj që është besimi në të vërtetë.

Ai, duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: «Kështu do të jetë pasardhja jote». Dhe, duke mos qenë i dobët në besim, nuk e mori parasysh trupin e tij, i bërë tashmë i vdekur (ishte pothuaj njëqind vjeç) as barkun e vdekur të Sarës. Madje nuk dyshoi me mosbesim në premtimin e Perëndisë, por u forcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte.

— Romakëve 4:18-21

Le të kuptojmë sfondin e kësaj historie. Abrahami dhe Sara nuk mund të bënin fëmijë. Nuk po them që ata kishin probleme në ngjizjen e një fëmije dhe duhej të vazhdonin të përpiqeshin. Dua të them se ata ishin pothuajse 100 vjeç dhe cikli i riprodhimit kishte përfunduar. Trupat e tyre nuk mund të kishin fëmijë; kjo ishte e pamundur! Perëndia i premtoi

“DHE BESIMI ËSHTË SIGURIA E GJËRAVE QË SHPRESOHEN, BINDJA E GJËRAVE QË NUK SHIHEN.”.

— HEBRENJVE 11:1

Abrahamit një bir edhe pse në natyroren ishte krejtësisht e pamundur. Bibla thotë se Abrahami ishte plotësisht i bindur se Zoti kishte fuqinë të bënte atë që kishte thënë, pavarësisht se faktet natyrore thoshin diçka tjetër. Këtu është, pra, përkufizimi ynë i besimit: “të jemi plotësisht të bindur se Zoti ka fuqinë të bëjë atë që ka premtuar”. Unë e them kështu: **Të jesh në marrëdhënie me qiellin** jo vetëm mendërisht, por plotësisht të bindur, zemrat tona janë plotësisht të bindura për ato që Zoti ka thënë, përkundër fushës natyrore që tregon diçka tjetër.

Përkufizimi ynë i besimit është:

Besim do të thotë të jesh plotësisht i bindur për ato që thotë Perëndia! Zemra dhe mendja jonë janë dakord me qiellin, zemrat tona janë plotësisht të bindura, të sigurta dhe në paqe.

Pse është i nevojshëm besimi?

Pse Perëndia nuk mund t'i shërojë të gjithë ata që janë në spital kur Ai e dëshiron këtë? Pse Ai nuk mund t'i ndalë luftërat? Pse Ai nuk mund të dërgojë engjëj për të na predikuar Ungjillin? Jam i sigurt që i keni dëgjuar të gjitha këto pyetje më parë. Përgjigja është se Ai nuk mundet. Nuk është se Zoti nuk ka aftësinë për ta bërë këtë, por Ai nuk ka juridiksion ose autoritet për ta bërë këtë. «Geri, a po thua se Zoti nuk mund të bëjë çfarë të dojë?» E di që kjo tingëllon vërtet e çuditshme për ju tani, por le të shohim Biblën për të gjetur përgjigjen tonë për këtë

por dikush dëshmoi diku, duke thënë:

“Ç’është njeriu, që të kujtohesh për të? Ose biri i njeriut, që të kujdesesh për të? Ti e bërë për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe e vure përmbi veprat e duarve të tua; Ti e nënshtrove gjithçka nën këmbët e tij.”

Sepse, mbasi ia nënshtroi atij gjithçka, nuk la asgjë pa ia nënshtruar. Por tani nuk e shohim ende gjithçka të nënshtruar.

– Hebrenjve 2:6-8

Ne mund të shohim nga këto vargje që Zoti i dha njeriut juridiksion

të plotë ligjor mbi të gjithë mbretërinë e tokës kur u vendos këtu. Nuk kishte asgjë që nuk ishte nën juridiksionin e tij. Ai sundoi mbi këtë fushë me juridiksion dhe autoritet absolut. Aftësia e tij për të sunduar me autoritet u mbështet nga qeveria e cila e kishte vendosur këtu. Në thelb, ai sundoi me autoritetin e deleguar të Mbretërisë së Perëndisë. Ai mbante kurorën e asaj qeverie, e cila përfaqësonte lavdinë e Perëndisë, vajosjen dhe pozicionin e nderit që ai mbante.

Për ta kuptuar më qartë se si duket kjo, mendoni për një mbret njerëzor. Edhe pse ai është njeri dhe nuk ka asnjë fuqi të vërtetë në qenien e tij fizike, ai mban një kurorë e cila nënkupton se ai përfaqëson jo vetëm vetveten por edhe të një mbretëri dhe qeveri të tërë. Fjalët e tij mbartin autoritet vetëm sepse mbështeten nga gjithë fuqia dhe burimet natyrore të qeverisë dhe mbretërisë që ai përfaqëson.

Nëse mendoni për një polic që drejton trafikun, ai e ndalon një kamion me rimorkio me një komandë: «Ndalo në emër të ligjit». Po, kamioni është shumë më i madh se njeriu dhe njeriu, në vetvete, nuk matet dot me kamionin, por kamioni ndalet. Ndalet jo për shkak të burrit, por për shkak të distinktivit që burri ka veshur, që përfaqëson qeverinë. Në këtë rast, qeveria është shumë më e madhe se njeriu që mban distinktin. Shoferi i kamionit nuk ka frikë nga njeriu, por ka frikë nga qeveria që përfaqëson burri, gjë që e bën kamionin të ndalojë. E njëjta gjë është e vërtetë këtu. Adami sundoi mbi gjithçka që u krijua në mbretërinë e tokës. Fuqia dhe sundimi i Zotit, të përfaqësuar nga kurora e lavdisë dhe nderit, i dhanë njeriut sigurinë që fjalët e tij të sundonin në emër të Mbretërisë së Zotit.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se kur Adami humbi aftësinë e tij për të sunduar mbi tokë duke kryer tradhëti ndaj qeverisë së Zotit, e humbi kurorën e tij. Mbretëria tokësore u ndot dhe ndryshoi.

Vdekja hyri në sferën tokësore dhe Satani tashmë kishte një të drejtë ligjore të autoritetit dhe ndikimit në punët e njerëzve. Është e domosdoshme që ju të kuptoni gjithashtu se njeriu është ende

sundimtari ligjor i mbretërisë tokësore, ashtu siç e kishte vendosur Zoti, por tani ai nuk ka autoritet të sundojë shpirtërisht siç kishte dikur. Megjithatë, edhe në gjendjen e tij të rënë, ai është ende në krye të tokës. Po, ai nuk e ka më kurorën e tij të qeverisë së Zotit për ta mbështetur.

Ai nuk ka asnjë autoritet të sundojë me fuqinë dhe lavdinë e Zotit;

KJO ËSHTË ARSYEJA PSE ZOTI DUHET TË PËRDORË NJERËZ TË MBUSHUR ME FRYMËN E SHENJTË PËR TË KRYER VULLNETIN E TIJ NË JETËN E NJERËZVE.

ai e ka humbur pozicionin e tij të nderit. Por ai është ende dera e vetme ligjore në realitetin tokësor. Kjo është arsyeja pse Zoti duhet të përdorë njerëz të mbushur me Frymën e Shenjtë për të kryer vullnetin e Tij në jetën e njerëzve.

Në të njëjtën mënyrë, Satani përdor njerëz të frymëzuar nga demonët për të përmbushur në sferën tokësore planin e tij për njeriun. Ky parim i juridiksionit të

njeriut mbi tokë është jetik që të kuptoni ligjin e Mbretërisë dhe pasi ta kuptoni, ai do t'ju përgjigjet shumë pyetjeve që mund të keni në të ardhmen se përse ndodhin gjëra të caktuara, ose përse disa gjëra kanë ndodhur apo nuk ndodhin frymërisht. Ju mund të thoni: «Por unë mendova se Zoti zotëronte tokën dhe plotësinë e saj?» E vërtetë, Ai e zotëron. Shpresoj që ky shembull do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë po them. Nëse ju lëshoj me qera një shtëpi që kam zotëruar, megjithëse ligjërisht më takon mua shtëpia, serish ligjërisht heq dorë nga e drejta për ta përdorur në çdo kohë që dua. Në shumicën e qirave ekziston një klauzolë që përcakton se kur pronarët mund të hyjnë legalisht në ambiente me qira - për shembull, për t'u marrë me një rast urgjence ose për të bërë riparime dhe njoftimin që kërkohet.

Nëse do të përpiqesha të hyja në shtëpi jashtë kësaj marrëveshjeje, do të konsiderohej hyrje me forcë, edhe e zotëroj pronën. Nëse kam shkelur ligjin e specifikuar në kontratë, atëherë detyrohem nga ligji të

liroj vendin edhe pse e kam në pronësi. Kjo ilustron përse Satanit iu desh të kalonte përmes Adamit për të hyrë në sferën tokësore. Vetëm Adami e kishte çelësin! Satanit iu desh të kalonte nëpër një derë dhe ajo derë ishte Adami. Nëse Satani do të përpiqej t'i vinte rrotull Adamit, do të nxirrej jashtë me ligj.

Pastaj djalli e çoi në një mal të lartë dhe, për një çast, i tregoi të gjitha mbretëritë e botës. Djalli i tha: «Unë do të të jap gjithë pushtetin e këtyre mbretërive dhe lavdinë e tyre, sepse mua më është dhënë dhe unë ia jap kujt të dua. Në qoftë se ti, pra, duke rënë përmbys, më adhuron, do të jetë krejt jotja»..”

– Luka 4:5-7

Ju mund të shihni në këtë varg që Satani pretendon se autoriteti dhe shkëlqimi (pasuria) e mbretërive të njerëzve i janë dhënë atij. Kush ia dha atij këtë autoritet? Ai që e kishte, Adami! Kështu që Perëndia nuk mund të depërtojë në punët e njerëzve pa kaluar nëpër një hyrje të ligjshme. Nëse Ai do ta bënte, Satani do të thoshte po bënte lojë të padrejtë. Jo, Zotit do t'i duhej të kalonte nëpër të njëjtën derë që Satani përdori për të sjellë qeverisjen dhe autoritetin e Tij në tokë dhe kjo derë ishte një njeri. Por a kishte një njeri të tillë?

Por Zoti i tha Abramit: «Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd dhe shko në vendin që do të të tregoj. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë; te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës”

– Zanafilla 12:1-3

Abrahami quhet babai i besimit tonë, sepse ai është njeriu që i hapi Perëndisë derën e mbretërisë së tokës me anë të së cilës të gjithë kombet në tokë do të bekoheshin. Sigurisht, kur ky varg flet për kombet që be-

**“SI PASOJË, BESIMI VJEN
NGA DËGJIMI I MESAZHIT
DHE MESAZHI DËGJOHET
PËRMES FJALËS PËR
KRISHTIN.”**

— ROMAKËVE 10:17

kohen, ai po flet për Jezus Krishtin, i cili më vonë do të bënte një rrugë që qeverisja e Perëndisë të kishte edhe një herë hyrje të ligjshme në sferën tokësore përmes besimit të Abrahamit. Besimi i Abrahamit hapi një portë ligjore për qiellin, të cilën Zoti e hapi përgjithmonë duke bërë një marrëveshje ligjore (besëlidhje) me Abrahamin dhe

pasardhësit ose trashëgimtarët e tij.

Më lejoni të parafrazoj atë që po them. Qeverisja e qiellit mund të fitojë hyrjen e saj në mbretërinë e tokës vetëm përmes një burri ose një gruaje në tokë sepse ata kanë juridiksion ligjor këtu. Kjo ligjshmëri mund të arrihet vetëm nëse një burrë apo grua binden plotësisht në zemrën e tyre për ato që thotë Zoti (besimi).

Një mënyrë tjetër për ta shprehur është se qielli mund të ndikojë ligjërisht në mbretërinë e tokës vetëm një burrë apo grua që dëshiron dhe zgjedhë të hyjë nën sundimin dhe autoritetin e Zotit. Ky është i njëjti parim që Satani përdori për të hyrë në tokë, duke përdorur Adamin për ta bërë këtë. Ai e bindi Adamin që Zotit nuk mund t'i besohej dhe e nxori zemrën e Adamit nga marrëveshja me Zotin. Si pasojë, Adami zgjodhi të besonte Satanin dhe hodhi poshtë autoritetin e Zotit.

Ky është i njëjti parim që Zoti përdori për të sjellë qeverinë dhe autoritetin e Tij përsëri në mbretërinë e tokës përmes Abrahamit. Abrahami i besoi Zotit dhe marrëveshja e tij u konsiderua nga Zoti si drejtësi, që do të thotë se u vendos marrëveshja e kërkuar ligjore.

Kjo marrëveshje midis dy palëve, Perëndisë dhe Abrahamit, e lejoi

Perëndinë të vendoste një kontratë ligjore (një besëlidhje që siguronte hyrjen e qiellit në mbretërinë e tokës, POR është thelbësore të theksohet se kjo marrëveshje preku vetëm Abrahamin dhe trashëgimtarët e tij. Të gjithë trashëgimtarëve të Abrahamit iu dha një shenjë e kësaj besëlidhje, që ishte rrethprerja. Kur një fëmijë ngjizej prej një burri të rrethprerë dhe një gruaje, i deklaronte Satanit dhe vetë babait dhe nënës se ky fëmijë qëndronte para qiellit si trashëgimtar i asaj marrëveshjeje ligjore që Perëndia dhe Abrahami kishin vendosur.

Sidoqoftë, siç kemi lexuar më parë, çdo burrë apo grua, megjithëse e kishte në dispozicion atë marrëveshje ligjore, përsëri duhej të përmbushte kërkesën ligjore të zemrës duke u bindur plotësisht për ato që tha Perëndia për të gëzuar me të vërtetë përfitimet personale të asaj marrëveshjeje që Perëndia dhe Abrahami bënë. Në thelb, besëlidhja çoi energjinë elektrike në shtëpinë e tyre, por ata gjithsesi duhej të ndiznin çelësin, duke e besuar dhe vepruar personalisht sipas Fjalës së Zotit.

Mirë, ne e dimë se çfarë është besimi dhe pse besimi kërkohet ligjërisht. Tani është e domosdoshme që të dimë se si të marrim besimin dhe se si të dimë nëse jemi në besim.

Si e marrim besimin?

Këtu është një e dhënë: Ju nuk mund të luteni për besim. U befasuat? E mora me mend.

Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë.

– Romakëve 10:17

Si vjen besimi duke dëgjuar Fjalën e Zotit? Kaq është e gjitha? Cili është procesi? A është vetëm dëgjimi i Fjalës gjithçka nevojitet që besimi të zhvillohet në frymën e njeriut? Për të kuptuar se si vjen

besimi dhe për çfarë po flitet te Romakëve 10:17, mund të shikojmë te Marku, kapitulli 4. Te Marku 4:13, Jezusi tha se nëse nuk kuptoni se çfarë po mëson Ai në këtë kapitull, nuk do të jeni në gjendje të kuptoni asnjë shëmbëlltyrë tjetër në Bibël. Unë do të thoja që është mjaft e rëndësishme!

Përse është kaq i rëndësishëm ky kapitull? Sepse na tregon se si qielli ndërlidhet me mbretërinë e tokës, si e fiton ligjshmërinë dhe ku ndodh kjo. Asgjë nuk është më e rëndësishme për jetën tuaj sesa të dini se për çfarë flet gjithë ky kapitull. «Si funksionon Mbretëria e Zotit?» mund te pyesni. Lexoni Markun, kapitulli 4! Në këtë kapitull, Jezusi na tregon tre shëmbëlltyra në lidhje me lindjen e besimit në frymën e njeriut, i cili, siç e dini tani, kërkohet që qielli të pushtojë ligjërisht tokën.

Tri historitë në këtë kapitull janë shëmbëlltyra e mbjellësit, shëmbëlltyra e njeriut që shpërndan farën dhe historia farës së sinapit.

Le ta nisim me historinë e dytë që Jezusi tregon te Marku, kapitulli 4, historia e njeriut që shpërndan farën.

Dhe tha: «Mbretëria e Perëndisë është si një njeri që hedh farën në dhe. Dhe natën dhe ditën, ndërsa ai fle e çohet, fara mbin e rritet, pa e ditur ai se si. Sepse dheu prodhon vetvetiu më parë kërcellin, pastaj kallirin dhe, më në fund, kallirin plot me kokrra. Dhe kur fryti piqet, menjëherë ai dërgon draprin, sepse erdhi koha e korrjes.»

– Marku 4:26-29

Para se të hidhemi në këtë fragment, le të përcaktojmë së pari termat tanë. Çfarë përfaqëson fara për të cilën po flet Jezusi dhe çfarë përfaqëson toka? Jezusi në të vërtetë i përcakton këto terma në shëmbëlltyrën e mëparshme të mbjellësit, në të njëjtin kapitull. Fara është Fjala e Zotit dhe toka është zemra e njeriut ose fryma e njeriut. Pra, në këtë shëmbëlltyrë, duke përdorur përkufizimin e Jezusit për

këto dy fjalë, do të thoshim se Jezusi po thotë që një njeri shpërndan Fjalën e Zotit në vet zemrën e tij. Atëherë e gjithë toka ose zemra e njeriut fillon të prodhojë besim (marrëveshje me qiellin) në sferën tokësore.

Para se të vazhdoj më tej, është kritike të mbani mend se cili është përkufizimi ynë i besimit: zemra e një burri apo gruaje të bindur fort për ato që thotë qielli. Ky fragment thotë se megjithëse njeriu nuk e di se si funksionon procesi, Fjala që u mboll në zemrën e tij fillon të rritet dhe të prodhojë marrëveshje vetvetiu. Kjo ndodh edhe kur fle, edhe kur është zgjuar; nuk ka rëndësi, procesi vazhdon. Teksa njeriu e mban Fjalën në zemrën e tij, ngadalë zemra e tij bie në ujdi me atë që thotë qielli dhe prodhohet besim.

Referenca jonë e Shkrimit në kapitullin 4 të Markut na tregon se zemra bën marrëveshje përmes një procesi. Historia na tregon se në fillim kur zemra jonë e pranon Fjalën, besimi fillon të formohet. Jezusi e krahason atë fazë me një filiz. Filizi më pas vazhdon dhe vazhdon të rritet dhe bëhet kërcell. Përfundimisht, lulja formohet në kërcell, por edhe në këtë fazë të vonë nuk ka asnjë frut, asnjë marrëveshje dhe asnjë ndryshim në sferën natyrore. Pastaj Jezusi thotë se procesi vazhdon dhe lulja çel dhe prodhon frutin. Kur procesi arrin në këtë pikë, kur fara e pjekur gjendet në frut, bëhet marrëveshja dhe besimi ndodhet aty, duke lejuar që burri ose gruaja të korrin në mbretërinë e tokës atë që qielli kishte mbjellë në zemrën e njeriut.

Tani kushto vëmendje të madhe. Le të shqyrtojmë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë. Qielli mbjell Fjalën e Zotit në mbretërinë e tokës, në zemrën e një burri apo gruaje, atje ku nevojitet marrëveshje.

Në këtë kohë, zemra e njeriut nuk është pajtuar ende me qiellin, por fillon të ndodhë një proces në zemër që lidh marrëveshje mes vet zemrës dhe asaj që është mbjellë. Jezusi përdor një ilustrim të shkëlqyer për të na e treguar këtë proces. Duke e krahasuar këtë proces me një fermer që mbjell një farë dhe se si rritet bima, Jezusi na jep një pamje të besimit. Në sferën natyrore, kur fara në lule piqet, duket **SAKTË-**

SISHT si fara që është mbjellë në tokë. Më lejoni ta them përsëri.

Kur fara që është në lulen e bimës piqet, duket saktësisht — SAKTËSISHT—si fara që është mbjellë në tokë.

Mbillni një bimë misri dhe fara e pjekur do të përputhet me farën që keni mbjellë. Ato janë të njëjta, duken të njëjta dhe kanë të njëjtën shije. Ju nuk mund t'i dalloni nga njëra-tjetra; janë identike.

Prandaj më lejoni të parafrazoj atë që Jezusi po thotë. Kur e dëgjojmë Fjalën (Romakëve 10:17), në fakt e shpërndajmë Fjalën e Zotit në njeriun tonë frymëror, zemrën tonë. Nëse e mbajmë atë Fjalë në zemrat tona, ajo do të piqet; dhe kur të jetë pjekur, pamja në zemrat tona (realitetin tokësor) do të përputhet me ato që thotë qielli. Nëse e shprehim me terma të tjerë, mund të themi se kur mbillni një premtim prej qiellit në zemrën tuaj, ai do të prodhojë vet besim në lidhje me atë që ka premtuar Zoti. Në fund, zemra juaj do të bindet plotësisht për ato që thotë qielli dhe do të keni një marrëveshje. Për shembull, nëse po përballeni me sëmundje, gjendja e trupit tuaj po ju thotë se jeni të sëmurë. Kur mbillni Fjalën e Zotit që thotë se Zoti e ka paguar çmimin për shërimin tuaj përmes asaj që bëri Jezusi, zemra juaj ngadalë fillon të bindet për atë që thotë Zoti.

Kur ajo fjalë piqet në zemrën tuaj, ti beson dhe thua me siguri se je shëruar. Ti nuk citon thjesht atë që thotë qielli. Zemra jote tashmë është plotësisht e bindur.

Kur thua, “Unë jam shëruar,” nuk është një formulë që po citon; përkundrazi, është ajo që beson dhe e di që është fakt. Ajo që thotë qielli, tashmë është bërë perceptimi yt për realitetin.

Ja pse Herbrenjve 11:1 thotë:

Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen.

Ekziston një siguri e mbinatyrshme për atë që thotë qielli kur besimi ndodhet aty, por duhet edhe një hap tjetër në këtë proces.

Njeriu tashmë duhet t'i vërë drapërin të korrës, që ta marrë në sferën e tij aktuale të ekzistencës atë për të cilën është i sigurt në zemrën e tij.

Dhe kur fryti piqet, menjëherë ai dërgon draprin, sepse erdhi koha e korrjes.

– Maru 4:29

Vini re se, edhe pse zemra ka një marrëveshje me qiellin dhe realiteti i qiellit është bërë realiteti i burrit ose i gruas, asnjë ndryshim i vërtetë nuk ka ndodhur ende në sferën fizike. Për shkak se njeriu natyrisht ka juridiksionin këtu në tokë, duhet gjithashtu të lëshojë autoritetin e qiellit në sferë e këtushme. Zoti nuk mund ta bëjë këtë pa burrin ose gruan. Unë mund t'jua tregoj këtë në vargjet e mirënjohura që diskutuam më parë.

*Sepse me zemër, njeriu beson në **drejtësi** dhe me gojë bëhet rrëfim për shpëtim.*

– Romakëve 10:10

Me zemër njeriu beson Fjalën, duke prodhuar besim dhe drejtësohet. Drejtësimi është një term juridik që do të thotë administrim i ligjit. Pra, kur zemra e një njeriu është në përputhje me qiellin dhe zemra e tij është plotësisht e bindur për ato që thotë qielli, ai drejtësohet. Tani është e ligjshme që qielli të derdhet në jetën e tij, në mbretërinë e tokës. Por të qenit vetëm i drejtësuar nuk e çliron fuqinë e Zotit. Ashtu si te shtëpia që ka rrymë elektrike nga termocentrali, duhet edhe një hap tjetër – të ndizet çelësi për të lëshuar energjinë dhe dritat do të ndizen. Përse? Sepse siç thekson Romakëve 10:10, ka një hap më tepër pas drejtësimi.

Një burrë apo grua që qëndron i drejtësuar para qiellit dhe tokës

duhet të rrëfejë ose të veprojë sipas kësaj marrëveshjeje për të lëshuar me të vërtet fuqinë dhe vajosjen e Zotit në mbretërinë e tokës. Ju lutem lexojeni atë varg përsëri e përsëri derisa të kuptoni plotësisht se çfarë po them. Kështu funksionon! Kjo është mënyra se si qielli fiton ligjshmërinë në mbretërinë e tokës, qielli ndërvepron me sferën tokësore përmes zemrës dhe pastaj fjalët dhe veprimet tona janë çelësat që lëshojnë në të vërtet fuqinë e qiellit. Ju lutemi, kushtojini vëmendje përsëri pjesës së dytë të këtij vargu: Ne jemi ata që duhet ta lëshojmë autoritetin e qiellit këtu.

Koncepti se qielli pret që një burrë apo një grua, para së gjithash, të sigurojë në mbretërinë e tokës ligjshmërinë dhe së dyti, juridiksionin, mund të shihet përmes asaj që Jezusi mësoi te Mateu 16 dhe 18.

Në të vërtetë ju them se ç'të keni lidhur mbi tokë do të jetë lidhur edhe në qiell; dhe ç'të keni zgjidhur mbi tokë do të jenë zgjidhur edhe në qiell.

– Mateu 18:18

Jezusi pohon këtu se Ai do t'i jepte kishës çelësat (autoritetin) e Mbretërisë së qiellit në mbretërinë e tokës. Ai tha se gjithçka që do të lidhim në tokë, do të lidhet edhe në qiell dhe çfarëdo që të zgjidhim në tokë, do të zgjidhet edhe në qiell.

Mendoni një oficer policie; ai ka autoritetin por qeveria ka pushtetin. Oficeri i policisë mban çelësat ose autoritetin e qeverisë, sepse është betuar të jetë një agjent i asaj qeverie. Atë që ai thotë, qeveria e mbështet. Mos harroni, vetëm një burrë ose grua ka juridiksion këtu, prandaj vetëm një burrë ose grua mund t'ia japë juridiksionin qiellit këtu.

Ekziston edhe një pikë shumë e rëndësishme që duhet të dini rreth besimit. Më lejoni t'i referohem përsëri për një moment vargjeve tona në kapitullin 4 të Markut.

*Sepse **dheu prodhon vetvetiu më parë kërcellin**, pastaj kallirin dhe, më në fund, kallirin plot me kokrra.*

– Marku 4:28

Mos harroni, Jezusi e përcaktoi dheun e përmendur në këtë shëmbëlltyrë si zemrën ose frymën e njeriut, siç e përmenda më parë. Vini re se ku prodhohet besimi; a te befason kjo? Nuk është produkt i qiellit, siç besojnë shumica e njerëzve por është prodhuar këtu në sferën tokësore dhe është produkt i zemrës suaj. Ju nuk mund të luteni për të ose t'ia kërkonit Perëndisë. Besimi nuk është i nevojshëm në qiell.

Ne nuk do të kemi nevojë për marrëveshje në qiell. Jo, kërkohet vetëm këtu në sferën tokësore dhe mund të ndodhë vetëm në zemrat e burrave dhe grave në tokë. Siç mëson shëmbëlltyra në Markun 4, ekziston vetëm një mënyrë për ta marrë atë, duke vendosur Fjalën e Zotit në zemrën tuaj dhe duke lënë që procesi i marrëveshjes të ndodhë. Pra, nëse kam nevojë për besim, çfarë do të bëj? Do ta shpërndaj Fjalën e Zotit në zemrën time dhe do ta lë të rritet derisa besimi të jetë aty. Kjo është e vetmja mënyrë. Përpara se ta lë Markun 4, dëshiroj të flas sërish për drapërin e përmendur aty.

**KJO ËSHTË MËNYRA SE SI
QIELLI FITON LIGJSHMËRINË
NË MBRETËRINË E TOKËS,
QIELLI NDËRVEPRON ME
SFERËN TOKËSORE PËRMES
ZEMRËN DHE PASTAJ FJALËT
DHE VEPRIMET TONA JANË
ÇELËSAT QË LËSHOJNË NË TË
VËRTET FUQINË E QIELLIT.**

*Dhe kur fryti piqet, menjëherë **ai dërgon drapërin**, sepse erdhi koha e korrjes.*

– Marku 4:29

Unë besoj se pjesa më e madhe e kishave nuk kanë mësuar se si të përdorin drapërin, që do të thotë se ata nuk janë mësuar se si të korrin atë që u nevojitet. Kisha në përgjithësi është mësuar se si të japë por jo si të kultivojë dhe korrë nga fara që ka mbjellë. Jezusi tregohet shumë specifik në këtë varg, duke thënë që kur të korrat e besimit tonë të jenë të disponueshme, NE duhet të përdorim draprin. Edhe pse mund të kemi bërë një punë të shkëlqyer për lirim të farës sonë me besim, nëse nuk dimë ta fusim në drapër, nuk do të ketë korrje. Sinqerisht, unë nuk dija asgjë për këtë derisa Zoti filloi të më mësonte se si funksiononte Mbretëria. Më lejoni t'ju jap disa shembuj se si duket kjo.

Më ftuan të flas në një kishë në Atlanta. Ishte një shërbesë natën e së Mërkurës dhe kisha nuk ishte aq e madhe, por kjo ishte mirë për mua. Thjesht më pëlqente t'u mësoja njerëzve për Mbretërinë.

Ndërsa mbërrita në kishë, më dukej e çuditshme që dyert ishin të kyçura dhe askush nuk ishte atje. Ishte dhjetë minuta para se të fillonte shërbesa. Dëgjova një zhurmë të fortë kamionçine; dukej sikur nuk kishte fare marmita. Ndërsa vështrova, pashë një kamionçinë të vjetër e të prishur që tërhiqej prapa rrugicës së kishës. Nuk mendova asgjë për të; në fund të fundit, isha në qendër të Atlantës. Teksa prisja, një burrë erdhi duke ecur prapa ndërtesës dhe u prezantua si pastori. Ai tha se i vinte keq që u vonua, por kamionçina e tij e vjetër nuk po ndizej. Ai më tha se duhej ta niste kamionçinën duke u drejtuar drejt dishezës, pastaj shtonte pak shpejtësinë duke lëshuar freksionin, meqenëse motorrino ishte jo funksionale. Ai tha se shumë herë ajo nuk ndizej fare dhe i duhej të ecte pesë milje deri në kishë.

Ndërsa vazhdonte të më tregonte për kishën e tij, ai më tha se megjithëse ishte pastori i kishës, funksioni kryesor i kishës ishte të ushqente njerëzit e brendshëm të qytetit. Ata ofronin mbi 10 000 vakte në muaj në atë vend. Teksa pastori fliste, unë mërzhitesha. Aty ishte një njeri i Zotit që ushqente 10 000 njerëz në muaj dhe nuk ka as një makinë që i zihet besë? Ai është pamja e vetme e Zotit që shumë prej atyre njerëzve që ushqehen do të shohin ndonjëherë. Nëse e shohin që

mezi shkon deri atje, që duhet të ecë në kishë pesë milje në një ditë vere 40 gradë celsius, a mund të besojnë se Zoti mund t' i ndihmojë? Unë mund ta rregulloja këtë. Kisha në shtëpi një makinë mjaft të re me 20 000 milje që mund t' ia dhuroja. Unë i tregova planin tim dhe i thashë se do të sillja një nga stafi im në Atlanta me makinën. Ai, natyrisht, u entuziazhua. Atë natë e kalova duke i mësuar atij dhe kishës së tij të vogël për Mbretërinë e Perëndisë dhe se si funksiononte ajo në lidhje me paratë.

Kur shkova në shtëpi, u sigurova që makina të dërgohej për në Atlanta. Kur anëtari i stafit tim erdhi në shtëpinë time për të marrë makinën, e dija se po bëja një transaksion frymëror në qiell. E dija që ndërsa çliroja atë makinë në Mbretërinë e Perëndisë, unë mund t' i besoja Zotit për për një automjet për të cilin do të kisha nevojë gjithashtu. Unë nuk jam i apasionuar pas makinave, domethënë nuk jam shumë i mirë me makinat. Disa njerëz janë, por unë nuk jam. Një makinë është vetëm një mjet për mua. Sigurisht që më pëlqen të kem një makinë të bukur, por zakonisht i përdor derisa të kenë nevojë të zëvendësohen.

Kur anëtari i stafit tim u ndal aty, unë shkova në garazh dhe vura duart mbi atë makinë dhe thashë: “O At’ unë e lëshoj këtë makinë në punën e shërbesës tënde dhe ndërsa e lëshoj këtë makinë, marr përsëri një makinë tjetër.” Hezitova. Unë e di se sa specifike është Mbretëria e Zotit dhe e dija që thjesht fjala «makinë» nuk do të bënte punë. Unë gjithashtu e dija që duhej të isha specifik dhe se Drenda dhe unë duhej të ishim në një mendje në lidhje me specifikat e asaj që morëm me besim. Ndërsa qëndroja atje në mes të fjalisë, kuptova gjithashtu se nuk e kisha idenë se çfarë lloj makine dëshiroja. Kështu që fillova nga e para, «Zot, sot e lëshoj këtë makinë në shërbimin tënd dhe besoj se do marr një makinë vërtet të bukur ndërsa mbjell, por do të duhet të kthehem te Ti për modelin dhe llojin kur ta kuptoj.» Kaq ishte; makina iku. Unë me të vërtetë nuk kisha ndonjë makinë në mendje që të mund të thosha: «Po, unë dua KËTË makinë». Kaluan disa muaj. Sigurisht,

Drenda që dakord me mua për ta dhuruar makinën dhe ashtu si unë, as ajo nuk kishte asnjë ide se çfarë lloj makine dëshironte. Gjatë dy muajve të ardhshëm kemi biseduar për makinat dhe më në fund një ditë ajo tha: «Ti e di, unë mendoj se do të më pëlqente të kisha një kabriolet.» Unë i thashë asaj se isha dakord dhe thashë se mendoja se dukej bukur, por çfarë lloji? Përsëri, ne nuk e dinim as se çfarë lloj kabriolesh ekzistonin. Por një ditë, teksa po dilnim për drekë, gruaja ime tha papritur, «Kjo është!» «Çfarë është?»- i thashë. «Kjo është», tha ajo ndërsa po tregonte me gisht përtej parkingut të restorantit ku ishim. «Çfarë është ajo?»- i thashë. «Ajo makina, ajo është vetura që dua!» Pastaj pashë një kabrio në parkim.

«Le të shkojmë të shohim se çfarë lloji është», thashë. Kështu që u nisëm drejt makinës dhe u afruam pas saj. Epo, nuk është çudi që na pëlqente. Ishte një BMW 645Ci, një kabrio i bukur me siguri dhe shumë i shtrenjtë. Të jem i singertë me ju, kur pashë atë makinë, mendova, «Mirë, Zot, na trego çfarë të bëjmë.» E dija që nuk do të paguaja 115 000 dollarë për një BMW të re, por gjithashtu e dija që Zoti mund të bëjë gjëra të mahnitshme. Unë dhe Drenda nuk i treguam askujt për veturën dhe as nuk ia përmendëm askujt se po kërkonim makinë.

Rreth dy javë më vonë, vëllai i Drendës na thirri dhe na tha: «Gjeta makinën e Drendës!» «Çfarë do të thuash që ke gjetur makinën e Drendës?» e pyeta. Ai tha, «Unë e pashë këtë makinë në shitje dhe papritmas ndjeva se duhej të ishte vetura e Drendës; dhe mendova se duhej të ta thoja.» «Çfarë lloj makine është?» e pyeta. «Është një BMW 645Ci dhe është perfekte; dua të them perfekte fare. Ka disa vite që ka dalë, ka kilometrazh të ulët dhe nuk ka gërvishtje. Është e përsosur. Për më tepër, ju e njihni personin që e shet.» «E njoh?» i thashë. Po, tha ai; «Duhet ta telefonosh për këtë.» Epo, kur ai më tha markën dhe modelin e makinës, duke e ditur se ishte pikërisht makina që unë dhe Drenda kishim thënë vetëm disa javë më parë se të dyve na pëlqente, e kuptova që Zoti kishte diçka në mendje.

E telefonova personin që kishte në pronësi makinën. Po, e njihja dhe folëm pak për makinën e ai po më tregonte se sa e bukur ishte. Dhe pastaj më tha këto fjalë. «A e di se çfarë, qëkur filluam të flisnim për këtë makinë, me të vërtetë ndihem sikur kjo supozohet të jetë makina e Drendës.» Unë madje nuk ia kisha përmendur që po kërkoja makinë për Drendën. Burri vazhdoi dhe tha: «Unë po të them se çfarë do të bëj, do të ta shes për 28 000 dollarë». Veshët e mi mezi e besuan atë që po dëgjoja. Makina vlente shumë më tepër se aq. Kur i tregova Drendës për këtë, ajo u entuziazmu. Ne i paguam paratë për atë makinë dhe e kemi edhe sot. Ende funksionon dhe duket shkëlqyeshëm. Ende nuk ka asnjë gërvishtje në të dhe kemi udhëtuar shumë me atë makinë, me tavanin ulur, nën tingujt e radios dhe me diellin që i jep jetë një dite të lodhshme.

Udhëtimi ynë i preferuar ishte të ngisnim atë kabrio të mrekullueshme nëpër malet e Kolorados, me furnizimet tona për kamping në bagazh. Vajza jonë Kirsten, ishte me ne në atë udhëtim dhe mbaj mend që po ecnim nëpër Kansas në I-70 gjatë natës me tavanin ulur. Kirsten po flinte ndërsa unë i jepja makinës. Yjet shkëlqenin aq shumë mbi kokat tona dhe rruga ishte e lirë, me përjashtim të një ose dy kamionëve të rastit. Ishte një nga ato netët e përsosura ku ajri është në rregull dhe gjithçka në botë duket e mrekullueshme. Ne i kaluam dy javët e ardhshme duke shëtitur nëpër shkëmbinj dhe zbulova se sa e mirë dhe lehtësisht e manovrueshme ishte ajo makinë. Vetëm një fjalë mund ta përshkruajë siç duhet - e mrekullueshme!

Por ja pyetja një milion dollarëshe. Si erdhi kjo makinë? Pse ishte ekzaktësisht makina që Drenda tha, “Kjo është!”? Unë e dija që Mbretëria e Perëndisë e solli atë makinë në jetën tonë. E dija se kur mbolla makinën e atij pastori po zbatoja ligjin frymëror. Më kujtohet kur thashë se do të më kthehej sërisht një makinë, jo një SUV, jo një Jeep, një makinë; më kujtohet që thashë një makinë e mirë. Por Drenda dhe unë duhej ta fusnim drapërin gati për korrije. Ajo makinë nuk do të shfaqej derisa të thonim: «Kjo është ajo!» Megjithëse po besoja kur

e dhashë atë makinë, nuk e kishim futur drapërin për korrije derisa Drenda tha: «Kjo është». Ndodhi një incident tjetër që nxori në pah këtë parim në një mënyrë edhe më të mrekullueshme. Siç mund ta dini, më pëlqen gjuetia. Unë jetoj në një vend shumë të mirë gjuetie dhe jam i bekuar me vendin tim të gjuetisë. Në 60 hektarë të mi, kam rreth 19 hektarë drurë dhe rreth 10 hektarë moçalishte. Unë gjuaj drerë dhe ketra çdo vit me shumë sukses. Gjithmonë ka rosa dhe pata që fluturojnë përreth, por kurrë nuk kam menduar vërtet për t'i gjuajtur. Oh, një ose dy herë, unë dhe djemtë e mi kemi zbritur në kënetë dhe kemi kapur disa pata për darkë. Por kurrë nuk kemi dalë për gjueti roash.

Disa vite më parë, ndërsa shihja dyzina rosash duke fluturuar në marshim, mendova ta provoj gjuetinë e tyre.

Uau, ishte mahnitëse! Gjatë gjuetisë së rosave të asaj vjeshte, zbulova se më duhej një praktikë serioze për të qëlluar rosat. Unë arrita të zë disa dhe zbulova se ato gjithashtu ishin shumë të mira për t'u ngrënë. Kam vërejtur se shumë herë rosat qëndronin vetëm jashtë rrezes ose në buzë të rrezes së pushkës, gjë që besoja se kontribuonte në disa nga gabimet e mia. Isha duke përdorur armën time të zakonshme, që e përdorja për gjithçka, nga lepujt te dreri, një model Remington 11-87. Mos më keqkuptoni, unë e dua atë armë dhe është një armë e shkëlqyer. Por kisha dëgjuar se kishte modele të reja armësh që ishin vetëm për gjueti rosash. Ato ishin të kamufluara dhe kishin dhomëza për plumba magnum prej tre e gjysmë inç, të cilat unë e dija se do të më ndihmonin në shkrepje. Kam planifikuar të shikoj njërën prej tyre para se të fillojë sezoni tjetër i rosave.

Sezoni i rosave kishte mbaruar, ishte Janar dhe unë po ecja përmes dyqanit të armëve e po shihja se si dukeshin armë të tilla. Ndërsa ecja në atë seksion, pashë që kishin një seksion të tërë vetëm për armët e gjuetisë së rosave. Pashë disa prej tyre dhe mendova të bleja atë që pëlqeja, por ishte 2 000 dollarë dhe sezoni ishte shumë muaj larg. “Do të pres,” mendova me vete. Por bëra diçka të pazakontë kur isha gati

të largohesha. Në të vërtetë nuk po e kuptoja se çfarë po bëja. E bëra pa e menduar. U drejtova nga pushka që doja dhe thashë me zë të lartë. «Unë do ta kem këtë armë, në emër të Jezusit.» Përsëri, nuk u mendova shumë për këtë; thjesht po deklaroja se do ta kisha atë armë. Zemra ime kishte një pamje të qartë të armës që doja. Isha ftuar të flisja në një konferencë biznesi disa javë më vonë dhe atje ndodhi diçka që kapi vëmendjen time. Pasi fola, pronari i kompanisë eci drejt meje dhe tha se kishin dashur të më jepnin një dhuratë në formë vlerësimi për ardhjen time. Ai tha, “Ne e dimë se të pëlqen gjuetia, ndaj të kemi blerë këtë pushkë.” U shokova sepse ata kishin blerë një Benelli, krejtësisht të ri, një armë gjahu për rosa, gjysmë automatike, saktësisht atë që kisha parë në dyqan dhe të cilën e kisha piketuar!

Kisha dhënë dhjetëra armë me kalimin e viteve, por nuk e kisha vënë kurrë draprin për korrije. Me fjalë të tjera, i kisha mbjellë ato armë me besim dhe bujari, por kurrë nuk i kisha futur në drapër. A e shihni këtë? Si u shfaq pikërisht ajo armë? Unë kurrë nuk kisha thënë: “Zot, kjo është! Kjo është ajo që dua”. Por në minutën që e bëra, të korrrat u shfaqën!

Po i tregoja historinë e gjahut një shokut tim në shërbesë. Ai tha: “Po, unë mendoj se Zoti e bën këtë ndonjëherë. Ai të bekon me një dhuratë të vogël të veçantë për të të thënë se Ai të do». Teksa mendoja për ato që tha, kuptova: “Jo, nuk është e drejtë. Po, Zoti më do, por Ai nuk donte që thjesht të më befasonte me një dhuratë të vogël.» Qeni, peshku, dreri që erdhën pikërisht sipas këtij rendi, makinat, të gjitha kishin ardhur jo sepse Zoti thjesht donte të më tregonte se më donte. Ai më tregoi se më donte kur dërgoi Jezusin për mua dhe më dha Mbretërinë!

Dua t'ju tregoj edhe një histori rreth korrijes. Siç ju thashë tashmë, unë nuk ia them shumë për makinat. Ne i përdorim ato derisa të jetë nevoja të zëvendësohen. Një shembull është Honda Piloti ynë tetë vjeçare. Na pëlqen ajo makinë, është e dobishme, funksionon mirë, duket e re, ndaj e mbajmë. Por shpesh mendonim të blinim një SUV

më të madh për të transportuar pasagjerë dhe mysafirë. Pak më parë, ne morëm me qira një *Cadillac Escalade* për një nga eventet që organizuam

në qendrën “Tani” dhe lëvizëm me të përreth.

**... PERËNDIA THJESHT DONTË
TË MË TREGONTE SE MË DONTË.
AI MË TREGOI SE MË DONTË KUR
DËRGOI JEZUSIN PËR MUA DHE
MË DHA MBRETËRINË!**

Na pëlqeu. Na pëlqeu e bardha e saj si perlë dhe na pëlqeu versioni i shkurtër i asaj që po ngisnim, ndryshe nga versioni i gjatë i *Escalade*. Thamë, “Kjo është ajo që duam, një *Cadillac Escalade*, e

bardhë perle, në versionin e shkurtër. Kemi nevojë të blejmë një të tillë.” Jeta ishte shumë e ngarkuar dhe me të vërtetë që nuk kishim kohë të shikonim përreth dhe të konsideronim një blerje.

Rreth një muaj më vonë, sapo kisha dalë nga dera e përparme e shtëpisë për të marrë gazetën e mëngjesit në verandë dhe më ra telefoni. Një burrë tha: “Hej, Pastor, unë dua të të blej një *Cadillac Escalade*; Çfarë ngjyre e deshiron? I surprizuar, thashë, “Uau, kjo është e jashtëzakonshme. Drenda dhe unë duam të bardhën perlë.” «Mirë,» tha ai, «më lër të kontrolloj përreth dhe të shoh se çfarë mund të gjej.» Prej entuziazmit, harrova t’i them se më së shumti na pëlqente versioni i shkurtër. Qëllimi i tij ishte të gjente një që ishte një ose dy vite e re dhe në formë të përsosur e me kilometrazh shumë të ulët.

Epo, nuk dëgjuaam nga ky burrë për një muaj, kur më në fund na telefonoi dhe tha, “E kam Escalad-ën tënde; eja më tako në këtë vend, në këtë kohë dhe mund ta marrësh në shtëpi.” Kështu që e takuam dhe ai kishte një makinë Escaladë të bardhë në perlë në versionin e të shkurtër. Ishte e bukur! “Më vjen keq që mori kaq shumë kohë për të ardhur te ti,” tha ai. “U përpoqa shumë të gjeja versionin që është më i gjatë por ato po kërkohen shumë dhe nuk kishte ansjë të disponueshme. Gjithçka që munda të gjej ishte versioni i shkurtër. Shpresoj që të jetë në rregull.” Në rregull? Kjo është saktësisht ajo që ne dëshironim dhe saktësisht ajo që kemi thënë!

Sërish pyes: Si u shfaq saktësisht makina që dëshironim? Epo, së pari, unë kam dhënë tetë vetura përveç makinës që i dhashë pastorit që përmenda më parë. Por unë kurrë nuk kisha thënë më parë, «Kjo është ajo!» për një makine, derisa Drenda e bëri këtë me BMW-në. Tani, përsëri, Drenda dhe unë kishim rënë dakord dhe kishim thënë me zë të lartë, «Kjo është ajo!» E kam thënë prej vitesh që kisha e jep në mënyrë të shkëlqyer mësimin për dhënien, por nuk i mëson njerëzit se si të korrin. Pra, a mund ta kuptoni se çfarë është drapri nga tregimet paraardhëse? Shpresoj të jetë e qartë! Unë kisha mbjellë shumë vetura me besimin se do më ktheheshin, por unë dhe Drenda kurrë nuk ramë dakord për një makinë të re. Përsëri, ne i ngamë makinat tona për një farë kohe. Por në minutën që thamë: «Kjo është ajo!» u shfaq. Fjalët tona janë drapri!

Vdekja dhe jeta janë nën pushtetin e gjubës; ata që e duan do të hanë frytet e saj.

— Fjalët e Urta 18:21

Ishte një sezon ku kisha dukej sikur jepte shumë mësim prej rrëfimit tonë. Unë kam qenë me njerëz, dhe ju gjithashtu mund të keni qenë, që thonë diçka dhe pastaj e mbulojnë gojën dhe thonë, «Unë duhet të kem kujdes se çfarë rrëfej». Kjo tingëllon si një detyrë fisnike dhe jam dakord që do t'ju ndihmojë ta mbani Fjalën në zemrën tuaj. Sidoqoftë, kujdesi ndaj asaj që rrëfeni nuk ka të bëjë fare me draprin. Çfarë? Por unë mendova se sapo the që fjalët tona janë drapri. Po, e thash, por thjesht të dish të përdorësh formulën për të thënë gjënë e duhur nuk është çelës në vetvete.

*Sepse ju them në të vërtetë se, nëse dikush **do t'i thotë** këtij mali: “Luaj vendit e hidhu në det” dhe nuk do të ketë dyshime në zemër të vet, por **do të besojë** se ajo që po thotë do të ndodhë, çdo gjë që të thotë do t'i bëhet.*

— Marku 11:23

Përsëri, në kapitullin 4 të Markut fjalët tua ja janë drapri! Në kohën kur kapitulli 4 i Markut flet për draprin, ai tashmë ka treguar procesin e besimit dhe se si ta merrni atë. Aty thuhet se kur fara të piqet vendosni draprin sepse ka ardhur koha e korrjes.

Të korrat kanë ardhur sepse ju besoni duke rënë dakord me qiellin në zemrën tuaj. Vargu i mësipërm tek Marku 11 mbart të njëjtat parime. Zemra juaj beson Fjalën e Perëndisë, pastaj ju flisni dhe çlironi autoritetin e qiellit. Por vini re frazën, “*por do të besojë se ajo që po thotë do të ndodhë.*” Testi i besimit është nëse ju e besoni atë që po thoni. Thjesht të thuash apo të shpallë fjalën e Perëndisë nuk është besim në vetvete. Nëse zemra juaj nuk bie dakord me qiellin, mund të shpallni sa të doni por asgjë nuk do të ndodhë. Pra duhet të monitorojmë atë që rrëfejmë apo zemrën tonë?

Njeriu i mirë e nxjerr të mirën nga thesari i mirë i zemrës së vet; dhe njeriu i lig i nxjerr të ligat nga thesari i lig i zemrës së vet, sepse goja e tij flet nga mbushullia e zemrës.

– Luka 6:45

Ruaje zemrën tënde me shumë kujdes, sepse nga ajo dalin burimet e jetës. Hiq dorë nga e folura me hile dhe largo prej teje buzët e çoroditura.

– Fjalët e Urta 4:23-24

Ne mund ta shohim qartësisht se ajo që themi del nga zemra jonë dhe ajo që besojmë. Duke ndjekur procesin te Marku, kapitulli 4, dimë se si të ndryshojmë atë që zemra jonë beson dhe ta përputhim me qiellin dhe me besim. Pastaj, kur bindemi plotësisht, e vendosim draprin me fjalët dhe veprimet tona. E kuptuat? Shkëlqyeshëm, le të vazhdojmë.

Ndërsa vazhdojmë diskutimin tonë për besimin, unë dëshiroj të ngre një pyetje së cilës duhet të jeni në gjendje t’i përgjigjeni.

Nga ta di se po besoj?

Kjo është një pyetje shumë e mirë, të cilën **duhet** të dini t'i përgjigjeni, duke qenë se është e pamundur të thuash lutjen e besimit pa besuar së pari. Ka disa mënyra për të kuptuar nëse po beson apo jo, shumë simptoma që duhet t'i njohësh dhe t'i kuptosh. Ti mund të marrësh shumë vendime të gabuara duke u bazuar te frika, kur nuk beson. Vendimet me bazë frikën do të të mbajnë peng në mallkimin e tokës dhe do të shkaktojnë humbjen e asaj që Perëndia dëshiron për ju. Pra cila është evidenca se po beson? Shenja e parë është e thjeshtë; mund ta shohësh edhe një herë përkufizimin tonë të besimit dhe të kuptosh se të qenit plotësisht i bindur në zemër është një çelës i vërtetë. Por shumë herë mendojmë se jemi të bindur, por në fakt kemi rënë dakord vetëm në mendjen tonë me Fjalën dhe jo në zemrën tona. Ju duhet të jeni në gjendje ta dalloni. Kur bindeni plotësisht, sigurisht që ekziston një marrëveshje mendore me atë që thotë Fjala, por edhe të dish se je i sigurt, një besim që sjell paqe dhe pritshmëri.

Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen.

– Hebrenjve 11:1

Nëse keni evidenca se keni patur diçka, a do t'ju duhet ende të siguroheni që e keni patur? Sigurisht që jo. Përsëri, kur besoni, e dini, keni paqe dhe siguri se e keni atë që thotë Fjala e Zotit, edhe pse mund të mos e shihni akoma. Shumë njerëz e thonë në këtë mënyrë: «Unë e di, që e di, që e di, që e di që e kam». Kjo njohuri vjen nga brenda dhe jo nga ato që ju tregojnë rrethanat. Ndodhet në frymën tënde ose në zemrën tënde. Frika ka shkuar, nuk ka më mendime bezdisëse mbi shqetësimet që bombardojnë mendjen tënde, është kryer.

Një aspekt tjetër i të besuarit është gëzimi dhe pritja. Përgjigja juaj

gjendet këtu. Ju e keni atë! Besim do të thotë më shumë sesa një ndjenjë paqeje ose sigurie, edhe pse do ta keni edhe këtë. Ju gjithashtu duhet të jeni në gjendje të mbronit pozicionin tuaj frymërisht. Kur them këtë, imagjino një sallë gjyqi dhe veten si avokat që po merr në pyetje dëshmitarin. Pse e besoni atë që besoni në lidhje me situatën tuaj? Si do ta mbronit pozicionin tuaj? Ekziston vetëm një përgjigje, Fjala e Zotit.

Për shembull, nëse dikush vjen në shtëpinë tënde the të thotë, “Hej, dil jashtë nga shtëpia ime,” a do t’i thoje ti, “Oh, më fal; na jep vetëm një ditë kohë dhe ne do të dalim jashtë”? Jo, nuk do ta bëje; me shumë mundësi do të qeshje. Nëse ai do të thoshte, “Jo, kjo është shtëpia ime; dil jashtë ose do të shihemi në gjyq,” përgjigja jote do të ishte, “Me kënaqësi do të shihemi në gjyq!”

Në seancë dëgjimore, ju me qetësi do t’i tregonit gjyqtarit dokumentet tuaja. Ai do t’i hidhte një vështrim dhe do të arrestonte djalin tjetër për ngacmim dhe do ta bënte të paguante të gjitha shpenzimet e gjykatës. Besimi juaj nuk u krijua nga mënyra se si u ndjeve dhe emocionet tuaja, por përkundrazi, nga ligji dhe nga fakti që e zotëron ligjërisht shtëpinë.

Kur bëhet fjalë për të besuarit, kam zbuluar se shumë herë njerëzit që nuk e kuptojnë se çfarë është besimi, ngatërrohen lehtësisht duke e vendosur besimin te veprimet e tyre në vend se ta vendosin te burimit i vetëm i besimit, që është Fjala e Zotit. Është e lehtë të ngatërrosh veprimin ose formulën e veprimit të Fjalës së Zotit me fuqinë e vërtetë të Mbretërisë, e cila vjen nga një zemër plotësisht e bindur. Për shembull, nëse keni mbjellë para në Mbretërinë e Zotit dhe unë ju pyes

Se përse besoni se do t’ju jepen sërish mbrapsh, përgjigja juaj nuk duhet të jetë, “Sepse në filan datë unë dhashë këtë shumë parash.” Ky rrëfim tregon vetëm veprimin tënd, formula nuk ka asnjë spirancë sigurie. Siguria juaj mund të vijë vetëm nga Fjala e Perëndisë.

Unë nuk mund ta llogaris numrin e njerëzve me të cilët jam lutur, që kur pyeten se përse besojnë se do të marrin kur unë lutem, thjesht më shikojnë pa asnjë përgjigje. Kur pyes, kërkoj besimin e tyre,

marrëveshjen e tyre me qiellin. Unë dua t' i dëgjoj të thonë: «Unë e di se do të marr, sepse Zoti më ka premtuar në këtë libër dhe në këtë varg që është i imi.» Nëse ata nuk mund të më japin një varg nga Shkrimi, ka më shumë shance që nuk janë të ankoruar dhe me të vërtetë që nuk e kanë fare idenë se ku po shkon varka e tyre.

“DHE BESIMI ËSHTË SIGURIA E GJËRAVE QË SHPRESOHEN, BINDJA E GJËRAVE QË NUK SHIHEN.”

— HEBRENJVE 11:1

Mos harroni, besimi mund të ekzistojë vetëm kur dini vullnetin e Zotit. Pse? Sepse besimi mund të ekzistojë vetëm kur zemra juaj është në përputhje me vullnetin e Zotit. Besoj se shumë njerëz mendojnë se besojnë kur në të vërtetë nuk është kështu. Përsëri, mendjet e tyre mund të bien dakord që Fjala e Zotit është e vërtetë dhe e mirë, por besimi ekziston vetëm kur zemrat e tyre binden plotësisht. Për shumë njerëz, mendja pajtohet me Fjalën e Zotit, por zemra e tyre nuk është e vendosur.

Ja ku është një ilustrim i mirë i asaj për të cilën po flas, një që besoj se do të tregojë se shumë nuk besojnë edhe pse mendojnë se po besojnë. Po sikur të të thosha se kohët e fundit kam zbuluar që qielli nuk është blu, siç thonë njerëzit, por ngjyra blu, siç e quajmë, është në të vërtetë e verdhë? Me fjalë të tjera, unë ju them se jemi mësuar gabim gjatë gjithë jetës sonë në lidhje me ngjyrat dhe se bluja nuk është në të vërtetë blu, por e verdhë. Çfarë do të bënit? A do të gulçoni nga tronditja dhe shpejt do të kapni celularin e do të telefononi mësuesin e klasës së parë dhe do t' i bërtisni, duke e akuzuar se e ka bërë lëmsh jetën tuaj, duke ju mësuar të gjitha ngjyrat gabim? Unë nuk mendoj kështu. Nuk do të kishte reagime emocionale frike, as drama. Ju thjesht do ta kuptonin se unë jam i marrë, do ta konsideronit komentin si të paarsyeshëm dhe do të vazhdonit punën tuaj. Pse? Sepse ju jeni plotësisht të bindur se bluja është blu!

Tani, le ta krahasojmë shembullin tim me diskutimin tonë mbi

besimin. Po sikur të jeni plotësisht të bindur për ato që Zoti ka thënë në lidhje me shërimin por një mjek ju thotë që do të vdisni nga kanceri? Ju do ta vështronit atë mjek dhe do të mendonit se ai është i marrë sepse e dini se nuk ka asnjë mundësi që kjo të ndodhë. Pse? Për shkak se jeni të bindur plotësisht për shërimin, për të cilin Jezusi ka paguar. E shikoni? Sigurisht, shumë njerëz luten, por pas ekzaminimit, zbuloj se lutjet e tyre nuk janë lutje besimi por shprese, të pasigurt për rezultatin. Miku im, kjo është arsyeja përse është kaq e rëndësishme që të ndërtohem në Fjalën e Zotit. Ne duhet të dimë se cili është vullneti i Zotit në mënyrë që të jemi të sigurt për atë që Ai thotë, dhe gjithashtu që të mund të refuzojmë atë që nuk është vullneti i Tij. Më lejoni t'ju jap një shembull nga jeta ime, i cili ilustron se sa e rëndësishme është të ushqehem me ato që thotë Zoti për jetën.

Isha i lodhur pasi kisha kaluar disa javë të vështira si pronar biznesi (kjo ndodhi para se të pastoroja një kishë). Orari im ishte mbushur me telefonata shitjesh dhe, sigurisht, isha nën presionin financiar të jetesës. Po shkoja te dentisti im për një mbushje rutinë. Gjithçka ishte normale derisa dentisti u bë gati të injektonte novokainë. Kur nguli gjilpërën, ndodhi një goditje e papritur dhe pastaj nofulla mu mpi menjëherë dhe jo ngadaltë. U habita dhe i thashë dentistit se çfarë ndodhi. Ai tha, “Oh, mendoj se kam goditur nervin.” Unë e pyeta shpejt, «A është normale?» Ai tha këto fjalë, “Epo, zakonisht shërohet”. Çfarë? A e dëgjova sakt? “Doktor, çfarë doni të thoni me zakonisht shërohet?” Ai tha, “Epo rreth 80-85 përqind të rastve shërohet plotësisht pa ndonjë efekt negativ të përhershëm”. Çfarë? Papritmas në mua u ngjall frika. Po tani si t'ia bëj?

A do të shërohet? Mendja ime po fillonte të konsumohej nga mendime të frikshme. Pas mbushjes së dhëmballës, fytyra ime mbeti e mpirë, ndryshe nga vizitat normale te një dentist, ku mpirja ngadalë shuhet. Unë po shkoja të takoja një klient rreth një orë larg klinikës së dentistit, kështu që kisha shumë kohë të mendoja për atë që sapo kishte ndodhur. Por gjatë rrugës isha në agoni, jo nga ndonjë dhimbje, por

nga mungesa e paqes dhe nga frika që po më vërtitej në mendje.

Më vonë, gjatë rrugës për në shtëpi, u ndala në shtëpinë e një shoku. Fytyra ime ishte akoma e mpirë dhe po kërkoja që dikush të më siguronte se kjo gjë do të shërohej. Vini re gabimin tim: Unë nuk po kërkoja Fjalën e Zotit por një person që se nuk ishte besimtar i fortë, për të gjetur siguri. I tregova këtij personi se çfarë kishte ndodhur dhe po prisja që të thoshte, “Nuk është ndonjë problem i madh Geri, do të shërohet!”

Në vend të kësaj, ja se çfarë dëgjova. “Oh, jo! Një mikut tim i ndodhi kjo dhe fytyra e tij nuk u shërua kurrë; fytyra e tij është e paralizuar që nga ajo kohë”. Nuk mund ta besoja atë që po dëgjoja!

Mendja ime u mbërthye nga frika. U solla sikur ta dija se gjithçka do të shkonte mirë dhe e falënderova për kohën e tij. Në dëshpërim e sipër, u ndala në shtëpinë e një shoku tjetër dhe drejtova të njëjtën pyetje dhe u trondita kur dëgjova të njëjtën përgjigje, «Oh, jo», tha ai, «Unë kisha një mik që i ndodhi e njëjta gjë dhe fytyra e tij nuk u shërua kurrë; fytyra është ende e paralizuar edhe sot.”

Pas kësaj vizite, u trishtova. E dija (në mendjen time) se Perëndia shëron, por nuk çlirohesha dot nga ajo frikë. Zemra ime ishte plotësisht e mbërthyer. Atë natë, isha në agon! Mendja ime ishte plot frikë dhe fytyra ishte ende e mpirë, njësoj siç ishte kur dola nga dentisti. Ndërsa po përpiquesha të flija, fillova të ndjej pak dhimbje poshtë veshit të djathtë. A ishte e vërtetë? Babai im kishte luftuar me paralizën faciale të Belli-t një ose dy vjet më parë dhe më kishte thënë se ajo kishte filluar me disa dhimbje pikërisht nën vesh. Paraliza e Belli-t ndodh kur nervi që kontrollon muskujt e fytyrës, i cili udhëton nëpër një vrimë të vogël në kockë pikërisht nën vesh, shtypet nga një infeksion ose inflamacion.

Ndërsa u shtriva duke u përpjekur flija, gjithçka që mund të dëgjoja ishin këto fjalë që më kalonin në mendje, «Ti ke paralizën e Bell-it ashtu si babai yt». Kur u zgjova në mëngjes, pata plotësisht paralizën Bell! Tani, jo vetëm që nofulla ishte e mpirë, por e gjithë fytyra në anën e djathtë ishte mpirë gjithashtu dhe as nuk mund të mbyllja sytë dhe gojën. Isha keq.

Shkova te një mjek lokal për të konfirmuar dyshimet e mia. Pas ekzaminimit, ai më pa dhe tha se me të vërtetë kisha paralizën Bell. Pastaj thashë: «Çfarë do të ndodhë më pas?» Ai tha, «Epo, në rreth 80 deri 85 përqind të rasteve, do të shërohet pa paralizë të përhershme». «A tha ai atë që unë mendova se tha?»

NË ATË MOMENT, UNË E DIJA SE SHPRESA IME E VETME ISHTE FJALA E ZOTIT.

Në atë moment, e dija se isha në telashe. E dija që djalli nuk do të ndalej aty dhe nuk doja të shihja se çfarë do të vinte më pas. Unë dija rreth luftës shpirtërore aq sa ta kuptoja se po shkoja në drejtim të gabuar. Mos harroni, kjo ndodhi vite para se të dija shumë rreth këtyre gjërave. Por unë dija aq sa të kuptoja se duhej ta zgjidhja frymërisht këtë gjë nëse doja kisha sukses për ta mposhtur atë. Unë gjithashtu kuptova se ky ishte një plan demonik për të më zënë në befasi kur isha i lodhur dhe pa telashe.

Në atë moment, unë e dija se shpresa ime e vetme ishte Fjala e Zotit. Në vetvete nuk kisha absolutisht asnjë aftësi për të ndalur frikën që më mundonte mendjen. Kështu që shkrova karta me vargje biblike mbi shërimin dhe i vendosa në të gjithë shtëpinë. U pendova para Zotit dhe fillova procesin e zhvillimit të besimit në zemrën time. E dija se duhej ta mbillja Fjalën në zemrën time për të zhvilluar besimin, kështu që meditoja mbi Fjalën e Zotit gjithë ditën.

Në fillim asgjë nuk ndryshoi. Fytyra ime ishte si e ngrirë dhe unë vazhdimisht luftoja me frymën e frikës. Pas një jave, pasi asgjë nuk kishte ndryshuar në fytyrën time, ndodhi! Njësoj si procesi që na mëson Marku 4:26, kur mbolla fjalën në zemrën time, besimi filloi të formohej, në fillim kërcelli, pastaj kalliri dhe në fund u maturua fara.

Gjatë gjithë këtij procesi nuk ka një marrëveshje, ndaj nuk ka ende besim. Sidoqoftë, edhe pse unë nuk shoh ndryshim apo nuk e di se si funksionon, sipas vargut tonë te Marku 4, gjëra po ndryshojnë në të vërtetë. Ndryshimi për të cilin po flas nuk është manifestuar ende

në sferën natyrore, por ndryshimi po ndodh në zemrat tona. Nëse mbahemi te Fjala, fjala dalëngadalë do të ndryshojë sistemin e besimit të zemrave tona nga mosbesimi në marrëveshje të plotë me vetë qiellin. Kështu që, në këtë rast, unë u mbajta te fjala, duke e ditur që ishte zgjidhja ime e vetme.

Papritur, një ditë, teksa po ecja nëpër shtëpinë të mbushur me gjithë ato karta plot me vargje biblike mbi shërimin, që i kisha shpërndarë kudo, pashë një kartë që e kisha parë njëqind herë. Por kur e pash kësaj here, BAM! Papritmas, vajosja zbriti te unë, frika u largua menjëherë dhe E DIJA që isha shëruar. Po, fytyra ime ishte akoma e mpirë. Nuk kishte asnjë ndryshim, por e dija se isha shëruar. Brenda disa orësh, fytyra u normalizua dhe mpirja u zhduk. Lavdi Zotit! Fjala funksionon!

Edhe pse kisha lejuar që jeta ime frymërore të dobësohej për shkak të neglizhencës dhe ngarkesës sime, përfundimisht e kuptova gabimin dhe u pendova për marrëzinë time. Kjo ndodhi kohë më parë, kur isha duke mësuar për herë të parë se si funksiononte vërtet besimi dhe nuk kisha shumë përvojë në këtë fushë. Shikoj prapa në atë që bëra, pyesja të tjerët për të ardhmen time si i marrë kur u gjenda në telashe, në vend që t' i drejtohesha Fjalës së Zotit.

Kur e kuptova se çfarë po ndodhte, u ktheva te Fjala e Zotit me siguri.

Fatkeqësisht, shumica e njerëzve nuk janë të sigurt në këtë proces, sepse ata kurrë nuk kanë mësuar rreth besimit dhe mënyrës se si ai vjen. Meqenëse nuk janë në dijeni të procesit, kur gjenden nën presion, nuk e përdorin Fjalën, duke menduar se nuk funksionon.

Kuptoni kundërsulmin e Satanit

Kristina erdhi në kishën tonë duke mos ditur shumë rreth Perëndisë. Ajo ishte rilindur në një nga shërbesat tona të së dielës dhe jeta e saj kishte ndryshuar me shpejtësi. Në kishën tonë, kemi një klasë orientimi

mbi Mbretërinë. Një nga fushat për të cilën flasim dhe mësojmë është e drejta ligjore për të marrë shërimin. Kristina kishte patur probleme me dëgjimin prej vitesh. Në fakt, ajo kishte mbajtur aparat dëgjimi për 40 vjet dhe kishte humbur mbi 50 përqind të dëgjimit të saj. E ëma ishte e shurdhër dhe i vëllai po vuante nga e njëjta gjë, humbja e dëgjimit. Kur Kristina dëgjoi që si besimtare kishte të drejtën ligjore të shërohej, u emocionua shumë!

Në klasë, gruaja ime shtriu duart e saj mbi të dhe u lut që dëgjimi t'i rikthehej dhe menjëherë, ajo mundi të dëgjojë në mënyrë të përsosur. Kristina filloi të ulërinte, qante dhe lavdëronte Perëndinë. Kur gruaja ime, Drenda dhe Kristina erdhën të më tregonin lajmin e mirë, ndjeva një nxitje për ta paralajmëruar për kundërsulmin e Satanit. I thashë Drendës ta instruktonte Kristinën që nëse simptomat do të ktheheshin tek ajo, të fliste me guxim dhe të shpallte se ishte e shëruar dhe ta shporrte Satanin. Mëngjesin tjetër testi erdhi. Dëgjimi i saj u kthye në gjendjen e mëparshme. Ajo veproi saktësisht siç i thamë, "JO! Satan, unë nuk e pranoj këtë. Unë jam e shëruar dhe jam shëruar në emrin e Jezusit!" Veshët e saj u hapën dhe mbetën të hapur. Mos harroni që Satani do të kundërsulmojë dhe do të përpiqet të rimarrë territor. Mos e lejoni. Qëndroni në Fjalën e Perëndisë!

Në këtë kapitull, mora kohë për t'ju treguar kuptimin bazë të asaj që besimi është, si funksionon, si ta dimë që jemi në besim dhe ku ta marrim besimin. Që Mbretëria e Perëndisë të veprojë në jetën tënde, duhet ta dish këtë. Mos harro, Jezusi i tha gruas, "Besimi yt të shëroi." Dhe po kështu do të jetë edhe për ty: Besimi yt, zemra jote - plotësisht e bindur për atë që qielli thotë dhe përdorimi i drapërit do të jetë përgjigja jote për çdo problem apo nevojë që mund të hasësh në jetë.

KAPITULLI 6

BEKIMI I ZOTIT

Isha ulur në një restorant me gruan time dhe me një folëse të ftuar. Ishte ora 10:00 e mbrëmjes dhe ne sapo kishim përfunduar një shërbesë të fuqishme. Kamariери erdhi për të marrë porosinë dhe filluam të bisedonim. E ftuara filloi t'i tregonte atij për kishën tonë dhe se sa e mrekullueshme kishte qenë shërbesa. Më pas ajo tha, “Të pëlqen gjuetia?” Ai i tha se i pëlqente shumë. E ftuara jonë i pëlqente gjithmonë historitë e mia të gjuetisë dhe në fakt, i pata dhënë asaj një prej librave të mi, *Faith Hunt* (Gjuetia e Besimit) për një mikun e saj. Unë e kisha atë libër me vete.

Kamarieri vazhdoi të fliste se si gjuante por kurrë nuk kishte zënë asnjë dre. Mikesha jonë filloi t'i shpjegonte se si operonte Mbretëria e Perëndisë dhe se ai duhej të kishte pritshmërinë se do ta merrte drerin e tij sa herë që të dilte për gjueti. Ai nuk dinte se çfarë të mendonte për ne. Por librin që kisha me vete ia ofrova atij. I thashë mikeshtë tonë që do t'i jepja asaj një kopje tjetër dhe ajo ra dakord. Kamarieri më falenderoi dhe premtoi se do e lexonte librin, por unë mendova se ajo do ishte hera e fundit që do dëgjoja prej tij. Por jo. Një vit më vonë, e njëjta folëse erdhi sërish tek kisha dhe na tregoi që e pëlqente shumë restorantin ku ishim një vit më parë dhe na pyeti nëse mund të shkonim sërish atje.

Kështu vepruam. Kur u ulëm, u habitëm që kishim të njëjtin

kamarier si një vit më parë. Kur u afrua, ai na vështroi dhe tha, “Hej, ju ishit këtu një vit më parë dhe biseduam për gjuetinë e drerit.” Ne thamë, “Po, e mbajmë mend.” Ai tha, “Unë e lexova librin që më dhatë dhe veprova ashtu siç shpjegohej aty. Unë mora dy drerë vitin e kaluar dhe pres të marr drerin tim edhe këtë vit.” Për ne ishte kënaqësi të dëgjonim historinë e tij, por jo të habitur. Mbretëria funksionon çdo herë!

Unë po zhvilloja një takim për 25 pastorë, duke u shpjeguar për Mbretërinë e Perëndisë dhe se si funksionon ajo. Ishte një takim i shkëlqyer. Kur isha gati për t’u larguar dhe stafi po pastronte, njëri prej pastorëve u afrua. Ai dhe gruaja e tij erdhën te gruaja ime dhe e pyetën nëse mund të flisnin me ne. Pastori filloi të na thoshte se shtëpia e tij do të merrej nga banka nëse deri në fund të javës nuk do të arrinin të paguanin 6 900 dollarë. Ai shpjegoi se nuk kishte para përveç 100 dollarëve, të cilat tani i mbante në dorë. “Kjo është gjithçka që kam,” tha ai, “por unë dua ta mbjell atë siç e keni mësuar sonte, nëse ju dhe gruaja juaj bini dakord me ne për paratë që na duhen këtë javë.” Ne të gjithë bashkuam duart dhe u lutëm dhe falënderuam Zotin për paratë.

Rreth një muaj më vonë, pashë të njëjtin pastor në një event tjetër, dhe ai vrapoi drejt meje shumë i emocionuar. “Më duhet të të them atë që ndodhi,” tha ai. “Unë nuk jua thashë këtë kur patëm biseduar më parë, por gruaja ime dhe unë kemi një biznes të vogël për stampim bluzash që e zhvillojmë në garazhin tonë herë pas here. Ne nuk bëjmë shumë me të, por ndonjëherë marrim porosi. Epo, të nesërmen e lutjes sonë me ju, ne morëm disa porosi në vlerë prej 8,900 dollarë. Na duhej të punonim shumë fort atë javë, por deri atë të premtë, kishim 6,900 dollarët që na duheshin për të mbajtur shtëpinë tonë. Faleminderit!”

Isha në një konferencë pastorësh në Karolinën e Veriut me rreth 500 pastorë të tjerë. Unë nuk po flisja, vetëm po merrja pjesë. Një burrë u afrua tek unë dhe më tha: «Unë kam nevojë të flas me ty». Ai ishte një pastor nga Gjermania dhe tha se kishte një histori interesante për të më treguar.

Djali i tij, i cili ishte adoleshent, në një farë mënyre kishte marrë CD-të e mia. Pasi i dëgjoi ato, ai vendosi që do të merrte një PlayStation 3 me besim pasi nuk kishte para për të. Unë besoj se të gjithë e dinë se çfarë është PlayStation 3, por në rast se nuk e njeh, është një sistem lojërash kompjuterike. Pastori më tregoi se si djali i tij erdhi në zyrën e tij një ditë dhe e pyeti nëse do të pajtohej me të për atë PlayStation 3. Djali i shpjegoi babait të tij se çfarë kishte mësuar në CD-të e mia dhe se si donte të mbillte një farë dhe të lutej me babanë e tij në lidhje me këtë. Kështu, pastori më tha se nuk e kishte menduar gjatë, por si pastor i kishës, kishte marrë një farë nga djali i tij, një ofertë financiare e bërë për kishën. Ai dhe djali i tij u lutën së bashku dhe ranë dakord që djali të kishte tani një PlayStation 3 dhe ata e konsideruan çështjen si të përfunduar.

Ditën tjetër, një burrë nga kisha e tyre kishte telefonuar pastorin dhe e kishte pyetur nëse djali i tij do të donte të bënte para shtesë pasi kishte një projekt afatshkurtër për të cilin kishte nevojë për ndihmë. Djali ishte i kënaqur dhe bëri mjaft para në atë projekt dy-ditor për të blerë PlayStation 3.

Kjo gjë kishte kapur vëmendjen e djalit të tij dhe disa javë më vonë, pastori tha që djali i kishte ardhur sërish në zyrë dhe kishte pyetur nëse do të binte darkod me të për diçka tjetër. Pastori kishte pranuar, por ishte surprizuar kur i biri i kishte kërkuar që të binin dakord që Perëndia t'i jepte muskuj më të mëdhenj. Pastori më tha mua që ai nuk kishte ditur si ti përgjigjej të birit për këtë.

Por i kishte thënë që duhej të bënte pjesën e tij kur të kërkonte muskuj dhe ai do të binte darkod me të kur ta kuptonte këtë. Djali i tij kishte rënë dakord. Sërish, i biri kishte mbjellë për muskuj më të mëdhenj dhe ata ishin lutur duke rënë dakord të dy për këtë.

Ditën tjetër, një makinë kishte ardhur te pastori. Ishte një familje nga kisha. Kur pastori kishte dalë për të biseduar me ta, i kishin thënë se po pastronin garazhin e tyre dhe kishin një set girash dhe peshash për të cilat kishin menduar se djali i pastorit mund t'i donte. Nëse jo, ata kishin menduar se pastori, të paktën mund të njihte dikë tjetër në kishë që do t'i donte. Pastori më tha se askush nuk dinte asgjë për dëshirën e

djalit të tij për muskuj dhe se ata sapo ishin lutur për këtë një natë më parë. Pastori tha se ishte shokuar! Ai kishte hyrë në shtëpi duke i thënë djalit të tij, “Ku janë ato CD?”

Këto lloj historish janë të zakonshme. Unë i dëgjoj gjatë gjithë kohës dhe dëshiroj që të jenë të zakonshme në jetën tuaj gjithashtu. Deri më tani, kemi diskutuar disa aspekte kryesore mbi funksionimin e ligjeve të Mbretërisë së Perëndisë, si dhe se si kërkohet marrëveshja ose besimi që qielli të fitojë ligjshmërinë ose juridiksionin në mbretërinë e tokës. Tani, le të shikojmë pak më thellë se si këto ligje të Mbretërisë mund të ndihmojnë për nevojat tona financiare.

Bekimi i Zotit pasuron dhe ai nuk shton vuajtje.

– Fjalët e Urta 10:22

Kur e pashë në fillim këtë varg, mendova, “Sigurisht, kjo nuk do të thotë atë që po thotë, apo jo?” Por kuptova se në fakt do të thotë saktësisht atë që thotë! Për ta kuptuar se çfarë do të thotë ky varg, do të shohim zanafillën, kur u krijua njeriu.

por dikush dëshmoi diku, duke thënë: «Ç’është njeriu, që të kujtohesh për të? Ose biri i njeriut, që të kujdesesh për të? Ti e bërë për pak kohë më të vogël nga engjëjt, ti e kurorëzove me lavdi dhe me nder dhe e vure përmbi veprat e duarve të tua; Ti e nënshtrove gjithçka nën këmbët e tij». Sepse, mbasi ia nënshtroi atij gjithçka, nuk la asgjë pa ia nënshtruar. Por tani nuk e shohim ende gjithçka të nënshtruar.

– Hebrenjve 2:6-8

Ne e lexuam më parë këtë pasazh, por është i rëndësishëm për diskutimin tonë tani. Kur njeriu u krijua, gjithçka në tokë u vendos nën sundimin e tij. Nuk ishte asgjë që nuk ishte nën sundimin e tij. Ai sundoi

realitetin tokësor nga një pozitë autoriteti të deleguar dhe mbajti kurorën e qeverisjes që ai përfaqësonte. Ai ishte i veshur me vajosje dhe i nderuar me autoritetin që i ishte dhënë. Satani, i cili kishte rebeluar kundër Perëndisë, ishte hedhur tashmë në tokë përpara se të shfaqej Adami.

Satani e përçmoi njeriun ndërsa u gjend duke u sunduar nga ky njeri që mbante kurorën e autoritetit të Zotit. Satanit tashmë iu desh t'i nënshtrohej kësaj krijese, e cila në gjendjen e saj fizike të krijuar dhe natyrore, ishte shumë më e dobët se ai.

Sidoqoftë, frymërisht, çdo fjalë që Adami tha kishte të njëjtin autoritet sikur Zoti ta thoshte vetë. Adami, një bir i Zotit, sundoi mbi tokë nga kjo pozitë e jashtëzakonshme e autoritetit dhe madhështisë.

Kështu që Satani e urrente këtë njeri dhe dëshironte me forcë autoritetin që zotëronte ai mbi tokë. Përgjigja e tij e vetme ishte që në një mënyrë apo një tjetër të hiqte prej njeriut kurorën dhe pozicionin që mbante. Kishte vetëm një problem të vogël. Satani nuk kishte fuqi ta merrte kurorën nga Adami;

Shpresa e tij e vetme ishte të mashtronte në ndonjë mënyrë Adamin që ta merrte vetë kurorën. Duke bindur Evën që Perëndisë nuk i duhej zënë besë dhe që jeta kishte shumë më tepër për të ofruar se sa jepte Perëndia, Adami dhe Eva zgjodhën të besonin Satanin përmbi Perëndinë dhe kryen tradhëti ndaj Perëndisë. Në fund, Adami dhe Eva humbën pozitën e tyre ligjore në Mbrëterinë e Perëndisë dhe Satani u bë perëndia i kësaj bote, siç e shohim Palin ta trajtojë te 2 Korintasve.

“BEKIMI I ZOTIT PASURON DHE AI NUK SHTON VUAJTJE.”

— FJALËT E URTA 10:22

*të cilëve **perëndia i kësaj bote** ua verboi mendimet e atyre që nuk besojnë, që drita e ungjillit të lavdisë së Krishtit, që është shëmbëllimi i Perëndisë, të mos ndriçojë tek ata.*

— 2 Korintasve 4:4

Para se të rebelohej, Adami gëzonte përfitimet e të qenit një bir. Gjithçka që kishte Zoti, Adami mund ta shijonte dhe ai kurrë nuk kishte njohur asnjë ditë skamjeje apo mendim frike, asnjë ditë të vetme të jetës së tij. Gjithçka që i duhej për të jetuar në planetin tokë ishte vendosur tashmë ary, para se ai të krijohej.

Nëse reflektojmë përsëri mbi gjashtë ditët e krijimit në librin e Zanafillës, zbulojmë se njeriu u krijua në fund të ditës së gjashtë të krijimit, pjesa e fundit e planit krijues të Zotit që u vu në vend. Fati i tij ishte të jetonte në ditën e shtatë, të cilën Zoti e shpalli si ditë pushimi. Kjo nuk ndodhi sepse Zoti ishte i lodhur, por sepse Ai kishte mbaruar dhe gjithçka ishte e plotë. Mendoni për një moment për atë që Zoti kishte përfunduar dhe planin e lavdishëm që ai kishte për njeriun. Për fat të keq, Adami i la të gjitha dhe gjatë këtij procesi, humbi pozitën e tij ligjore në Mbretëri.

Kur Zoti iu afrua pas vendimit të tij për të mos iu bindur, i tha:

toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frytin e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, derisa të rikthehesh në dhe, sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh».

– Zanafilla 3:17b-19

Gjëja e parë që dua të shihni është se Perëndia nuk e mallkoi tokën, Adami e bëri. Ai kishte sundim të plotë mbi të. Ai ishte kujdestari i saj. Adami, duke pasur një sundim të plotë dhe absolut mbi tokën, kreu tradhti ndaj qeverisjes së Perëndisë dhe në thelb e dëboi Perëndinë. Ky vendim kishte shtrirje të jashtëzakonshme, jo vetëm për Adamin, por edhe në të gjithë tokën dhe në çdo burrë apo grua që do të jetonte në tokë që nga ajo ditë e tutje. Megjithatë ai ende mbante juridiksionin e tij mbi mbretërinë e tokës që Perëndia i kishte dhënë, ai e gjeti veten

të pafuqishëm për të sunduar nga perspektiva e kurorës dhe qeverisë që ai përfaqësonte dikur dhe që mbështeste sundimin e tij. Duke qenë e ndarë nga vetë jeta, vdekja, e cila ishte një koncept i huaj për Adamin, zuri vend.

Zoti e përball Adamin me atë që kishte kryer dhe i thotë se, së pari, përmes mëkatit të tij, ka humbur pozicionin ligjor në qeverinë e Perëndisë. Dhe për shkak se Adami ishte përfaqësuesi i asaj qeverie në planetin tokë, qielli humbi përfaqësimin e tij ligjor përmes të cilit fitoi juridiksionin në mbretërinë e tokës. Së dyti, vetë toka tani është prekur dhe nuk do të prodhojë më furnizime si më parë në Kopshtin e Edenit. Tani mundimi i dhimbshëm dhe djersa e vetë Adamit kërkohej që toka të prodhonte atë që i duhej dhe që ai të mbijetonte. Ferrat dhe gjembat tani do jenë kudo dhe jeta bëhet e vështirë; mbijetesa kthehet në mënyrë jetese.

Unë e quaj këtë mënyrë të vështirë jetese dhe mentalitetin e mbijetesës, të njollosur nga aroma e frikës dhe vdekjes, e cila rëndon mbi çdo njeri që erdhi pas Adamit, sistemin e mallkimit të tokës. Është vendi ku unë dhe ti jemi rritur dhe sistemi i mbijetesës që të gjithë e njohim shumë mirë. Davidi e quan luginë e hijes së vdekjes të Psalmi 23.

Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua; shkopi yt dhe kërraba jote janë ato që më japin zemër.

— Psalmi 23:4

Është një mbretëri ku frika e vdekjes përshkon ajrin. Por ka edhe një pasojë tjetër negative. Njeriu humbet marrëdhënien e tij me Perëndinë dhe, rrjedhimisht, nuk e njeh vetveten – ai nuk e sheh më qëllimin dhe identitetin e tij të krijuar. Kur njeriu u krijua, atij iu dha një qëllim, një detyrë. Ai duhej të sundonte mbi tokë në emër të Perëndisë. Me fjalë të tjera, ai kishte një detyrë dhe qëllim të dhënë nga Perëndia

për jetën e tij. Por tani e gjithë mendja e njeriut është zhvendosur në mbijetesë. Mbijetesa bëhet qëllimi i tij dhe detyra e tij e re e mandatuar për mbijetesë.

Tani, çdo vendim që njeriu merr do të filtrohet përmes mallkimit të mbijetesës, qoftë duke gjetur ose duke grumbulluar sigurim. Nuk ka fare paqe; çdo ditë është plot dhimbje dhe djesë. E vjetmja mundësi arratisjeje nga kjo jetë mbijetese, nga ky stërmundim, siç e quajmë sot, është të grumbullosh mjaftueshëm rezerva që të mos vrapojmë më.

Kjo është ëndrra e çdo burri apo grua që nga rënia e njeriut. Ky është qëllimi i tyre kryesor, të ndalojnë së vrapuari.

Kushdo që ka fat të ketë një të ardhur shtesë e grumbullon atë me shumë kujdes dhe mbrojtje. Ata e mbajnë atë me një frikë të madhe se mos e humbasin, sepse nëse kjo ndodh, ata përsëri do të detyrohen ose skllavërohen të vrapojnë me mundim të dhimbshëm dhe djesë. Ëndrra e njeriut, qëllimi i tij i mbijetesës, siç kam thënë, është që në një farë mënyre të gjejë mjaft furnizime që të mund të ndalet së vrapuari si skllav i mbijetesës dhe të gjejë prehje. Unë dua të sigurohem që ta keni kuptuar qartë këtë fakt: Në sistemin tokësor të mallkimit të mbijetesës, të gjithë janë lodhur duke vrapuar.

Mbaj mend që u ulëm me një pastor një mëngjes. Ai po më thoshte se e donte shërbesën çdo mëngjes kur ngrihej deri në momentin që

NË SISTEMIN TOKËSOR TË MALLKIMIT TË MBIJETESËS, TË GJITHË JANË LODHUR DUKE VRAPUAR.

kujtonte gjendjen e financave të tij, borxhin dhe mungesën e parave. Ai tha se çështjet e tij financiare ishin si një batanije e lagur që përpiquej t'i mbyste jetën dhe t'i grabiste gjithë gëzimin e asaj që bënte. Nuk janë vetëm pastorët që përballen me këtë lloj mosfunksionimi. Është një mënyrë jetese për shumicën e

familjeve, sepse jetojnë me borxhe.

Të gjithë po kërkojnë një rrugëdalje dhe e vetmja rrugëdalje është

pasuria, duke pasur më shumë se sa duhet. Nën sistemin e mallkimit të tokës, identiteti përcaktohet tani nga ato që keni dhe paratë që mund të bëni. Së pari, njeriu dëshpërimisht përpiqet të mbulojë lakuriqësinë e tij, humbjen e qëllimit dhe identitetit të tij të vërtetë të krijuar dhe vesh një falsitet. Ai tani përpiqet të zëvendësojë vajosjen e Perëndisë, e cila dikur e mbulonte me lavdi, me pasuri. Së dyti, ai gjithashtu përpiqet të zëvendësojë pozicionin e tij të kurorëzuar të nderit, nga i cili sundoi në Mbretërinë e Perëndisë, me krenarinë e jetës dhe sundimin mbi njerëzit e tjerë. Njeriu tani konsumohet nga një gjë - gjetja ose grumbullimi i pasurisë. Identiteti i tij tani caktohet nga sa pasuri ka dhe nga sa pushtet mund të ushtrojë mbi njerëzit e tjerë. Statusi dhe pozita në shoqëri janë shumë të rëndësishme për vetëvlerësimin e njeriut të rënë. Mendoni për këtë. Zakonisht cila është pyetja e parë që një njeri do t'i bënte dikujt tjetër? “Çfarë pune bën?” Pse? A jemi vërtet të shqetësuar dhe të interesuar?

Jo në të vërtetë, por pyetja përcakton nivelin tonë të respektit për atë person. Me fjalë të tjera, po pyesim veten, “Kush është ky njeri? Çfarë pozicioni ose lartësie mban në mbretërinë e tokës? Me sa respekt duhet ta nderoj atë?” Unë po flas vetëm nga këndvështrimi i një burri këtu, zonja. E kuptoj që ju zonjat operoni nga një këndvështrim krejt tjetër mbi identitetin.

Sot ky sistem i mallkimit të tokës është ende në fuqi! Njerëzit filtrojnë të gjitha vendimet e tyre përmes filtrit të gjetjes ose grumbullimit të parave. Njerëzit lëvizin jashtë shtetit për të marrë një punë më të mirë pa u menduar dy herë në lidhje me qëllimin e tyre. Të gjithë duan të jenë yje roku. Pse? Për shkak të identitetit (pozitës) dhe pasurisë.

U krye një sondazh me mijëra studentë të shkollave të mesme lidhur me çfarë profesioni dëshironin të kishin kur të rriteshin. Gjashtëdhjetë e pesë përqind e tyre tha se qëllimi i tyre ishte të bëheshin të famshëm. Të famshëm? Herën e fundit që kërkoja për këtë, të qenit i famshëm as nuk ishte një profesion.

Një studim tjetër zbuloi se 30 përqind e punëtorëve e urrenin

punën e tyre dhe një tjetër zbuloi se 40 përqind nuk e pëlqenin punën e tyre. Pra kemi 70 përqind të punëtorëve në Shtetet e Bashkuar, të cilët nuk e pëlqejnë atë që po bëjnë! Atëherë pse gjenden aty? Për shkak se janë skllevër të mbijetesës, vrapojnë me dhimbje dhe djersë për të mbijetuar. Qëllimi dhe pasioni nuk futen në ekuacion për shumicën e këtyre punëtorëve; pagimi i faturave është faktori motivues. Të qenit skllav i nevojës për të gjetur para lë pak hapësirë për mundësi. Kush paguan më shumë para fiton çdo herë. Quhet betejë për të jetuar. Është vendi ku jetojmë unë dhe ti. Krijoni në mendjen tuaj pamjen e një hamsteri që vrapon aq shpejt sa mundet, duke mos shkuar askund veç kafazit të tij. Ne qeshim dhe mendojmë se kjo është e lezetshme. Por në botën reale, nuk është aspak e lezetshme. Njerëzit vdesin në atë kafaz dhe nuk arrijnë kurrë aty ku shpresonin se do të përfundonin.

Edhe ju mos kërkonit çfarë do të hani ose do të pini, dhe mos jini në merak, sepse kombet e botës i kërkojnë të gjitha këto, por Ati juaj e di që ju keni nevojë për to. Përkundrazi, kërkonit më parë mbretërinë e Perëndisë dhe të gjitha këto do t'ju shtohen.

– Luka 12:29-31

Vrapimi me mund dhe dhimbje është i vetmi sistem që njohim. Nëse do të të thosha që duhej të dilje nga borxhi, e theksoj që DUHET të dalësh nga borxhi për 12 muaj, përndryshe e gjithë familja jote do të transportohet në Polin e Veriut përgjithmonë (po përdor një shembull ekstrem për ta theksuar), çfarë do të bëje? Unë do të të tregoj se çfarë do të bëje. Ju menjëherë do të fillonit të formulonit një plan për të djersitur dhe për të vrapuar më shpejt. Ju do të thonit: “Epo, unë mund të bëj edhe disa punë me kohë të pjesshme. Gruaja mund të bëjë edhe disa punë me kohë të pjesshme dhe fëmijët mund të ndihmojnë gjithashtu.” E shihni, ky është sistemi i vetëm i sigurimit që keni mësuar, sistemi i dhimbshëm i mundimit dhe djersës. Më lejoni t'ju jap një pamje tjetër

të këtij sistemi.

Le të supozojmë se po vrapoj në rrugën ku banon dhe gjej një qese letre bojë kafe në anën e kundërt të rrugës, me dhjetë milion dollarë në të. Ngazëllem aq shumë, por e di që duhet ta raportoj. Kështu, meqë të njoh, vrapoj për te shtëpia jote dhe të kërkoj të përdor telefonin tënd. Telefonoj departamentin e policisë ndërsa ti rri pranë dhe dëgjon. Unë u tregoj atyre se çfarë ka ndodhur dhe çfarë kam gjetur. Pas një heshtjeje të shkurtër, ndërsa kontrollojnë të dhënat e tyre, ata më thonë se nuk kishin asnjë raport për humbje parash dhe se unë mund t' i mbaj. (Nuk mendoj se kjo është ajo që do të thoshin ata, por funksionon për ilustrimin tim.) Kur ata të më thonin këtë, unë do të kërceja dhe bërtisja nga gëzimi. Atëherë do të të tregoja ty atë që ata kishin thënë dhe do të shpërtheja në gëzim.

Ti do të buzëqeshje me mirësjellje ndërsa unë gëzoja dhe i shpjegoja të gjitha këto.

Por çfarë mendon se do të bëje në tryezën e darkës atë natë ndërsa ia transmeton këtë histori bashkëshortes? Do të buzëqeshje? Unë nuk mendoj kështu. Do të thojë: «KJONUKËSHTE _____!» E plotësove vendin bosh, apo jo? Nga e di se fjala, «E DREJTË» është përgjigjja e saktë? Unë do të ta tregoj, sepse kështu je rritur. Ky ishte sistemi me të cilin u rrite. Mundim dhe djersë.

Në shembullin tim, unë gjeta para pa punuar dhe ky është sistem mashtrimi. Nuk është i drejtë. Nuk është i drejtë sepse nuk kisha punuar për ato para; thjesht i gjeta. Duke e ditur që ndoshta nuk do të kesh kurrë një fat të tillë, do të konsumoheshe nga xhelozia dhe hidhërimi, duke ditur që ditët e tua do të mbushen akoma me skllavëri të detyruar për të mbijetuar.

Nga ana tjetër, nëse do të vija një ditë në kishë me të gjitha rrobat të grisura dhe të pista dhe do të ngrihesha dhe do të thuja njerëzve: «Ia dolëm! Unë dhe Drenda kemi punuar 22 orë në ditë gjatë dhjetë viteve të fundit dhe më në fund kemi paguar shtëpinë tonë, »vendi do të shpërthente në brohoritje dhe duartrokitje. Pse? Sepse dikush

ia doli mbanë dhe kjo është inkurajuese. Dikush ia doli mbanë; ka një rrugëdalje! Ndoshta ne mund të shtrëngojmë dhëmbët, të gëlltisim gjithçka, të paguajmë çmimin dhe të jemi gjithashtu të lirë. Por pse nuk bërtitën dhe duartrokitën të gjithë kur gjeta paratë në rrugë? Dhe pse ishte kaq e lehtë për ju ta plotësonit vendin bosh? Sepse kështu mendoni; është ajo që ëndërroni gjithashtu. Të jesh i drejtë është sistemi i dhimbshëm i mundimit dhe djersës që të gjithëve na është mësuar. Paratë pa punë nuk janë të drejta.

Por arratisja nga mudi i dhimbshëm dhe sistemi i djersës është ëndrra e secilit. Të bëhesh i pasur, të jesh milioner janë mendime torturuese për shumicën e njerëzve. Një milion dollarë, nuk janë njësoj si dikur, por edhe thjesht si një numër, ai ende është tregues i pasurisë. Pasuria ofron mundësinë e lirisë që qëndron në kontrast me mundimin e përditshmëm që shumica e njerëzve jetojnë.

Të gjithë janë lodhur duke vrapuar dhe të kesh një million dollar do të thotë që më në fund po bën atë që dëshiron të bësh. Mendoni për këtë: Cila është thirrja e llotarisë LIRIA! Liri për të patur një zgjedhje, për të marrë vendime që nuk çenojnë pagesën e faturave apo jetesën.

Shfaqja “*Kush do të bëhet Milioner?*” është shumë e njohur. Të gjithë e ëndërrojnë atë lloj lirie. Ndërsa shohin shfaqjen, njerëzit përfshihen emocionalisht, brohorasin me konkurrentën, duke shpresuar se do ia dalin.

Ndryshojmë temën me shpejtësi, vjedhja në përkufizimin e saj më të thjeshtë është gjithashtu siguri pa punuar për të patur. Në një kuptim të korruptuar, ajo gjithashtu ofron liri nga sistemi i mallkimit të tokës. Le të biem dakord atëherë që të gjithë duan të ndalojnë së vrapuari! Por a ka ndonjë rrugëdalje? Skemat e parave janë pa vlerë. Unë marr të paktën dhjetë email-e në ditë nga njerëz jashtë shtetit që më tregojnë historinë e tyre të trishtë se si trashëguan 20 milion dollarë dhe kanë nevojë për dikë që t’i ndihmojë t’i sigurojnë në mënyrë të sigurt. Ata ofrojnë gjysmën e shumës nëse thjesht dal vullnetar që të marr paratë e tyre dhe t’i ruaj. Sigurisht, ata më pas kërkojnë adresën time të

postës elektronike dhe që unë të paguaj tarifën e vogël të përpunimit, tarifën e transportit, sigurimin, sido që e quajnë tarifën që kërkojnë për të dhënë trashëgiminë. Me të vërtetë? A dukem gjë i marrë?

Unë kam patur një klient që më telefononte dhe ai kërkonte këshilla për investime. Unë i bëja pyetjet e mia të zakonshme dhe zbulova se ai kishte rreth pesë milion dollarë për të investuar. Ai më tha se nuk kishte para në atë moment, por do të merrte një trashëgimi. E pyeta se sa kohë mendonte se nevojitej që pasuria të lirohej dhe ai më tha rreth dy javë. Kështu që e telefonova pas rreth dy javësh dhe ai tha se duhej pak më shumë kohë. Ai nuk po merrte dot trashëgiminë e lëshuar nga banka evropiane që e mbante. Epo, kjo më tërhoqi vëmendjen, kështu që fillova ta pyes. Historia ishte se atij i kishte vdekur xhaxhai i supozuar në Francë.

Ky xhaxha i kishte lënë pesë milionë dollarë. Sidoqoftë, kishte një detyrim tatimor prej 50 000 dollarësh që duhej paguar përpara se atij t'i kalonte trashëgimia. Ai më tha që ishte ende duke u përpjekur të merrte paratë dhe kishte aplikuar për një kredi hipotekore.

E pyeta atë nëse kishte avokat dhe ai tha, "Po, avokati që më telefonoi nga Franca po merret me këtë." "Pra ti nuk ke një avokat amerikan që po merret me çështjen?" Ai tha, "Jo, unë kam vetëm atë që më telefonoi nga Franca." Ai vazhdoi të më shpjegonte që për shkak se e kishte të vështirë të gjente 50 000 dollarët, avokati në Francë i kishte thënë se do të paguante gjysmat dhe ai mund ta paguante kur të lirohej shuma totale. "Jo," i thashë, "ky është mashtrim!" Edhe pse ai s'kishte dëgjuar kurrë më parë për këtë xhaxha të supozuar, ai besonte se ishte i vërtetë. Unë e telefonova dy javë më vonë dhe më tregoi që kishte pothuajse të gjithë shumën që duhej t'i jepte bankës. I thashë përsëri atij, "Ata i kanë tashmë pesë milionë dollarë. Nëse do të donin vërtetë taksën, ata thjesht mund të të shkruanin një email ose të të dërgonin një formular ku mund të firmosje duke i autorizuar për të mbajtur shumën 50 000 dollarë nga shuma totale që kanë." Por ai nuk më besonte dhe ishte i bindur që po i tregonin të vërtetën.

Të dielën, kur isha në kishë, pata një rast të njëjtë. Një djalosh po më kërkonte këshilla për investimin e disa parave që ai do të merrte nga një trashëgimi përtej oqeanit. Nuk e lash të përfundonte fjalinë. I thashë, “E di, e di, ata duam që ti të paguash një tarifë që të mund të lirojnë paratë e tua, apo jo?” “Epo, po, por ti nga e di?” I thash të njëjtën gjë, që e gjithë kjo ishte një mashtrim. Megjithëse i nuk e njihte njeriun që supozohej të kishte vdekur dhe nuk kishte asnjë avokat këtu në SH.B.A., përsëri përpiquej të më bindte që paratë ishin reale. Pse këta djem bien pre e këtyre gjërave?

Sepse duan të jenë të lirë! Ata nuk mund ta lënë rastin t’ju ikë, sepse, në mendjet e tyre, edhe nëse ka një të dhjetën e miliardit mundësi që të jetë e vërtetë, ata e dëshirojnë.

Më lejoni t’ju jap një shembull tjetër. Biznesi i shërbimeve financiare që zotëron Drenda dhe unë mbulon të gjithë Shtetet e Bashkuara. Është shumë mirë! Mundësia në kompaninë time është e vërtetë. Kam njerëz që fitojnë qindra mijëra dollarë në vit. Por ka edhe shumë për të mësuar në biznesin tim. Ju po menaxhoni paratë e njerëzve. Ka ligje që duhet t’i njihni dhe strategji për planifikimin e pasurisë që duhen mësuar.

Unë kisha vendosur reklama në radio në zonën e Kolumbus, Ohajo në një radio lokale të krishterë ku kërkoja rezyme, pasi më duheshin disa kandidatë të mirë të mundshëm. Morëm rreth 50. Në vend që të caktoja intervista menjëherë, vendosa të mbaj një seancë orientimi në një hotel aty pranë që do të më ndihmonte të shohisja kandidatët. Takimi do të mbulonte potencialin e madh që ka kompania jonë në treg, pasi jemi të gatshëm të ndajmë jo vetëm mënyrën e funksionimit të financave, por edhe se si të vendoset në praktikë kjo këshillë në një perspektivë të krishterë. Gjithashtu, mbulonim mënyrën e funksionimit të një kompanie në lidhje me procedurat, tarifat, kërkesat për trajnim dhe licencim. E dija nga përvoja se shumë nga kandidatët e mi do të tërhiqeshin kur të shihnin sa punë duhej të bëhej për të fituar 200 000 dollarë në vit.

Pas takimit, po ecja nëpër korridorin e hotelit dhe pashë se salla kryesore ishte e mbushur me mbi 1 000 njerëz. Të gjithë kishin ardhur për të njëjtën arsye. Një kompani e famshme, me shumë nivele po prezantonte se si mund t'i bashkoheshin kompanisë së tyre. Por pse kishte kaq shumë njerëz në krahasim me ata 50 që ishin në takimin tim? Përgjigja është e thjeshtë: paraja! Fatkeqësisht, dhe kjo nuk është saktësisht ajo që po thoshte kompania me shumë nivele, perceptimi ishte se “Nëse hyj brenda, unë mund të referoj tre persona dhe bam, unë jam një milioner”. Kisha punuar aq sa ta kuptoja se kushdo që bënte shumë para në bizneset me shumë nivele, kishte punuar fort.

Po, potenciali është aty, por përsëri, perceptimi është para e lehtë dhe “Nëse e lë këtë mundësi të shkojë, shikoni të gjithë këta njerëz këtu, unë do të humbas mundësinë e jetës!” Ju lutem mos më keqkuptoni. Kam shumë miq të mirë që kanë fituar miliona nga këto lloj kompanish dhe ka shumë kompani të shkëlqyera atje. Por unë thjesht po tregoj mendësinë e punës në to. Të bësh para lehtë do të thotë të pasurohesh shumë në sistemin e mbijetesës të mallkimit të tokës.

Nëse do të ndaloni për një moment dhe do të pyesni veten se sa mendoni për paratë, qoftë si të fitoni apo si ta mbronit paratë që keni, do të habiteni.

Unë do ta përsëris vetëm që ta kuptoni: të gjithë duan të ndalin vrapin dhe janë lodhur duke jetuar vetëm për të mbijetuar! Joshja e fundjavës është ndalimi. Joshja e pushimeve është se mund të ndalemi. Joshja e daljes në pension është se më në fund mund të ndalemi dhe të bëjmë atë që duam të bëjmë.

Mos më keqkuptoni. Pikëpamja e shumicës së njerëzve për jetën nuk është se duan thjesht të ulen dhe të mos bëjnë asgjë. Dhe unë nuk jam duke thënë se ky është vullneti i Zotit për ju. Jo, ne jemi krijuar që të jemi aktivë në detyrën tonë, në qëllimin tonë të krijuar në mënyrë unike. Fatkeqësisht, shumica e njerëzve janë shumë të zënë duke vrapuar vetëm për të mbijetuar, pasi kanë hequr dorë nga ëndrrat e tyre vite më parë.

Jam i sigurt që keni dëgjuar dikë të thotë këtë, ose ndoshta e keni thënë vetë: «Unë duhet të shkoj në punë sot». Epo, siç e keni kuptuar tashmë, njerëzit nuk janë aq mirë emocionalisht kur «duhet» të shkojnë në punë.

Sidoqoftë, ata lulëzojnë kur duan dhe shkojnë në punë me një pasion dhe zell për atë që po bëjnë. Zakonisht, nuk ndodh kështu me një shumicë të madhe të jetës së njerëzve. Në vend të kësaj, ata ende thonë: “Unë duhet të shkoj në punë sot.” Thjesht për të marrë pagën, thjesht edhe një ditë tjetër në zyrë, një ditë tjetër vetëm për të mbijetuar, duke kaluar me vështirësi. Shumica e fillojnë mirë jetën, plot emocione. Puna që bënë thjesht për të paguar faturat ishte një gjë e përkohshme, derisa të zgjidhnin disa gjëra. Por ajo që kuptuan ishte se jeta u bë një turbullirë dhe diku rreth të dyzetave, kuptuan se nuk kishte rrugëdalje. Quhet kriza e moshës së mesme dhe për herë të parë, kuptojnë se janë bllokuar.

PA RREGULLUAR ÇËSHTJEN E PARAVE, DO TË JENI TË DESTINUAR TË VRAPONI NË MENTALITETIN E MBIJETESËS TË SISTEMIT TË MALLKIMIT TË TOKËS PËR GJITHË JETËN TUAJ.

Miku im, kjo nuk është jeta që ka krijuar Zoti për t'u jetuar. Ju tashmë e dini këtë. Por, shpëtimi nga kjo e ardhme e vajtueshme është arsyeja pse unë dhe Drenda kemi thënë për vite me radhë që nëse nuk e rregulloni çështjen e parave, nuk do ta gjeni kurrë qëllimin tuaj,

qëllimin unik për jetën tuaj. Pa rregulluar çështjen e parave, do të jeni të destinuar të vraponi në mentalitetin e mbijetesës të sistemit të mallkimit të tokës gjithë jetën tuaj.

Nëse nuk rregulloni çështjet e parave tuaja, nuk do ta zbuloni kurrë qëllimin tuaj të krijuar!

Për të bërë një krahasim, le të flasim se si mund të duket jeta juaj. Le të shqyrtojmë hobit tuaj. Le të themi se është golfi. A keni dëgjuar

ndonjëherë dikë që thotë: “Sa inat, duhet të shkoj të luaj golf sot!”? Ose a keni dëgjuar dikë që thotë: “Djalosh, është e premte mbrëma; unë i urrej netët e së premtes. Do të doja të ishte mëngjesi i së hënës, që të mund të kthehesha në punë.” Ose le të themi që hobi juaj është peshkimi. A do të të dëgjoj ndonjëherë të thuash: «Sa inat, sot duhet të shkoj të peshkoj»? Jo, besoj se do të dëgjoj që e ke pasion. Çfarë do të ndodhte nëse do ta jetonit jetën tuaj me të njëjtin pasion dhe zell për atë që po bëni dhe të jeni në gjendje të përqendroheni në pasionin tuaj e të gjeni pikën tuaj të fortë, jo kulmin e mundimit? Po sikur t’i kishit paratë e nevojshme për t’u kujdesur për familjen tuaj dhe të bënit një jetë pa stres financiar? A ka ndonjë mënyrë për ta bërë këtë? Unë dhe Drenda mësuam se ka!

Bekimi i Zotit pasuron dhe ai nuk shton vuajtje.

– Fjalët e Urta 10:22

Hidhini një vështrim të gjatë dhe të ngadalhtë këtij vargu. Hebraisht, fjalë për fjalë, do të thotë pasuri pa shtuar punë të vështirë. E shikon Mbretëria e Perëndisë siguron një mënyrë shpëtimi nga munda i dhimbshëm dhe sistemi i djersitjes që na la Adami. A mundet që ky varg po thotë me të vërtetë atë që po thotë? Do të binit dakord që nëse është kështu, atëherë sapo keni lexuar lajmin më të mirë që keni dëgjuar prej një kohe shumë të gjatë. Pikërisht! Kjo është arsyeja përse Isaia 61, duke folur profetikisht për Jezusin dhe atë që Ai do të bënte në shërbesën e Tij, thotë:

Fryma e Zotit, Zoti, është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t’u dhënë një lajm të mirë të varfërve.

– Isaia 61:1

Cili është lajmi i mirë për një person të bllokuar në mënyrën e mbijetesës së sistemit të mallkimit të tokës? Liria financiare, natyrisht! Jezusi, fjalë për fjalë, po thotë se Mbretëria e Zotit siguron përtej kufijve të sistemit të mallkimit të tokës për të vrapuar me mund dhe dhimbje. Le ta pranojmë. Ju mund të vraponi vetëm me këtë shpejtësi dhe shumica e njerëzve po vrapojnë shumë fort dhe nuk çlirohen dot shpejt. Unë vrapova aq shpejt sa munda ato nëntë vjet që unë dhe Drenda ishim në borxhe të mëdha.

Qindra mijëra klientë të panumërt që firma jonë ka parë gjatë 27 viteve të fundit po ashtu vraponin me dhimbje sa më shpejt që të mundnin. Megjithatë, përkundër zellit të tyre, ata ishin ende të bllokuar në një jetë skllavërie financiare. Të gjithë ata na telefonuan sepse kishin kuptuar se ishin të pashpresë financiarisht, ëndrrat e tyre për pavarësi financiare dukeshin gjithnjë e më të vështira për t'u arritur dhe vizioni ishte zëvendësuar me mbijetesën. Kontrolloni fjalën provizion me mua për një moment.

Provizioni është pro-vizionit.

Pa provizion nuk mund të ketë vizion sepse pa provizion, ta marrësh provizionit, bëhet dhe është vizioni juaj. Gjithsesi, kështu jetojnë shumica e njerëzve - një jetë pa vizion. Kjo është skllavëria në formën e saj më mashtruese.

KAPITULLI 7

DERA

Le të rishikojmë për një moment se çfarë kemi mësuar deri tani për Mbretërinë e Perëndisë. Së pari, kemi mësuar se njeriu u vendos në tokë në një pozicion për të sunduar mbi të. Pamë te Hebrenjve 2:7-8 që nuk kishte asgjë në tokë që nuk ishte subjekt i njeriut. Për shkak të kësaj, zbuluam se njeriu ishte çelësi ose dera për në mbretërinë e tokës. Satani e dinte këtë, prandaj shënjestroi Adamin dhe Evën në planin e tij për të fituar autoritet mbi tokë. Kur Adami dhe Eva iu nënshtruan planit të tij të mashtrimit, mëkatuan dhe hoqën qeverisjen e autoritetit ligjor të Zotit mbi jetën e tyre. Fryma e Perëndisë, i cili i mbuloi ata në krijim, tashmë duhej të tërhiqej. Ata mbetën lakuriq, jo vetëm fizikisht, por edhe frymërisht. Unë mund ta imagjinoj tronditjen që ata hasën kur Fryma e Perëndisë u largua prej tyre. Bibla thotë se ata menjëherë filluan të endnin gjethe fiku për t'u mbuluar, pasi e kuptuan se ishin lakuriq.

Njeriu ende e kishte pozicionin për të sunduar tokën siç i ishte dhënë që në krijim, por humbi autoritetin dhe fuqinë për të sunduar tokën në sferën frymërore. Për shkak se njeriu zgjodhi të rebelohej kundër Perëndisë dhe të besonte e ta mbeshteste veten te autoriteti i Satanit, erdhi gjykim i që Satani (Luciferi) mori kur u dëbua nga qielli. Ai gjykim ishte një vend i quajtur ferr, një vend torture dhe dëbimi i përjetshëm nga prania e Perëndisë.

Duhet të theksohet se ferri nuk u krijua kurrë për njeriun ose duke pasur njeriun në mendje. Asnjëherë nuk ka qenë qëllimi i Zotit që njeriu të përfundojë aty.

*Atëherë do t'u thotë edhe atyre që do të jenë në të majtë:
“Largohuni nga unë, të mallkuar, në zjarr të përjetshëm, të
përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij.*

– Mateu 25:41

Për të shpëtuar njeriun nga fati i tij, Perëndisë iu desh të ristabilizonte qeverisjen e autoritetit të Tij në tokë. Ai iu desh të gjente një mënyrë për ta marrë mbrapsht autoritetin që Satani mbante. Kishte vetëm një mënyrë se si mund të ndodhte kjo. Dikush pa mëkat do të duhej të dilte vullnetarisht në vend të Adamit për të marrë dënimin me vdekje. Por kishte një pengesë të vogël, që ky plan të realizohej. Çdo njeri në tokë, duke qenë pasardhës i Adamit, ishte i njollosur nga mëkati, ndaj ishte i paafte të mbante Frymën dhe autoritetin e Perëndisë. Por Zoti pati një plan se si ta tejkaluar këtë problem. Plani kërkonte që kërkesat e Tij të drejta, ligji i Tij, të vendosej dhe të shkruhej në sferën tokësore, që me anë të tij, një njeri që jeton në sferën tokësore të shpallet i pafajshëm nga i njëjti ligj, nëse është e mundur. Atëherë dhe vetëm atëherë ai njeri mund të dilte legalisht vullnetar për të zënë vendin e Adamit, duke marrë mbi vete penalitetin dhe dënimin që meritonte Adami.

Por kishte një problem të vërtetë te ky koncept pasi njeriu që mund ta zbatonte këtë plan sakrifice nuk mund të ishte pasardhës i Adamit, pasi kjo linjë gjaku ishte njollosur dhe larguar nga prania e Zotit. Atëherë, si mund të realizohej plani i shpëtimit? Që ai të mundësohej, duhej që Zoti të vendoste më të vërtetë mbi tokë një njeri që nuk ishte nga linja e Adamit, i cili do të ishte i gatshëm të sakrifikonte veten për njerëzimin.

Por sfera tokësore i qe dhënë Adamit dhe pasardhësve të tij, kështu që nën atë status ligjor, kjo do të ishte gjithashtu e paligjshme. Kishte vetëm një mënyrë për ta realizuar këtë, vetëm një. Ai njeri do të duhej të lindte këtu, por të mos ishte pasardhës i Adamit.

Në pamje të parë, mund të bini dakord se kjo do të ishte përsëri e pamundur. Por teknikisht, ekzistonte një mënyrë. Zoti mund të vendoste ligjërisht një farë mashkulli te një grua në tokë nëse do të gjente

një burrë që do ta besonte Atë për ta bërë këtë, duke i dhënë kështu juridiksionin ligjor për ta kryer këtë. Mos harroni, njeriu e mbante çelësin për mbretërinë e tokës. Satani kishte përdorur të njëjtin çelës për të hyr në mbretërinë e tokës dhe për të vjedhur pozicionin frymëror të autoritetit të Adamit mbi të. Që plani i Zotit të funksiononte dhe t'i provonte Satanit ligjshmërinë e këtij plani në mbretërinë e tokës, i cili me siguri do të reagoonte keq, Zoti kishte nevojë të gjente një burrë dhe grua që do ta besonin Atë për një fëmijë kur ishte krejtësisht dhe përgjithmonë e pamundur që ata të kishin fëmijë. Ata do të duhej ta besonin Zotin për të pamundurën.

Lindja e atij fëmije duhej të kishte të bashkëngjitur premtimin e fatit të tij, që përmes asaj linje të gjitha kombet të bekoheshin, sepse përmes linjës së tij Perëndia do të kishte ligjshmërinë dhe juridiksionin të sjellte Jezusin në botë. Nëse do të kishte një çift që do të besonte se Perëndia mund të ngjizte një fëmije në një bark shterpë, do të besonte që përmes atij fëmije çdo komb do të bekohej dhe që lindja e tij do t'u jepte më shumë pasardhës sesa rëra në bregun e detit, atëherë Perëndia do të kishte ligjshmërinë që i duhej për të vendosur më vonë farën e Tij te Maria, nëna e Jezusit. Por a mund të gjente Perëndia një burrë të tillë? Emri i tij ishte Abraham, ati i besimit tonë.

Ai, duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: «Kështu do të jetë pasardhja jote». Dhe, duke mos qenë i dobët në besim, nuk e mori parasysh trupin e tij, i bërë tashmë i vdekur (ishte pothuaj njëqind vjeç) as barkun e vdekur të Sarës. Madje nuk dyshoi me mosbesim në premtimin e Perëndisë, por u forcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte.

– Romakëve 4:18-21

Abrahami dhe Sara i besuan Zotit dhe lindi Isaku kur ata ishin shumë të moshuar dhe të paaftë për të bërë fëmijë. Meqenëse Abrahami ishte ai që i besoi Zotit, premtimi mund të vinte vetëm përmes derës që Abrahami hapi. Jezusi do të duhej të vinte nëpërmjet pasardhjes së Abrahamit. Më lejoni ta bëj këtë shumë të qartë.

Që Perëndia ta sillte Jezusin në botë, duhej ta sillte përmes pasardhjes së Abrahamit. Kështu duhej! Ardhja përmes Abrahamit ishte e vetmja mënyrë e ligjshme. Kjo është arsyeja që kur shikoni kapitullin e parë të Mateut, gjeni një listë gjatë emrash.

Ky kapitull është kapitulli i parë për një arsye. Ai vërteton faktin se këtu në mbretërinë e tokës, Jezusi është një pasardhës i Abrahamit. Kjo duhej të regjistrohej në tokë, ku Satani pretendon sundimin dhe autoritetin e tij ligjor. Nëse kjo listë nuk do të ishte e saktë ose nëse Jezusi nuk do të kishte ardhur me të vërtet nga pasardhja e Abrahamit, atëherë Satani mund të pretendonte se lindja dhe jeta e Jezusit ishin

një mashtrim dhe Ai nuk ishte i kualifikuar të paguante çmimin për mëkatin tonë.

Nëse e mbani mend, Izraeli kishte shumë ligje që e ndalonin martesën jashtë kombit të tyre. Martesa jashtë racës së tyre

ATA ECËN MBI MALLKIMIN E MUNDIT DHE DJERSËS SË DHIMBSHME MBIJETESË.

dënohej me vdekje.

Tani e dini pse ajo prejardhje duhej të mbetej e pastër dhe pse ata e vëzhgonin nga afër. Po, do të gjeni përjashtime në lidhje me gra nga jashtë kombit të Izraelit që u martuan me izraelitë, si Rahabi, e cila jetonte në qytetin e Jerikos dhe fshehu spiunët që ishin dërguar për të vëzhguar vendin. Po, ajo është listuar në kapitullin e parë të Mateut sepse u martua me një Izraelit. Por ju duhet të kuptoni që në kulturën hebraike ishte burri ai që ruante linjën trashëguese të pasardhjes.

Më lejoni për një moment ta shpjegoj kështu. Ka pasur shumë diskutime për sa kohë ka qenë njeriu në tokë. A ka ndonjë mënyrë

për ta ditur vërtetet përgjigjen? Po! Unë mund t'ju siguroj për këtë fakt. Lista në kapitullin e parë të Mateut duhet të jetë e saktë. Askush nuk mungon aty, përndryshe, unë dhe ju nuk do të ishim duke shijuar shpëtimin që gëzojmë aktualisht. Satani do të pretendonte se është fallco. Kjo listë është perfekte! Kështu që, bazuar në të, ju mund të vlerësoni përafërisht kohën totale të njeriut në tokë.

“Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë; te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës»..”

– Zanafilla 12:2-3

Siç mund ta shihni te ky varg, kjo derë në mbretërinë e tokës që Abrahami vendosi është dera e ligjshme përmes së cilës Jezus Krishti eci më vonë dhe bekoj të gjithë njerëzit në tokë. Megjithëse Abrahami dhe pasardhësit e tij i dhanë Perëndisë ligjshmërinë dhe juridiksionin e nevojshëm për të sjellë fuqinë dhe ndikimin e qeverisë së Tij përsëri në tokë, njeriu ishte ende i bllokuar nën peshën e mëkatit dhe vdekjes frymërore derisa Perëndia të sillte Jezusin në botë. Ai do të paguante çmimin e mëkatit të Adamit. Por, në mënyrë rigoroze në lidhje me dispozitat, tani zbulojmë se Abrahami dhe trashëgimtarët e tij, ata që mbanin shenjë e rrethprerjes, lulëzuan. Ata ecën mbi mallkimin e mundit dhe djersës së dhimbshme për mbijetesë.

Abrami ishte shumë i pasur me bagëti, argjend dhe ar.

– Zanafilla 13:2

Ne shohim në këtë varg një ndryshim të madh që solli kjo

besëlidhje në lidhje me dispozitat. A shihni diçka ndryshe nga ato që Zoti i thotë Abrahamit krahasuar me ato që i tha Adamit te Zanafilla 3:17? Mos harroni, pasi Adami mëkatoi, Zoti i tha atij që do të mbijetonte përmes mundit të dhimbshëm dhe djersës së tij. Por, te Abrahami, shohim diçka ndryshe. Zoti thotë “Unë do të të bëj.” Nuk thotë që Abrahamit u la aftësia e tij për të vrapuar dhe djersitur me mundime të dhimbshme. Ai thotë se tani Zoti është përfshirë. Zoti tha: “Unë do të të bëj!” Pra, a e shohim Abrahamin që mezi ia dilte mbanë pas kësaj? Zor se e shohim kështu!

Abrahami ishte i pasur! Fëmijët e tij ishin të pasur. Abrahami jetoi një jetë jashtë sistemit të mallkimit të tokës. Ai kishte më se mjaftueshëm! Nuk u desh shumë që njerëzit ta vinin re ndryshimin.

Ky ndryshim vazhdoi gjatë gjithë pasardhjes së tij. Në fakt, pak breza pas Abrahamit, nipi i tij, Jakobi punoi për Labanon, vjehrrin e Jakobit. Labano pa bekimin e Jakobit dhe u përpoq ta mashtronte për shkak të begatisë së tij. Por Zoti bëri që t’i binin në kokën e vet planet e për të vjedhur bekimin e Jakobit dhe bekoi Jakobin me pasuri të madhe.

Ajo që po them është se edhe pse njerëzit u përpoqën ta ndalnin këtë bekim, nuk mundën. Për sa kohë që trashëgimtarët i qëndruan besnikë besëlidhjes së tyre dhe adhuruan Perëndinë, Perëndia i begatoi.

Mendoni për implikimet e kësaj që po them! Unë marr lloj lloj

**“DHE ZOTI DO TA
URDHËROJË BEKIMIN TË
JETË MBI TY NË HAMBARET
E TUA DHE MBI TË GJITHA
ATO GJËRA KU TI DO TË
VËSH DORË;”**

— LIGJI I PËRTËRIRË 28:12A

letrash dhe email-e nga njerëz që më thonë se flas shumë për paratë. Ata më thonë se begatia nuk është vullneti i Zotit. Ata theksojnë se të gjithë duhet të vuajmë shumë gjatë jetës për t’i shërbyer Zotit. Unë pajtohem me një pjesë të deklaratës së tyre. Jezusi me të vërtetë tha te Marku 10:30 se begatia jonë do të bëj që të përndiqemi. Fatkeqësisht, shumë të krishterë besojnë se Zoti është një shef i vështirë dhe ne

duhet të vuajmë duke mbijetuar, të betohemi se do të jetojmë në varfëri dhe do të vuajmë prej sëmundjeve dhe sprovave. Jo, ky është mallkimi dhe jo bekimi i tokës! Zoti dëshiron t'i stabilizojë financat tuaja.

Perëndia dëshiron t'ju stabilizojë ju!

Derisa financat tuaja të jenë të sigurta dhe të stabilizuara, ju jeni të detyruar të vraponi për të mbijetuar gjatë gjithë jetës tuaj, në pamundësi për të përmbushur detyrën tuaj frymërore, duke jetuar në thelb një jetë skllavërie. Shikoni se çfarë u tha Perëndia pasardhësve të Abrahamit te Ligji i Përtërirë 28:8-13.

“Dhe Zoti do ta urdhërojë bekimin të jetë mbi ty në hambaret e tua dhe mbi të gjitha ato gjëra ku ti do të vësh dorë; dhe do të të bekojë në vendin që Zoti, Perëndia yt, të jep. Zoti do të të vendosë që të jesh për të një popull i shenjtë, ashtu si të është betuar, në qoftë se do të respektosh urdhërimet e Zotit, Perëndisë tënd, dhe do të ecësh në rrugët e tij; kështu tërë popujt e dheut do të shohin që ti je i thirrur me emrin e Zotit dhe do të kenë frikë prej teje. Zoti, Perëndia yt, do të të mbushë me të mira, me frytin e barkut tënd, me frytin e bagëtisë sate dhe me frytin e tokës sate në vendin që Zoti u betua t'u japë etërve të tu.

Zoti do të hapë për ty qiellin, thesarin e tij të mirë, për t'i dhënë tokës sate shiun në kohën e duhur dhe për të bekuar veprën e duarve të tua; ti do t'u japësh hua shumë kombeve, por nuk do të marrësh asgjë hua. Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti dhe do të jesh gjithnjë lart dhe kurrë poshtë në rast se u bindesh urdhërimeve të Zotit, Perëndisë tënd, që sot të urdhëron t'i respektosh dhe t'i zbatosh.

Vini re se në këtë tokë të re ata nuk ishin stabilizuar akoma megjithëse e kishin premtimin. Por Moisiu u thotë atyre që Zoti do t'i vendosë! Për të kuptuar se si mund të duket kjo dhe çfarë Perëndia po përpiket t'u thotë atyre, mendoni për një lis. Kur është filiz, nuk ka lëshuar rrënjë mirë. Çdokush mund ta zhvendosë aty ku dëshiron. Por kur ai lis rritet dhe maturohet, askush nuk e lëviz dot. Është rrënjësor thellë.

Dhe Zoti do ta urdhërojë bekimin të jetë mbi ty në hambaret e tua dhe mbi të gjitha ato gjëra ku ti do të vësh dorë; dhe do të të bekojë në vendin që Zoti, Perëndia yt, të jep. Zoti do të të vendosë...

– Ligji i Përtërirë 28:8-9a

Atëherë, çfarë të jesh i themeluar financiarisht? Zoti na tregon pikërisht këtë në vargun 12b:

ti do t'u japësh hua shumë kombeve, por nuk do të marrësh asgjë hua. Zoti do të bëjë që të jesh koka dhe jo bishti.

Zoti po thoshte se Ai do t'i bekonte aq shumë saqë ata do të ishin huazues dhe kurrë më huamarrës. Ata do të ishin koka dhe jo bishti. Bishti nuk ka ku shkon; shkon vetëm atje ku e çon koka.

I pasuri sundon mbi të varfrit dhe huamarrësi është skllav i huadhënësit.

– Fjalët e Urta 22:7

Huamarrësi nuk është i stabilizuar. Ai është në mëshirën e huadhënësit, duke punuar si skllav pa liri. Por Zoti thotë: “JO! Unë do të të stabilizoj! Askush nuk mund t'ju thotë të largoheni nga shtëpia

juaj sepse do të jetë e paguar. Askush nuk mund të rimarrë makinën tuaj, sepse do të jetë e paguar. Kuzhina juaj do të jetë plot me ushqime dhe ju do të paguani vetë, duke përmbushur detyrën tuaj të dhënë nga Zoti me një paqe të përsosur financiare. Ju do të jeni të qëndrueshëm

Perëndia dëshiron të kesh begati!

KAPITULLI 8

FUQIA E BESNIKËRISË

Ai që do të lexoni është një parim i fuqishëm i Mbretërisë, aq sa ndjeva se meritonte të ishte nëntitulli i këtij libri. E gjejmë në historinë dhe jetën e Jozefit, nipit të madh të Abrahamit. Për t'jua treguar historinë, vëllezërit e tij e urrenin Jozefin dhe donin ta hiqnin qafe. Në të vërtetë, donin ta vrisnin, por një nga vëllezërit nuk donte të shkonte aq larg; kështu që, në vend të kësaj, e shitën atë te disa tregtarë që e çuan në Egjipt, ku ai u shit te Potifari, një kapiten i rojeve të Faraonit.

Ndërkaq Jozefi u çua në Egjipt; dhe Potifari, oficeri i Faraonit dhe kapiten i rojave, një egjiptas, e bleu nga ismaelitët që e kishin sjellë atje. Zoti që me Jozefin dhe ky kishte mbarësi dhe banonte në shtëpinë e zotërisë së tij, egjiptasit. Dhe zotëria i tij e pa që Zoti që me të dhe që Zoti e sillte mbarë në duart e tij gjithçka bënte. Kështu Jozefi fitoi hir në sytë e tij dhe hyri në shërbimin vetjak të Potifarit, që e emëroi kryeadministrator të shtëpisë së vet dhe i la në dorë gjithçka zotëronte.

Nga çasti që e bëri kryeadministrator të shtëpisë së vet dhe për gjithçka që zotëronte, Zoti e bekoi shtëpinë e egjiptasit për shkak të Jozefit; dhe bekimi i Zotit përfshiu gjithçka ai kishte në shtëpi dhe në fushë. Kështu Potifari la gjithçka kishte në dorë të Jozefit dhe nuk shqetësohej më për asgjë, përveç ushqimit të vet.

— Zanafilla 39:1-6a

Kushtojini vëmendje vargut 2a, “*Zoti që me Jozefin dhe ky kishte mbarësi*”. Çfarë do të thotë kjo? A nuk është Zoti me të gjithë? Në kontekstin e asaj që kemi diskutuar në kapitujt e mëparshëm në lidhje me prejardhjen, përgjigjja është jo. Mos harroni, besimi i Abrahamit dhe besëlidhja që pasoi i dhanë Zotit hyrje ligjore vetëm te Abrahami dhe trashëgimtarët e tij. Pra, kur flasim për Zotin që është me të gjithë, nuk duhet ngatërruar me Zotin që i do të gjithë. Ai i do të gjithë. Por për ata që nuk kanë qëndrim ligjor para Zotit, duart e Tij janë të lidhura.

ishit në atë kohë pa Krishtin, të përjashtuar nga qytetaria e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjet e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë. Por tani, në Krishtin Jezus, ju që dikur ishit larg, u afruat me anë të gjakut të Krishtit.

– Efesianëve 2:12-13

Vini re se ky varg flet për të qenit pa besëlidhje, që do të thotë se Zoti dhe fuqia e Tij janë ndarë ligjërisht nga një person. Pse? Për shkak se Zoti nuk ka ligjshmëri ose juridiksion në mbretërinë e tokës pa një marrëveshje ligjore, një besëlidhje të vendosur me një burrë apo grua në tokë. Ky varg e tregon qartë këtë kur thotë se pa një besëlidhje, njerëzit janë pa shpresë dhe pa Zot në botë. Mos harroni që kur Jezusi vendosi një besëlidhje të re për ne, ne u bëmë anëtarë të familjes së Perëndisë dhe qytetarë të Mbretërisë së Tij të madhe. (Efesianëve 2:19.) Kështu që tani, duke parë përsëri vargjet tona te Zanafilla 39, e kuptojmë se fraza “*Zoti që me Jozefin*” do të thotë që ligjërisht,

Zoti kishte ndikim ligjor në jetën e Jozefit përmes besëlidhjes që gjyshi i tij Abraham kishte vendosur. Kjo besëlidhje ligjore, që lejonte bekimin dhe ndikimin e Zotit, doli mbi sistemin e mundimit dhe dhimbjes së tokës. Ishte e ligjshme që Zoti ta bekonte Jozefin. Mos harroni atë që Zoti i tha Abrahamit më herët: «*Unë do të të bëj*». Për arsye se Zoti ishte me Jozefin, duke e ndihmuar në jetë, ai pati sukses

në gjithçka që bëri, aq sa mjeshtri i tij pagan, Potifari, pa një ndryshim të madh në aftësinë e Jozefit në krahasim me shumë burra të tjerë që kishte parë. Duhet të përmend këtu që kur përparojmë me ndihmën e Zotit, njerëzit që jetojnë nën sistemin e mallkimit të tokës për mbijetesë e venë re ndryshimin! Potifarit i bëri aq përshtypje sa e vuri Jozefin në krye të tërë pasurisë së tij.

Ka shumë parime të Mbretërisë të zbuluara në këtë pasazh, por çelësi i çelësave zbulohet këtu. Unë e quaj atë «Fuqia e Besnikërisë», ose ju mund ta quani «Parimi Potifar». Ai gjendet te Zanafilla 39:5:

**ZOTI NUK KA LIGJSHMËRI
OSE JURIDIKSION NË TOKË
PA NJË MARRËVESHJE
LIGJORE, NJË BESËLIDHJE
TË VENDOSUR ME NJË
BURRË APO GRUA NË TOKË.**

*Nga çasti që e bëri kryeadministrator të shtëpisë së vet dhe për gjithçka që zotëronte, Zoti e bekoi shtëpinë e egjiptasit për shkak të Jozefit; dhe **bekimi i Zotit përfshiu gjithçka ai kishte në shtëpi dhe në fushë.***

Unë dua që ju të keni një pamje të qartë të asaj që po ndodh këtu. Një ditë Jozefi nuk ishte në krye dhe ditën tjetër ishte. Bibla e shënon momentin kur ndodhi ai ndryshim. Bekimi i Zotit erdhi mbi të gjitha gjërat e Potifarit, tërë pasurinë e tij! Por ai nuk e njohte Perëndinë e Jozefit dhe nuk ishte pjesë e kombit të Izraelit. Atëherë, si mund të ndodhë kjo dhe çfarë do të thotë kjo? Ja përgjigja. Kur Potifari e vuri pasurinë e tij nën autoritetin e Jozefit, pa e ditur, pasuria e tij kaloi nën besëlidhjen që Jozefi kishte me Perëndinë.

Sendet e Potifarit, pasuria e tij dhe prona ndryshuan të gjitha mbretëritë!

E shihni, prona e Potifarit ishte ende e lidhur legalisht me sistemin e tokës së mallkuar derisa u vu nën kujdesin e Jozefit.

Kur Potifari vendosi pasurinë e tij nën juridiksionin e autoritetit të Jozefit, ai nuk e kuptoi se po e vendoste gjithashtu nën ndikimin e bekimit të Zotit. Bibla më tutje thotë se me Jozefin në krye, Potifari nuk duhej të shqetësohej për asgjë përveç ushqimit që hante.

Ai nuk kishte asnjë shqetësim! Pa pasur asnjë merak, Potifarit iu desh të përqendrohej vetëm te detyra dhe qëllimi i tij si kapiten i rojeve egjiptiane. Ka shumë për të parë këtu, por ajo që përjetoi Potifari, pa e ditur vet ai, ishte ajo që Hebrenjve 4 e quan pushimi i Shabatit dhe po, është në dispozicion për besimtarët e Dhjatës së Re.

Nëse studioni shabatin, do të zbuloni se Zoti nuk i lejoi izraelitët të bënin ndonjë punë atë ditë; nuk ka pasur djersitje ose mundim të dhimbshëm. E shtuna, natyrisht, ishte dita e shtatë e javës dhe

korrespondonte me ditën e shtatë të krijimit. Me siguri ju kujtohet se dita e shtatë e krijimit ishte dita që Zoti e shpalli si ditë pushimi. Kjo nuk ndodhi sepse Zoti ishte i lodhur, por përkundrazi, sepse Ai kishte përfunduar gjithçka. Gjithçka ishte e plotë. Dita e shtatë ishte dita në të cilën, në fillim, njeriu u krijua për të jetuar, një ditë pa shqetësime, me gjithçka që njeriu kishte nevojë para se t'i

AJO U QAJT DITA E SHABATIT, NJË PAMJE E DITËS KU NJERIU NUK DO T'I DUHEJ TË MUNDOHEJ ME DHIMBJE DHE DJERSË VETËM E VETËM PËR TË MBIJETUAR PAK MË GJATË.

munjonin. Por sigurisht, ne e dimë që Adami e humbi këtë prehje kur u rebelua kundër Zotit. Duke u rebeluar kundër Zotit, Adami ia hoqi mundësinë Zotit për të siguruar për të. Kështu, ai e humbi atë vend sigurimi që Zoti kishte siguruar më parë. Adami u detyrua të sigurojë vetë, duke e kaluar tërë kohën duke punuar me mund dhe djersë, vetëm për të mbijetuar.

Por Zoti nuk e la njeriun pa shpresë. Ai i tregoi njeriut një pamje të prehjes që Ai një ditë do të rivendoste. Ajo u quajt dita e Shabatit, një pamje e ditës ku njeriu nuk do t'i duhej të mendohej dhimbshëm dhe me djesë, vetëm për të mbijetuar pak më gjatë. Kur Potifari preku bekimin e Zotit që Jozefi e mori me anë të besëlidhjes, ai preku aftësinë e Zotit për të siguruar përmes Jozefit dhe gjeti prehje. Gjithçka ishte gati; ai nuk kishte shqetësime.

Kështu Potifari la gjithçka kishte në dorë të Jozefit dhe nuk shqetësohej më për asgjë, përveç ushqimit të vet.

– Zanafilla 39:6

Për të kuptuar domethënien e ditës së Shabatit dhe atë që Zoti po i tregonte njeriut, duhet të bëni një pyetje të thjeshtë. Si ishte e mundur dita e Shabatit?

Dua të them, në sistemin e mallkimit të tokës, njeriu vraponte çdo ditë vetëm për të mbijetuar. Nëse kjo ishte e vërtetë, atëherë si nuk iu desh njeriut të vraponte edhe ditën e shabatit? Si siguronte ai të shtunën nëse nuk punonte? Kjo është një pyetje e mirë e cila kërkon përgjigje, e te përgjigjja gjejmë të gjithë zbulesën e «bekimit të Zotit» në të cilin hyri Jozefi.

Unë mendoj se një ilustrim i shkëlqyer i këtij parimi gjendet te kapitulli 25 i Levitikut kur Zoti i shpjegon Vitin e Jubileut kombit të Izraelit. Për t'ju dhënë pak histori, Viti i Jubileut ndodhte çdo 50 vjet dhe kishte shumë rëndësi si vit, ndaj unë nuk do të hyj thellë këtu. Sidoqoftë, pjesa që dua të kuptoni është se ata nuk mund t'i mbillnit tokat e tyre atë vit. Në fakt, nuk mund të mbillnin tokat e tyre as në vitin e 49-të sepse ishte vit shabatit. Kështu, dua të keni një pasqyrë të qartë të asaj që po ndodh: Izraelit iu tha që nuk mund të mbillnin tokat e tyre në vitet e 49-të dhe 50-të. Atëherë do të duhej të prisnin deri në fund të vitit të 51, që pasi t'i kishin mbjellë tokat, të mbjellat

të bëheshin për t'u korrur. Pra, në thelb, Zoti po u thoshte se do të kalonin një periudhë tre-vjeçare pa të korra. Nëse do t'ju thosha që nuk do të keni mundësi të paguheni për tre vjet, ju do të shqetësoheni pak. Epo, edhe Izraeli ishte i shqetësuar. Në të natyrshmen, kjo nuk ishte e mundur. Por Zoti po u tregonte atyre diçka.

“Por në rast se thoni: ‘Çfarë do të hamë vitin e shtatë po nuk mbollëm dhe nuk korrëm prodhimet tona?’ Unë kam urdhëruar që bekimi im të vijë mbi ju vitin e gjashtë dhe ai do t’ju japë një korrje që do të mjaftojë për tre vjet. Kështu vitin e tetë do të mbillni dhe do të hani nga korrja e vjetër deri në vitin e nëntë; do të hani nga korrja e vjetër derisa të vijë e reja.”

– Levitiku 25:20-22

Shabati u bë i mundur vetëm sepse Zoti e bekoi ditën e gjashtë me një pjesë të dyfishtë, ose më shumë se sa duhet. Lejoni që kjo frazë të rrokulliset pak në mendjen tuaj. A nuk është kjo ajo që dëshiron çdo burrë dhe grua, më se mjaftueshëm? Kur Zoti i dha njeriut një pjesë të dyfishtë në ditën e gjashtë, Ai po i kujtonte njeriut se Ai ishte furnizuesi i tyre dhe Ai gjithmonë siguronte më shumë se sa duhej. Le te jemi te sinqertë; teprica siguron lirinë nga stërmundimi. Na çon nga skllavëria në mundësi zgjedhjesh. Më e rëndësishmja, ajo na çliron që të gjejmë dhe të përparojmë në qëllimin dhe pasionin tonë. Kjo është ajo që gëzonte Potifari. Asnjë shqetësim. Çdo nevojë që kishte ishte plotësuar. E vetmja gjë në të cilën duhej të përqendrohej ishte qëllimi i tij. Përsëri, siç kemi thënë Drenda dhe unë, “Derisa të rregulloni çështjen e parave, kurrë nuk do të jeni në gjendje të gjeni qëllimin tuaj.” Por, ka një lajm të mrekullueshëm! Pushimi Shabatit është akoma në dispozicion sot dhe ofron një vend ku nevojat tona plotësohen dhe ku mund të begatohemi.

*Mbetet, pra, një prehje shabati për popullin e Perëndisë.
Sepse kush ka hyrë në prehjen e tij, ka pushuar edhe ai vetë
nga veprat e tij, ashtu si Perëndia nga të tijat.*

– Hebrenjve 4:9-10

Mbretëria e Perëndisë zëvendësoi për Potifarin ligjin e mundit të dhimbshëm dhe djersës të mbretërisë së tokës dhe do të bëjë të njëjtën gjë për ju. Kur të mësojmë se si të përdorim Mbretërinë e Perëndisë, mund të përparojmë dhe të gjejmë qëllimin tonë. Jeta mund të jetë argëtuese, plot pasion dhe gëzim, vërtetë!

Bekimi i Zotit pasuron dhe ai nuk shton vuajtje.

– Fjalët e Urta 10:22

Bekimi i Zotit sjell pasuri dhe Zoti nuk shton asnjë punë të vështirë me të !!! Ne mund të jetojmë përmbi sistemin e djersës dhe mundit të dhimbshëm të Zanafillës 3:17. Kam jetuar nën atë sistem të vjetër të mbijetesës për shumë vite derisa mësova se si funksiononte Mbretëria e Zotit. Edhe ju mund ta mësoni. Zoti është me ju!

Ai mund t'ju ndihmojë! Ju mund të përparoni. Jo, më lejoni ta riformuloj: Ju duhet të përparoni. Potifarët e botës, ata që nuk e njohin Zotin dhe janë përkulur nën mallkimin e një pune të pashpresë, të vështirë, duke u përpjekur të mbijetojnë, po ju shikojnë.

Atyre nuk iu bën përshtypje feja jote, ndërtesa e kishës, apo vargjet biblike sepse nuk mund të shohin përtej mungesës të përgjigjeve. Ju nuk mund të prisni që njerëzit t'ju dëgjojnë kur u tregoni se sa i madh është Zoti, kur jetoni në të njëjtën mungesë, mbijetesë dhe stres të tmerrshëm financiar si ata. Jo, ju duhet të demonstroni se si duket Mbretëria, ashtu si Jozefi. Nuk dua të jem i vështirë, por njerëzit nuk janë budallenj. Ata po kërkojnë përgjigje.

Unë nuk isha zë ndikimi për shumë vite. Askush nuk më kishte

kërkuar të isha në TV; nuk po drejtoja ndonjë kishë me mijëra. Pse? Sepse nuk kisha asgjë për të thënë, asnjë zgjidhje, asnjë përgjigje, asnjë provë që Zoti ishte i gjallë dhe me mua. Po huazoja para nga familja ime vetëm për të mbijetuar. Makina ime po copëtohej, shtëpia ime po copëtohej dhe jeta ime po shkatërrohej. Pse dikush do dëshironte të dëgjonte se sa i madh ishte Zoti im? Po, isha rrugës për në qiell dhe

NDALONI SË QËNDRUARI MIDIS DYSHIMIT DHE MOSBESIMIT QË JU RRETHON. NDRYSHONI BESNIKËRINË TUAJ DHE SHIJONI MBRETËRINË E PERËNDISË!

qielli është gjëja më e madhe, por njerëzit nuk kanë për të të dëgjuar se sa i madh është qielli nëse nuk e demonstroi qiellin këtu në sferën tokësore. *Fuqia e Besnikërisë*

Dëgjoni, gjithçka që po them është se, nëse Zoti është Zot dhe Fjala e Tij është e vërtetë, atëherë ajo duhet të funksionojë. Jeta jonë duhet të duket dhe të jetë ndryshe! Ne duhet ta arrijmë këtë brez me të vërtetën e Mbretërisë. Potifarët po

shikojnë.

Pse e titullova këtë libër *Fuqia e Besnikërisë*? Sepse Potifari u fut në Mbretërinë e Zotit dhe shijoi pushimin e shabatit, ku djersitja dhe munda i dhimbshëm nuk janë mënyrë jetese, ku nuk ka frikë dhe mbretëron paqja. Mbretëria është vendi ku mbijetesa zëvendësohet me qëllimin dhe pasionin, ndërsa varfëria me sigurimin. Si u fut Potifari në Mbretëri? Ai i vendosi problemet dhe shqetësimet e tij nën juridiksionin e Mbretërisë së Zotit. Në parim, megjithëse nuk e kuptoi se çfarë bëri, ai u rreshtua me Zotin. Ai ra dakord dhe hyri nën juridiksionin e Mbretërisë së Zotit. Potifari u tregua aq i zgjuar sa i vendosi punët e tij nën kujdesin e Jozefit sepse pa përgjigje. Edhe ju mund ta bëni këtë; kjo është ajo që kemi bërë unë dhe Drenda. Kështu u shfaqën dreri, paratë, makinat dhe shtëpia që na duhej. Prandaj më lejoni t'ju jap një sugjerim. Nëse doni të shijoni gjithçka që Zoti ka për ju, ndryshoni

besnikërinë tuaj. Ndaloni rreshtimin e vetes përkrah dyshimit dhe mosbesimit që gjendet përreth jush. Ndryshoni besnikërinë tuaj dhe shijoni Mbretërinë e Zotit!

KAPITULLI 9

USHQEJINI JU!

Kur u takova për herë të parë me Donin, ai kishte ardhur në zyrën time shumë i shkurajuar dhe me borxhe. Asgjë nuk dukej se po shkonte siç duhej në jetën e tij në atë kohë. Kur u ula dhe bisedova me të, zbulova se ai ishte tre deri në katër muaj mbrapa me qiranë dhe me pothuajse çdo faturë tjetër që kishte. Kishte probleme martesore, gruaja ishte e lodhur nga gjendja e tyre financiare dhe kishte filluar të humbte respektin për Donin, pasi ai nuk ishte në gjendje të siguronte për të dhe pesë fëmijët e tyre. Fakti ishte se, Doni kishte humbur respektin për veten e tij. Dhe kishte plot pyetje.

Puna e tij përfshinte shitjen e sigurimeve shëndetësore në të gjithë shtetin e Ohajos, por mungesa e suksesit po e çonte me shpejtësi në një rrugë katastrofike financiare.

Pavarësisht nga të gjitha gjërat që shkonin kundër Donit, unë pashë potencial tek ai. Ai ishte i gatshëm të mësonte dhe i gatshëm të punonte. Ky kombinim i fuqishëm më intrigoi aq sa e punësova dhe investova në mirëqenien e së ardhmes së tij. Në fund të fundit, ishte një investim që solli fitime të mëdha për të dy ne.

Kompania ime e re sapo kishte fituar një udhëtim në Hawai prej një nga shitësve tanë dhe unë ndjeva se do të ishte një shans i madh për të ndarë me Donin për Mbretërinë e Perëndisë. Megjithëse Doni ishte i krishterë, ai nuk kishte të njëjtin botëkuptim si unë. Dhe megjithëse

kisha provuar disa herë të ndaja parimet e Zotit me të në këtë fushë, por ai thjesht nuk dukej se e besonte atë që i thosha.

Vazhdoja të kërkoja një mënyrë për të tërhequr vëmendjen e Donit, që do ta ndihmonte të kuptonte se edhe ai mund të kishte sukses nëse mësonte se si funksiononte Mbretëria e Zotit. Sidoqoftë, Doni ishte dekurajuar aq shumë sa e kishte të vështirë të besonte në vetvete dhe të besonte se ndryshimi mund të ndodhte vërtet. E dija që ky udhëtim në Hawai ishte shansi im.

Në javët para se unë dhe Doni të largoheshim, folëm për atë që do të shihnim dhe bënim atje. Një interes i veçantë tërhoqi vëmendjen e Donit si asgjë tjetër. Ai donte të kapte një peshk shpatë në ujërat e bukur të Oqeanit Paqësor. “Hawaii është kryeqyteti i botës i peshkut shpatë”, më tha Doni i ngazëllyer. “Unë gjithmonë kam dashur të kap një peshk shpatë; ka qenë një ëndërr e imja.” Për herë të parë pas disa javësh, pashë një shkëlqim në sytë e Donit. Diçka në të vërtetë e entuziazmoi dhe unë e dija se emocionimi i tij do të hapte derën e një mësimi të fuqishëm.

“Don,” i thashë, “a e di se është e mundur të dish, jo të shpresosh, por të dish se do të kapësh një peshk shpatë në Hawaii nëse troket në Mbretërinë e Zotit?” I hutuar, por i intriguar, Doni donte të dinte më shumë dhe unë vazhdoja me shpjegimin tim për Mbretërinë. Unë citova Markun 11:24, i cili thotë: *“Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkon duke u lutur, besoni se do t’i merrni dhe ju do t’i merrni.* Për Donin, kjo ishte pothuajse shumë e mirë për ta besuar. Mora kohë për ta ndihmuar atë të kuptojë Mbretërinë dhe si ta çlirojë besimin e tij. Dhe kështu, para se të niseshim në udhëtimin tonë, ai dhe gruaja e tij mbollën ashtu si unë për drerin tim, u lutën në marrëveshje dhe besuan se kishin marrë një peshk shpatë.

Ndërkohë, Doni bëri gjithçka që dinte të bënte për të mbajtur pjesën e tij të korrjes. Ai bëri disa hulumtime mbi varkat dhe çmimet në dispozicion dhe më në fund rezervoi me një kapiten për të cilin ndihej mirë. Gjithçka ishte vendosur, dhe ne të gjithë ishim aq të ngazëllyer kur shkonim në ujërat blu të Hawait.

Dita e lundrimit mbërriti dhe ndërsa hipëm në anije, me gëzim i thamë kapitenit se sot ishte dita që do të kapnim një peshk shpatë. Ndërsa ai priste që ne të kishim një ditë të suksesshme të peshkimit për peshq të tjerë të këtij lloji ai na siguroi që shanset nuk ishin në favorin tonë për të kapur një peshk shpatë atë ditë. Me dy anije turistike charter çdo ditë për katër muajt e fundit, ekuipazhet e tij kishin sjellë vetëm një peshk shpatë. Kjo ishte kryesisht për shkak të faktit se nuk ishte ende sezoni i i këtij peshku, pasi ata janë peshq migrues.

**“PRANDAJ PO JU THEM:
TË GJITHA ATO QË JU
KËRKONI DUKE U LUTUR,
BESONI SE DO T’I MERRNI
DHE JU DO T’I MERRNI.”.**

— MARKU 11:24

Duke refuzuar të dekurajoheshim, me respekt i thamë atij se do të merrnim një të tillë dhe vazhduam të bënim gati pajisjet tona.

Pas gjashtë orësh, nuk patëm asnjë ngacmim të vetëm të kallameve tanë dhe unë po shqetësohesha pak, se mosveprimi mund të dobësonte besimin e Donit. Në shqetësimin tim, unë i bëra një pyetje me zë të lartë. “Don”, bërtita nga ndenjësja te ura mbi Donin, “më lejo të të bëj një pyetje. Kur e more atë peshkë shpatë, kur të shfaqet apo kur u lute?” Me kofidencë, Doni u përgjigj i bindur, «Geri, kjo është e thjeshtë. E mora kur u luta ». U ngazëlleva dhe fitova kofidencë kur dëgjova përgjigjen e tij. Atëherë e kuptova që Doni e kishte marrë seriozisht udhëzimin tim dhe ishte i vendosur ta kishte atë peshk.

Minuta më vonë, kallami i Donit filloi të lëvizte dhe u përkul në det ndërsa shokët bërtisnin, «Peshku!»

“Mos u entuziazmo shumë”, paralajmëroi kapiteni. “Është një peshk i madh, në rregull, por nuk është peshk shpatë. Ata dalin menjëherë në sipërfaqe dhe bëjnë kërcime të jashtëzakonshme në ajër, ndërsa ky peshk po qëndron thellë.” Minutat po kalonin ndërsa Doni vazhdonte të luftonte me peshkun që ende nuk kishte ardhur aq afër sipërfaqes sa për t’u parë.

Aq i lodhur sa ishte Doni, po aq ishte edhe peshku dhe shpejt u dorëzua. Doni dhe unë nuk u befasuam kur ai nxorri në sipërfaqe një peshk shpatë të bukur blu ndërsa gjithë të tjerët në anije shtangën.

Fotoja e Donit dhe peshqve të tij është në zyrën time edhe sot e kësaj dite si një dëshmi për të tjerët dhe një kujtesë e vazhdueshme për mua për realitetin e Mbretërisë. Nga jashtë, ishte thjesht një peshk. Por për Donin, ai peshk do të thoshte shumë më tepër. Nëse Mbretëria funksiononte për peshkun, sigurisht që do të funksiononte për gjithçka tjetër që i duhej në jetë.

Për Donin, ishte vetëm fillimi i kuptimit të ndikimit që Mbretëria e Perëndisë mund të kishte në jetën e tij. Kthehuni disa mijëra vjet

**ASHTU SI ERA NUK MUND
TË SHIHET, POR KA NJË
EFEKT TË DUKSHËM
NË SFERËN NATYRORE,
KËSHU MBRETËRIA E
PERËNDISË ËSHTË REALE
DHE KA EFEKT NË SFERËN
NATYRORE.**

prapa dhe do të mësoni për një burrë të quajtur Nikodem, i cili e pyeti Jezusin posaçërisht për Mbretërinë e Zotit. Kapitulli 3 i librit të Gjonit regjistron përgjigjen e Zotit, «Era fryn ku të dojë dhe ti ia dëgjon zërin, por nuk e di nga vjen dhe ku po shkon; kështu është edhe çdo njeri që është lindur nga Fryma» (v.8). Ajo ditë e bukur në bordin e varkës me Donin është një shembull shumë i mirë për këtë.

As Doni dhe as unë në të vërtetë nuk mund ta shihnim Mbretërinë e Zotit, por ne me siguri e pamë dhe e ndjemë efektin e saj kur ai peshk i madh erdhi atë ditë. Ashtu si era nuk mund të shihet, por ka një efekt të dukshëm në sferën natyrore, ashtu edhe Mbretëria e Zotit është reale dhe ka efekt në fushën natyrore. Duke mësuar ligjet që qeverisin Mbretërinë e Perëndisë, ne bëjmë ndryshime në jetën tonë ashtu si Doni atë ditë.

Mirë, pyetja është: Si u shfaq ai peshk? Ka një përgjigje për këtë pyetje. Ju nuk mund të thoni thjesht se Zoti e solli. Jo, ne duhet të kuptojmë se si e dinim se do të shfaqej. Ju me të vërtetë duhet ta dini

këtë sepse mund të ketë një ditë kur të keni nevojë për një peshk shpatë, një makinë ose thjesht ushqime. Fakti është se kjo histori nuk ka të bëjë me peshkimin dhe as historitë e mia të gjuetisë nuk janë për drerat. Historia na jep të dhëna në lidhje me Mbretërinë dhe si funksionon ajo. Pati një arsye që peshku u shfaq! Jezusi kaloi shumë kohë duke u mësuar dishepujve të tij se si funksiononte Mbretëria, por përveç se fliste për të, Ai edhe e demonstronte.

Ju lutem lexoni me vëmendje. Mbretëria nuk funksionon si sfera tokësore në të cilën jeni rritur. Ju vërtet nuk do të jeni në gjendje ta rrokni këtë plotësisht në mendjen tuaj. Ajo funksionon në bazë të ligjeve, ligje të ndryshme nga ato me të cilat jemi mësuar këtu në tokë. Por ne mund t'i mësojmë këto ligje. Jezusi kaloi shumë kohë duke demonstruar dhe mësuar këto ligje të Mbretërisë kudo që shkoi. Një nga historitë e mia të preferuara ku Jezusi demonstroi Mbretërinë ndodh te Marku 6. Është historia e njohur e Jezusit që ushqen 5 000 burra me pesë bukë dhe dy peshq. Megjithëse e kisha dëgjuar me milona herë këtë histori në kishë, askush nuk më kishte treguar ndonjëherë se si e bëri Jezusi këtë.

Duke qenë se u bë vonë, dishepujt e tij iu afruan dhe i thanë: «Ky vend është i shkretë dhe tashmë është vonë. Lejoji këta njerëz që të shkojnë në fushat dhe në fshatrat rreth e qark që të blejnë bukë, se s'kanë gjë për të ngrënë». Por ai, duke iu përgjigjur, u tha atyre: «U jepni ju të hanë!». Dhe i thanë: «A të shkojmë ne të blejmë për dyqind denarë bukë dhe t'u japim të hanë?». Por ai u tha atyre: «Sa bukë keni? Shkoni e shikoni». Ata, mbasi e mësuan, thanë: «Pesë bukë e dy peshq»..

Atëherë ai i urdhëroi ata që t'i ulin të gjithë, grupe-grupe, mbi barin e njomë. Kështu ata u ulën grupe-grupe nga njëqind e nga pesëdhjetë. Dhe ai si mori të pesë bukët dhe të dy peshqit, ngriti sytë nga qielli, i bekoi dhe i theu

bukët dhe ua dha dishepujve të vet, që t'ua vinin përpara atyre; dhe të dy peshqit ua ndau të gjithëve. Dhe të gjithë hëngrën dhe u ngopën. Dhe mbloodhën dymbëdhjetë shporta plot me copa buke dhe me mbetje peshku. Dhe ata që hëngrën bukët ishin rreth pesë mijë burra.

– Maru 6:35-44

“Jezus, ne kemi një problem. Njerëzit janë të uritur dhe nëse nuk largohen tani, ata do të shkojnë në shtëpi shumë vonë; dhe ne jemi të shqetësuar.” Atëherë, çfarë u thotë Jezusi atyre? «Oh, Zoti im, keni të drejtë. E kam humbur totalisht sensin e kohës; le ta mbyllim takimin menjëherë.» Jo, Ai thjesht tha: «Ushqejini ju». Çfarë? Bibla regjistron se atje ishin 5 000 burra, por duke llogaritur gratë dhe fëmijët, mund të kishin qenë 20 000 njerëz. Të ushqyerit e këtij grupi njerëzish, edhe nëse do të kishit burime, do të kishte qenë një detyrë e madhe, një detyrë e pamundur. Jam i sigurt që dishepujt nuk mund ta besonin atë që po thoshte Jezusi. Reagimi i tyre ndaj zgjidhjes së Tij jep një pasqyrë të qartë të mendjes tipike në sferën tokësore. “Por, Jezus, për këtë do të duheshin pagat e tetë muajve! A duhet të shpenzojmë kaq shumë për bukë?” Para së gjithash, vini re se si ata menjëherë e konvertuan problemin e tyre në mungesën e sigurimit në sistemin ekonomik të mallkimit të tokës, mundit të dhimbshëm dhe djersës, tetë muaj për të qenë të saktë.

Një ditë po lutesha dhe Zoti më tha se kisha një mendje sipas mishit. U hutova; çfarë do të thoshte kjo? A kisha probleme me epshin? Jo, Ai po i referohej të menduarit tim dhe se si po kufizohesha sepse sistemi i të menduarit të mallkimit të tokës po filtronte të ardhmen time dhe se sa shpejt mund ta menaxhoja mendjen time.

Të gjithë e bëjmë këtë. Nëse na duhet një shtëpi e re, shohim koston e saj dhe menjëherë llogarisim nëse mund ta përballojmë apo jo. Si e llogarisim? Përmes mallkimit të tokës kuptojmë se sa shpejt mund të vrapojmë. Le ta shohim, unë marr 15 dollarë në orë shumëzim me

40 orë në javë barabartë ... “Uau, nuk mund ta përballoj atë shtëpi”. Kështu që e lini mënjatë si diçka të pamundur. Nëse filtrojmë secilën ide përmes filtrit se sa shpejt mund të vrapojmë, ASNJEHERË nuk do ta prekim mënyrën e jetës së Mbretërisë sepse Zoti nuk është i lidhur me sistemin e vrapimit. Zoti po më thoshte që nëse doja të angazhohesha për Mbretërinë, do të më duhej të filloja të mendoja sipas Mbretërisë - gjithçka është e mundur!

Në këtë gjendje ishin dishepujt kur thanë, “Për këtë duhen tetë muaj rrogë.” Në thelb, ata po thonin që ishte e pamundur të ushqejë aq shumë njerëz.

Më lejoni të ilustroj se si tingëlloi për ta Jezusi kur tha, “Ushqejini ju”. Imagjinoni sikur të isha pastori juaj dhe ju të ishit duke kaluar kohë të vështira dhe të kishit mbetur prapa në pagesën e hipotekës. Të ishit tre muaj mbrapa dhe gati të humbisnit shtëpinë tuaj. Ndaj vini tek unë dhe më pyesni nëse kisha mund t’ju ndihmojë me pagesat. Unë pastaj me shumë qetësi ju them: “Kam një ide më të mirë. Pse thjesht nuk e shlyen dhe nuk do të kesh fare pagesa të prapambetura?” Më pas do të më shikonit me një vështrim që thotë, “Ti nuk po e kupton se çfarë po të them”. “Jo, pastor, mendoj se e ke plotësisht gabim. Ne nuk kemi para; kjo është arsyeja pse kemi ardhur te ju. Thjesht kemi nevojë që kisha të na ndihmojë, në mënyrë që të kryejmë pagesat.” Përsëri, unë ju shikoj me shumë qetësi dhe ju them: “Jo, unë e kuptoj atë që po thua dhe të dhashë një zgjidhje të shkëlqyer. Thjesht duhet të paguani shtëpinë dhe nuk do të keni asnjë pagesë të prapambetur”. Ju do të mendonit se jam i çmendur.

Epo, kështu duhet të jenë ndjerë dishepujt. “Jezus, ti nuk e ke seriozisht që duhet të ushqejmë të gjithë këta 20 000 njerëz, apo jo? Kjo thjesht nuk është e mundur. Thjesht nuk kemi burime për ta bërë këtë. Dhe nëse do të kishim një plan për të shkuar dhe punuar mjaftueshëm sa për të fituar ato para dhe të organizonim transportin për të marrë bukën, derisa të ktheheshim, të gjithë do të kishin vdekur. Edhe sikur të kishim para, nuk kemi kohën e nevojshme për t’ia dalë.” Kjo është

mënyra se si u përgjigjemi gjërave të pamundura në natyroren, kur nuk shohim asnjë mënyrë që gjërat të ndodhin. Kur nuk sigurohen para, vizioni ynë vdes.

Jezusi nuk i la dishepujt atje në atë situatë pa përgjigje dhe Ai nuk do t'u kishte thënë t'i ushqejnë njerëzit nëse nuk do të kishte një mënyrë për ta bërë. Ai ishte gati t'i tregonte sistemin tjetër - Mbretërinë në veprim. Me dishepujt të hutuar, Jezusi merr përgjegjësinë.

“Çfarë keni? Shkoni dhe shikoni,” tha Jezusi. Dishepujt u kthyen dhe thanë: “Kemi gjetur pesë bukë dhe dy peshq”. Sapo u gjetën pesë peshqit dhe dy bukët, Jezusi u kërkoi dishepujve që t'i sillnin tek Ai. Ai merr bukën dhe peshkun dhe i bekon dhe pastaj ua kthen menjëherë. Për syrin natyror, asgjë nuk kishte ndryshuar, por në fushën frymërore, kishte ndodhur diçka shumë e rëndësishme, diçka që është një çelës për të kuptuarin tonë të Mbretërisë. Jezusi i udhëzon dishepujt të shpërndajnë bukën e peshqit dhe ata shikojnë të mrekulluar ushqimin që shumëzohet para syve të tyre dhe ushqehen të gjithë 20 000 njerëzit. Çfarë ndodhi? Si ndodhi?

Për ta zbuluar, duhet të ndalemi pak dhe të vëzhgojmë nga afër detajet e kësaj ngjarje. Fjala «bekoj» fjalë për fjalë do të thotë të veçosh ose të shenjtërosh. Kështu që mund të themi se kur Jezusi foli për ushqimin dhe e bekoj atë, buka dhe peshku kaluan nga një mbretëri në tjetrën.

Në mbretërinë e tokës, të ushqesh 20 000 njerëz me pesë bukë dhe dy peshq nuk është e mundur. Por në Mbretërinë e Zotit, të gjitha gjërat janë të mundshme. Në fakt, historia nuk mbaron këtu. Para se të mbaronte, dishepujt mbledhën 12 shporta me copat që kishin mbetur. Pesë bukë dhe dy peshq kaluan nga pamjaftueshmëria te përmbushja e nevojës për 20 000 njerëz dhe në fund patën më shumë nga sa kishin në fillim? Kështu funksionon Mbretëria, më shumë se mjaftueshëm!

Si një shkencëtar frymëror, kur vështrova më nga afër historinë, pashë të njëjtën formulë që Perëndia më dha për drerin. Përmes gjuetisë së drerit, Perëndia më mësoi së pari të mbjell në Mbretërinë e

Tij një porcion të çfarëdo gjëje që më duhej. Kjo është ajo që ai djalë bëri me bukët dhe peshqit që kishte. Ai i vendosi ato nën autoritetin e Mbretërisë së Zotit dhe ato u shumëfishuan, duke ushqyer rreth 20 000 njerëz dhe tepruan 12 kosha. Vini re që buka u shumëfishua në bukë dhe peshqit u shumëfishuan në peshq.

Kështu funksionon. Unë mund të mbjell peshk në Mbretëri dhe ai mund të shumëhohet si peshk. Por, po nëse kam nevojë për peshk dhe nuk kam peshk për të mbjellë? Përgjigja - para! Mos harroni, paratë janë një sistem shkëmbimi. Unë dhe ju «emërtojmë» para çdo ditë. Ne i quajmë ato qumësht, shtëpi, rroba, bukë dhe gjithçka tjetër që na nevojitet çdo ditë. Paraja mund të kthehet në gjithçka që na nevojitet. Kështu është kur mbjellim; ne mund t'i emërtojmë paratë. Në vend që të zbresim në dyqan dhe të blejmë peshk që të mund të mbjellim peshk, ne thjesht mund të përmendim vetëm paratë. Kjo mund të ndodhë me dhënien tuaj, por jo me të dhjetën tuaj, pasi Zoti tashmë i ka dhënë një emër. Ne mund të shohim të njëjtin ligj shumëfishimi te Luka 5.

**ZOTI MË MËSOI QË SË
PARI TË MBILLJA NË
MBRETËRINË E TIJ NJË
PJESË TË ÇFARËDO
GJËJE QË MË DUHEJ.**

Dhe ndodhi që Jezusi, kur qëndroi në bregun e Ligenit të Gjenësaretit e ndërsa turma po shtyhej rreth tij për të dëgjuar fjalën e Perëndisë, pa dy barka duke qëndruar në breg të ligenit, nga të cilat kishin dalë peshkatarët dhe po lanin rrjetat. Atëherë hyri në një nga ato barka, në atë që ishte e Simonit, dhe iu lut që të largohej pak nga bregu.

U ul dhe i mësonte turmat nga barka. Dhe, kur pushoi së foluri, i tha Simonit: «Shko në të thella, dhe hidhini rrjetat tuaja për të zënë peshk». Dhe Simoni, duke u përgjigjur, i tha: «Mjeshtër, u munduam gjithë natën dhe nuk zëmë

asgjë; por, mbi fjalën tënde, do ta hedh rrjetën». Dhe, si bënë kështu, zunë një sasi të madhe peshku dhe rrjeta e tyre po shqyhej. Atëherë u bënë shenjë shokëve të tyre, që ishin në barkën tjetër, që të vinin e t'i ndihmonin. Dhe ata erdhën dhe i mbushën të dyja barkat, aq sa gati po fundoseshin.

– Luka 5:1-7

Si shkencëtar shpirtëror, le të shohim nga afër historinë. Si u shfaqën ata peshq? A mund ta vesh re? Jezusi po ecën përgjatë bregut dhe gjen një varkë që dëshiron ta përdorë për t'i predikuar turmës. Ai e pyet Pjetrin, pronarin e anijes, nëse mund ta përdorë dhe Pjetri thotë: «Sigurisht». Në fund të fundit, ata kishin mbaruar punë me te⁴; ata kishin peshkuar gjithë natën dhe nuk kishin kapur asgjë. Pasi Jezusi përdor varkën, i thotë Pjetrit që të kthehet dhe të peshkojë në ujëra të thella sërish. Jam i sigurt se kjo kërkesë tërhoqi vëmendjen Pjetrin, sepse u përgjigj: “Jezus, kemi peshkuar gjithë natën dhe nuk kemi kapur asgjë”. Pjetri ishte një peshkatar profesionist dhe dinte të peshkonte. Bazuar në përvojën e tij, peshqit thjesht nuk ishin atje. Në natyroren, thjesht nuk kishte kuptim të ktheheshin sërish. Ata tashmë i kishin mbledhur pajisjet dhe kishin përfunduar pastrimin e rrjetave. Unë nuk besoj se Pjetri do ta kishte bërë këtë veç nëse sapo kishte dëgjuar një predikim një orë nga Jezusi që e kishte prekur si kurrë më parë.

Kështu që tha “Për shkak të asaj që ti thua unë do t'i hedh rrjetat sërish.” Pjetri u kthye dhe kapi aq shumë peshq sa që rrjetat e tij ishin gati të çaheshin dhe varka thuajse po mbytej. Me dëshpërim kërkoi ndihmën e bashkëpunëtorëve të tij, të cilët ishin ende në breg dhe ata erdhën menjëherë e rrjetat e tyre gjithashtu u mbushën aq shumë sa gati po çaheshin. Bibla regjistron reagimin e Pjetrit, ai u mahnit!

Si ndodhi kjo? A ka të dhëna? A mund ta dimë? E përmbledhur shkurt, është parimi i fuqisë së besnikërisë, për të cilin folëm më parë. Kur Pjetri e la Jezusin të përdorte varkën e peshkimit, varka dhe biznesi ndryshuan mbretëritë. Biznesi doli nga juridiksioni i sistemit të

mallkimit të tokës dhe ra nën juridiksionin e Mbretërisë së Zotit. Duke qenë nën juridiksionin e Mbretërisë së Zotit, Zoti kishte ligjshmërinë të shkarkonte një fjalë njohurie dhe t'i tregonte Jezusit vendndodhjen e saktë të peshkut; “Atje në ujëra të thella”.

Pra, le ta zbërthejmë këtë ngjarje. Jezusi e huazon varkën e peshkimit nga Pjetri, i cili sapo kishte dalë nga një natë e gjatë peshkimi pa asnjë rezultat. Në këtë shkëmbim, varkat vijnë nën juridiksionin e Mbretërisë së Zotit. Jezusi tani e di përmes Frymës së Shenjtë vendndodhjen e saktë të peshkut. Jezusi pastaj e drejton varkën e Pjetrit në vendin e saktë. Më pas varka e Pjetrit mbushet pothuajse plot me peshk. Varka e miqve të tij gjithashtu është pothuajse duke u mbytur për shkak të sasisë së madhe. Atëherë, si u zunë peshqit? Në terma të thjeshtë, përmes një fjale udhëzuese të drejtpërdrejtë nga qielli. Le ta pranojmë, çdokush mund të kapë peshk nëse e di saktësisht se ku ndodhet. Mendoni për atë që sapo thamë. Zoti di gjithçka; Ai mund t'ju ndihmojë dhe t'ju tregojë se çfarë të bëni.

Kur Drenda dhe unë u thyem dhe filluam të mësonim mbi Mbretërinë, Zoti më dha një ëndërr natën që të filloja një biznes që në të vërtetë nuk dija si ta filloja. Ky biznes po funksionon ende që prej 28 vitesh, duke prodhuar qindra mijëra dollarë të ardhura neto në vit. Gjatë këtyre 28 viteve më ka lejuar të mbjell miliona në shërbesë dhe të 4 ndihmoj njerëzit.

Si ndodhi? Dëgjova nga qielli dhe kështu mund të bëni edhe ju! Më lejoni t'ju jap një shembull.

Po zhvilloja një konferencë pesë-netëshe mbi Mbretërinë e Perëndisë disa vite më parë. Pas natës së dytë, një burrë me emrin Kris erdhi tek unë dhe më kërkoi të lutem për të. E pyeta për çfarë duhej të luteshim. Ai më tregoi historinë e tij. Ai kishte një biznes me një djalë, i cili kishte shpërdoruar para nga biznesi, duke e çuar drejt falimentimit. Ai ishte në martesën e tij të katërt, nuk po shkonte mirë dhe ishte vetëm 40 vjeç. Ai më tha se kishte qenë aq në depresion sa kishte marrë një pistoletë të mbushur, kishte ardhur rreth e rrotull për ca kohë dhe ishte

ndalur në një pikë karburanti të mbyllur me qëllimin për t'u vetëvrrarë.

Ishte ora 3:00 e mëngjesit kur, i ulur atje me pistoletën e mbushur, i ra zilja e celularit. E kishte njohur numrin menjëherë. Ishte ish partneri i tij. Ai sigurisht që nuk donte të fliste me të, kështu që nuk u përgjigj. Kumboi përsëri, përsëri dhe përsëri. Në fakt, i telefonoi 11 herë kur më në fund, Kris vendosi t'i përgjigjej. Fjalët e para nga goja e ish-partnerit të tij ishin, «Ku je, dhe çfarë po bën?» Kur Kris i tregoi, ish-partneri i tij tha: “Mos lëviz; Po vij tani!” Me sa duket, partneri i tij i vjetër sapo i kishte dhënë jetën Zotit dhe donte ta ndante këtë me Krisin. Çuditërisht, ai ndjeu një urgjencë për të kontaktuar Krisin në 3:00 të mëngjesit dhe kur Kris nuk u përgjigj, ai vazhdoi të përpiqej.

Kur partneri i Krisit u shfaq, e drejtoi Krisin te Zoti dhe jeta e Krisit u ndryshua rrënjësisht. Gjithçka filloi të bëhej më mirë. Ai gjeti një kishë të mirë, martesë e tij filloi të përmirësohej. Gjithçka po shkonte më mirë, përveç të ardhurave të tij. Kris nuk kishte një punë dhe për këtë më kërkoi të lutem. Përmes konferencës, unë mësova saktësisht atë që po ju tregoj në këtë libër, se si Mbretëria mund të bëjë gjëra të mahnitshme duke ia kaluar aftësive tona.

Ndërsa Kris mendonte se si Fryma e Shenjtë mund të na udhëheqë dhe të na ndihmojë me orientim dhe ide, edhe ai papritur pati një ide. Ai në të vërtetë nuk kishte shumë mundësi financiare.

Në fakt ai gatonte një tortë të shkëlqyer me krem djathi. Specialiteti i tij ishte një tortë me bazë të shëndetshme, që ai e dinte se ishte më e mira që kishte ngrënë ndonjëherë. Në fakt, Krisi ishte i njohur nga të gjithë miqtë e tij si djali që bënte tortën më të mirë me krem djathi. Ai kishte qenë shumë herë në dyqanin e ushqimeve bio dhe kishte provuar disa nga produktet e tyre të pjekura, por kishte vënë re se të gjitha kishin mungesa. Krisi nuk kishte shumë mundësi, por ndjeu se kjo ishte një mundësi për të, të shiste ëmbëlsira. Ai ishte i sigurt se nëse do të çonte njërin nga ëmbëlsirat e tij në atë dyqan dhe ata do ta provonin, ata do të dëshironin ta shisnin. Ai ishte i sigurt se do të shitej më shumë se produktet e tyre. Pra, kjo është pikërisht ajo që bëri. Ai

gatoi një kek me krem djathi dhe e çoi atë në dyqan pa paralajmërim. Sikur çdo gjë të ishte përgatitur me dorë, ndodhi që CEO i të gjithë zinxhirit të atyre dyqaneve vizitoi atë vend pikërisht kur u paraqit Krisi. Drejtori i Përgjithshëm ra dakord të shijonte kekun dhe t'i bënte të ditur mendimin e tij.

Atë natë, Krisi u kthye përsëri përpara takimit për të biseduar me mua. Ai më tregoi atë që kishte bërë dhe më kërkoi që të lutesha përsëri me të për kontratën me këtë dyqan. Epo, të nesërmen Krisi shkoi përsëri atje dhe ishte i ngazëllyer! Ai më tha që CEO donte që ai të përgatiste kekun e tij jo vetëm për dyqanin ku e kishte provuar vet, por për të gjitha dyqanet e të gjithë zinxhirit. Ai gjithashtu e pyeti se çfarë tjetër mund të përgatiste. Krisi ishte i tronditur! Çuditërisht, CEO erdhi natën e fundit të konferencës dhe doli përpara e i dha zemrën Zotit dhe u pagëzua me Frymën e Shenjtë. Mora një letër prej tij dy javë më vonë ku më thoshte se dëshironte të mbillte përsëri në Mbretërinë e Zotit. Ai po i jepte dhjetë përqind të aksioneve të tij të kompanisë për shërbesën tonë, *Faith Life Now*. E pabesueshme! Zoti mund të marrë një ide dhe të bëjë diçka të madhe nga asgjëja.

KAPITULLI 10

GRUMBULLONI PA U SHQETËSUAR!

A keni parë ndonjëherë një kalë në verë pas një vrapimi të gjatë? Ata janë të mbuluar në djesë; një lloj djerse e shkumëzuar. Kur i sheh në këtë gjendje mund të thuash se kanë punuar shumë fort. Gjithmonë më bëjnë këtë pyetje, “Geri, a po thua që unë nuk duhet të punoj?” Jo, nuk po them këtë dhe as Fjala e Zotit nuk thotë këtë. Por mënyra se si punon përbën një ndryshim të madh. Për shembull, historia që lexuam për Pjetrin dhe miqtë e tij, të cilët mbushën dy varka plot me peshq sa gati po mbyteshin. Ata kishin punuar gjithë natën për të kapur peshk, por pa sukses. Më pas sigurisht, Jezusi erdhi dhe u tregoi ku ishte peshku me një fjalë njohurie. Në këtë pikë, edhe ata punuan, por ishte një lloj krejt tjetër pune. Ata punuan ndërsa i tërhiqnin me siguri ata peshq. Por a po peshkonin?

E di që këtu po luaj me fjalët. Ne e përdorim termin peshkim për shumë gjëra. Një grua po peshkonte për një kompliment. Pra, a po peshkonte Pjetri? Kur shkova për gjueti, ju thashë se drerin e mora për rreth 40 minuta. Por a po gjuaja? Me fjalë të tjera, nëse e dini se ku ndodhen peshqit, a jeni duke peshkuar? Nëse e di që do e marr drerin, a quhet gjueti? Unë po e them këtë vetëm që të mund të kuptoni ndryshimin. Po, unë po punoj, por nuk po punoj gjithë natën duke mos kapur asgjë. Kryesisht, duke pasur atë që më duhet në jetë, unë jam në gjendje të punoj në Mbretërinë për biznesin e Atit dhe qëllimin tim.

Unë do ta quaj këtë grumbullim!

Kur Pjetri shkoi te Jezusi duke e pyetur se si të paguanin taksat e tyre te Mateu 17:27b, Jezusi tha:

“...shko në det, hidhe grepin dhe merr peshkun e parë që do vijë lart, hapja gojën dhe do të gjesh një staterë; merre dhe jepua atyre për ty dhe për mua.”

Vini re Jezusi nuk tha, “Mirë, Pjetër, ne kemi taksat për të paguar. Unë do t’ju tregoj se çfarë të bëni; shkoni në qytet për rreth tre muaj, gjeni një punë, fitoni para dhe pastaj kthehuni përsëri te skuadra pasi të keni bërë paratë për të paguar taksat tona.” Jo, Jezusi nuk e tha këtë. Pse? Sepse nëse do të kthehej përsëri në të menduarit e sistemit të mallkimit të tokës, Pjetrit do t’i duhej të linte detyrën e tij dhe të fillonte të vraponte pas parave. Në vend të kësaj, Jezusi na tregon se si funksionon Mbretëria dhe si duhet të funksionojmë ndërsa jemi këtu në mbretërinë e tokës. Përgjigjja që mori Pjetri është edhe përgjigjja për ju. Jezusi i tregoi Pjetrit thjesht se ku ishte furnizimi, mënyra që duhej të përdorte për ta korrur dhe saktësisht atë që duhej të kërkonte. Gjithçka që Pjetri duhej të bënte ishte të shkonte ta mblidhte.

Ndërsa shikojmë Jezusin me dishepujt e Tij, ata zakonisht habiteshin dhe tronditeshin kur shihnin që Mbretëria po vepronte. Kur Jezusi thau fikun me fjalët e Tij në kapitullin 11 të Markut, Bibla thotë se Pjetri u mahnit. Kur Llazari doli nga varri pasi kishte qenë i vdekur prej katër ditësh, ata u mrekulluan. Kur Pjetri, Jakobi dhe Gjoni kapën gjithë ata peshq, u mrekulluan. Unë dhe Drenda me kalimin e viteve, vazhdimisht jemi mahnitur, kemi mbetur me gojë hapur duke thënë, “A e pe atë?”, teksa ende mësojmë gjithnjë e më shumë rreth mënyrës se si funksionon Mbretëria. Teksa po flasim për grumbullimin me ndihmën e Frymës së Shenjtë, duhet t’ju çoj te Mateu, kapitulli 6. Bibla ime ka një nëntitull mbi këtë fragment, i cili thotë: “Mos u

shqetëso!” Ky kapitull më pëlqen.

“Askush nuk mund t’u shërbejë dy zotërinjve, sepse ose do të urrejë njërin dhe do ta dojë tjetrin, ose do t’i ngjitet njërit dhe do ta përçmojë tjetrin; nuk mund t’i shërbeni Perëndisë dhe mamonit.

Prandaj po ju them: mos u shqetësoni për jetën tuaj, për atë që do të hani dhe do të pini, as për trupin tuaj, për atë që do të vishni. A nuk është vallë jeta më shumë se ushqimi dhe trupi se veshja? Vini re zogjtë e qiellit: nuk mbjellin, nuk korrin dhe nuk mbledhin në hambare; dhe Ati juaj qiellor i ushqen. A nuk vleni ju shumë më tepër sesa ata? Dhe cili nga ju, me gjithë shqetësimin e tij, mund t’i shtojë shtatit të vet qoftë një kubit?

Pse shqetësoheni për veshjen tuaj? Vini re si rriten zambakët e fushës: nuk lodhen dhe nuk tjerren; dhe po ju them se as Salomoni, me gjithë laudinë e vet, nuk ishte veshur si një nga ata. Por nëse Perëndia e vesh kështu barin e fushës, që sot është dhe nesër hidhet në furrë, a nuk do t’ju veshë shumë më tepër ju, njerëz besimpakë? Mos u shqetësoni, pra, duke thënë:

“Çfarë do të hamë ose çfarë do të pimë, ose me çfarë do të vishemi?”. Sepse paganët i kërkojnë të gjitha këto; Ati juaj qiellor, pra, e di mirë se ju keni nevojë për këto të gjitha. Por para së gjithash kërkon mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto do t’ju shtohen. Mos u shqetësoni, pra, për të nesërmen, sepse e nesërmja do të shqetësohet vetë për vete. Secilës ditë i mjafton e keqja e vet».”

– Mateu 6:24-34

Jezusi thotë që ju nuk mund t’u shërbeni dy zotërinjve. Ju mund të mendoni se mundeni por nuk mundeni. Ju do të doni njërin dhe vetëm njërin. Unë mund t’ju them se cili është. Është ai që i besoni

për të përmbushur nevojat tuaja. Kur Zoti më foli në atë shtëpi të vjetër në fermë se unë nuk kam marrë kurrë kohë për të mësuar se si funksiononte Mbretëria e Tij, Ai po më thoshte se nuk kishte qenë në të vërtetë zotëria im. Ai nuk ishte ai të cilit i shërbeja dhe i besoja plotësisht. Oh, sigurisht, unë shkoja në kishë, isha bujar, e doja Zotin dhe e dija që po shkoja në qiell. Por kurrë nuk kisha marrë kohë për të mësuar sistemin e Zotit të financave dhe se si funksionon Mbretëria e Tij.

Sepse atje ku është thesari juaj, atje do të jetë edhe zemra juaj.

– Luka 12:34

Lexoni ngadalë, “*Sepse atje ku është thesari juaj, atje do të jetë edhe zemra juaj*”. Shumëkush pëlqen ta kthejë dhe të thotë: «Atje ku është zemra juaj, aty është thesari juaj». Por kjo nuk është ajo që po thuhet dhe nuk është mënyra se si funksionon. Njerëzit mendojnë se kjo do të thotë se ata mund ta duan Zotin të dielën në mëngjes dhe aty gjendet thesari i tyre. GABIM! Sistemi që ju i besoni për të përmbushur nevojën tuaj është vendi ku gjendet thesari juaj.

Jezusi thotë se i kemi të gjitha mbrapsh!

Zoti dëshiron të jetë vet i pari në jetën tonë, jo paraja. Nëse paratë janë thesari ynë, ato do të jenë të parat, duke kërkuar kohën, përparësitë dhe dashurinë tonë. Kjo është arsyeja pse Pjetri nuk duhej ta linte detyrën e tij e të fituarit para kur erdhi fatura e taksave. Kjo është arsyeja pse Zoti duhet të na mësojë të grumbullojmë dhe të mos stërmundohemi. Jezusi duhet të na mësojë mënyrën e Mbretërisë, si t'i besojmë Zotit për sigurimin tonë, duke çliruar kështu zemrat që ta duam Perëndinë me gjithë zemrat tona! Jezusi tha: “A nuk është jeta më shumë se ushqimi dhe trupi më shumë se veshja?” Ai po thoshte se jeta nuk është për të zotëruar gjëra.

Qëllimi i jetës është që ato gjëra t'ju shërbejnë juve dhe qëllimit tuaj në tokë. Megjithatë, çfarë shohim? Shumica e njerëzve po vrapojnë pa

pushim duke u shërbyer atyre gjërave. Njerëzit vrapojnë për të paguar hipotekën, për të paguar këstin e makinës, për të paguar faturat. Jezusi thotë se kjo nuk është jetë! Tani, mos u tërhiq pas duke thënë, “E sheh, Jezusi Vetë thotë se të kesh gjëra është e keqe”. Jo, nuk e thotë.

Në vargun 33 Ai tha që nëse kërkonti së pari Mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e Tij, të gjitha këto gjëra do t’i shtohen jetës tuaj. Çështja nuk është ku gjejmë problemin; por te zemra. Nëse Zoti nuk do donte që të kemi, Jezusi do ta kishte thënë.

Në vend të kësaj, Ai tha se të gjitha këto gjëra që bota ndjek pas do të shtohen në jetën tonë nëse jetojmë sipas mënyrës së Perëndisë.

Me fjalë të tjera, jeta nuk vlen vetëm për gjërat, por fatkeqësisht shumica e njerëzve veprojnë ashtu. Ata nuk kanë zgjidhje; ata janë skllevër. Është e pamundur t’i

shërbesh dy zotërinjve dhe t’i shërbesh gjërave nuk është jetë. Jezusi vazhdon dhe shpjegon se ekziston një sistem tjetër, një vend i paqes financiare dhe dispozitash që ju jep liri të jetoni. Quhet Mbretëri.

Në mësimet e Tij këtu te Mateu 6, Jezusi na tregon me dy shembuj se si duket Mbretëria. Ai thotë, *“Vini re zogjtë e qiellit: nuk mbjellin, nuk korrin dhe nuk mbledhin në hambare; dhe Ati juaj qiellor i ushqen. A nuk vleni ju shumë më tepër sesa ata?”* (v. 26).

Zogjtë nuk mbledhin në hambare!

Ata nuk marrin përsipër të sigurojnë nevojat e tyre të përditshme.

Jo, Ati i ushqen ata. Ata thjesht duhet të mbledhin atë që u nevojitet çdo ditë. E shikon? Ata nuk djersijnë me mund të dhimbshëm për jetën e tyre. Ata mbledhin!

**NËSE PARATË JANË
THESARI YNË, ATO DO
TË JENË TË PARAT,
DUKE KËRKUAR KOHËN,
PËRPARËSITË DHE
DASHURINË TONË.**

Lulet nuk lodhen dhe nuk tjerrin!

“Pse shqetësoheni për veshjen tuaj? Vini re si rriten zambakët e fushës: nuk lodhen dhe nuk tjerrin.”(v.28).

Lulet nuk vishen vetë me mundim dhe djersë. Jo, Ati i vesh ato. Jezusi vazhdon dhe na tregon juve dhe mua përgjigjen. Ekziston edhe një mënyrë tjetër për të jetuar, mënyra e Mbretërisë! Jezusi thotë, “*Por para së gjithash kërkonti mbretërinë e Perëndisë dhe drejtësinë e tij dhe të gjitha këto do t’ju shtohen.*”(v.33). Çfarë do të thotë “kërkonti Mbretërinë e Perëndisë” ? Do të thotë të kuptosh se si funksionon! Studioni ligjet që e qeverisin atë. Mësoni se si funksionon sistemi i Perëndisë!

Nëse do të të zbrisja nga aeroplani në një vend ku nuk ke qenë kurrë më parë, detyra jote e parë do të ishte të mësoje se si funksionon ajo mbretëri: si ushqehen, si blejnë e shesin dhe ligjet që rregullojnë vendin. E njëjta gjë është e vërtetë edhe në Mbretërinë e Zotit. Ju duhet të mësoni se si funksionon Mbretëria e Zotit që të jeni në gjendje të shijoni përfitimet e të qenit pjesë e saj. Unë e di nga përvoja ime se sa kam humbur kur nuk dija si funksiononte Mbretëria. Përgjigja për ju është e thjeshtë. Ju duhet një revolucion financiar. Në një revolucion, njerëzit rebelohen kundër qeverisë së tyre dhe vendosin një qeveri të re. Ju duhet të bëni të njëjtën gjë. Ju duhet ta hidhni poshtë atë qeveri të vjetër të sistemit të mallkimit të tokës me gjithë mungesën dhe dëshpërimin e tij dhe të shijoni një mënyrë të re jetese - të jetoni në Mbretërinë e Zotit, me ligje të reja, pa mangësira dhe me gëzim të madh!

KAPITULLI 11

FLUTURIMI ËSHTË MË I LEHTË SE ECJA!

Nëse do të ktheheshit pas në histori dhe do të donit të shkonit nga New York City në San Francisco, do të duhej të shkonit me anije. Para se të hapej Kanali i Panamasë udhëtimi përreth Amerikës së Jugut mund të zgjaste një vit. Më vonë, kur u vendos Ura e Oregonit, mund ta bënit për katër muaj. Sot, mund të arrini atje për katër orë. Si? Duke përdorur një ligj të ri, ligjin e ngritjes. Ky ligj i ngritjes ka qenë gjithmonë këtu - zogjtë e përdorën çdo ditë - por njerëzit nuk e kuptonin. Ashtu si për ligjet natyrore të fluturimit, shumica e të krishterëve thjesht nuk janë të vetëdijshëm për këto ligje të Mbretërisë, edhe pse kanë lexuar rreth tyre në pjesën më të madhe të jetës. Mbretëria e Zotit është këtu, ndohet në ju dhe ju keni të drejtë ligjore të gëzoni përfitimet e saj. Në fushën natyrore, ligjet e fluturimit nuk e anulojnë ligjin e gravitetit, ata e zëvendësojnë atë. Me fjalë të tjera, për sa kohë që jeni duke operuar në përputhje me ligjet që rregullojnë fluturimin, ju jeni duke fluturuar, edhe pse graviteti është ende në fuqi. Do të duhej të bini dakord se është shumë më lehtë të fluturosh katër orë sesa të marrësh një varkë për një vit! Epo, atëherë filloni t' i bëni gjërat në mënyrën e shpejtë dhe lini mënjane metodat tuaja të vjetra e të ngadalta.

A keni parë ndonjëherë një flutur monark? Këtu në Ohajo, gjatë vjeshtës, do të shihni qindra flutura monark duke fluturuar drejt jugut për dimrin. Ato fluturojnë drejt Meksikës, një udhëtim prej 2

000 miljesh.

Por ja cili është thelbi. Ato nuk kanë qenë kurrë më parë atje! Nga e dinë se si të shkojnë dhe kur të shkojnë? Nëse Perëndia ka bërë një rrugë për fluturën Monark, Ai ka një rrugë edhe për ty. Si formohet flutura?

Termi quhet metamorfozë. Rrënja është fjala “morf,” që do të thotë ndryshim. Shumica e njerëzve e dinë që një flutur monark nuk është flutur që në fillim. Përkundrazi ato lindin si larva. Në fazën e të qenit larvë, ato jetojnë në një bimë qumështore dhe rriten në madhësi derisa, dukshëm, janë gati për një ndryshim të madh. Pasi arrijnë një madhësi të caktuar, ndërtojnë një fshikëz, një lloj guacke në të cilën larva mbyllet për 7 deri në 15 ditë. Më pas, flutura del nga fshikëza duke qenë dhe duke vepruar shumë ndryshe nga faza e larvës. Jeton dhe mbijeton në një nivel krejtësisht të ri ekzistence. Fluturon! Në vend që të jetë e kufizuar te bima qumështore, ajo tani mund të fluturojë kudo që dëshiron. Është e bukur dhe ka një hir dhe bukuri të pakonkurueshme në natyrë.

Por veprimi më i mahnitshëm që të tërheq është aftësia e saj për të fluturuar larg telasheve. E shikoni, flutura monark nuk mund të jetojë në dimrin e acartë që është klima normale në veri. Do të ngordhte. Por Zoti krijoi një mënyrë që kjo krijesë të fluturojë larg telasheve, duke fluturuar 2 000 milje në një vend ku nuk ka qenë kurrë më parë. Nga e di ajo rrugën deri atje? Si e bën atë? Metamorfoza. Dhe Bibla thotë që përmes të njëjtit proces mund të fluturoni mbi problemet tuaja, madje edhe në situata që nuk e keni idenë se si t'i trajtoni, ashtu si flutura Monark.

Stivi, një miku im, po shkonte në shtëpi me makinën e tij një natë dhe goditi një dre. E shkatërroi makinën. Fatkeqësisht, furgonit të familjes, i vetmi mjet që kishin, iu dëmtua rëndë motorri. Kompania e sigurimit mund t'i siguronte Stivit vetëm një makinë me qera për dy javë për humbjen e makinës, por nuk mund të dëmshpërblenin më shumë se kaq. Stivi dhe Karen nuk dinin çfarë të bënin. Biznesi i Stivit

kërkoj që të kishte një makinë pasi ishte në departamentin e shitjeve dhe drejtonte kërkesat e shitjeve çdo natë.

Ata kishin dëgjuar rreth mësimëve të Mbretërisë aq kohë sa ta dinin se Zoti ishte zgjidhja e tyre. Në atë kohë, ata nuk kishin para shtesë për të zëvendësuar automjetet. Kështu që e dinin se Zoti dhe Mbretëria ishin shpresa e vetme. Dy javët e përdorimit të makinës me qira falas po mbylleshin shpejt dhe ende nuk kishte përgjigje. Çuditërisht, një natë para se Stivi të merrte përsëri makinën me qira, mori një telefonatë nga një burrë që i tha se kishte një makinë që donte ta jepte dhe meqë e dinte se Stivi vinte në kishën time, ai i telefonoi Stivit për ta pyetur nëse njihnte ndonjë familje në kishën tonë që kishte nevojë për makinë. Stivi menjëherë i shpjegoi situatën e tij dhe tha se do të ishte mirënjohës ta merrte makinën për vete dhe familjen e tij. Kjo ishte e mrekullueshme, por Stivi kishte gjashtë fëmijë dhe vetura e vogël nuk mjaftonte për ta. Sidoqoftë, shfaqja e kësaj makine i kishte inkurajuar ata.

Të djelën pasardhëse, ata të dy dolën para kishës dhe më kërkuan të lutesha me ta për makinën e tyre të ardhshme. Karen tha, “Pastor, ne besojmë se kemi marrë një furgon Honda Odyssey me besim dhe dëshirojmë që ju të bini dakord me ne teksa mbjellim farën për këtë.” Unë thashë, “Po sigurisht.” Kështu që u lutëm. Në të vërtetë nuk mund ta mbaj mend se sa javë kaluan, jo aq shumë, ndoshta tre ose katër, deri në ditën kur u ndalëm pranë shtëpisë së tyre. Kur u ndalëm pranë, u futëm në kuzhinën e tyre dhe atje, në derën e frigoriferit, ishte një foto e një Honda Odyssey. Karen tha që çdo ditë kur hapte atë frigorifer, ajo vinte dorën në atë fotografi dhe falënderonte Zotin për atë furgon.

Rreth një javë më vonë, sekretarja ime më telefonoi dhe më tha: “Pastor, morëm një telefonatë interesante sot.” Një burrë donte t’i jepte një furgon kishës. Tani, në atë kohë askush nuk e dinte se si Stivi dhe Karen kishin deklaruar me besim marrjen e një furgoni të ri sipas llojit që dëshironin.

Kështu që i thashë sekretares time, “Çfarë lloj furgoni është?” Ajo tha, “është një Honda Odyssey.” “Në çfarë gjendje është?” Ajo tregoi se

burri kishte thënë se ishte në gjendje perfekte, pa asnjë gërvishtje në të dhe kishte vetëm 70 000 milje. Unë i thashë se e dija ku do të shkonte ai furgon. I tregova Drendës për këtë dhe i kërkova të telefononte Karen. Kur Drenda telefoni, e pyeti Karen si po shkonin gjërat dhe a kishin parë ndonjë lëvizje në lidhje me nevojën e tyre për automjet. Fjalët e para të Karen ishin: “Epo, jam një ditë më afër!” Drenda tha: “Epo, ti je më afër nga sa mendon. Ejani ta merrni”.

Mua më pëlqejnë histori të tilla, apo jo? Historia vazhdon ndërsa Stivi dhe Karen fituan më shumë siguri në Mbretëri.

Rreth asaj kohe, Steve dhe Karen donin një shtëpi. Ata kishin jetuar me qira për disa vite dhe menduan se ishte koha të kishin shtëpinë e tyre; por nuk kishin para për të blerë një të tillë.

Ata kishin shkuar në banka të panumërta për të pyetur në lidhje me blerjen e tokës dhe të gjithë u kërkuan të njëjtën gjë, të kishin

50 për qind të shumës. Në këtë pikë në jetën e familjes së tyre të re, ata thjesht nuk kishin aq para në dorë sa për t'u kualifikuar. Karen u dekurajua dhe më pyeti për këtë. Ne ramë dakord që Perëndia do të hapte një rrugë. Kështu që ata filluan të shikonin prona dhe shtëpi të ndryshme.

Një nga pronat që panë tërhoqi vëmendjen e tyre. Ishte në zonën që donin të ndërtonin dhe ishte vetëm 55 000 dollarë për 55

**SHUMË HERË, E KUFIZOJMË
VETEN DUKE E PESHUAR TË
ARDHMEN TONË ME ATË QË
MENDOJMË SE ËSHTË E MUNDUR.
POR ME ZOTIN, TË GJITHA
GJËRAT JANË TË MUNDSHME
NËSE THJESHT LEJOJMË QË
FJALA E ZOTIT TË NDRYSHOJË TË
MENDUARIT TONË.**

hektarë. Përsëri, ata nuk kishin para për parapagim.

Unë kisha dëgjuar për një bankë të vogël, që nuk ishte në atë zonë,

por dy orë larg, e cila do ta pranonte kapitalin si një pjesë të parapagimit për tokën. Kjo ishte shumë e pazakontë. U tregova atyre për këtë gjë, dhe ata caktuan një orar për të biseduar me bankën. Toka u vlerësua rreth 100 000 dollarë dhe banka u tha se ata nuk kishin nevojë të parapaguanin asgjë. Kështu që ata e blenë tokën pa asnjë parapagim dhe ndërtuan një shtëpi të këndshme në ata hektarë të bukur, pa asnjë pagesë shtesë. Stivi dhe Karen vazhduan të begatonin, njësoj si unë dhe Drenda, duke vepruar sipas mënyrës së Mbretërisë.

Unë kam shumë histori të tilla në të gjithë kishën time dhe pres që edhe ju të keni plot histori të tilla në jetën tuaj. Zoti mund të bëjë gjëra të mahnitshme dhe nganjëherë të çuditshme për të përmbushur nevojat tona. Shumë herë, ne e kufizojmë veten duke e peshuar të ardhmen tonë me atë që mendojmë se është e mundur. Por me Zotin, të gjitha gjërat janë të mundshme nëse thjesht lejojmë që Fjala e Perëndisë të ndryshojë mendimet tona.

Dhe mos u konformoni me këtë botë, por transformohuni me anë të ripërtëritjes së mendjes suaj, që të provoni cili është i miri, i pëlqyeri dhe i përsosuri vullnet i Perëndisë.

– Romakëve 12:2

Si besimtarë, ne nuk duhet konformohemi me modelin e kësaj bote. Pali i referohet sistemit të mallkimit të tokës dhe mënyrës së tij të jetës dhe, posaçërisht, mënyrës së të menduarit. A keni qepur ndonjëherë fustan apo a keni ndërtuar diçka duke u nisur nga një plan? Nëse e keni provuar dhe nuk ju ka pëlqyer si ka dalë, çfarë do të ndodhte nëse do ta provonit përsëri sipas të njëjtit model? Do të merrni të njëjtin rezultat. Kështu që Pali po thotë se ne duhet të transformohemi duke përtërirë mendjet tona; duhet të ndryshojmë modelin sipas të cilit jetojmë. Duhet të mendojmë ndryshe nga sa mendon bota.

Ajo fjalë «transformohuni» është e njëjta fjalë për të cilën sapo folëm,

«metamorfozë», dhe do të thotë ndryshim. Na duhet një metamorfozë! Ne kemi nevojë të mendojmë si Zoti. Duhet të mendojmë si në Mbretëri. Në vend që të mendojmë nga perspektiva e shëmtuar, të bllokuar dhe të dënuar të vdesim si larva dimri, ne duhet t'i besojmë Zotit për një mënyrë krejt të re jetese. Atëherë dhe vetëm atëherë mund të fluturojmë mbi problemet tona dhe të pajisemi për të ditur se cili është vullneti i mirë dhe i përsosur i Zotit në çdo situatë. Nëse nuk e përqafojmë këtë ndryshim të të menduarit, mendjet tona të vjetra vazhdimisht do të thonë: «Jo, jo, nuk mund ta bëj atë. JO, nuk e kuptoj se si mund të ndodhë kjo».

Kush do ta kishte menduar ndonjëherë se larva e shëmtuar do të ishte në gjendje të fluturonte me kaq hir dhe përsosje? Duke parë larvën dhe duke menduar për 2 000 milje udhëtim që duhet të bëjë, thjesht do të tundnit kokën dhe do të thonit: «E PAMUNDUR!» Por në Mbretërinë e Zotit, të gjitha gjërat janë të mundshme. Më shikoni mua. Kur fillon programi im televiziv, ai fillon duke më referuar mua si një ekspert financiar. Ndonjëherë kujtoj përsëri ditët e mia si larvë dhe them: “Kjo është e mahnitshme!”

Duke folur për fluturimin, sapo unë dhe Drenda filluam të mësonim se si funksiononte Mbretëria, vendosa që doja një aeroplan. Unë kam qenë pilot që në moshën 19-vjeçare dhe gjithmonë kisha marrë me qira aeroplanë, por asnjëherë nuk kisha patur në pronësi një të tillë. Sigurisht ju e dini përse; unë nuk kisha para për asgjë. Kështu që një ditë e vendosa këtë çmenduri; një aeroplan nuk është i vështirë për Mbretërinë e Zotit. Pse po e kufizoj Mbretërinë sipas asaj që mendoja se ishte e mundur për mua? Kështu që plotësova një çek, në pjesën e përshkrimit shkrova, “Për avionin tim.” (dhe rendita detajet). Vura duart mbi të dhe e dërgova me postë, duke besuar se e kisha marrë aeroplanin kur u luta, sipas Markut 11:24.

“Prandaj po ju them: Të gjitha ato që ju kërkon duke u lutur, besoni se do t'i merrni dhe ju do t'i merrni.””

Gati një muaj më pas shkova te një mjek për një ekzaminim rutinë. U habita kur, papritur, mjeku tha: “A njihni dikë që dëshiron të blejë një aeroplan?” Mendova se ishte e çuditshme. “Çfarë lloj aeroplani?” e pyes. Unë u habita dhe u ngazëlleva pasi ishte saktësisht aeroplani për të cilin kisha besuar kur u luta. Kështu që e pyeta se ku mund ta shihja dhe ai më tha se ndodhej në aeroportin pranë shtëpisë sime. Më lejoni të shpjegohem. Shtëpia ime ndodhet në njërin skaj të aeroportit lokal. Çdo aeroplan që zbarkon duhet të fluturojë direkt mbi shtëpinë time. Fakti që shikoja avionë që vinin dhe iknin gjithë ditën dhe fakti që pista ishte vetëm një milje larg derës sime të përparme do të thoshte që unë duhej ta kisha një aeroplan!

Kështu që thirra një mik që të vinte me mua për ta parë këtë aeroplan. Ai ka fluturuar gjatë gjithë jetës së tij dhe gjithashtu ishte instruktor fluturimi. Ndërsa shikonim aeroplanin, e dija që ishte i imi; ishte i përkryer! Ishte pikërisht ai që doja. Unë kisha vetëm një problem, të njëjtin problem me të cilin isha ballafaquar prej vitesh kur bëhej fjalë për të patur një aeroplan - nuk kisha para. E keni patur ndonjëherë këtë problem? Por kësaj here nuk do të tërhiqesha nga frika. E dija që ky ishte aeroplani im. Thjesht nuk e dija ende se si Zoti do t' i sillte paratë.

Disa muaj më parë, unë dhe Drenda po kërkonim hapësirë për zyrat për kompaninë tonë. Ne e dinim se ku dëshironim të ndodhej biznesi, por nuk kishte asgjë për shitje në atë zonë; kështu që filluam të shikojmë disa zona të tjera. Gjetëm disa ndërtesa që për pak i blemë, por ndiejnim një kontroll në frymën tonë për të mos marrë asnjërën prej tyre. Ne vetëm vazhdonim të ktheheshim në zonën ku e dinim se do të ishte zyra, me shpresën se do të gjenim hapësirën e duhur. Ndërsa ishim duke u lutur për këtë vendim, një ditë babai im më thirri dhe më tha këto fjalë:

“Unë e di, ju do të thoni se ky është Zoti, por unë dhe nëna juaj kemi biseduar dhe duam t'ju japim ndërtesën tonë për zyrë.” Ndërtesa që ata zotëronin ishte pikërisht aty ku shpresoja të gjeja hapësirë për zhvendosjen time. U shokova!

Për të kuptuar atë që sapo ndodhi, ju duhet të dini se babai im nuk ishte besimtar në atë kohë. Ai tregohej shumë cinik sa herë përmendej Perëndia. Në fakt, bëhej aq keq sa e kisha të pamundur të flisja me të për Perëndinë. Madje lutesha që Perëndia të dërgonte dikë tjetër në shtegun e tij për t'i predikuar Krishtin. Unë e dija që nuk mund ta arrija; ai nuk më dëgjonte. Por babai im u shpëtua disa vite më vonë, kur ishte 80 vjeç. Mrekullisht, ai u shpëtua duke parë programin

**JETA IME, E CILA ISHTE
KUFIZUAR NË MBIJETESË
DHE FRIKË, TANI ISHTE
TRANSFORMUAR NGA
MBRETËRIA E PERËNDISË.
DUKE NDJEKUR LIGJET E TIJ,
UNË ISHA NË GJENDJE TË GJEJA
NJË JETË ME MUNDËSI TË
PAKUFIZUARA**

tonë në TV, që shpjegonte të gjitha gjërat e mahnitshme që Perëndia po bënte. Ai kaloi tre vitet e fundit të jetës së tij si një person i ndryshuar dhe shkante në kishë çdo fundjavë.

Një ditë, kur shërbesa sapo kishte përfunduar, dola në korridor. Pashë babanë tim duke folur me dikë që e njihje prej vitesh, një anëtar i kishës sime. Ndërsa po ecja drejt tyre, dëgjova këtë burrë që pyeste babanë tim se përse kishte filluar të vinte në kishë. Babai

im u përgjigj se ai kishte parë shumë gjëra që nuk mund t'i shpjegonte. Falënderoni Zotin! Kështu supozohet të jetë.

Por ne duhet t'i kthehemi asaj thirrjeje telefonike në lidhje me atë ndërtesë, para se babai im të shpëtohej. Unë dhe Drenda u shokuam që ai na e dha ndërtesën. E dinim që ishte Zoti, natyrisht; dhe mund t'i kishim thënë babait kur ai na telefonoi: «Po baba, ke të drejtë; ky është Zoti!»

Ndërtesa kishte nevojë për disa punime për ta sjellë atë sipas kodit tregtar, në mënyrë që të funksiononte për nevojat e zyrave tona. Ishte dhjetor kur babai im më dha ndërtesën, dhe unë prita deri në pranverë që të filloja rindërtimin. Ndërtesa ishte mbyllur gjatë dimrit, por askush nuk e përdorte atë, dhe babai im tha se e kishte mbyllur ujin.

Kështu qëndruan gjërat gjatë muajve të dimrit deri rreth një javë pasi shkova të shikoja aeroplanin. Vëllai im telefonoi dhe më tha se do ishte mirë të kaloja nga ndërtesa ime, sepse po dilte ujë në atë rrugë. Moti ishte ngrohur dhe me sa duket babai im kishte gabuar; uji nuk ishte fikur gjatë dimrit. Unë shkova me makinë drejt ndërtesës dhe një banjo e sipërme kishte qënë duke punuar për ditë ose edhe javë me radhë. I gjithë muri i katit të poshtëm kishte rënë. Unë e di që në sipërfaqe kjo tingëllon si një histori e keqe, por ajo që ju dhe vëllai im nuk dini, është se unë tashmë kisha nënshkruar një kontratë për të hequr të gjithë suvanë e të gjithë ndërtesës, e gjithë suvaja e jashtme u hoq dhe u bë një ridizenjim i plotë i ndërtesës që do të fillonte për disa javë. Pra, ky dëmtim i ujit nuk ishte aspak problem pasi gjithçka e dëmtuar duhej të hiqej gjithsesi. Por lexo këtë - kompania ime e sigurimeve më shkroi një çek për dëmin, i cili mjaftonte për të blerë aeroplanin!

Sapo mora aeroplanin dhe ndërtesën e zyrës, të gjitha pa borxhe. Po, funksionoi! Tani kur fluturoj me atë aeroplan lart mbi tokën bujqësore, më kujtohet se fluturimi me atë aeroplan është si Mbretëria e Zotit. Funksionimi dhe ligjet e saj na lejojnë të jetojmë jetën në një dimension tjetër. Ashtu si larva dhe flutura, ajo larvë kurrë nuk do të ishte në gjendje t'i drejtonte këmbët aq shpejt sa të shkonte në Meksikë. Jeta ime, e cila ishte e kufizuar në mbijetesë dhe frikë, tani ishte transformuar nga Mbretëria e Zotit. Duke përdorur ligjet e saj, unë isha në gjendje të gjeja një jetë me mundësi të pakufishme.

Ndërsa e mbyll këtë libër, dëshiroj t'ju lë me një varg. Jam i sigurt që ju e keni dëgjuar këtë varg gjithë jetën tuaj. Por mendoj se tani ai do të ketë një kuptim plotësisht të ri për ju.

Ejani tek unë, o të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju çlodh. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe do të gjeni çlodhje për shpirtrat tuaj. Sepse zgjedha ime është e butë dhe barra ime është e lehtë!.

– Mateu 11:28-30

Jezusi erdhi të marrë zgjedhën tonë, mundin e dhimbshëm dhe djersën e sistemit të mallkimit të tokës. Tani duhet të marrim zgjedhën e Tij (ka mbaruar) dhe të gjejmë prehje (dita e shtatë, shabati i vërtetë) për shpirtrat tanë.

Ju mund të përjetoni gjëra të mahnitshme në jetën tuaj ndërsa bëni thjesht atë që bëri Potifari, të veproni sipas mënyrës së jetës së Mbretërisë. Merrni një vendim sot për ta vendosur veten në përputhje me ligjet e Mbretërisë së Zotit dhe filloni të shijoni fuqinë e besnikërisë. Filloni revolucionin tuaj financiar sot, mësoni mënyrën e vjetër të të jetuarit, qeverisjen e vjetër, sistemin e mallkimit tokësor të varfërisë, sëmundjes dhe mungesës së shpresës. Lini mënyrat tuaja të vjetra të larvave dhe filloni të fluturoni duke përdorur ligjet e Mbretërisë, të cilat Jezusi ju dha liri t'i përdorni. Ju jeni një qytetar i asaj Mbretërie.

Ju keni të drejta ligjore!

Nëse ky libër ju duket interesant dhe jeni të vendosur të bëheni student i Mbretërisë, më lejoni t'ju drejtoj në *GaryKeesee.com*. Aty do të gjeni një bibliotekë informacioni që do t'ju ndihmojë dhe këshillojë mbi Mbretërinë. Unë gjithashtu do t'ju inkurajoj të bëheni një Partner i Revolucionit të Ekipit ku do të keni akses në evente të veçanta dhe seanca trajnimi.

Drenda dhe unë jemi të përkushtuar të ndihmojmë individët dhe familjet se si të fitojnë në jetë. Kjo është arsyeja pse Drenda prodhon transmetimin e saj televiziv, të quajtur *Drenda*. Është një program që synon jetën familjare dhe inkurajimin e grave të të gjitha moshave. Ju lutemi vizitoni *Drenda.com* për më shumë informacion.

Së fundmi, Drenda dhe unë do të donim të konsideronit mbështetjen e kishave dhe pastorëve në të gjithë botën. Projekti ynë i ungjillizimit H-3 është një zgjatim i dëshirës tonë për t'i ndihmuar njerëzit praktikisht në jetën e tyre. H-3 siguron dhjetëra mijëra materiale mësimore për pastorët në të gjithë botën çdo vit. Ne gjithashtu ndihmojmë të ushqejmë të uriturit, mbështesim shërbesat me qëllim ndalimin e trafikimit në shumë vende, mbështesim jetimoret, mbështesim financiarisht pastorët në shumë vende dhe gjithashtu mirëmbajmë një shtëpi për gra këtu në Ohajo. Qëllimi ynë është të ndihmojmë njerëzit në të gjithë tokën, që të mësojnë mbi Mbretërinë e Perëndisë dhe të mësojnë mbi lirinë dhe përmbushjen që Perëndia dëshiron që ne të gjithë të kemi.

Faleminderit shumë që më lejuat të ndaj historinë tonë të mrekullueshme me ju. Tani, shkoni dhe krijoni një histori të mahnitshme për veten tuaj me Mbretërinë e Perëndisë.



REVOLUCIONI YT FINANCIAR

Fuqia e Besnikerise

Lexoni këtë libër nëse...

JENI TË LODHUR NGA SITUATA JUAJ FINANCIARE

DËSHIRONI TË LIROHENI NGA BORXHET

NUK E DINI SE KU TË FILLONI

JENI TË PASHPRESË

Gary Keesee i ka përjetuar vetë këto situata. Për nëntë vite të gjata, jeta e tij ka kaluar një trazirë intensive emocionale për shkak të situatës së tmerrshme financiare. Telefonata nga kreditorët, nga zyra e taksave, paragjykimet dhe turpi ishin mënyra e jetesës për të. Por e gjitha ndryshoi një ditë kur Perëndia i foli Garyt për financat e tij dhe i dha një sekret që ndryshoi në mënyrë radikale jetën e tij. Ai u lirua nga borxhet, filloi kompani shumë milionë dollarëshe dhe tani ndan këto çelësa që ndryshuan jetën e tij përmes programit televiziv, *Fixing the Money Thing* (Të rregullosh çështjen e parave) që transmetohet çdo ditë kudo në botë. Gary ua ka mësuar këto koncepte qindra mijëra njerëzve nëpër botë në konferenca dhe në shërbesa personale. Ai bie dakord që ka shumë parime që janë pjesë e një jete të suksesshme. Por nëse ai do të ndante vetëm njërin prej tyre do të ishte ky libër. Gary ju fton të bashkoheni me revolucionin dhe të ndryshoni rrënjësisht financat tuaja përmes *Fuqisë së Besnikërisë*.



Gary Keesee është një autor, folës, biznesmen, ekspert financiar dhe pastor që ka një pasion për t'i ndihmuar njerëzit që të fitojnë në jetë, veçanërisht në fushën e besimit, familjes dhe financave. Gary dhe gruaja e tij Drenda kanë krijuar disa biznese të suksesshme dhe janë themeluesit e *Faith Life Now*, që prodhon dy programe televizive - *Fixing the Money Thing* dhe *Drenda*, si dhe konferenca mbarëbotërore dhe burime praktike. Çifti Keesee janë gjithashtu pastorët e kishës 'Faith Life' afër Kolumbus në Ohajo.

P. O. Box 779, New ALBANY, OH 43054
www.garykeesee.com